

**IDEATORI: ZBULIMI I TË
VËRTETËS SË NËNTOKËS
SHTETËRORE BRITANIKE**

ADNAN HARUN JAHJA

Edicioni i parë i botuar në gjuhën angleze, Maj 2017

Botuar nga:

SHTËPIA BOTUESE ARAŞTIRMA

Kayışdağı Mah. Değirmen Sok. Nr: 3

Atasehir - Stamboll / Turqi

Tel: +90.216.6600059

Printuar nga: Doğa Basım

Shtypshkronja. Tic. Ltd. Şti.

İkitelli Org. Sanayi Bölgesi, Turgut Özal Cad.

Çelik Yenil Endüstri Merkezi Nr: 117/ 2A-2B

İkitelli - Stamboll / Tel: +90.212.4070900

Të gjitha përkthimet nga Kurani janë nga:

The Noble Qur'an: a New Rendering of its Meaning in English

nga Hajj Abdalhaqq dhe Aisha Bewley, botuar nga Bookwork,

Norwich, UK. 1420 CE/1999 AH.

Shkurtesa dhe akronime:

(*p.q.m.t*): Paqja qoftë mbi të (në referencë të profetëve)

britishdeepstate.com

Përmbajtja

Hyrje: Njohja me 'Ideatori'	14
Pjesa e parë: Fuqia e fshehtë e cila manipulon botën:	
Nëntoka Shtetërore Britanike	18
Çfarë lloji i fuqisë së fshehtë?.....	20
Ngritja e strukturës së thellë mafioze.....	24
Plani darvinist i Nëntokës Shtetërore Britanike.....	32
"Interesi i Britanisë"	44
Themelet të cilat formësojnë interesin britanik	52
Kompania britanike e Indisë Lindore	53
Shoqëria mbretërore	67
Tryeza e rrumbullakët	72
Komiteti i 300-ve	83
A kanë njohuri Sh.B.A-të për Nëntokën Shtetërore Britanike?.....	95
Klubi i Romës	104
Organizata të tjera sekrete të kontrolluara nga Nëntoka Shtetërore Britanike	108
Këshilli i kurorës së 13-të	108
Instituti Tavistock	110
Kafka dhe kockat	112
Drejt rendit të ri botëror: Një shtet i vetëm në botë	116
E gjithë fuqia i përket Zotit.....	118
Pjesa e dytë: Lufta e parë botërore dhe Nëntoka Shtetërore Britanike	120
Një politikë e re osmane.....	122
Një grackë ekonomike nga britanikët për të shpejtuar rënien e Perandorisë Osmane: Traktati i Balta Limanit.....	124

Si Nëntoka Shtetërore Britanike organizoi komplotin që dërgoi në luftë.....	130
Dhurata e Abdul Hamidit të II-të për Britaninë: Qipro	132
Planet e Nëntokës Shtetërore Britanike për të pushtuar Egjiptin	136
Skema e Nëntokës Shtetërore Britanike për të parandaluar Unionin Islamik	138
Lufta e madhe po ndërron	140
Politika e Nëntokës Shtetërore Britanike për të shpërfillur Perandorinë Osmane	141
Britanikët arrijnë të nxisin disa prej Arabëve kundër Turqëve.....	144
Figura kryesore prapa Revoltës së Sharif Huseinit: Spiuni Britanik ‘Lawrence’	149
Luftanijet Osmane të rrëmbyera nga Britanikët dhe Pagesa që nuk u kthye kurrë	158
Humbja më e madhe e Nëntokës Shtetërore Britanike: 'Fushata Gallipoli'	162
Individi i vërtetë përgjegjës për humbjen në Gallipoli: Winston Churchill.....	167
Fitorja turke të cilën britanikët dëshirojnë të harrojnë: Kut Al Amara	181
Hapi i parë në dizajnimin e Lindjes së Mesme: Marrëveshja e Sykes-Picot.....	194
Fituesi i vetëm i luftës: Britania.....	200
Pjesa e tretë: E vërteta prapa rënies së Perandorisë Osmane	206
Një perandori bie	208
1. Konkensionet e dhëna për britaninë dhe borxhi i parë	209
2. Vlerat morale bien teksa përhapet Darwinizmi	216
Si futi rrënjët Darwinizmi në Perandorinë Osmane?	217
Teoria e Evolucionit në vendet Osmane-Arabe	233
Pikëpamjet Evolucioniste dëmtojnë Perandorinë Osmane, Indinë dhe Pakistanin	238

Fatkeqësia që solli rënien e Perandorisë Osmane: Darwinizmi	239
3. Vlerat morale bien me shpejtësi në Perandorinë Osmane teksa alkoholi, bixhozi dhe amoraliteti përhapen.....	243
Hapet fabrika e parë osmane e rakisë dhe birrës	244
Prodhimi i verërave dhe eksporti gjatë Sundimit të Abdul Hamidit të II-të	248
Hapja e shtëpiave publike dhe përhapja e prostitucionit në shoqërinë osmane.....	252
Hapja e fabrikës së duhanit gjatë Sundimit të Abdul Hamidit II-të	254
4. Puçet ushtarake dhe humbjet territoriale.....	258
Origjina e të gjitha puçeve: Puçi i vitit 1876	259
Humbjet territorial pas puçit të vitit 1876.....	264
Puçet tjera ushtarake	266
5. Humbja e marinës dhe ushtrisë Osmane.....	269
6. Spiunët britanikë në Perandorinë Osmane	274
Disa nga spiunët britanikë që arritën të infiltrohen në Perandorinë Osmane	280
7. Sykofantët e Nëntokës Shtetërore Britanike	285
Admiruesit Osmanë të Anglisë	285
Shërbyesit besnik të Imprealizmit Britanik në skenën politike osmane.....	300
8. Nëntoka Shtetërore Britanike nxit trazira në të gjithë Perandorinë	302
Politika provokuese e Nëntokës Shtetërore Britanike	304
9. Propaganda	320
Provokuesit Britanik targetojnë Turqinë.....	322
Mësime të rëndësishme në histori.....	334
10. Pashatë 'Britanik' në ushtrinë osmane	338
Zyrtarët britanik të Osmanëve	338
Turqit në dokumentet e Nëntokës Shtetërore Britanike.....	348

Nëntoka Shtetërore Britanike planifikon të shpërfill Perandorinë Osmane.....	349
Nëntoka Shtetërore Britanike dhe trazirat armene	350
Nëntoka Shtetërore Britanike dhe Lufta turke për pavarësi	354
Plani kurd i Nëntokës Shtetërore Britanike	358

Pjesa e katërt: Çështja armene e manipuluar nga Nëntoka Shtetërore Britanike 362

Projekti 150 vjeçar për të dopësuar Turqinë	364
Njerëzit besnik apo ' <i>Millet-i Sadıka</i> '	365
'Territori Armen' si mjet propagandues	369
Nëntoka Shtetërore Britanike fillon të manipuloj disa armenë.....	371
Baza e Nëntokës Shtetërore Britanike për trazirat armene: Qipro	374
Trazirat rajonale para Luftës së Parë Botërore	377
Ndikimi i të ashtuquajturëve Misionarë në komunitetin armen.....	384
Kampanja përçmuese nga mediat Britanike	387
Trazirat e shekullit 19 dhe afrimi i luftës.....	390
Kampanja e Kaukazit në Luftën e Parë Botërore.....	396
Nëntoka Shtetërore Britanike solli shkatërrimin më të madh tek armenët.....	401
Fakte për zhvendosjen masive të armenëve.....	402
Faktet flasin të vërtetën.....	408
Zgjidhja e vetme për çështjen armene është Dashuria dhe Uniteti.....	414

Pjesa e pestë: Mjeshtëria e Propagandës të Nëntokës Shtetërore Britanike dhe Rrjeti Global i Medias..... 416

Inxhiniria Sociale	418
Aktivitetet e inxhinierisë sociale të Nëntokës Shtetërore Britanike	420
Mjeti më i rëndësishëm i inxhinierisë sociale: Media	423
Ngritja e strukturës së thellë mafioze britanike	428

Propaganda e zezë fillon teksa Perandoria Osmane fillon të humb terren.....	428
Byroja e propagandës e Nëntokës Shtetërore Britanike: 'Wellington House'	438
Propaganda e zezë kundër Turqve gjatë Luftës së Parë Botërore.....	442
Mbështetësit Turq të Wellington House	446
Propaganda e zezë antiturke e destinuar për myslimanët e tjerë	452
Ndikimi i Wellington House në ShBA	458
Luftë në mes të propagandave: Lufta e Dytë Botërore	462
Propaganda e shëmtuar vazhdon.....	464
Pjesa e gjashtë: Okupimi i Stambollit	466
Rëndësia e Stambollit.....	468
Plani sekret që filloi me betejën e Gallipolit.....	469
Okupimi i Stambollit do të nënkuptonte arritjen e objektivave të shumta të Nëntokës Shtetërore Britanike	474
Stambolli: Qendra që zbuloi komplotet sekrete evropiane	478
Taktikat britanike për të justifikuar okupimin	482
Okupimi i Stambollit, Parlamenti i fundit Osman dhe pakti Nacional.....	498
Vendet strategjike për Okupim: Kulla Galata dhe rëndësia e rrethinës së Galatas	503
Cenzurimi i Medias gjatë okupimit britanik	513
Mbështetësit e Nëntokës Shtetërore Britanike gjatë okupimit.....	516
Shoqëria e miqëve të Anglisë - Grupet Britanike në Perandorinë Osmane	517
Said Nursi refuzon Fetva kundër forcave nacionaliste	520
Nëntoka Shtetërore Britanike nuk mund të ndal Lëvizjen kombëtare turke për pavarësi	522
Organizuesit e okupimit dhe lidhjet në Nëntokën Shtetërore.....	524

Spiunët në territorin Osman raportojnë në qeverinë e Stambollit.....	530
Qasja e Nëntokës Shtetërore Britanike në Sulltanat dhe planet për të ardhmen e Perandorisë Osmane.....	532
'Një shtet i pavarur i Konstadinopolit': Plani për të kontrolluar ngushticat	536
Trazirat kundër forcave kombëtare në Anatolia dhe lidhjet e tyre me nëntokën shtetërore	538
Çlirimi i Stambollit	540
Përpjeket e Nëntokës Shtetërore Britanike për të marrë Islamin nga Myslimanët.....	544
Pjesa e shtatë: Rruga për në Lozanë	546
Pas luftës së madhe	548
Arkitektët e traktatit të Sevres.....	549
Turqia e re në rrugë për Lozanë	553
Britania përpara negociatave të Lozanës	554
Çështja e Mosul-it dhe traktati i Lozanës.....	560
Mosuli gjatë historisë.....	564
Mosuli gjatë Luftës së Parë Botërore.....	568
Iraku pas rrethimit të Kutit.....	570
Iraku pas luftës	572
Dini i Luanit	575
Duke kërkuar një zgjidhje për Mosulin	580
Bisedimet fillojnë.....	583
Intrigat britanike	590
Liga e kombeve - Britania e Madhe	593
Mosuli refuzon mandatin Britanik	595
'Operacioni Kurdistan'.....	598
Turqia tërhiqet nga Mosuli	601

Finalizimi i traktatit të Lozanës	602
Mosuli pas Lozanës	605
Kryengritja e Nëntokës Shtetërore Britanike nxit trazirat në të gjithë rajonin	606
Mosuli është i humbur	614
Çka na shpjegon pyetja për Mosulin?	616
Kapitullimet në traktatin e Lozanës	620
Interesi i madh i Britanisë së Madhe.....	621
Osmanët tentojnë ti shfuqizojnë kapitullimet	623
Kapitullimet duhet të shfuqizohen për tu arritur pavarësia e plotë	624
Rrugës për në Lozanë	627
Një tërheqje lufte.....	627
Fillon përpjeka e dytë.....	628
Plani i kapitullimeve nga Nëntoka Shtetërore Britanike.....	631
Populli i devotshëm turk refuzoi hegjemoninë britanike.....	634
Konluzione: Ideatori i vërtetë	636
Shtojca: Mashtrimi i Evolucionit.....	640

Hyrje: Njohja e 'Ideatori'

Njohja e 'ideatorit'

Përplasjet, konfliktet dhe luftërat e vazhdueshme të cilat shkatërrojnë botën e sotme, supozohet se do të ndodhin tani, në ditët e fundit, siç na ka paralajmruar Profeti Muhamed (p.q.m.t) para 1,400 viteve. Gjithsesi, meqenëse Zoti krijon gjithçka të bazuar në arsye, mjedisi i paqëndrueshëm i epokës sonë ka disa nga arsyet e veta dhe detyra e dexhallit (antikrishtit) është krijimi i këtyre shkaqeve, në mënyrë që të ndodhë ballafaqimi midis së mirës dhe së keqes. Gjithsesi, kjo përballje do të përfundojë me fitorën intelektuale të Imam *Mehdisë* (p.q.m.t), i cili do të ngritet në Epokën e Artë, në kohën për paqen e plotë në një botë plot dhimbje. Kjo fitore do të shënojë mboshtjen e *dexhallit*, burimit të së keqes, dhe fillimin e një epoke të sigurt për botën, e cila deri në ato momente ishte arenë e luftërave dhe konflikteve. Imam *Mehdiu* (p.q.m.t) do të udhëzoj për dashurinë, largimin nga urrejta dhe për përpjekjen intelektuale për ti dhënë fund të gjitha konflikteve në mënyrë që të mbizotërojë vëllazëria në botë; me fjalë tjera, ai do ti sjell fundin e cytjeve të *dexhallit*. Epoka e Artë të cilën Zoti i Plotëfuqishëm na premtoi është shumë afër.

Beteja në mes të mirës dhe të keqes është e lashtë. Përgjatë historisë, sistemi i dexhallit ka arritur të marrë në kontroll administrata përmes mjeteve të ndryshe dhe më pas të përdorë mbështetësit e djallit për ti larguar njerëzit nga rruga e drejtë, të ju mësoj urrejten, zemërimin, hidhërimin, padashurinë dhe vrasjen. Sot, sistemi i *dexhallit*, i cili zvarritet në errësirë dhe i referohemi më së shumti si 'ideatori', është Nëntoka Shtetërore Britanike.

Nëntoka Shtetërore Britanike, sot me kujdes zbaton plane e ideuara shekuj më parë. Në fakt, shumë nga skenat shqetësuse që shohim sot, janë rezultat direkt i këtyre planeve djallëzore. Kjo Nëntokë Shtetërore është plotësisht e vetëdijshme se është afruar koha për shfaqjen e Imam *Mehdiut* (p.q.m.t), andaj ka dyfishuar përpjekjet djallëzore që të pengojë që kjo të ndodhë. Është gabim të menduarit se, përmes, katastrofave, shkatërrimit, luftërave dhe krizave ekonomike, mund të ndalohet shfaqja e Imam *Mehdiut* (p.q.m.t). Gjithsesi, shfaqja e Imam *Mehdiut* (p.q.m.t) është e paracaktuar dhe askush nuk mund të ndal përcaktimin.

Versioni i parë i *Ideatori: Zbulimi i të vërtetës së Nëntokës Shtetërore Britanike* ofron depërtimin në fazat e zhvillimit të Nëntokës Shtetërore Britanike dhe në veçanti skemat dhe komplotet kundër Perandorisë Islame dhe botës myslimane. Është e domosdoshme ti njohim këto skema nga e kaluara, të cilat dërguan në rënien e një Perandorie dhe ndarjen e botës myslimane, ngase vetëm atëherë do të jemi të aftë të kuptojmë të vërtetën e sotshme botërore.


Është gjithashtu e rëndësishme të theksohet se vetë populli britanik dhe administrata britanike nuk ka mundur të shpëtoj nga planet djallëzore të Nëntokës Shtetërore Britanike, dhe në fakt, kanë qenë një nga caqet kryesore që nga fillimi. Sakaq, Nëntoka Shtetërore ka dëmtuar flamurin britanik dhe parlamentin britanik si pjesë të planit të tyre. Si rikujtim i këtij komploti të rrëzikshëm i cili ka për cak këto simbole të rëndësishme, foto të flamurit britanik dhe parlamentit britanik janë përdorur shumë herë në këtë libër.

Është e rëndësishme të studiohen me kujdes faktet e prezantuara në libër dhe të kuptohet qëllimi i synuar. Kritika në këtë libër nuk ka për cak shtetin britanik, qeverinë britanike, flamurin britanik dhe popullin britanik. Në të kundërtën, populli britanik janë, të devotshëm, të sjellshëm, të rafinuar dhe kanë qenë gjithmonë miq të mirë. Kritika është e drejtuar vetëm për strukturën nëntokësore e cila ka sjellur vetëm shkatërrim për të gjithë botën, përfshirë edhe popullin britanik. Megjithatë, sistemi i *dexhallit* është i destinuar të dështoj, si të gjitha sistemet e *dexhallit* në të kaluarën, është përgjegjësia e jona të ekzaminojmë me kujdes *dexhallin* dhe metodat e tij, si dhe të bëjmë përpjekje intelektuale për të

eksponuar atë. Pavarësisht nga religjioni, gjuha dhe raca e tyre, njerëzit e mirë duhet të bashkohen dhe të formojnë një familje e cila sjell dashuri në botë.

Në fund, *dexhalli* do të mboshtet dhe fitorja do ti takoj mbështetësve të Zotit.

Për ata të cilët e marrin Zotin për mik, Profetin e tij dhe ata të cilët besojnë: është pala e Zotit e cila është fitimtare! (Kur'an, 5:56)



Fuqia e fshehtë e cila manipulon botën: Nëntoka Shtetërore Britanike

Çfarë lloji i fuqisë së fshehtë?

Nëntokat shtetërore janë struktura të fshehta të cilat janë krijuar nga grupe të paligjshme të cilat depërtojnë në sistemet shtetërore dhe marrin kontrollin e qeverive. Duke i rezistuar ndryshimit herë përmes dhunës dhe herë përmes propagandës, këto institucione ndjekin agjendat e tyre dhe nuk i përgjigjen autoriteteve ligjore. Ato veprojnë mbi ligjin dhe institucionet ligjore duke përdorur fuqinë dhe kërcënimet për të arritur synimet e tyre, si dhe më e rëndësishmja, janë nën mbrojtjen e organizatave të fuqishme mafioze. Në këtë formë, ato arrijnë të ruajnë praninë dhe ndikimin në shumë shtete të botës. Ato, ndërtojnë perandori të frikës për të kontrolluar administrata shtetërore. Pavarësisht sa të pavarur mund të duken presidentët aktual dhe sistemet politike të shteteve të ndryshme, për arsye të imponimit të cilit i nënshtrohen, ata zakonisht duhet të operojnë nën mbikqyrjen e afërt të këtyre strukturave nëntokësore. Vendimet e udhëheqësve, pavarësisht sa të arsyeshëm dhe të ndërgjegjshëm mund të jenë, lehtësisht mund të shfuqizohen nga nëntokat shtetërore, të cilat janë në gjendje të nisnin konflikte, përplasje dhe lëvizje separatiste për të çuar përpara synimet e tyre.

Nëntokat shtetërore, kanë ekzistuar në një formë ose një tjetër pothuajse në të gjitha vendet. Disa prej tyre u bënë shumë të fuqishme, ndërsa disa të tjera kanë fituar fuqinë e mjaftueshme për të thënë fjalën e vetme për çështjet shtetërore të vendeve të tyre. Gjithsesi, ekziston një organizatë me rrënjë të thella mafioze e cila është më mbizotruese dhe sunduese se nëntokat tjera shtetërore, përfshirë edhe nëntokën shtetërore të Sh.B.A-ve. Ajo organizatë është Nëntoka Shtetërore Britanike.

Nëntoka Shtetërore Britanike është organizatë mafioze e themeluar prapa dyerve të mbyllura me qëllim të zhvillimit të një rendi të ri botëror përmes përdorimit të metodave të pamëshirshme dhe dinake. Ky rend i ri botëror, kërkon të shfrytëzojë të gjitha kombet e tjera dhe të ndërtojë një botë mizore nën udhëheqjen e diktaturës Anglo-Saksone. Gjithsesi, duhet të theksohet se asaj të cilës po i referohet këtu nuk është sistemi shtetëror i Britanisë së Madhe.

Që nga shekulli 5-të kur u formua për herë të parë, Nëntoka Shtetërore Britanike, ka punuar, në mënyrë të sofistikuar, për të përhapur, amoralitetin, pabesimtarinë, degjenerimin moral, kriminalitetin, agresionin, zemërimin, dhunën, armiqësinë, separatizmin dhe terrorizmin në të gjithë botën. Në të njëjtën kohë, ka arritur të marrë nën kontroll sistemin financiar botëror, përpara se të ushtronte kontroll në territoret dhe politikën shtetërore të vendeve. Me kalimin e kohës, Nëntoka Shtetërore Britanike arriti të përfshihet në pothuajse të gjitha ngjarjet e mëdha botërore. Rënia e pushteteve, luftërat, puçet ushtarake, ndarja e vendeve, mbështetja e grupeve terroriste dhe të gjitha praktikatat dhe sulmet e ngajshme djallëzore, gjithmonë kanë qenë në linjë me vendimet e ndërmarra prapa dyleve nga Nëntoka Shtetërore Britanike. Udhëheqësit e errët të kohës kanë ndjekur vendimet e marra në disa nga Lozhat Masonike të kontrolluara nga ateistë që nga shekulli i 5-të dhe kanë arritur në pozita ku u bënë të aftë t'u diktonin ato vendime vendeve të tyre përkatëse.

Është e rëndësishme të theksohen dy gjëra qënësore: në një masë të madhe, Masoneria sot operon, si një strukturë e denjë shpirtërore që respekton të gjitha besimet. Masoneria fetare është një organizatë e lavdërueshme dhe elitare që gëzon një ndikim të madh. Veçanërisht në kohën e sotshme, me fjalë të tjera, në kohën e fundit të botës, ato do të marrin role të rëndësishme gjatë shfaqjes së *Mehdiut* (p.q.m.t). Gjithsesi, disa nga organizatat Masonike

kritikohen ngase në të kaluarën, kanë bërë përpjete të gjerë për të përhapur pabesimtarinë. Për këtë arsye, ne do të kritikojmë këtë organizatë sekrete tek e cila i ka fillat lindja e Nëntokës Shtetërore Britanike, siç është pabesimtare dhe e korruptuar moralisht gjatë kohës që ishte themeluar dhe gjatë kohës që ka ngritur nëntokën shtetërore. Për të qenë të qartë, shënjestra e kritikës sonë nuk janë organizatat Masonike të kohës moderne.

Pika e dytë është mundësia e ngatërrimit të nëntokës shtetërore me shtetin ligjor. Ky libër nuk do të fokusohet në shtetin britanik *per se*, por nëntokën shtetërore e cila është infiltruar dhe ka mbijetuar brenda shtetit ligjor për shekuj.

Megjithëse ka praktika të qeverisë britanike që ne jo gjithmonë i arsyetojmë, është e qartë se ato janë bërë nën ndikimin e nëntokës shtetërore. Prandaj, është vendimtare të theksohet se kritika në këtë libër nuk është e drejtuar ndaj shtetit ligjor.

Është gjithashtu e rëndësishme të vihet në pah se kritika nuk është për popullin e vendit në fjalë. Përkundrazi, ne thellësisht e vlerësojmë popullin britanik. Populli është i pafajshëm dhe i pastër nga planet e ndyta të nëntokës shtetërore. Prandaj, ne duam të potencojmë në kohë, se akuzat direkte për Nëntokën Shtetërore Britanike në këtë libër nuk kanë asgjë të përbashkët me popullin britanik. Në të vërtetë, njerëzit nuk janë ndier komod me praktikën e nëntokës shtetërore dhe natyrisht, ata kanë qenë gjithashtu viktimë të shumë projekteve nëntokësore. Për këtë arsye dhe për hir të njerëzve të cilët jetojnë në ato vende, është vendimtare që komplotet e këtyre strukturave të ekspozohen. Pas shpalesjes së këtyre kompleteve, organizatat nëntokësore të cilat bëjnë plane dinake kundër qytetarëve të tyre do të humbin ndikimin, fërkimeve të krijuara artificialisht në mes të qytetarëve dhe administratave do t'ju vie fundi dhe mënyrat për të jetësuar dashurinë në botë do të përhapen. Është e rëndësishme që lexuesi të ketë parasysh këto pika përgjatë leximit.

Ngritja e Strukturës Mafioze të Nëntokës

Nëntoka Shtetërore Britanike është një organizatë ateiste me histori të gjatë. Qëllimi përfundimtar i kësaj organizate është sundimi i botës nga Anglia dhe përhapja në të gjithë botën e ideologjisë anti-fetare të inspiruar nga dexhalli. Mbështetës të Nëntokës Shtetërore Britanike, përgjatë historisë, kanë kultivuar këtë sistem dinak nën mashtrime të ndryshme me metoda të liga për të ushtruar kontrollin në të gjithë botën. Nganjëherë, ata kanë fituar kontrollin e disa vendeve nga brenda, në disa raste kanë arritur të ushtrojnë ndikimin e tyre mbi sistemin ligjor, ushtarak apo edukativ, apo kanë ndikuar mbi mediat e këtyre vendeve dhe kanë shkaktuar shkelje ligjore dhe konflikte. Duke nxitur trazira në shumë vende, përmes orkestrimit të 'revolucioneve portokalli', përgatitjes së puçeve ushtarake, apo nganjëherë organizimit të drejtëpërdrejt të puçeve të tilla, si dhe shfrytëzimit të medias, madje edhe të sistemit ligjor me qëllim të krijimit të polarizimit të shoqërisë për të arritur kontroll mbi administratat shtetërore, kanë qenë disa nga synimet kryesore të Nëntokës Shtetërore Britanike. Nëntokat Shtetërore kanë vendosur se metodat më efektive për të ndarë shoqërinë janë përmes dobësisë të shpirtit, traditës dhe vlerave morale. Kjo është arsyeja pse kanë zhvilluar metoda të tilla si përhapja e idhujtarisë, inkurajimin e degradimit moral, largimin nga zakonet dhe tradita në mënyrë që të përhapet perversiteti seksual në shoqëritë të cilat i synojnë.

Për të arritur këto synime, Nëntoka Shtetërore Britanike punon në bashkëpunim me strukturat nëntokësore të shteteve respektive dhe përdor metoda të ndryshme për ti dhënë anëtarëve të saj mundësinë për ta infiltruar nëntokën në shoqëri. Ata kanë metoda të caktuara për të arritur synimet e tyre, më e zakonshmeja është dërgimi i individëve në kapacitetet të ndryshme si, ambasador, përfaqësues të qeverive, ushtarak apo gazetarë, në vendet të cilat i synojnë me qëllim të krijimit të një sistemi efektiv të intelgjencës. Gjatë historisë, kanë instaluar spiunë në vendet të cilat kanë pasur plan të rrëzojnë, përfshirë Perandorinë Osmane. Ata gjithashtu formuan aleanca të ndyra me qarqe të ndryshme në vendet e synuara dhe bënë përpjete të gjerë për të arritur në këtë përfundim. Qëllimisht kërkuan njerëz të pakualifikuar,

lakmitarë dhe me prirje sykofantike, të cilët në veçanti admironin kulturën britanike. Aktivitetet e spiunazhit të këtyre individëve kanë hapur rrugë për shumë projekte shkatërruese të planifikuara nga një fuqi e frikshme si Nëntoka Shtetërore Britanike. Sot, situatë nuk ka ndryshuar. Ndonëse, Shtetet e Bashkuara të Amerikës paraqiten si super fuqi, në të vërtetë kanë qenë nën ndikimin e Nëntokës Shtetërore Britanike për një kohë të gjatë, dhe si duket janë ende nën atë ndikim. Planet e fshehta të Nëntokës Britanike, janë në një pjesë të dukshme në Lindjen e Mesme dhe Afrikës, përderisa situata e paqëndrueshme në atë rajon rritet. Ndonëse, paraqitet se disa akterë tjerë janë në prapaskenë, plani i errët i cili synon të ndajë Lindjen e Mesme në shtete të vogla të cilat janë më lehtë të shfrytëzueshme i ka takuar gjithmonë Nëntokës Shtetërore Britanike.

Nëntoka Shtetërore Britanike, ka përdorur kolonizimin si metodë kryesore të planit për dominim. Duke vepruar mbi premisat e racës superiore, ka aplikuar kolonizimin siç nuk është parë asnjëherë në botë. Duke luajtur një rol domethënës në kolonizimin e Afrikës, pasi që kompanitë e ndërtuara nga tregtarët britanikë organizuan aktivitetet të ndryshme për të çuar përpara këtë qëllim. Këto kompani kanë fituar territore të mëdha në shtetet respektive, ku më pas kanë fituar pozicione për të ndikuar në fillimin e luftërave apo lidhjen e paqes, deri sa vendet e rajonit hynë në mënyrë të plotë nën kontrollin e tyre. Pasi janë mveshur me kompetenca të gjera nga administratat e këtyre vendeve, ato pothuajse u kthyen në vetë shtete individuale.

Nëntoka Shtetërore Britanike u përpoq të dobësojë vendet e synuara nga brenda dhe për këtë qëllim, nuk u përmbajt nga nxitja e ndjenjave separatiste në grupet minoritare apo mbështetja e fshehtë e grupeve terroriste. Aktivitetet të ngjajshme të nëntokës shtetërore vazhdojnë aktualisht në kapacitetet të plota.

Disa nga agjencionet shtetërore të inteligjencës, aktualisht operojnë nën kontrollin e nëntokës shtetërore të vendeve të tyre. ShBA-të dhe disa nga njësitë e CIA, janë fajtuar për pothuajse gjithçka që po ndodh sot në gjithë botën, në të vërtetë, megjithëse pa dëshirë dhe dijenin e tyre ata e kanë të pamundur të devijojnë nga vendimet e Nëntokës Shtetërore Britanike, apo nëntokës shtetërore të shteteve të tyre.

Disa nga zyrtarët dhe individët e dërguar në pozita kyçe në Lindjes e Mesme janë trajnuar dhe janë zgjedhur në mënyrë specifike nga Nëntoka Shtetërore Britanike. Një rishikim i të kaluarës së këtyre individëve, zbulon lehtësisht se ata janë trajnuar në kolegje spiunazhi, për njësitë e inteligjencës së nëntokës shtetërore. Këta individë mund të vijnë në pozita të rëndësishme dhe madje të bëhen udhëheqës të shteteve të tyre në Lindjen e Mesme. Kjo lejon që menaxhimi i burimeve dhe planet e shteteve përkatëse të mbeten në linjë me planet e Nëntokës Shtetërore Britanike.

E gjithë kjo e bën të qartë se çdo analizë e ngjarjeve botërore kërkon një studim më të thellë, në vend të qasjes tipike për të fajtuar ShBA-të, qeveritë e ndryshme, burrshtetasit apo shërbimet e inteligjencës. Një vëzhgim i tillë i plotë, do të shpie gjithmonë në drejtim të Nëntokës Shtetërore Britanike dhe se si gjithmonë i kanë qëndruar besnik planit strategjik të sajuar shekuj më parë. Duhet të kihet parasysh se zhvillimet aktuale në botë, si luftërat, kryengritjet, varfëria, imigrimi, degradimi moral, përhapja e mosbesimit, humbja e shpirtërores dhe incidente të tjera të cilat dërgojnë në kolaps, nuk ndodhin spontanisht dhe janë modele vijuese të formuara në bazë të planeve të bëra shekuj më parë prapa dyerve të mbyllura.

Duke thënë këtë, një pikë e veçantë duhet të kihet parasysh: pavarësisht sa të shpërndara, sa të tmerrshme, apo sa në mënyrë sistematike po zbatohet planet e sajura prapa dyerve të mbyllura, fuqia i përket vetëm Zotit. Zoti i krijon të gjitha ato plane. Pavarësisht se në mënyrë shumë tinzare këto organizata bëjnë planet e tyre, përcaktimi i Zotit i tejkalon gjithmonë këto plane. Ska rëndësi se sa e frikshme dhe tinëzare mund të duket fuqia nëntokësore, plani i Zotit do të mbizotërojë gjithmonë. Prandaj, është e rëndësishme të mbajmë në mend këtë fakt teksa i shqyrtojmë në detaje planet e Nëntokës Shtetërore Britanike. Zoti i Plotëfuqishëm sqaron në ajetin Kuranor:

A mos vallë dëshirojnë të të mashtrojnë? Por të mashtruarit janë ata që nuk besojnë. Apo ata kanë ndonjë zot tjetër përveç Allahut? Lavdia i përket Allahut mbi gjithëçka që Atij ia mveshin! (Kur'an, 52:42-43)

Në këtë libër, ne do të zbulojmë të gjitha aktivitetet tinëzare të Nëntokës Shtetërore Britanike, në mënyrë të argumentuar me dokumentet dhe evidenca relevante. Shembuj nga e kaluara dhe koha jonë do të ndihmojnë të hedhin dritë mbi veprimtarinë e kësaj organizate nëntokësore.

Duhet të mbajtur mend se arsya kryesore prapa lindjes së Nëntokës Shtetërore Britanike dhe aktiviteteve të saj të tmerrshme në të gjithë botën ka qenë gjithmonë iluzioni i racës superiore i cili ka kënaqur apetitete e anëtarëve të Nëntokës Shtetërore Britanike. Kjo klikë është bindur se raca e tyre është superiore dhe e gjithë bota duhet t'u shërbej atyre dhe se të gjitha shtetet e botës dhe sistemet botërore duhet të jenë nën kontrollin e Britanisë. Veçanërisht Darwinizmi, i cili ka përgatitur bazën për katastrofat e tmerrshme të cilat ndodhën në të gjithë botën në shekullin e kaluar, ka qenë mashtrimi më i madh i masave të cilin Nëntoka Shtetërore Britanike, e shpiku për të ndërtuar infrastrukturën e lartpërmendur.

Plani Darwinist i Nëntokës shtetërore Britanike

Fjalët e mëposhtme të Cecil Rhodes (1853-1902), një politikani homoseksual britanik i cili ka punuar për vite me radhë në Afrikën e Jugut, përmbledhin bazën raciste të imprealizmit Britanik:

Pse nuk e formojmë një shoqëri sekrete me vetëm një objektiv: përparimin e Perandorisë Britanike dhe vënie e të gjithë botës së pacivilizuar nën sundimin Britanik, për rimëkëmbjen e Shteteve të Bashkuara për të ndërtuar një Perandori të vetëm të racës Anglo-Saksone.

Përfaqësuesit sekret të civilizimit Britanik, të cilët filluan të njihen si përfaqësues të 'Perandorisë ku dielli nuk perëndon kurr', pas revolucionit industrial, kanë ëndërruar për të sunduar botën që nga themelimi i perandorisë së tyre. Një thënie tjetër nga Rhodes vetëm sa e vërteton pohimin e tyre:

Është detyrë e jona të shfrytëzojmë çdo mundësi për të fituar më shumë territore, dhe ne duhet ta mbajmë këtë ide gjithmonë para syve tanë: më shumë territor nënkupton më shumë nga raca Anglo-Saksone, më shumë nga më të mirët, nga raca më humane dhe më e ndershme që ka bota.²

Kjo qasje tërësisht raciste ka një ngjajshmëri të frikshme me idetë e bashkëkohësit të tij, Charles Darvinit, i cili ka besuar se 'racat e favorizuara nga natyra do të triumfojnë dhe të ashtuqajturat racat primitive do të zhduken'. Teoria e evolucionit e propozuar nga Darvini pohon se jeta është formuar nga një sërë rastësish, dhe përmes incidenteve të rastësishme speciet janë kthyer në specie tjera, dhe se e gjithë jeta është prodhim i një sistemi evolucionar i bazuar tërësisht në rastësi. Pasiqë, mendimi evolucionist nuk është asgjë tjetër përveçse një pikëpamje materialiste e cila ka dominuar që nga civilizimet antike të Greqisë dhe Egjiptit, ka gjetur një terren pjellor në Angli, e cila ka qenë një kala e mendimit materialist për vite. Avanturisti Britanik, Charles Darwin, i cili ishte emri që përhap lajthitjen evolucioniste në të gjithë botën, ka luajtur vetëm një pjesë të planit të Nëntokës Shtetërore Britanike.

Propozimi i teorisë evolucioniste përmes maskës shkencore, dhe më pas mbështetja e kësaj teorie, duke përdorur Darwinin, nuk ishte asgjë tjetër përveç zbatimit të një vendimi të marrë në lozhat Masonike ateiste të asaj kohe. Anëtarët e Këshillit Suprem të shkallës së 33-të të ritit Masonik të Misraimit gjatë asaj periudhe në Paris, vendosën të mbështesin evolucionin si fakt shkencor pa pasur nevojë për vërtetim logjik:

*It is with this object in view [that the theory of evolution is scientific] that we are constantly by means of our press, arousing a **blind confidence in these theories**. The intellectuals... will puff themselves up with their knowledge and **without any logical verification of them** will put into effect all the information available from science, which our agentur specialists **have cunningly pieced together for the purpose of educating their minds in the direction we want**. Do not suppose for a moment that these statements are empty words: **think carefully of the successes we arranged for Darwinism.**³*

Siç e bënë të qartë ky vendim sekret, plani për të përdorur mediat, intelektualët, ekspertët dhe akademikët është planifikuar për të siguruar një pranim të verbër të teorisë së evolucionit, dhe taktikat dinake janë përdorur për të formësuar mendimet e njerëzve. Jo shumë kohë më pas, sistemi ateist në SH.B.A, përqafoi vendimin e Ritët të Misraimit.

Pas këtij plani, vendimarrësit ndërtuar një diktatur Darwiniste që kontrollonte shumicën e pozitave kryesore në të gjithë botë. Ndërsa ky plan u vë në veprim, herë pas here në mënyrë sekrete, ndikimi i kësaj diktature u përhap në

agjencitë qeveritare, mediat, universitetet, shkollat dhe madje edhe në institucionet e artit. Pavarësisht refuzimit të gjerë nga publiku, teoria e evolucionit u prezentua si shkencore, dhe me anë të taktikave të ndryshme manipuluese, njerëzit u mësuan me këtë mashtrim. Në të njëjtën kohë, faktet shkencore kundër evolucionit, duke përfshirë fosilet e gjalla, janë mbajtur larg nga syri i publikut, ndërsa ata të cilat nuk e pranuan këtë teori u dëbuan nga rrethet shoqërore dhe akademike. Shumica e tyre u heshtën nga presioni dhe përçmimi mediatik.

Diktatura Darwiniste e cila vepron nën kujdestarinë e Nëntokës Shtetërore Britanike është ende aktive dhe me ndikim. Sot, pothuajse nuk ka asnjë shtet në botë, duke përfshirë edhe shtetet myslimane, që nuk e ligjërojnë evolucionin në shkollat e tyre. Disa organizata mediatike të disa vendeve janë pothuajse të detyrara të publikojnë si të vërteta 'lajmet nga evolucionit' të përgatitura nga Nëntoka Shtetërore Britanike. Edhe në vendet islamike, gënjeshtër e evolucionit që mohon qartë Zotin dhe që nuk ka asnjë bazë shkencore, tani është një 'imponim' që akademikët janë të detyruar të mbështesin. Presioni i Nëntokës Shtetërore Britanike është aq i fuqishëm, sa që së fundmi Kisha Angleze i ka kërkuar falje Darwinit⁴ si dhe Papa ka mbajtur një konferencë në mbështetje të Darwinizmit në vendlindjen e tij.

Nëntoka Shtetërore Britanike zbatoi në mënyrë sistematike vendimet e saja për të përhapur Darwinizmin si religjion. Thomas Huxley, i cili sa ishte gjallë ishte i njohur si një mbështetës i madh i Darwinit, madje i njohur nga disa edhe si 'bulldogu i Darwinit', ishte anëtar i Shoqërisë Mbretërore. Njësojë si anëtarët e tjerë të këtij institucioni, si një nga organizatat shkencore më me ndikim në Britaninë e Madhe, edhe ai ishte një ateist.⁵ Shoqëria Mbretërore, apo Shoqëria Mbretërore e Londrës për Përmirësimin e Njohurive Natyrore, ka qenë një akademi e themeluar në vitin 1662. Shumica e anëtarëve të kësaj organizate kanë qenë ateist dhe homoseksual.⁶ (Mund të gjeni informacion më të detajuar për Shoqërinë Mbretërore në faqet në vazhdim).

Çfarë e bëri Thomas Huxleyin – anëtarë të Shoqërisë Mbretërore në një moshë mjaft të re, ndonëse nuk kishte arritje personale, ishte fakti se ai ishte shumë i afërt me Darwinin dhe ishte përkrahësi i ti më i madh. Anëtarët e tjerë të Shoqërisë Mbretërore ndihmuan gjithashtu Darwinin para dhe pas botimit të librit të tij. Në të vëretë, ata e kanë përkrahur aq shumë Darwinin dhe Darwinizmin sa kanë filluar të shpërndajnë 'Medaljen e Darwinit' për shkenctarët në mënyrë të ngjajshme me çmimin Nobel.

Me fjalë të tjera, Darwini nuk ishte i vetëm. Në momentin që propozoi teorinë e tij, në mënyrë shumë të organizuar, ai ishte i drejtuar nga Nëntoka Shtetërore Britanike. Kjo mbështetje e organizuar erdhi direkt nga Nëntoka Shtetërore Britanike, e cila ishte shumë e etur për pranimin e teorisë së evolucionit në të gjithë botën. Ata besuan se mund t'i ndihmonte të largonin masat nga feja dhe të gjitha vlerat morale, dhe ti shëndreronin ato në shoqëri të dobët, të brishta të cilat mund të binin lehtësisht nën kontrollin e Britanisë. Ata ishin të vetëdijshëm se shoqëri të tilla do të krijonin individë egoist dhe lakmtarë. Sipas planit, pasi që shoqëritë të kenë arritur në atë pikë, do të ishte më e lehtë për t'i shfrytëzuar dhe abuzuar, për të drejtuar dhe përhapur propagandën.

Për më tepër, pasi që Darwinizmi ngrit konceptin e gabuar të 'racës superiore', dhe meqenëse mjetet propaganduese do të shfaqnin Britanikët si versionin më të përparuar të races së bardhë, ata menduan se përhapja e kësaj teorie do të ndihmonte të bindnin shoqëritë e tjera që të pranonin superioritetin e Britanikëve. Kjo do ta kishte bërë më të lehtë për përfaqësuesit e nëntokës shtetërore, për të bërë pretendime mbi shoqëritë e tjera dhe për të shfrytëzuar komunitetet në Afrikë dhe Lindjen e Mesme. Ky pretendim për superioritet lindi dëshirën për të dominuar. Ata besuan se çdo mjet për hir të dominimit të botës ishte i justifikuar. Për këtë arsye, Nëntoka Shtetërore Britanike, pa ndjeshmërinë për atë se ç'ndodhi në pjesën tjetër të botës, ose duke pasur parasysh numrin e njerëzve të vrarë në luftërat e filluara në mënyrë të panevojshme, pa ndjeshmërinë për ndarjen e vendeve, vazhdoi të avansojë agjendën e saj dhe do të vazhdojë të bëjë po të njëjtën gjë. Sidoqoftë, askush nuk do të pyetet për prejardhjen ose entninë e tij ose saj në Ditën e Gjykimit. Ata të cilët mashtrohen me pretendimet e racës superiore, dhe të cilët shkaktojnë trazira si përfundim, do të tmerrohen atë ditë. Gjithsesi se përfaqësuesit e nëntokës shtetërore janë të pavëmendshëm për këtë fakt:

Atëherë kur do të fryhet në Sur, atë ditë ndërmjet tyre nuk do të ketë farefisni; dhe as që do të pyesin për njëri-tjetërin. (Kur'an, 23:101)

"Interesat e Britanisë"

'Interesat e Britanisë' është mbase koncepti më i rëndësishëm për Nëntokën Shtetërore Britanike. Shumica mund të mendojnë se është normale që shtetet të punojnë për të mbrojtur interesat e tyre. Sidoqoftë, duhet të mbahet në mend se Nëntoka Shtetërore Britanike është një fuqi mbi shumicën e vendeve tjera. Prandaj, kur bëhet fjalë për interesat britanike, ngrihet një fuqi mafioze, e aftë të bëjë gjithçka pa marrë asnjë përgjegjësi. Në këtë kuptim, 'interesat më të volitshme të Britanisë' mund të jenë shumë të kushtueshme. Në të vërtetë, për të promovuar këto interesa, ndonjëherë paqja braktiset, vendet ndahen, fillojnë sulmet e grupeve terroriste dhe madje shpallen luftëra.

Disa nga udhëheqësit britanikë iu referuan hapur kësaj qasje të frikshme të orientuar drejt interesave të tyre.

Lord Palmerston i cili shërbeu si Kryeministër i Britanisë në mesin e shekullit të 19t-të, e shpjegoi këtë këndvështrim në një fjalim të mbajtur në vitin 1865:

Kur njerëzit më pyesin, ..., për atë që quhet politikë, përgjigja e vetme është se në secilin rast kur ipet mundësia, ne mendojmë të bëjmë atë që mund të duket si më e duhura, duke i parë interesat e vendit tonë si një parim udhëheqës.⁷

Palmerston gjithashtu tha:

Ne nuk kemi aleatë të përjetshëm dhe armiq të përherëshëm. Interesat tona janë të përjetshme dhe të përherëshme.⁸

Eduard Grey, Ministri i Jashtëm i atëhershëm i Mbretërisë së Bashkuar, e mbështeti këtë pikëpamje me fjalët e mëposhtme:

Ministrat e Jashtëm Britanikë janë udhëhequr nga ajo se çfarë u dukej se ishte interes i menjëhershëm i vendit, pa bërë llogaritje për të ardhmen.⁹

Këshilltari special i ish-Presidentit amerikan Truman, Ambasadori Davies, theksoi fjalët në vijim në lidhje me ish-Kryeministrin britanik Churchill:

Cilado qoftë madhështia e Churchill-it, ai ishte 'së pari, së fundmi dhe gjatë gjithë kohës një anglez i madh, më shumë i interesuar për të ruajtur pozicionin e Anglisë në Evropë sesa për të ruajtur paqen.¹⁰

Menaliteti që zgjodhi interesat britanike mbi paqen, ndikoi në shumë udhëheqës britanik gjatë gjithë historisë. Arsyea kryesore prapa kësaj tendence, është fakti se ata udhëheqës nuk mund të largoheshin nga ndikimi i Nëntokës Shtetërore Britanike, për të cilën gjëja më e rëndësishme ishte të bindte të gjithë botën të pranonte të ashtuquajturën superioritet britanik, që buronte nga idetë e gabuara të evolucionit.

Për shkak të këtij mentaliteti, Britania ka qenë gjithmonë vendi më i zëshëm për politikën okupuese në të gjithë botën. Në të vërtetë, janë vetëm 22 vende në botë të cilat nuk i ka pasur nën okupim gjatë historisë. Territorët e okupuara dikur nga Britanikët arrijnë në 90% të të gjitha tokave në botë.¹¹ Aktualisht, 22 vende janë pjesë e Mbretërisë së Bashkuar, dhe 14 prej tyre janë jashtë shtetit. Mbretëresha e Anglisë Elizabeta e II-të, është mbretëresha e këtyre 22 shteteve, duke shtuar edhe 16 vendet tjera. Këto shtete janë, Kanada, Australia, Zelandë e Re, Xhamajka, Barbados, Bahamas, Grenada, Papua Guinea e Re, Ishujt Solomon, Tuvalu, Saint Lucia, Saint Vincente, Ishujt Grenadine, Islands, Belize, Antigua dhe Barbuda, Saint Kitts, Nevis dhe Fiji. Edhe pse këto vende fituan pavarësinë e tyre, Mbretëresha Elizabeta e II-të, konsiderohet ende mbretëresha e tyre.

Mbretëresha, e konsideruar si kreu i Komonvelthit, emëron një guvernator të përgjithshëm si përfaqësues në ato vende. Ajo zakonisht emëron politikan në pension apo emra të tjerë elitare, me këshillën e Kryeministrit të vendit përkatës. Guvernatori i përgjithshëm jep miratimin mbretëror për legjislacionin e miratuar nga parlamenti, nënshkruan dokumente zyrtare, hap dhe mbyll zyrtarisht seancat parlamentare, shpërbën parlamentin para zgjedhjeve dhe kryen

funksiione të tjera të ngjashme.¹² Me fjalë të tjera, Britania ende gëzon fuqi seioze – dhe në shumë raste vendimtare – në këto vende.

Një shembull kryesor është kriza kushtetuese e Australisë që ndodhi në vitin 1975. Kryeministri Australian Gough Whitlam adaptoi një qëndrim të qartë kundër Nëntokës Shtetërore Britanike dhe ekspozoi komplotet e mbrapshta kundër vendit të tij, për të pohuar pavarësinë e Australisë. Tre vite pas zgjedhjes së tij në vitin 1972, Whitlam po thoshte se MI6 e Britanisë po vepronte kundër qeverisë së tij: *'Britanikët në të vërtetë po dekodonin mesazhe të fshehta duke ardhur në zyrën time për politikë të jashtme.'*

Qëndrimi i guximshëm i Whitlam nuk u la pa përgjigje nga Nëntoka Shtetërore Britanike. Mbretëresha e Mbretërisë së Bashkuar, duke vepruar nën ndikimin e Nëntokës Shtetërore Britanike, shkarkoi Kryeministrin Australian dhe shpërbëu parlamentin në vitin 1975. Sipas *the Guardian*, pas këtij incidenti, *'Politika Australiane nuk u këndell kurrë, dhe as shteti nuk e mori pavarësinë e vërtetë.'*¹³ Sot, Australia është ende pjesë e Komunvlethit. Ky shembull i vetëm është i mjaftueshëm për të treguar se sa e fuqishme mund të jetë hegjemonia e Nëntokës Shtetërore Britanike ndaj vendeve tjera.

Nën ndikimin e Nëntokës Shtetërore Britanike, Britania, në tokat që pushtoi gjatë historisë, zakonisht ka punuar për të theksuar dallimet në mes të grupeve të ndryshme etnike dhe fetare. Nëntoka Shtetërore, i ka indoktrinuara ata që të besojnë se janë armiq dhe se koncepti i 'racës superiore' ka qenë gjithmonë pjesë e kësaj politike. Nëntoka Shtetërore Britanike zgjedh një grup etnik midis një morie grupesh tjera të cilët kanë jetuar së bashku për ndoshta me shekuj dhe u thotë atyre 'ju jeni raca superiore', dhe pastaj i vë ata kundër njëri-tjetrit. Është e bindur se një strategji e tillë do ta bëjë më të lehtë qeverisjen e këtyre shoqërive, pasi grupet e përçara nuk mund të bëhen bashkë 'për të formuar një fuqi të vetme të përbashkët'. Historia është plot me shembuj të kësaj politike.

Për shembull, gjenocidi i tmerrshëm që ndodhi në Ruandë nuk ishte një dukuri e rastësishme, regjionale. Nuk ishte e pavaruar as nga Nëntoka Shtetërore Britanike.

Politikat e Nëntokës Shtetërore Britanike, zakonisht fokusohen në krijimin e ndarjeve, nxitjes së ndarjeve ekzistuese apo krijimit të ndarjeve artificiale. Në lidhje me kombet tjera, nëntoka shtetërore është përpjekur gjithmonë të 'mbajë përplasje të mbrehta, të krijoj ndarje nëse nuk ekzistojnë dhe të nxisë mosmarrëveshje'. Ata që dështojnë të përshtaten me këtë politikë, nëse është e nevojshme eliminohen përmes metodave të ndryshme, sepse siç shpjegohet më lartë, gjëja më e rëndësishme për ata që qëndrojnë pas këtyre planeve janë 'Interesat e Britanisë'.

Themelet që Formësojnë Interesat Britanike

Nëntoka Shtetërore Britanike gjithmonë ka kërkuar të imponojë dominimin e etnisë britanike, interesave dhe fuqisë britanike që nga fillimi i Perandorisë Britanike. Nëntoka shtetërore, e cila është në të vërtetë një organizatë e fshehtë nëntokësore, punoi për të ndjekur këtë qëllim dhe u përpoq të hynte në role të ndryshme administrative nën mashtrimin e petkut ligjor. Këto përpjekje ndonjëherë vinin nga vetë agjencitë shtetërore, dhe në shumicën e kohës përmes organizatave dhe fondacioneve të fshehta. Këto organizata dhe fondacione provuan shumë metoda për të mbështetur interesat britanike në vendet e tjera. Ato kryesisht përdorën median, formësuan politikatat e udhëheqësve dhe nganjëherë përdorën spiunë për t'i infiltruar politikatat e vendeve të tjera. Këto organizata manipuluan udhëheqës, përcaktuan politikatat dhe strategjitë për vende të ndryshme dhe u përpoqën të bënin që secili shtet të punonte në përputhje me interesat britanike.

Këto organizata dhe fondacione janë veçanërisht të afta në përdorimin e metodave propagandistike në shoqëritë ku jetojnë. Duke përdorur metoda të ndryshme, ato arrijnë të propagandojnë çdo ide. Universitetet, shkollat, akademitë, publikimet shkencore, mediat, madje edhe qeveritë u përdorën për përpjekje të tilla propagandistike dhe ndihmuan në përhapjen e Darwinizmit. Degradimi moral në shoqëri është gjithashtu për arsye të përdorimit të gjerë të këtyre metodave. Për shembull, prezantimi i perversitetit të homoseksualizmit si sjellje normale, është një tjetër rezultat i përpjekjeve të gjera të këtyre organizatave.

Le ta kujtojmë një pikë të rëndësishme këtu; organizatat e përmendura janë institucione ligjore me njerëz të mirë dhe të ndershëm që punojnë për to, të cilët nuk janë në dijeni të aktiviteteve të përmendura të nëntokës shtetërore dhe qëllimit të vërtetë të organizatave. Kritika jonë, sigurisht se nuk është e drejtuar në punët ligjore apo njerëzit të cilët bëjnë gjëra të ndershme në këto organizata. Kritika jonë është e drejtuar tek mendësia e gabuar që formoi bazën për një mori veprimesh tinëzare të kryera përmes këtyre organizatave. Nuk ka dyshim, se njerëzit edhe nëse bëjnë gabime, mund të ndryshojnë. Arsyeja pse po zbulojmë sekretet e nëntokës shtetërore, është të tregojmë pasojat e dëmshme të veprimeve të individëve të cilët ishin përfshirë në këto çështje, t'i paralajmërojmë ata dhe t'i inkurajonte që të ndryshojnë për të mirë. Qëllimi është konstruktiv dhe jo destruktiv. Prandaj është e rëndësishme të kihet parasysh ky qëndrim, teksa lexuesi mëson për këto fakte.

Për më tepër, ky libër fokusohet kryesisht në vitet kur këto organizata u krijuan për herë të parë. Megjithatë, disa nga këto organizata ende veprojnë nën mbikëqyrjen dhe udhëzimet e nëntokës shtetërore, është e mundur që të kenë adoptuar ide dhe vizion tjetër. Sidoqoftë, gjatë viteve të para që u formuan, ato shkaktuan dëme të mëdha sepse vepuruan direkt nën direktivat e Nëntokës Shtetërore Britanike dhe udhëhoqën operacione që do të kishin pasojat e dëmshme edhe për brezat e ardhshme. Ne do të përqendrohemi veçanërisht në këtë aspekt të çështjes.

Kompania Britanike e Indisë Lindore

Kompania e Indisë Lindore [East India Co.] u zyrtarizua me miratimin e Mbretëreshës Elizabeta I, në vitin 1600. Kontrolli britanik në Indi filloi kur kjo kompani u krijua në Londër dhe më pas mori të ardhurat e qeverisë në rajonin e Bengalit, në Indi. Pas kësaj ngjarje historike, Nëntoka Shtetërore Britanike, filloi ngadalë ndërtimin e dominimit në Indi. Menjëherë më pas, u krijua Shërbimi Civil Indian, i njohur gjithashtu si Shërbimi Civil Perandorak, që lejoi britanikët të kontrollonin jo vetëm principatat e pavaruara, por të gjithë Indinë. Gjithashtu, sigurohej që oficerët britanikë të mund të merrnin të gjitha pozitave kryesore.

Kjo shënoi fillimin e kolonizimit të Indisë- 'diamantin në kurorë'- të Nëntokës Shtetërore Britanike. India tani ishte ndarë në klasa: familjet fisnike që kërkonin të ruanin të drejtat e tyre dhe një klasë e re e mesme që i detyrohej Britanisë për ekzistencën e tyre.

Kompania e Indisë Lindore, transferoi sistemin bankar '**fractional reserve banking**', të inspiruar nga sistemi bankar babilonez dhe i cili ishte hapi i parë drejt praktikave moderne të qendërimit të sistemit bankar. (**Fractional reserve banking** i referohet praktikës kur bankat mbajnë një sasi të caktuar të depozitave që marrin, dhe pjesën tjetër ua ofrojnë investitorëve dhe tregut si hua, etj. Bazohet në fitimin e interesit, në para të cilat praktikisht nuk ekzistojnë). Ky sistem financiar solli një varg praktikash interesante. Sistemi në fjalë, luajti një rol të rëndësishëm në shumë konflikte dhe luftëra si Revolucionin Francez, Betejat Napoleonike, Luftën Anglo-Boer [lufta në mes të Perandorisë Britanike dhe dy shteteve Boer në Afrikën e Jugut], Luftën e Parë Botërore dhe Revolucionin Bolshevik. Madje edhe Revolucioni Bolshevik në të vërtetë ishte i planifikuar dhe financuar nga organizatat sekrete të kontrolluara nga Nëntokë Shtetërore Britanike. Vetë Lenini pranoi në Mars të vitit 1922 se revolucioni nuk kishte qenë një lëvizje e pavarur. Ai deklaroi qartë gjatë Kongresit të 11-të të partisë, se partia po drejtohet nga një 'makinë e madhe burokratike'¹⁴

Sot, është një fakt i njohur gjerësisht se luftërat konsiderohen si një burim i rëndësishëm i të ardhurave për **reserve banking systems**. Dr. John Coleman, një zyrtar i pensionuar i intelgjencë, shpjegon këtë të vërtetë me fjalët vijuese:

Është vlerësuar nga historiani i luftës Alan Brugar, se bankierët ndërkombëtar bënë një fitim prej 10,000 dollarëve për çdo ushtarë të rënë në betejë. Jeta është e lirë kur bëhet fjalë për Komitetin e 300-Bankierëve të Illuminati-Rothschild-Warburg, të cilët financuan të dy anët e luftës.¹⁵

Komiteti prej 300-ve të cilëve i është referuar këtu do të shpjegohet në detaje në faqet vijuese.

Kompania e Indisë Lindore, u themelua për herë të parë me qëllimin e shfrytëzimit të vendeve me resurse të pasura natyrore, me theks të veçantë Indinë, Kinën dhe Republikën e Afrikës së Jugut. Siç u shpjegua më lartë, **'fractional reserve banking'** është përdorur nga Britania dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës për të financuar Luftën e Parë Botërore. Në vitin 1661, Mbreti Britanik Charles i II-të i dha Kompanisë së Indisë Lindore të drejtën për të bërë luftë dhe paqe me vendet e pavaruara. Kjo ishte hera e parë që një kompanie private, të angazhuar në veprimtari financiare, iu dhanë të drejta të tilla. Këto të drejta u përdorën për të zaptuar prodhimtarin dhe zonat bujqësore në vende të ndryshme, pasi kjo kompani financiare arriti në një pozicion të tillë ku anëtarët e saj mund të takoheshin me princa, ajo arriti të dominonte **fractional reserve system** që rriti ofertën e parave në treg. Nga viti 1830, e gjithë India ishte praktikisht nën kontrollin e Kompanisë së Indisë Lindore.¹⁶

Në vitin 1702, kompania u riemërua si Kompania Britanike e Indisë Lindore (BEIC), dhe sistemi i rezervave i përdorur në Indi u eksportua në të gjithë botën. Ky sistem është gjithashtu origjina e praktikave moderne bankare të rezervave shtetërore që kontrollojnë të gjitha tregjet sot; me fjalë të tjera, sistemi që krijoi bankat qendrore.

Një nga gjërat e para që bëri Kompania Britanike e Indisë Lindore ishte përdorimi i spiunëve për të dobësuar ndikimin e Sikëve të cilët qëndronin prapa sistemit të kastave. Si pjesë e zakoneve indiane, sistemi i kastave u kthye në mënyrë të frikshme dhe raciste pas hyrjes britanike. Si rezultat i përpjekjeve të Nëntokës Shtetërore Britanike, ndodhën ndarje të thella në mes të Myslimanëve dhe Sikëve.

Në vitin 1813, qeveria britanike ripërtiri statutin e Kompanisë Britanike të Indisë Lindore për 20 vite të tjera. Në vitin 1833, parlamenti vendosi të zgjasë kohëzgjatjen e statutit edhe një herë për 20 vite të ardhshme. Megjithatë, zërat kritikë filluan të ngriheshin në Indi kundër sundimit të Kompanisë Britanike të Indisë Lindore. Rebelimi i vitit 1857 (i njohur ndryshe si Rebelimi i Sepojës) rezultoi që India të vihej nën kontrollin e drejtëpërdrejtë të Perandorisë Britanike dhe Mbretëresha Viktoria të marrë titullin Perandore e Indisë në vitin 1987. Kriza e urisë që ndodhi po atë vit shkaktoi vdekjen e më shumë se 2 milion indianëve, të cilët konsideroheshin të shtresave më të ulët. Përveç kësaj, gjatë tërë kohës së regjimit të Kompanisë Britanike të Indisë Lindore, më shumë se 6 milion njerëz nga shtresat më të varfëra humbën jetën për shkak të urisë.

Pas asaj kohe kontrolli i Nëntokës Shtetërore Britanike në Indi u rrit edhe më shumë. Individët e trajnuar në shkollat më të mira të Britanisë, u vendosën në pozitat kryesore gjyqësore dhe administrative të Indisë, si dhe në mediat të cilat patën një efekt të madh në shoqëri. Pasi që Nëntoka Shtetërore pati kontroll jo vetëm mbi vendin në përgjithësi, por edhe në principatat e pavaruara, ajo e kishte më të lehtë të ushtronte ndikimin kudo. Një komisioner britanik ishte caktuar të punonte me secilin princ. Ishte fakt i njohur gjerësisht, se komisionerët morën princërit nën kontrollin e tyre dhe i vëzhguan çdo lëvizje të tyre. Vendi nuk kishte aspak pavarësi ushtarake, ashtu si nuk kishin liri në politikën e brendshme apo politikën e jashtme. Me sundimin e Britanisë, gjithçka që zotëronte India u vu nën kontrollin e Nëntokës Shtetërore Britanike.

Dihet gjithashtu se tregtia e opiumit lulëzoi me kontributin e Nëntokës Shtetërore Britanike dhe u bë një nga mjetet më të rëndësishme të shfrytëzimit të Indisë. Robert Clive, një figurë e famshme në okupimin britanik të Indisë, mori nën kontroll e tij tokat më pjellore të opiumit deri në vitin 1765.¹⁷ Tregtia e drogës u bë pjesë e situatës së frikshme dhe raciste në rajon. Nëntoka Shtetërore Britanike mori kontrollin e administratës në Indi, të cilën e konsideronte një treg të mirë, shkaktoi përçarje në mes të njerëzve, përdori racizmin si levë, mori kontrollin e burimeve dhe filloi të menaxhonte trafikun e drogës, i cili i ndihmoi në forcimin e kontrollit mbi vendin.

Nga ajo ditë, India u bë qendër, përmes së cilës Nëntoka Shtetërore Britanike menaxhoi disa projekte të ndryshme propagandistike. Roli më i rëndësishëm administrative në këtë projekt u morë përsipër nga Kompania Britanike e Indisë Lindore. Kjo kompani, si një organizatë ombrellë për të gjitha organizatat e fshehta të ndërtuara për të formësuar çështjet

botërore, përbënte hapin e parë të Nëntokës Shtetërore Britanike në shekullin e 19-të, drejt qëllimit të saj për të sunduar botën.

Shoqëria Mbretërore

Britain sapo kishte dalë nga një luftë civile e përgjakshme në vitin 1660 dhe për këtë arsye kishte filluar një proces të komplikuar të rimëkëmbëmbjes. Shoqëria Mbretërore u themelua gjatë kësaj periudhe tensioni. Mbreti Charlesi i II-të, ishte i pasionuar me fizikën eksperimentale dhe prandaj hapi rrugën për themelimin e këtij institucioni. Siç do të rikujtojnë lexuesit, Shoqëria Mbretërore kishte në mes të anëtarëve të saj Tomas Huksleyn, ‘të ashtuquajturit bulldogu i Darvinit’ ku ai punonte me zell për të përhapur Darwinizmin. Siç u shpjegua më parë, qëllimi themelor i këtij institucioni ishte përhapja e ateizmit duke përdorur metodat më efektive të mundshme. Përhapja e Darwinizmit ishte një nga ato metoda.

Fillet e Shoqërisë Mbretërore shkojnë pas në kohë, në takimet e fshehta dhe jozyrtare të njohura si ‘Kolegji i Padukshëm’ të organizuara nga shkencëtarët londinezë për të debatuar për ‘filozofinë natyrore’ në vitin 1645. Ata shkencëtarë që u pranuan në Lozhat Operative Masonike nën sundimin e Vromwell, morën pjesë në mbledhjet e Lozhave Ateiste Masonike dhe në këtë mënyrë u bënë të afërtë me njëri-tjetrin. (Lozhat Operative Masonike ndërtuan katedrale, kështjella, dhe pallate në Mesjetë.)

‘Kolegjet e Padukshme’ u themeluan nga këta individë. Ky grup, u themelua nga *Rosicrucians* (një organizatë sekrete e themeluar në shekullin 16 në Evropë), frymëzuar nga filozofi britanik Sir Francis Bacon, e cila më vonë do të shndërrohej në Shoqërinë Mbretërore.

Është fakt i njohur se Shoqëria Mbretërore u themelua pasi filozofi homoseksual, Sir Francis Bacon zgjodhi homoseksualë të tjerë dhe se institucioni strehonte homoseksualë të shekullit të 17-të.¹⁸ Megjithëse, Shoqëria Mbretërore e kohës moderne nuk ka dëshirë të pranojë këtë fakt, shumë të dhëna historike do të dëshmojnë për këtë informacion. Në të vërtetë, një tjetër themelues i Shoqërisë Mbretërore, kleriku Dr. John Wilkins, ishte gjithashtu homoseksual. Wilkins mbajti takimet e para në shtëpinë e tij dhe në Kolegjin Wadham (Kolegji Wadham është pjesë përbërëse e Universitetit të Oksfordit) dhe aty vuri bazat e Shoqërisë Mbretërore. Një tjetër bashkëthemelues, Sir Robert Moray, ishte homoseksual Skocez, ndërsa Robert Boyle, një tjetër anëtar i cili më vonë do të zgjidhej president i Shoqërisë Mbretërore, ishte një homoseksual Irlandez.¹⁹

Me vetë faktin se Shoqëria Mbretërore, kohët e fundit i dha një çmim, Bruno Perreaut, një bashkëpunatori kërkimor në Universitetin e Kembrixhit, për punën e tij në temën "*Çfarë është Familja? Puna shoqërore dhe birësi nga homoseksualët në Francë dhe Mbretërinë e Bashkuar*", tregon se ky institucion ende mbështet pikëpamje të ngajshme.²⁰

Takimet që u mbajtën në Kolegjin Wadham në Oksford, në vitin 1648, luajtën një rol të madh në formësimin e Shoqërisë Mbretërore. Arsyeja kryesore pas themelimit të kësaj shoqërie nën maskimin e të qenurit shkencorë ishte ndihma për të ndërtuar idenë e evolucionit. Këto organizata dhe grupe sekrete siguruan bazën e mashtrimit të evolucionit, i cili nuk do të promovohet zyrtarisht deri në vitin 1800. Kjo lëvizje që filloi si një shoqëri e fshehtë e debatit për filozofinë natyrore, kishte për qëllim të prodhonte një gënjeshtër nën maskimin e shkencës. Në fillim të kësaj qëndronin kolegjet e padukshme të lartpërmendura, të cilat më pas u institucionalizuan nën udhëheqjen e administratorëve homoseksualë të përmendur dhe u emërua si Shoqëria Mbretërore.

Kuptimi mekanik i universit të Isaac Newtonit, i cili u zgjodh President i Shoqërisë Mbretërore në vitin 1703 dhe qëndroi në këtë pozitë deri në vdekjen e tij në vitin 1727, u përdor për të zhvilluar filozofinë antifetare të Shoqërisë Mbretërore. Të gjithë anëtarët e Shoqërisë Mbretërore dhanë kontributin dhe mbështetjen e tyre për Darwinin si para dhe pas botimit të librit të tij.

Themelet e para të Chatham House, e renditur si një ndër institucionet mbështetëse të veprimtarive të institucioneve të nëntokës shtetërore, u vunë gjithashtu nga Shoqërinë Mbretërore. Chatham House dhe institucionet tjera të cilat Nëntoka Shtetërore Britanike i shfrytëzon për intelegjencë dhe qëllime të tjera të ndryshme, do të trajtohen më në detaje në vijim.

Tryeza e rrumbullakë

Politikani britanik Cecil Rhodes, siç është shpjeguar më parë, ishte homoseksual dhe mbajti qëndrime raciste, duke favorizuar idenë e mbretërimit anglo-sakson në botë. Ai dëshironte që kjo etni të rritet dhe të sundojë botën. Në testamentin e tij të fundit, ai theksoi:

Unë pretendoj se ne jemi raca më e mirë në botë, dhe sa më shumë që e popullojmë botën është më mirë për racën njerëzore...Unë pretendoj që çdo hektarë i shtuar në territorin tonë do të thotë përhapje më e madhe e racës angleze.²¹

Duke përkrahur idenë e një dominimi anglo-sakson përmes okupimit territorial, Rhodes propozoi idenë e ndërtimit të një tryeze të rrumbullakët që më vonë do të punonte për të ndërtuar një shtet botëror që do të drejtohet nga britanikët. Rhodes ishte një politikan i vendosur në Afrikën e Jugut dhe ishte përgjegjës për okupimit me forcë të tokave të popujve autoktonë në përputhje me planet për dominim të egër në atë rajon. Për ta siguruar këtë gjë, ai vuri fiset vendase kundër njëri-tjetrit dhe nisi shumë kryengritje. Përmes këtyre revoltave, ai arriti të siguronte kontrollin e plotë të britanikëve në Afrikën e Jugut. Kapitujt e mëposhtëm do të trajtojnë në detaje praktikat Cecil Rhodes. Sidoqoftë, këto fjalë përmbledhin në mënyrë të përsosur, mendësinë shtypëse dhe brutale të Rhodesit: *'Unë preferoj tokën para zezakëve.'*²²

Deklarata e tjera të Rhodes në testamentin e tij, në lidhje me popullin indogjen afrikan dhe anglo-saksonët janë si në vijim:

Afrika është ende e gatshme për ne, është detyrë e jona të marrim atë. Është detyrë e jona të shfrytëzojmë çdo mundësi për të fituar më shumë territore dhe se duhet ne ta mbajmë këtë ide gjithmonë para syve tanë: më shumë territor nënkupton më shumë nga raca Anglo-Saksone, më shumë nga më të mirët, nga raca më humane dhe e ndershme që ka bota.²³

Kjo mendësi raciste, në fakt, është përmbledhje e bazës së të menduarit të Nëntokës Shtetërore Britanike. Gjatë të së njëjtës periudhë, kur u bë e qartë se Amerika e Veriut nuk do të merrej me metoda ushtarake, nëntoka shtetërore vendosi të përdorë dallimet racore si levë. Për këtë qëllim, Nëntoka Shtetërore Britanike, filloi të fokusohet në politikat eugjenike. (Eugjenike: ideja e përmirësimit të racës njerëzore, duke eliminuar të dobëtit dhe personat me aftësi të kufizuar dhe duke inkurajuar qiftëzimit e individëve të shëndetshëm). 'Tavolinat e rrumbullakëta' të Cecil Rhodes dhe Alfred Milnerit u bënë promovuesit kryesorë të kësaj politike.

Lëvizja e 'tryezës së rrumbullakët' krijoi një shoqëri 'eugjenike' në vitet e 1880-të dhe 1890-ta. Qëllimi i shoqërisë eugjenike u bazua në mendimet e sëmurura të 'rindërtimit të shoqërisë duke eliminuar racat e konsideruara inferiore'. Ky mendim i tmerrshëm darvinist ishte shumë i popullarizuar në qarqet e këtyre fondacioneve shumë kohë para se Darvini të dilte me idenë e tij, por u zbatua hapur si politikë vetëm pas Darvinit. Në këtë pikë, do të jetë e arsyeshme të kujtojmë se vetë Darvini ishte një tjetër projekt i hartuar dhe ideuar nga këto institucione. Duhet gjithashtu të theksohet se pioneri i ideve eugjenike në Britani, ishte kushëriri i Darvinit, Francis Galton. Djali i Darvinit, Leonard Darvini ishte mbrojtës dhe zbatues i kësaj ideologjie. Winston Churchill ishte gjithashtu një nga ata që mbështetën lëvizjen eugjenike.

Për këta njerëz, raca e vërtetë ishte raca anglo-saksone e përfaqësuar nga britanikët, ndërsa të tjerët ishin ata që duhet të eliminoheshin. Si pjesë e përpjekjeve të kryera për këtë qëllim, Amerika e Veriut, me rrënjët e saj kryesisht të bazuara në Perandorinë Britanike, ishte planifikuar si pjesë e shtetit të vetëm botëror anglo-saksone, ku pasuritë e të gjitha këtyre shteteve do të kontrolloheshin nga Britania.²⁴

Drejtuësit e tryezës së rrumbullakët besuan se për të arritur këtë qëllim, ata duhej të merrnin kontrollin e të gjitha materialeve të prodhimit, industrive financiare dhe organizatave shkencore të vendeve përkatëse. Ata donin të ndërtonin një strukturë, një lloj të 'shtetit policor', i cili do të ndërtonte një shtet të vetëm botëror duke i bërë Anglo-Saksonët sundimtarë, duke i eliminuar racat e tjera dhe kolonializuar pjesën e mbetur.

Lëvizja 'tryeza e rrumbullakët' e ideuar nga Rhodes e konsideroi Afrikën e Jugut si qendrën e perandorisë. Aparteidi, i cili u formësua në Afrikën e Jugut dhe dha masakra të tmerrshme, është rezultat i politikave raciste të këtij personi.

Struktura e Iluminatit që ishte pionere për themelimin e Tryezës së Rrumbullakët, më vonë përgatitën rrugën për organizatat tjera si, Grupi Bilderberg, Instituti Mbretëror i Çështjeve Ndërkombëtare i njohur ndryshe si Chatham House, CFR, Komisioni Triateral dhe Klubi i Romës. Të gjitha këto organizata u mbështetën nga Nëntoka Shtetërore Britanike dhe u krijuan për të ndihmuar në kryerjen e aktivitetëve ndërkombëtare të Nëntokës Shtetërore Britanike. (**Iluminati**: Shoqëri sekrete e themeluar më 1 Maj, të vitit 1776. Është pretenduar të ushtrojë kontrollin e mendimeve në përputhje me qëllimet e saj për të marrë kontrollin mbi qeveritë dhe korporatat me qëllim për të krijuar një Rend të Ri Botëror ku monarkitë do të shkatërroheshin, ndikimi fetar do të zbehej dhe rregulli shoqëror do të elemonohej).

Komiteti i 300-ve

Komiteti i 300-ve, i themeluar në vitin 1727, shërbeu si qendra e të gjitha organizatave sekrete të cilat punojnë për nëntokën shtetërore, përfshirë tryezën e rrumbullakët. Ndonëse aktualisht më së shumti punon për interesat amerikane, fillimisht u themelua nga aristokratët britanikë. Është fakt i njohur që ky institucion formëson politikën, tregtinë, bankat, mediat dhe ushtrinë. Komiteti prej 300-ve, i cili është mbajtur i fshehtë për një kohë të gjatë, në përgjithësi menaxhon dhe kontrollon organizata të shumta si, Chatham House, CFR, Grupi Bilderberg, Komisioni Trilateral, Frimasonerinë, Rosicrucian, Klubin e Romës, Korporatën RAND, PNAC (Projekti për Shekullin e Ri Amerikan – një think tank me seli në Washington, D.C.), dhe Shoqërinë Mbretërore. Në mënyrë që të mbajë nën kontroll institucionet e mëdha financiare si bankat qendrore dhe vetë qeveritë, ky grup përdor një rrjet që përfshin të gjitha grupet e tryezës së rrumbullakët, think tank-et dhe organizata të tjera të fshehta.²⁵

Është e ditur se shumë president të ShBA-ve, përfshirë Presidentin George H. W. Bush, morën vendime të ndikuara nga Chatham House, përderisa Chatham House i merr udhëzimet nga rrethi i lartë administrativ i Komitetit të 300-ve, i cili është i njohur gjithashtu si Olimpianët.²⁶ Emri Olimpianë simbolizon dëshirën e këtij grupi të lartëcekur për ta parë veten aq të fuqishëm sa të ashtuquajturit perënditë e Olimpikut dhe është e rëndësishëm gjithashtu në atë se shpjegon se sa lartë ky komitet e vlerëson vetën.²⁷ Nuk është më sekret që në Luftën e Gjirit të vitit 1991, ushtria amerikane u përdor në linjë me vendimet e Komitetit të 300-ve për të vendosur Kuvajtin nën kontrollin britanik.²⁸

Sipas hulumtimit të bërë nga Dr. John Coleman, Komiteti i 300-ve është i lidhur direkt me Kompaninë Britanike të Indisë Lindore. Është e pranuar gjerësisht se shumë zyrtarë të lartë të Kompanisë Britanike të Indisë Lindore ishin komunistë. Siç u shpjegua në faqet e mëparshme, tregtia e opiumit që pati një shtytje në Indi nën përkujdesjen e Kompanisë Britanike të Indisë Lindore, ndihmoi dhe forcoi shumë fillimisht kompaninë e më pas edhe Komitetin e 300-ve që u krijua si pjesë e kompanisë. Ndërsa u rrit me fluksin e parave, ky institucion me kohë mori fuqinë e mjaftueshme për të rregulluar punët e botës.

Si Kompania Britanike e Indisë Lindore ashtu edhe udhëheqësit e nëntokës shtetërore të lidhur me Komitetin e 300-ve ishin të njohur për urrejten e tyre të thellë ndaj feve Abrahamike: Hebraizmit, Krishterimit dhe Islamit. Iluminati veçanërisht, ishte një organizat sekrete e ngritur kundër këtyre besimeve. Fjalët e mëposhtme të Adam Weishaupt, themeluesit të Iluminatit, më 1 maj 1776, janë të një rëndësie të lartë, pasi ato na ndihmojnë të kuptojmë politikën e institucioneve të nëntokës shtetërore:

*Vëni re sekretin tonë: ...Nëse, për të shkatërruar krishterimin dhe të gjitha besimet tjera, ne kemi pretenduar se kemi fenë e vetme të vërtetë, mos harroni se qëllimi justifikon mjetet dhe se të mençurit duhet të përdorin të gjitha mjetet për të bërë mirë, të cilat mjete të ligjët i përdorin për të bërë keq. Kjo nuk mund të bëhet në asnjë mënyrë tjetër përveç përmes organizatave sekrete, të cilat gradualisht, dhe në heshtje, do të zotërojnë qeveritë shtetërore dhe do të përdorin ato mjete për të arritur këtë qëllim. Qëllimi i këtij urdhëri ishte të shkatërronte krishterimin dhe të rrëzonte qeveritë civile.*²⁹

Organizatrat e Nëntokës Shtetërore Britanike, të përqendruara rreth këtij mentaliteti, zhvilluan kauzat e tyre në përputhje me rrethanat. Që nga koha kur u vendosën për herë të parë, qëllimi i tyre kryesor ka qenë minimizimi i ndikimit të feve Abrahamike në shoqëri, eliminimi i qeverive civile përmes puçeve dhe zëvendësimi i tyre me qeveri të cilat u raportojnë atyre. Gazetari Jacob de Haas, një hebre hasidik britanik dhe një udhëheqës i hershëm i lëvizjes sioniste në

Shtetet e Bashkuara, deklaroi se treqind burra qeverisnin ngjarjet botërore, ata madje zgjedhën president të tillë si Wilson dhe delegatë që morën pjesë në konferencën e Lidhjes së Kombeve në Paris.³⁰

Burrështetasi gjerman Walther Rathenau shkroi si më poshtë në një kolumne, më 24 dhjetor të vitit 1921:

Janë vetëm treqind burra, secili nga ata njohin njëri-tjetrin dhe qeverisin me fatin e Evropës. Ata zgjedhin pasardhësit e tyre nga grupi i tyre. Këta burra kanë në duart mjetet për t'i dhënë fund formës së Shtetit, të cilën ata e konsiderojnë gjë të paarsyeshme.³¹

Për arsye të këtyre deklaratave, Jacob de Haas dhe Walther Rathenau u vranë në mënyrë misterioze.

Ne duhet të kujtojmë në këtë pikë se Komiteti i 300-ve vepron gjithashtu mbi premisën e të ashtuquajturër superioritet Anglo-Sakson, ashtu si tryeza e rrumbullakët dhe organizatat e tjera të kontrolluara nga Nëntoka Shtetërore Britanike. Për ta, një botë më e vogël është më e lehtë për tu sunduar. Për ta, burimet e botës janë të çmuara dhe nuk duhet të konsumohen nga njerëzit e 'tepërt'. Për ta, ekzistenca absolute e racës së tyre është zgjidhja e vetme për këtë 'problem'. Dr. John Coleman shpjegon objektivat e organizatave të fshehta të Nëntokës Shtetërore Britanike në vijim:

Urdhëri për të shumëzuar dhe nënshtruar tokën që gjendet te Zanafilla duhej përmbysur. Kjo bëri thirrje për një sulm ndaj krishterimit; shpërbërje e ngadaltë, por e sigurt e shteteve industrial; shkatërrimi i qindra miliona njerëzve, të quajtur nga Komiteti i 300-ve si 'popullsia e tepërt' dhe heqja e çdo udhëheqësi i cili guxon të qëndrojë në rrugën e planeve globale të Komitetit të 300-ve.³²

Komiteti i 300-ve, për të arritur këtë qëllim, adaptoi një politikë të rritjes dhe zgjerimi të ngjajshme me institucionet e tjera të cilat raportojnë tek Nëntoka Shtetërore Britanike. Kjo politikë kërkon veprime të caktuara. Planet për të ardhmen të bëra nga Komiteti i 300-ve, që kur u krijua për herë të parë, janë akoma të vlefshme sot dhe vihen në lëvizje hap pas hapi. Këto hapa mund të përmbliidhen si më poshtë:

* Komiteti i 300-ve, i cili përdor fuqinë financiare për të avansuar me politikën e tij të shfrytëzimit të të dobëtve, dëshiron një rend të ri botëror ku të gjitha fetë dhe politikat monetare drejtohen nga një dorë e vetme. Ky duhet të jetë një rend botëror i udhëhequr dhe i sunduar nga Britanikët. Ata besojnë se për të arritur këtë qëllim fetë duhet të merren nën kontroll. Përfaqësuesit e nëntokës shtetërore ndërtuan planet e tyre për krishterimin në vitin 1700, dhe që nga viti 1920 ata hartuan një plan ku të gjitha kishat do të unifikoheshin, pra do të ishin një. Në këtë mënyrë, ata nuk do të refuzonin të gjitha besimet menjëherë, ngase kishin frikë se mund të shkaktonin reagime të ashpëra. Ata donin të ishin në gjendje të kontrollonin të gjitha besimet nga një burim i vetëm përmes një kiske të vetme që do të përfaqësonte fenë e tyre të shpikur.

* Fitimi i kontrollit mbi qeverisjen e vendeve të pavarura mund të jetë i mundur vetëm pasi të jetë fituar kontrolli mbi sistemin shoqëror. Sidoqoftë, kjo mund të bëhet vetëm kur njerëzit si dhe udhëheqësit e tyre merren nën kontroll. Për ta arritur këtë gjë, Komiteti prej 300-ve hartoi një strategji që do t'i jepte fund të gjitha ndjenjave nacionaliste dhe patriotike në vendet e synuara. Ata besuan që sapo të ishin zhdukur vlerat nacionaliste, nuk do të mbetej asgjë për njerëzit për të luftuar dhe në këtë mënyrë do të ishte më e lehtë për ti kontrolluar këta njerëz, veçanërisht pasi udhëheqësit e tyre të frenohen. Kjo është pikërisht ajo që ndodhi në vendet si Iraku.

* Përhapja e homoseksualitetit dhe bërja e tij një sjellje e pranueshme në shoqëri është një objektiv i rëndësishëm për ta. Për këtë qëllim, homoseksualiteti lavdërohet në emisione, koncerte, lojëra sportive etj; homoseksualët janë sjellë veçanërisht në qendër të vëmendjes në shfaqjet televizive; homoseksualët që pretendojnë të jenë priftërinj dhe hoxhallarë vlerësohen publikisht; homoseksualiteti portretizohet si një mënyrë jetese e arsyeshme dhe madje e admirueshme në filma dhe seriale televizive, dhe vetë media vazhdon të përhapë idenë e gabuar se homoseksualiteti është një 'fakt i jetës' i pamohueshëm. Për më tepër, për vite me radhë, ka pasur përpjekje sistematike për të larguar dhe heshtur këdo që refuzon nocionin e homoseksualitetit për shkak të bindjeve të tij morale ose fetare, si dhe përpjekje të vazhdueshme për të justifikuar këtë akt. Kjo ide propagandohet në masë të madhe në shkolla, homoseksualët diskriminohen pozitivisht në klubet e shkollës dhe studentët të cilët nuk e aprovojnë homoseksualitetin dëbohen nga rrethi shoqëror; të gjitha këto si pjesë e së njëjtës përpjekje inxhinierike shoqërore.

* Komiteti i përmendur gjithashtu kërkon të rrisë sasinë e drogave në treg, t'i bëjë ato të ligjshme dhe të ngritë nivelin e rënies morale në shoqëri. Institucioni i familjes është objektivi numër një, sepse të gjithë e dinë se shoqëritë e privuara nga vlerat familjare do të jenë më të prirura të degjenerohen. Bërja e të rinjve të ndjehen të pashpresë dhe pa ambicie është pjesa më e rëndësishme e këtij plani. Ata supozuan se papunësia do të ushqente këto ndjenjat dhe ashtu si Komiteti prej 300-ve, administratorët e Klubit të Romës vendosën që rritja e papunësisë do t'i çonte të rinjtë në dëshpërim. Ata arritën në përfundimin se të rinjtë në një gjendje të tillë shpirtërore do të ishin më të prirur për përdorim të drogës dhe për degjenerim si dhe institucioni i familjes do të binte si rezultat. Duhet theksuar se shkatërrimi i institucionit të familjes ka qenë gjithashtu prioritet kryesor i lëvizjeve komuniste. Drejtuesit komunist-socialistë të Komitetit të 300-ve të cilët synojnë shkatërrimin e familjeve nuk paraqet asnjë befasi.

* Komiteti gjithashtu u përpoq të shpopullonte qytetet e mëdha. Masakrat e kryera gjatë kohës së Pol Potit dhe Stalinit ishin metoda të ndjekura për këtë qëllim. Duhet të theksohet se planet e masakrës së Pol Potit janë mbikëqyrur nga Thomas Enders, një anëtar i Klubit të Romës dhe zyrtar i lartë në Departamentin e Shtetit Amerikan. Është gjithashtu një fakt interesant se Komiteti prej 300-ve po kërkon të rikthejë përgjegjësitë e masakrës së Kamboxhias.³³

* Të gjitha studimet shkencore përveç atyre që shërbejnë për qëllimet e Komitetit u ndaluan. Kjo ishte e vërtetë veçanërisht në lidhje me teorinë e evolucionit. Sot, provat shkencore e zhvlerësojnë qartë teorinë e evolucionit. Sidoqoftë, siç u shpjegua më parë, kjo teori është një gënjeshtër e zhvilluar nga ky komitet dhe organizatat tjera shoqëruese, të cilat janë nën shërbim të planeve të Nëntokës Shtetërore Britanike. Për këtë arsye, është jetike për ta që provat që hedhin poshtë teorinë e evolucionit të mos dalin në dritë, ose të mësohen në shkolla apo të nxirren në pah në çfardo mënyre. Kjo është arsyeja pse më shumë se 700 milion fosile të zbuluara deri më tani janë mbajtur në mënyrë të fshehtë sepse asnjë prej këtyre fosileve nuk kishte kaluar nëpër ndonjë ndryshim Me fjalë të tjera, është e qartë se këto fosile i përkasin specieve që nuk kishin kaluar në ndonjë proces të evolucionit. Në të vërtetë, asnjë fosil që supozohet se ka kaluar në ndryshimet e darvinit nuk është gjetur kurrë. Për më tepër, teoria e evolucionit po përballlet me një dilemë të madhe në nivelin molekular. Kjo është arsyeja pse kampi evolucionist po përpiqet të lidhë zhvillimet e fundit në shkencën molekulare me pikëpamjet e tyre evolucionare, megjithëse këto zhvillime hedhin gjithashtu poshtë plotësisht nocionin e evolucionit. Për shembull, ende nuk është shpjeguar nga evolucionistët se si një proteinë e vetme mund të krijohet vetë, siç dëshirojnë të pretendojnë evolucionistët. Është e pamundur që ata të japin ndonjë shpjegim shkencor sepse në mënyrë që një proteinë e vetme të krijohet, 100 lloje të ndryshme të proteinave duhet të jenë të pranishme dhe të ndihmojnë në prodhimin e asaj proteine të vetme. Kjo dilemë është një nga provat më të rëndësishme që shkatërron plotësisht idenë e evolucionit. Edhe pse teoria e evolucionit është një teori e dështuar, ekziston një përpjekje masive për ta mbajtur atë në jetë. Ky është edhe një shembull tjetër i inxhinierisë sociale intensive: diktatura e tanishme darviniste, mbajtja e shkollave, universiteteve, pozicioneve akademike, mediave, botimeve shkencore, madje edhe qeverive nën kontrollin e tyre, është produkt i Komitetit prej 300-ve dhe anëtarëve të tij.

* Shpopullimi ka qenë gjithmonë objektivi kryesor i institucioneve të nëntokës shtetërore dhe Komiteti prej 300-ve ka hartuar strategjitë e tij në përputhje me këtë qëllim. Sipas kësaj strategjie, me luftërat e kontrolluara që do të fillojnë në vendet e zhvilluara, popullsia do të ulej, por situata do të rëndohej në vendet e botës së tretë. Në ato vende, epidemitë do të fillonin duke kujtuar projektin e tmerrshëm të shpopullimit të Thomas Malthusit, politikat e urisë të zbatuara nga Stalini do të përsëriteshin dhe në këtë mënyrë, Nëntoka Shtetërore Britanike do të kishte hequr qafe popullsinë që e konsideronte "të tepërt" (njerëzit e shënjestruar nga politika të tilla sigurisht që janë mbi këto pretendime). Qëllimi i tyre ishte të hiqnin qafe 'të ashtuquajtur turmë të tepërt' deri në vitin 2050, siç përmendet nga anëtarët e tryezës së rrumbullakët.

* Një metodë tjetër është shkatërimi i trazirave në vende të ndryshme duke nxitur kryengritje dhe çrregullime, duke përdorur kryesisht mediat si dhe disa servilë të tyre në vende përkatëse. Megjithëse krizat zakonisht fillojnë për arsye të vogla dhe të parëndësishme, qëllimi është përdorimi i metodave të ndryshme të propagandës për të shkaktuar irritim publike dhe për të filluar trazira të pandalshme. Me këtë politikë, ata synojnë të krijojnë një perceptim se këto vende nuk janë në gjendje të qeverisin vetë dhe se është e nevojshme që ato të futen nën

sundimin e Komitetit të caktuar. Ne mund të shohim zbatimin tinëzar të këtyre metodave në Lindjen e Mesme, Amerikën e Jugut, Afrikën, disa vende evropiane dhe madje edhe në Shtetet e Bashkuara.

Shtetet botërore drejtohen, fshehurazi ose në mënyrë të qartë, nga Nëntoka Shtetërore Britanike ndërsa publiku i tyre është plotësisht i pavetëdijshëm për ekzistencën e kësaj fuqie sunduese. Udhëheqësit dhe popujt përkatës paguajnë çmimin më të lartë për këtë gjë.

Filozofi dhe historiani britanik Lord Bertrand Russell, një anëtar i Komitetit të 300-ve, shpjegon pikpamjen politike që ai shpiku për Afrikën me fjalët e mëposhtme:

Nëse një qeveri botërore do të punojë normalisht, disa kushte ekonomike duhet të plotësohen. Lëndët e para janë thelbësore për industrinë ... Unë mendoj se ne duhet ta përfshijmë në pronësi të padëshirueshme, jo vetëm pronësinë nga individë ose kompanitë, por edhe nga shtetet e ndara. Lënda e parë, pa të cilën industria është e pamundur, duhet t'i përkasë autoritetit ndërkombëtar dhe t'u jepet kombeve të ndara..³⁴

Ky plan i përmendur nga Russell po zbatohet sot në një masë të madhe. Burimet natyrore të Lindjes së Mesme dhe veçanërisht të Afrikës janë kryesisht nën kontrollin e kombeve të ndryshme dhe të gjitha këto kompani, pavarësisht se përfaqësojnë në dukje kombet e tjera, në fakt kontrollohen nga Nëntoka Shtetërore Britanike. Lënda e parë në Afrikë kërkon industri, dhe pa ato industri, ata nuk janë në gjendje ta nxjerrin dhe përpunojnë atë. Sistemi në Afrikë u la qëllimisht në një gjendje kaq primitive dhe të dobët. Me këtë mekanizëm, burimet e pasura të Afrikës do të jenë nën kontrollin e vazhdueshëm të Nëntokës Shtetërore Britanike.

* Ka shumë 'mësues' dhe 'udhëheqës' në Komitetin e 300-ve dhe detyra e tyre e vetme është të bindin masat që ndryshime të mëdha 'thjesht ndodhin' dhe për këtë arsye duhet të pranohen.³⁵ Secila prej kryengritjeve, luftërave dhe grushtshteve të organizuara në vendet e ndryshme janë pasojë e këtyre politikave tinëzare 'të familjarizimit'.

* Kryengritjet, konfliktet dhe krizat e ndryshme të cilat fillojnë në vendet e ndryshme duhet të bëhen në emër të demokracisë. Pranvera Arabe, e cila premtoi 'demokraci', nuk filloi vetvetiu ose në mënyrë të pavarur, nuk ishte një kryengritje e papritur nga komunitetet që u informuan dhe u vetëdijshuan më shumë. Pranvera Arabe ishte një pjesë e planit për të marrë Lindjen e Mesme, plan i cili u formua nga komiteti dhe u përmend shumë vite më parë. Shteti i tanishëm i Sirisë, konflikti i pafund në Irak, Libi, Jemen dhe Lindja e Mesme që përballet me konflikte të vazhdueshme, është rezultat i planeve të hartuara me kujdes nga Nëntoka Shtetërore Britanike dhe tani planet e tyre po funksionojnë ashtu si i kanë paraparë.

* Bashkëpunimi me grupe të ndryshme terroriste, detyrimi i shteteve ligjore dhe qeverive të pavarura kombëtare që të fillojnë negociata me grup terroriste, është një detyrë tjetër e këtij komiteti. Sidoqoftë, për të arritur këto qëllime, janë treguar të kujdesshëm të përdorin fjalë të cilat devijojnë nga kuptimi i tyre i vërtetë: "demokracia", "të drejtat e njeriut", "të drejtat themelore dhe liritë". Këto fraza, të cilat janë natyrshëm të rëndësishme për vendet e botës, tani përdoren gjerësisht për grupet terroriste. Një shembull shumë i qartë i kësaj u përjetua në Turqi. Janë bërë përpjekje të vazhdueshme për të detyruar qeverinë turke të ulet në tryezë me organizatën terroriste PKK, por jo shumë kohë më pas, qeveria turke e kuptoi gabimin dhe për shkak të qëndrimit të vendosur të qeverisë turke dhe Presidentit Rexhep Tajip Erdogan, filloi një luftë e re kundër grupeve terroriste. Sidoqoftë, meqenëse ky qëndrim i ri nuk i shkonte aspak për shtat Nëntokës Shtetërore Britanike, Turqia ishte nën presion dhe kërcënim të vazhdueshëm nga Evropa dhe Mbretëria e Bashkuar për të mos u pranuar kurrë në Bashkimin Evropian. Në të njëjtën kohë, PKK u mor nën krahët e atyre njerëzve dhe institucioneve që ishin nën ndikimin e Nëntokës Shtetërore Britanike. Faqet vijuese do të merren me komplotet të cilat lidhen me PKK-në dhe sykofonët që ndihmojnë Nëntokën Shtetërore Britanike.

A kanë njohuri ShBA-të për Nëntokën Shtetërore Britanike

Udhëheqësit britanikë në shumicën e rasteve nuk përmbaheshin duke iu referuar qartë politikave të Nëntokës Shtetërore Britanike. Për shembull, sipas ish-kryeministrit britanik Benjamin Disraeli *'Qeveritë nuk qeverisin por thjesht kontrollojnë makinerinë e qeverisë, duke qenë se ato vetë kontrollohen nga një dorë e fshehtë'*.³⁶

Kjo është gjithashtu e vërtetë për ShBA-të. Ka qenë qëllimi i vazhdueshëm i Komitetit të 300-ve që të marrë përsipër të gjithë sistemin amerikan, nga ekonomia deri tek skena politike. Vërejtjet e mëposhtme të Theodore Roosevelt, i cili ishte gjithashtu një anëtar i Komitetit të 300-ve, mund të konsiderohen si një rrëfim i tij, duke deklaruar se qeveritë zakonisht drejtohen nga nëntoka shtetërore:

Pas qeverisë së dukshme qëndron e ulur në fron një qeveri e padukshme duke mos pasur asnjë lidhje dhe duke mos pranuar asnjë përgjegjësi ndaj njerëzve. Shkatërrimi i këtyre qeverive të padukshme, goditja e aleancave të shenjta në mes të bizneseve të korruptuara dhe politikës së korruptuar është detyra e parë e udhëheqësis së sotme.³⁷

Roosevelt pa dyshim se i referohet Nëntokës Shtetërore Britanike, e cili nuk ka asnjë përgjegjësi para njerëzve. Si një anëtar i Komitetit prej 300-ve, Roosevelt ishte i njoftuar nga afër me këto struktura të thella. Megjithatë ai i tha publikut të tij se 'kjo qeveri e padukshme duhej shkatërruar', ai e dinte në mënyrë të përsosur se në këto rrethana, do të ishte shumë e vështirë të shkatërrohej një strukturë të tillë.

Woodrow Wilson, Presidenti i 28-të i ShBA, tha fjalët në vijim në lidhje me këtë çështje:

Qeveria, e cila ishte krijuar për njerëzit, ka rënë në duart e bosëve dhe punëdhënësve të tyre, në shërbim të interesave të veçanta. Një perandori e padukshme është ngritur mbi format e demokracisë.³⁸

Kjo perandori e padukshme e cila sundon mbi të gjitha format e demokracisë është Nëntoka Shtetërore Britanike e cila operon përmes institucioneve dhe politikave dinake.

John F. Kennedy, Presidenti i 35-të i Amerikës, i cili u vra në rrethana misterioze, ishte një tjetër president i cili ishte i vetëdijshëm për kontrollin e Nëntokës Shtetërore Britanike mbi Shtetet e Bashkuara dhe nuk u përmbajt asnjëherë duke e theksuar këtë fakt. Ky qëndrim i sinqertë dhe përpjekjet për të ekspozuar Nëntokën Shtetërore Britanike ishin arsyt kryesore për vrasjen së tij. Kennedy punoi shumë për të stabilizuar sistemin bankar të Rezervës Federale gjatë administratës së tij, dhe kjo e vendosi atë drejtpërdrejt në llupën e nëntokës shtetërore. Komitetit, i cili bëri shumë 'përpjekje të gabuara' në ndërtimin e sistemit bankar të rezervave nuk i pëlqente aspak që sistemi u eliminua plotësisht në mënyrë të pavarur nga aprovimi i tyre.

Dr. John Coleman pohon se vrasja e Kennedy ishte një operacion i MI6 i kryer me ndihmën dhe asistimin e FBI dhe CIA. Duhet të theksohet se ka patriotë të vërtetë dhe njerëz të ndershëm në Shërbimin Informativ Britanik që kryejnë detyra të rëndësishme. Sidoqoftë, nuk duhet harruar se ashtu si shumë udhëheqës botërorë dhe shërbime të inteligjencës, shërbimi i inteligjencës britanike MI6 është gjithashtu nën ndikimin e Nëntokës Shtetërore Britanike.

Coleman shpjegon se Kennedy ishte privuar plotësisht nga të gjitha shërbimet e sigurisë dhe trupat e tij para vrasjes. Ai gjithashtu zbulon dokumente që sigurojnë prova se kërkesa nga Forcat e Armatosura të SHBA-ve për të mbrojtur Presidentin u refuzua nga shërbimi i inteligjencës. Sot është një fakt i njohur që vrasja e Kennedy ishte një punë e shërbimit sekret që kishte të gjitha karakteristikat e nëntokës shtetërore. Provat përkatëse do të shqyrtohen më tej në kapitujt vijues në lidhje me marrëdhëniet midis Mbretërisë së Bashkuar dhe SHBA-ve.

Pika më e rëndësishme është trajtimi i tmerrshëm që ju nënshtrohen presidentët të cilët sfidojnë sistemin. Kennedy shpesh ankohej për kontrollin e nëntokës shtetërore dhe nuk hezitonte ta shprehte atë në çdo rast. Fjalët e mëposhtme të Kennedy në fjalimin e tij përpara Shoqatës Amerikane të Botuesve të Gazetave në Hotel Waldorf-Astoria, New York City, më 27 Prill të vitit 1961, janë veçanërisht të rëndësishme për të zbuluar se sa ndikim ka nëntoka shtetërore në qeveritë legjitime:

Vetë fjala 'sekret' është e neveritshme në një shoqëri të lirë dhe të hapur; dhe ne si një popull jemi historikisht kundër shoqërive të fshehta, betimeve të fshehta dhe procedurave të fshehta. Ne jemi kundërshtuar në të gjithë botën nga një komplot monolit dhe i pamëshirshëm që mbështetet kryesisht në mjete të fshehta për zgjerimin e sferës së saj të ndikimit - në infiltrim në vend të pushtimit, në përmbysje në vend të zgjedhjeve, në frikësim në vend të zgjedhjes së lirë. Është një sistem që ka rekrutuar burime të mëdha njerëzore dhe materiale në ndërtimin e një makine të fuqishme, shumë efikase që ndërthur operacione ushtarake, diplomatike, ekonomike, shkencore politike dhe të inteligjencës. Përgatitjet nga ky sistemi fshihen, nuk botohen. Gabimet e tyre janë djegur, nuk

janë bërë publike. Disidentët e tyre heshten, nuk lavdërohen. Asnjë shpenzim nuk vihet në dyshim, asnjë sekret nuk zbulohet. ... Po kërkoj ndihmën tuaj në detyrën e jashtëzakonshme të informimit dhe paralajmërimit të popullit amerikan. ... I sigurt se me ndihmën tuaj njeriu do të jetë ai që lindi për të qenë: i lirë dhe i pavarur..³⁹

Kjo analizë shumë e saktë nga Kennedy pati pasoja të tmerrshme për të. Ky është një shembull shumë i rëndësishëm se si frikësohen udhëheqësit që punojnë për të ekspozuar nëntokën shtetërore. Shumë udhëheqës u shtypën me metoda të ngjashme dhe u detyruan të nënshtrohen. Me fjalë të tjera, edhe superfuqitë si Amerika nuk mund të mbrojnë veten nga të qenit skllav i këtij sistemi të tmerrshëm.

Qëllimi i fundit: 'Një ShBA Komuniste'

Ne kemi parë se Nëntoka Shtetërore Britanike ka marrë gjithashtu kontrollin e ShBA-ve, ashtu si ka marrë kontrollin e pjesës tjetër të botës. Deklaratat e mësipërme nga Presidentë të ndryshëm të ShBA-së vetëm se e konfirmojnë këtë të vërtetë. Ndikimi i Nëntokës Shtetërore Britanike në Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të shqyrtohet më tej në kapitujt vijues.

Sidoqoftë, duhet theksuar se Komiteti prej 300-ve, dhe komitetet e tjerë të ngjashëm që raportojnë në Nëntokën Shtetërore Britanik, janë vetëm pjesë të vogla të përpjekjes për të bërë "ShBA-n një komb komunist". Përpjekjet për të arritur këtë qëllim kanë vazhduar deri më sot dhe janë bërë edhe më të qarta me dy mandatet presidenciale socialiste të Presidentit Obama.

Organizimi i Komitetit prej 300-ve është identik me organizimin e organizatës më të vjetër tregtare britanike e cila me kohë u shndërrua në Kompaninë Lindore të Indisë, e cila më vonë u shndërrua në Kompaninë Britanike të Indisë Linore, ata besonin se sapo një rregull komunist dhe kontroll britanik të vendoseshin thellë në ShBA, marrja e kontrollit mbi vendet e tjera të zhvilluara do të ishte më e lehtë.⁴⁰

Kompania Britanike e Indisë Lindore ishte një institucion nëntokësor që prezantoi dhe instaloi komunizmin në të gjithë botën. Si rezultat i përpjekjeve të tyre, komunizmi u përhap thellë në shoqëri dhe vende të ndryshme. Ata besuan se sistemi komunist duhet gjithashtu të lëshojë rrënjë në Amerikë, sepse vetëm atëherë ShBA-të do të ktheheshin në rrënjët e tyre dhe do të binin përfundimisht nën sundimin britanik. Mënyra për të arritur këtë gjë, ishte duke eliminuar shtetet kushtetuese. Nëntoka Shtetërore Britanike ka punuar prej shumë kohësh për të arritur këtë synim.

Dr. John Coleman, përmes hulumtimeve të tij, zbuloi se ishte Kompania e Indisë Linore dhe Instituti i Marrëdhënieve të Paqësorisht që raportonin tek Komiteti i 300-ve, tek komiteti i cili financoi sulmin në Pearl Harbour të ekzekutua më 7 dhjetor të vitit 1941.⁴¹ Siç do të kujtojnë lexuesit, ishte pikërisht ky sulm arsyeja se pse ShBA-të hynë në Luftën e Dytë Botërore si një aleat i shtetit britanik. Ky sulm i dha Roosveltit arsyen e nevojshme për t'u bashkuar në luftë me britanikët. Për më tepër, pas këtij sulmi, u bë më e lehtë përhapja e propagandës se Gjermania po kërkonte të pushtonte ShBA-në. Kështu, ishte siguruar e gjithë shtypa artificiale e nevojshme për pjesëmarrjen e ShBA-ve në luftë.

Dokumentet sekrete zbulojnë se Roosevelt ishte në dijeni për sulmin në Pearl Harbor një muaj para se të ndodhte. Pas sulmit, u përhapën thashethemet se japonezët po planifikonin sulme të tjera, këto thashetheme dërguan në bombardimin e Tokios, ku qindra mijëra njerëz humbën jetën, e më vonë më shumë jeta u humbën në lëshimin e bombave atomike që shkaktuan dy katastrofa historike. Kjo 'mbështetje e ShBA-ve' siguroi fitoren e aleatëve britanike në luftë.

Është e qartë se ShBA-të, pavarësisht fuqisë së tyre, nuk mund të largonin ndikimin dhe kontrollin e Nëntokës Shtetërore Britanike. Plani për të bërë ShBA-në, një vend komunist është një dredhi që Nëntoka Shtetërore Britanike ka ndjekur për një kohë të gjatë dhe për të arritur këtë synim ka zbatuar hapa të kujdesshëm. Ka pasur raste kur ky plan për ShBA-të u bë më i dukshëm. Së pari, identiteti anti-komunist i ShBA-ve u theksua kur vendi luftoi në Kore dhe Vietnam për të përmbushur këtë paraqitje. Kjo ishte një pjesë e planit të Nëntokës Shtetërore Britanike, i cili kërkonte të çimentonte idenë se fuqia imprealiste e botës ishte padyschim kundër komunizmit. Sidoqoftë, ndërsa kjo ndodhi, fazat e krijuara për të dërguar ShBA-në, në komunizëm gjithashtu u vunë në praktikë në një mënyrë graduale. Sot, si rezultat i kësaj strategjie të kujdesshme, ShBA-të janë aktualisht më pranë komunizmit se asnjëherë më parë.

Lideri Socialist i ShBA-së Antikomuniste

Barack Obama shërbeu si President i ShBA-ve për dy mandate. Kur u zgjodh për herë të parë, retorika e tij kundër luftës, prejardhja racore si dhe rrënjët myslimane të paraardhsëve të tij, i kishin fituar mbështetje të madhe në grupin e njerëzve fetarë si dhe në grupin i cili ishte kundër luftës. Me përfundimin e mandatit të tij, u bë e qartë se ai nuk arriti të mbante premtimet e tij, si tërheqjen e ushtarëve amerikanë nga Lindja e Mesme ose mbylljen e objektit të Guantanamo. Në të vërtetë, Forca Ajrore e ShBA-ve është ende e pranishme në Lindjen e Mesme. Ajo që është veçanërisht e dukshme janë tendencat socialiste-komuniste të Obamas, të cilat vetëm pak kohë më parë u bënë të qarta.

Kur Obama fitoi një vend në Senat, Partia Komuniste e Amerikës bëri një deklaratë zyrtare dhe tha: *'Kjo ishte një fitore historike. Ishte një fitore për pavarësinë politike'*. Kur u zyrtarizua mandati presidencial i Obamas, partia në fjalë shkroi në faqen e saj të internetit: *'Partia jonë në mënyrë aktive e mbështeti Obaman gjatë zgjedhjeve paraprake'* Në të vërtetë, lideri i Partisë Komuniste të Amerikës, John Bachtell pranoi se në vitin 2015 mbështetën oferën zgjedhore të Obamas në të gjitha shtetet.

Kur Obama fitoi zgjedhjet në Iowa në vitin 2004, gazeta e Partisë Komuniste të Amerikës festoi me fjalët e mëposhtme:

Fitorja e Obamas ishte më shumë se një lëvizje progresive; ishte një kapërcim dialektik që çon në një epokë të re të luftës.. Një herë Marksi e krahasoi luftën revolucionare me punën e urithit, i cili nganjëherë gërmon aq thellë nën tokë sa nuk lë gjurmë të lëvizjes në sipërfaqe. Ky është gërmimi i vjetër revolucionar, jo vetëm që tregon gjurmët e tij në sipërfaqe, por edhe në thellësi..⁴²

Obama gjatë një interviste për David Mendel shpjegoi se kur ai ishte më i ri merrte pjesë në konferencat komuniste dhe i simpatizonte ato. Vlen të përmendet gjithashtu se mbështetësit kryesorë të Obamas në ofertën e tij presidenciale ishin zakonisht njerëz me prejardhje komuniste dhe marksiste. Për shembull, Bill Ayers dhe Bernardine Dohrn, të cilët filluan dhe menaxhuan fushatën dhe garën për senat të Obamas, ishin dy marksistët më radikalë të luftës në Vietnam. Alice Palmer, një politikane që prezantoi Obaman në politikë dhe që njihet gjithashtu si mentore e tij, është gazetarja e parë afrikano-amerikane që u lejua të hynte në Bashkimin Sovjetik dhe të merrte pjesë në Kongresin e 27-të Komunist. Familjet e Valerie Jarrett dhe David Axelrod, dy ndihmësve më të afërt të Obamas, janë komunist të famshëm. Gjithashtu, kisha e Obamas njihet si një ndër kishat që ndjek besimin neo-marksiste libertarian. Addie Wyatt, një nga pastorët e kësaj kisha, i cili është gjithashtu një nga mentorët e Obamas, është anëtar i Partisë Komuniste të Amerikës.

Programi ekonomik i zbatuar nga Obama konsiderohet një program Marksist-Leninist.

Klubi i Romës

Nga vitet 1940, Elizabeta, Mbretëresha e Anglisë, po sundonte mbi 31 vende. Ajo zotëronte një të gjashtën e të gjitha tokave në botë, e cila kishte një vlerë totale prej 28 trilionë dollarë amerikanë. Me ndërrimin e ekuilibrave në botën e pas Luftës së Dytë Botërore, Nëntoka Shtetërore Britanike u detyrua t'i drejtohet organizatave të tjera. Klubi i Romës ishte një prej tyre.

Shumë njerëz mendojnë se Klubi i Romës është një organizatë autonome sepse është e vendosur në Romë dhe është e lidhur me Kishën Katolike. E vërteta është se Klubi i Romës është një pjesë e rëndësishme e Komitetit prej 300-ve dhe funksion si një degë e Nëntokës Shtetërore Britanike, vetëm se vepron me një emër tjetër.

Klubi i Romës dhe Bilderberg Group janë institucionet më të rëndësishme të politikës së jashtme të Komitetit të 300. 'Një shtet i vetëm botëror' që u përmend shkurtimisht gjatë shqyrtimit të qëllimeve të Komitetit prej 300-ve ishte synuar të vihej në praktikë nga Klubi i Romës. Shteti i vetëm botëror i referohet një rendi botëror të udhëhequr vetëm nga Nëntoka Shtetërore Britanike, ku të gjitha burimet do të jenë në dispozicion të tyre. Sipas këtij plani, do të kishte një 'fe të vetme' krejtësisht të ndryshme nga fetë Abrahamike që do të mblidhte njerëzit rreth një besimi të rremë. Ata e planifikuan këtë pseudo-fe sepse e dinin se ishte e pamundur t'i bënin njerëzit të humbnin besimin e tyre. Ata shpresuan që kjo qasje gradualisht do t'i bënte njerëzit të largoheshin nga fetë hyjnore dhe të vinin në një pikë ku njerëzit do t'i nënshtroheshin lehtësisht Nëntokës Shtetërore Britanike.

Plani për këtë rend të vetëm botëror u bë më i qartë në veçanti pas viteve 1990, por rrënjët e tij shkojnë pas që prej shekujsh. Nga themelimi i Shteteve të Bashkuara të Amerikës tek lufta civile, të gjitha detajet u planifikuan me kujdes për të siguruar ekzistencën e strukturës së përmendur. Dr. John Coleman shkruan se amerikanët janë njerëzit që janë mashtruar më së shumti nga Nëntoka Shtetërore Britanike gjatë gjithë historisë botërore. Ai pohon se degjenerimi i tanishëm moral në shoqërinë amerikane është rezultat i drejtpërdrejtë i këtij ndikimi dhe pohon se për herë të parë në historinë e tyre amerikanët po e ndjenjtë këtë rënien kaq shumë. Për Coleman, e gjithë kjo është rezultat i drejtpërdrejtë i aktiviteteve të Komitetit të 300-ve dhe lidhjes së tij me Klubin e Romës, të dy këto klane raportojnë tek Nëntoka Shtetërore Britanike.

Detyra e Klubit të Romës është të zhvillojë dhe përhapë ide anti-industriale, veçanërisht në Shtetet e Bashkuara. Krijimi i shoqërive të varfëra, largimi i njerëzve nga bindjet e tyre fetare, udhëheqja e njerëzve dhe veçanërisht të rinjtë drejt depresionit në një përpjekje për të krijuar breza lehtësisht të manipulueshëm dhe pa qëllim për jetë kanë qenë ndër synimet kryesore të këtij grupi. Përhapja e përdorimit të drogës, përhapja dhe bërja e homoseksualitetit akt të pranueshëm, përhapja e adhurimit të shejtanit, iluzionet dhe besime të tjera të ngjashme të shtrembëra dhe ndërtimi i sekteve pabesimtare kanë qenë qëllimet e tyre të tjera.

Në librin e titulluar *Koha, Perspektiva dhe Morali* botuar nga Komiteti i 300-ve, autori Bernard Levin flet për qëllimet e mëposhtme të Klubit të Romës:

Një nga teknikat kryesore për thyerjen e moralit, përmes një strategjie terrori, konsiston pikërisht në këtë taktikë: mbajeni personin të mjegullt për atë se ku ai qëndron dhe se çfarë ai mund të presë. Për më tepër, nëse lëkundjet e shpeshta midis masave të rënda disiplinore dhe premtimeve për trajtim të mirë, së bashku me përhapjen e lajmeve kontradiktore, e bëjnë të paqartë situatën, atëherë individit mund të pushojë së ditur nëse një plan i veçantë do të çonte atë drejt ose larg qëllimit të tij. Në këto kushte, edhe ata individë që kanë qëllime të përcaktuara dhe janë të gatshëm të rrezikojnë janë të paralizuar nga konflikti i brendshëm në lidhje me atë se çfarë duhet të bëjnë.⁴⁴

Sot, shumë njerëz po vuajnë për shkak të këtij plani tinëzar. Duke luftuar me një konfuzion masiv, këta njerëz tani kanë humbur vlerat e tyre morale, qëllimet dhe motivin e jetës. Prandaj, shoqëritë e tilla me kohë shndërrohen në masa pothuajse të kontrolluara nga Nëntoka Shtetërore Britanike. Duke parë situatën aktuale, ky plan duket se po funksionon në shumë pjesë të botës, përfshirë ShBA-të.

Por një gjë duhet të mbahet mend: Zoti gjithmonë do të shkatërroj planet e mbrapshta::

A nuk e ke parë ti se çfarë bëri Zoti juaj me njerëzit e Elefantit? A nuk i kthej Ai të gjitha skemat e tyre në asgjë? (Kur'an, 105:1-2)

Organizata të tjera Sekrete të kontrolluara nga Nëntoka Shtetërore Britanike

Nëntoka Shtetërore Britanike u infiltrua në këto organizata, mirëpo u përhap edhe më shumë gjithashtu përmes shoqatave familjare, këshillit mbretëror dhe organizatave tjera. Këto janë pjesë të rëndësishme të politikave të sundimit botëror të filluar nga Kompania Britanike e Indisë Lindore, dhe për të vazhduar më tutje me Tryezën e Rrumbullakët dhe Komitetin prej 300-ve. Le t'i analizojmë këto grupe shkurtimisht:

Këshilli i Kurorës i 13-të

Në mes të grupeve të cilat sundojnë botën si pjesë e Nëntokës Shtetërore Britanike, ekziston një grup i quajtur si 'Këshilli i Kurorës i 13-të'. Ky grup përbëhet nga familjet më të fuqishme dhe më të pasura në botë dhe mund të japë udhëzime madje edhe për Komitetin prej 300-ve përderisa vendos për çështjet botërore të cilat janë në tavolinë.

Illuminati është termi më i vjetër që përdoret për t'iu referuar këtyre 13 familjeve të gjakut. Askush nuk mund të vërë në dyshim kompetencat ose kufijtë e këtyre 13 familjeve, të cilat janë gjithashtu anëtarë të lartë të shumë organizatave sekrete dhe burokracive shtetërore.

Piramida 13 hapëshe, e cila paraqitet në kartëmonedhën e dollarit është diagrami organizativ i këtyre fuqive që dëshirojnë të sundojnë botën. Illuminati vendosi ta përdorë këtë markë si simbol më 1 maj të vitit 1776 dhe për t'iu referuar kësaj date ata vendosën datën MDCCLXXVI (viti 1776) në shkallën e poshtme të piramidës (e cila shfaqet në kartëmonedhën amerikane të një dollari). Shumë njerëz gabimisht besojnë se kjo ishte një datë që i referohej Pavarësisë Amerikane. Në maje të kësaj piramide, ekziston një sy, i njohur me fjalët e tyre si 'Syri i Arkitektit të Madh të Universit'. Duke zbritur në piramidë, Këshilli i Kurorës i 13-të pasohet nga Këshilli 33 dhe Komiteti prej 300-ve. Në të vërtetë, askush nuk e di saktë se kush i përbën këto këshilla dhe komitete.

Instituti Tavistock

Klinika Tavistock u themelua në vitin 1921 nga John Rawlings Rees, një oficer mjekësor në Trupat Mjekësore të Ushtrisë Mbretërore. Klinika Tavistock, e cila operoi si një organizatë e shëndetit mendor gjatë Luftës së Dytë Botërore, u rindërtua dhe u zgjerua në vitin 1946 me përkrahjen dhe fondet e Fondacioni Rockefeller. Pasi u emërua si Instituti Tavistock, Fondacioni Rockefeller i caktoi këtij instituti detyrën për hulumtime dhe studime mbi luftën. Arena kryesore e zbatimit praktik të hulumtimeve të këtij instituti, megjithëse e shpërndarë në shumë vende nëpër botë, ishte në ShBA. Instituti dhe punimet e tij vazhdojnë të jenë sekretë më i ruajtur i ShBA-ve.

Instituti Tavistock është veçanërisht i frymëzuar nga hulumtimi i psikoanalistit të famshëm Sigmund Freud mbi 'kontrollin e sjelljes njerëzore'. Instituti u përpoq të kontrollonte sjelljen njerëzore dhe të formësonte komunitetet në përputhje me interesat e tyre. Kjo ishte planifikuar si një metodë për të marrë shoqërinë nën kontroll duke përdorur metoda psikologjike.

Sot instituti ka një rrjet të gjerë të bashkëpunimit me institucione të njohura duke përfshirë Universitetin e Sussex, Institutin për Hulumtime të Stanfordit, Institutin Esalen, Institutin për Teknologji të Massachusetts (MIT), Institutin Hudson, Fondacionin për Ruajtje të Trashigimisë, Qendrën për Studime Strategjike dhe Ndërkombëtare në Universitetin Georgetown (CSIS), Forcat Ajore të Intelegjencës, Korporatën RAND, Korporatën MITER, Shoqërinë Mont Pèlerin, Komisioni Trilateral, Fondacionin Ditchley dhe Klubin e Romës. Të gjitha programet OSS (Zyra e Shërbimeve Strategjike) dhe CIA janë zhvilluar nën mbikëqyrjen e Institutit Tavistock.

Sot Instituti Tavistock operon me një rrjet fondacionesh prej 6 miliard dollarë amerikanë në vit vetëm në Shtetet e Bashkuara⁴⁵ dhe përshkruan misionin e tij strategjik si shndërrim nga kombet-shtete industriale në një shtet botëror post-industrial si dhe transferimin e rendit shoqëror te oligarkët. Me fjalë të tjera, qëllimi i këtij institucioni është që të ndërtojë 'shtetin e vetëm botëror' nën mbikëqyrjen e Nëntokës Shtetërore Britanike, qëllim i cili është i njëjtë me të gjitha organizatave e tjera sekrete.

Detyra e ndërmarrë nga Instituti Tavistock për të arritur këtë qëllim ishte afrimi i njerëzve përmes mënyrave psikologjike dhe dobësimi i fuqisë së tyre me efekte psikoanalitike. Metoda kryesore ishte zhvillimi i mënyrave për të ndikuar te njerëzit. Në këtë aspekt, ata shpresuan se njerëzit nuk do të kundërshtonin diktatorët e nëntokës të emëruar nga Nëntoka Shtetërore Britanike ndërsa bota lëvizte drejt shtetit të vetëm botëror-komuniste. Për këtë qëllim, shkencëtarët në Institutin Tavistock punuan për vite me radhë në zhvillimin e mënyrave për të dobësuar lidhjet familjare, shkatërruar vlerat si, besimin, nderin dhe ndjenjat patriotike me qëllim për t'i zëvendësuar ato me sjellje degjeneruese siç janë perversiteti dhe homoseksualiteti.

Instituti Tavistock vazhdimisht punon në shpërlajen masive të trurit të masave dhe shpesh i vë këto teknika në provë në shoqëri të ndryshme. Ata projektojnë incidente që do t'i lënë njerëzit të frikësuar, të shqetësuar dhe të traumatizuar, pastaj i studiojnë rezultatet nga terreni dhe punojnë për të ndryshuar gjendjet e tyre psikologjike dhe neurologjike. Kur shqetësimi bëhet pjesë e shoqërisë, bëhet shumë më e lehtë për të manipuluar masat. Duhet të mbahet mend se një nga qëllimet kryesore të Nëntokës Shtetërore Britanike ka qenë gjithmonë marrja e shoqërive nën kontrollin e tyre.

Kafka dhe Kockat

Shoqëria 'Kafka dhe Kocka', është themeluar në Universitetin Yale në vitin 1832 nga William Huntington Russell dhe Alphonso Taft, është një komunitet studentor që është veçanërisht interesant për shkak të strukturës së saj sekrete dhe mënyrës së zgjedhjes së studentëve të saj. Megjithëse është i vendosur në Universitetin e Yale, është i lidhur me Nëntokën Shtetërore Britanike. Universiteti Yale mban emrin e Elihu Yale, i cili kishte shkuar në shkollë në Britani dhe kishte punuar si guvernator i Kompanisë Britanike të Indisë Lindore. U shpjegua më herët sesi Kompania Britanike e Indisë Lindore, ishte në shumë mënyra, qendra nga e cila linden shumë organizata sekrete dhe që fillimisht ndihmoi në organizimin dhe kryerjen e aktiviteteve të fshehta të Nëntokës Shtetërore Britanike. Elihu Yahe, pasi bëri shumën të mëdha parash brenda kompanisë, u kthye në Britani për të vazhduar me operacionet e fshehta atje. Për shkak të donacioneve që ai dërgoi në një shkollë në Connecticut, kolegji u riemërua si Yale në vitin 1718.⁴⁶

Kushtet për t'u bërë anëtar i Skull and Bones përfaqësohen me frazën BASP, e cila qëndron për: B=Bardhë, AS=Anglo-Sakson dhe P=Protestant. Me fjalë të tjera, origjina anglo-saksone dhe besimi protestant janë kërkesa për anëtarësimin. Udhëheqësit kujdesen që anëtarët e rinj të kenë qenë anglo-saksonë dhe protestantë për 6 deri në 7 brezat e kaluar. Me fjalë të tjera, origjina e tyre duhet të jetë në Angli dhe njerëzit me origjinë dhe besime të tjera nuk pranohen.

Ky institucion po punon gjithashtu për të ashtuquajturën idenë e fesë së vetme botërore. Prandaj, besimi protestant është vetëm një pretekst për të garantuar origjinën anglo-saksone, sepse ashtu si organizatat e tjera të ngjashme, ky grup nuk është grup fetar por përkundrazi, kërkon që të përhapë ateizmin.

Askush nuk ka qasje në listën e anëtarëve, përfshirë administratën e universitetit. Vetëm 15 persona pranohen në vit në këtë grup dhe këta njerëz më vonë emërohen në pozicione kyçe në vend. Familjet dhe miqtë e anëtarëve gjithashtu përfitojnë nga kjo anëtarësi. Pranimi është i mundur vetëm me ftesë dhe inaugurimi është shumë i ngjashëm me atë të masonëve. Ritet e tyre janë sekrete dhe asnjë informacion nuk mund të dalë jashtë organizatës.

Kjo shoqëri sekrete zakonisht konsiderohet si degë e Illuminatit në ShBA. I vetmi ndryshim është se shoqëria e përmendur në shumicën e rasteve fokusohet tek të rinjtë.

Shoqëria 'Kafka dhe Kockat' gëzon ndikim të madh. Ka lidhje direkte me Rosicrucians, Komisionin Trilateral dhe CFR-në. Ajo ka pasur më shumë se 2,500 anëtarë në 150 vitet e fundit dhe konsiderohet si një nga ideologët themeloretë të rendit të ri botëror. Nëntoka Shtetërore Britanike e përdor këtë organizatë si një levë të rëndësishme për të mbajtur Shtetet e Bashkuara nën kontroll. Me anë të kësaj dhe organizatave të tjera të ngjashme, ajo drejton të gjitha operacionet nga Evropa dhe ka një ndikim të drejtpërdrejtë në politikën e brendshme dhe të jashtme të ShBA-ve.

Drejt Rendit të Ri Botëror: Një Shtet i Vetmë Botëror

Përveç organizatave të përmendura më lartë, Nëntoka Shtetërore Britanike ka operuar përmes nën-organizatave si Shoqëria Mont Pèlerin, Bohemian Grove, dhe Rosicrucians. Kjo strukturë u përpoq të arrijë qëllimin e saj për 'shtetin e vetëm botëror' përmes këtyre organizatave dhe siç shpjegohet nga Cecil Rhodes, vendosi një udhërrëfyes të përqendruar në ekzistencën dhe sundimin e anglo-saksonëve. Këto operacione u kryen përmes fondacioneve të ndryshme duke filluar nga vitet 1700 dhe dërguan në skenat e tmerrshme që ne i shohim sot me metoda të ndryshme, si dobësimi i vendeve të fuqishme, apo edhe shkatërrimi i tyre si në rastin e Perandorisë Osmane, duke shfrytëzuar vendet e pasura me burime natyrore, duke i tërhequr njerëzit në dëshpërim si dhe duke ndjellur pasiguri në një mënyrë sistematike.

Sot, Nëntoka Shtetërore Britanike, është në gjendje të ndjek qëllimin e saj në mënyrë të lirshme dhe gjithëpërfshirëse si asnjëherë më parë. Për këtë arsye, operacionet e fshehta të kësaj organizate mafioze nuk kanë qenë kurrë më efektive. Siç ishte planifikuar fillimisht, tani darvinizmi mësohet në të gjithë botën, ndërsa përdorimi i drogës dhe degjenerimi moral kanë arritur nivele të papara, homoseksualiteti i imponohet shoqërisë si një "stil normal jetese" dhe çdo udhëheqës që guxon të kundërshtojë udhëzimet e Nëntokës Shtetërore Britanike largohet menjëherë nga pozita e tyre. Prandaj, për momentin, të gjitha vendet e botës, përfshirë Shtetet e Bashkuara, po veprojnë nën kontrollin e Nëntokës Shtetërore Britanike siç ishte planifikuar fillimisht në vitet 1700.

Shumë udhëheqës botëror marrin pjesë në takimet sekrete të mbajtura në organizatat si Chatham House, të cilat janë në përgjithsi nën ndikimin e Nëntokës Shtetërore Britanike. Pikat udhërrëfyese të udhëheqësve formohen gjithmonë pas atyre takimeve dhe vendimet e papritura dhe të rëndësishme merren gjithmonë nga këto organizata sekrete. Zemrat e këtyre institucioneve kanë qenë organizatat e para sekrete, siç u shpjegua më sipër. Për momentin, çdo zhvillim në botë, nga luhajtjet ekonomike deri tek krizat politike, nga vendimet e luftës deri te grusht shtetet ushtarake, ndodhin në përputhje me vendimet e marra në bazat e nëntokave shtetërore.

Është koha që kjo organizatë e fortë, e cila arriti t'i shmanget ekspozimit në një masë të madhe deri më tani – madje edhe kur u ekspozua ishte shumë e fortë për t'u kundërshtuar nga ata që e zbuluan atë - të ekspozohet dhe shfuqizohet. Ky operacion i fshehtë që e dërgon botën drejt racizmit, komunizmit, mosbesimit, homoseksualitetit, urisë dhe varfërisë, duhet të ekspozohet në çdo mënyrë. Duhet të dihet se autori i vërtetë nuk është gjetur kurrë deri më tani, dhe gjithmonë ka pasur devijime. Ajo që duhet të bëhet më tutje është të bëhemi të vetëdijshëm për dredhitë e kësaj organizate të fshehtë e cila kërkon të sundojë botën në përputhje me dëshirat e tyre, dhe të shohim konspiracionin ashtu si është.

Duhet të theksohet se qëllimi i vërtetë në këtë libër është për të ndihmuar njerëzit e përfshirë në Nëntokën Shtetërore Britanike dhe në strukturat tjera përkatëse për të korrigjuar gabimet e tyre. Me shpresë se ata do të kuptojnë gabimet e tyre me anë të provave konkrete të paraqitura në libër dhe do të frymëzohen për të korrigjuar gabimet e tyre. Duhet gjithashtu të theksohet se bota është arenë e betejës në mes të mbështetësve të *Mehdiut* dhe të *dexhallit*. Kjo duhet të jetë një betejë efektive e kryer në mënyrë intelektuale. Me mirësin e Zotit, është e sigurt se mbështetësit e *Mehdiut*, të cilët janë në anën e paqes dhe dashurisë pa marrë parasysh besimin e tyre, do të jenë triumfues në ditën e fundit. Për këtë arsye, zbulimi i njerëzve të cilët padashur u bënë mbështetës të *dexhallit* dhe ndihmimi i tyre për të korrigjuar gabimet e tyre duhet të jetë një nga qëllimet e mbështetëse të *Mehdiut*.

Bëni durim. Durimi yt është vetëm me ndihmën e Zotit. Mos u brengos nga ata dhe mos u ngushto nga komplotet që ata kurdisin. Zoti është me ata që i frikësohen Atij dhe me ata që bëjnë mirë. (Kur'an, 16:127-128)

E gjithë fuqia i përket Zotit

Përgjatë këtij kapitulli, është përshkruar një lëvizje sekrete e *dexhallit* e cila ka arritur të ushtrojë ndikim të madh në botë përmes mjeteve të ndryshme. Pavarësisht nga të gjitha këto fakte, lexuesit duhet të mbajnë një gjë në mendje: kjo jetë është sprovë. Kjo është arsyeja pse e mira dhe e keqja u krijuan. E mira dhe e keqja gjithmonë do të përfshihen në konflikt dhe prandaj, mbështetësit e së mirës dhe mbështetësit e së keqes duhet të zgjedhin anët e tyre. Por më e rëndësishmja, Zoti krijon të mirën dhe të keqen. Asnjë prej tyre nuk është i pavarur nga Zoti. Prandaj, si qëllimet ashtu edhe pritrat e keqbërësve janë nën kontrollin e Zotit. Pavarësisht se shumë përpiqen, ata nuk mund të bëjnë asgjë tjetër përveç asaj që ka caktuar Zoti.

I gjithë pushteti, autoriteti dhe sundimi i takon Zotit të Plotfuqishëm, Zotit të botrave, i Cili ka kontroll mbi të gjitha botërat, i Cili është i vetëdijshëm për gjithçka dhe i Cili ka fuqi të pafundme.

Prandaj, pa marrë parasysh sa të forta dhe të pathyeshme mund të duken fuqitë sekrete që ndërtojnë këto kurthe, ato janë të parëndësishme dhe të pavlefshme në vështrimin e Zotit. Ata janë shërbyes të Zotit që kanë nevojë për Të në çdo moment. Siç shpjegon Zoti në vargun vijues, edhe nëse komplotet e tyre janë aq të forta sa të zhdukin malet, ata me siguri do të dështojnë përballë fuqisë së Tij të pafundme.


Ata sajuan dredhitë e tyre, por Allahu i di dredhitë e tyre. Edhe sikur prej dredhive të tyre të shembeshin malet, ata nuk do t'ia dalin mbanë. (Kur'an, 14:46)

Përmbajtja e këtij libri ka për qëllim të ekspozojë sistemin e *dexhallit* i cili u rrënjos thellë si pjesë e sprovës në këtë botë, dhe gjithashtu të tregojë mënyrat për ta kundërshtuar këtë sistem intelektualisht. Njerëzit e mirë duhet të kryejnë një veprimtari të kundërt për të treguar më të mirën e tyre dhe për t'i dhënë fund në mënyrë intelektuale kësaj tiranie. Kjo është një mënyrë që një individ të dëshmojë veten e tij përpara Zotit. Nuk duhet harruar që gjithashtu Zoti krijoi komplotet e *dexhallit*, por si komplete të destinuara të dështojnë. Ato dredhi do të dështojnë, por Zoti kërkon arsyet dhe mënyrat që këto të ndodhin. Ata që bëjnë një përpjekje intelektuale drejt këtij qëllimi do të jenë mjeti për dështimin e atyre kompleteve.

Duhet të mbahet mend gjithashtu se ka njerëz të panumërt në këtë botë të cilët persekutohen. Përballë kësaj situate të rëndë, shumica e njerëzve zgjedhin çdo mënyrë vetëm për të qëndruar larg rrugës së rrezikshme. Ata mendojnë se në këtë mënyrë e ndihmojnë veten duke heshtur përballë tiranisë. Sidoqoftë, Zoti dëshiron që ne të ndihmojmë të shtypurit dhe të përndjekurit. Nuk ka dyshim se Zoti do të largojë çdo tirani në botë dhe do të vendosë drejtësi për të dobëtit. Sidoqoftë, situata është e tillë në këtë botë dhe është koha 'e jonë' për të bërë përpjekje, si pjesë e provës sonë. Është detyrë e jona të bëjmë gjithçka që mundemi intelektualisht dhe shkencërisht dhe të bëhemi aleat me vëllezërit tanë të krishterët dhe myslimanë për t'i dhënë fund kësaj tiranie duke i besuar Zotit, duke kërkuar strehim tek Ai dhe duke kërkuar ndihmën e Tij.

Ne tani po jetojmë në Kohët e Fundit, kohën kur ne do të dëshmojmë shfaqjen e Hazreti *Mehdiut* dhe Profetit Jezus (paqja qoftë mbi të). Ndërsa Zoti na dha lajmin e tij të gëzuar në Kuran, Tevrat, Ungjil dhe hadithet [thëniet e Profetit Muhamed (paqja qoftë mbi të), se kjo do të jetë një kohë kur shtypja dhe gjakderdhja mbarojnë dhe zëvendësohen me paqe, dashuri dhe dhembshuri. Ne e dimë se pa marrë parasysh sa të fuqishëm janë mbështetësit dhe planet e *dexhallit*, ata do të munden nga *Mehdiu* dhe Profeti Isa (paqja qoftë mbi ta). Asnjë tirani nuk do të lihet në ditët e fundit, pasi të gjithë, nën udhëheqjen e Mehdiut dhe Profetit Isa (paqja qoftë mbi ta), do të shkojnë drejt të mirës dhe të bukurës. Është detyrë e jona ndaj Zotit të bëjmë pjesën tonë në ndryshimin e njerëzimit për mirë dhe përgatitjen e njerëzimit për këtë epokë të bekuar.

Zoti do të forcojë të vërtetën me fjalët e Tij, edhe pse këtë e urrejë mëkatarët. (Kur'an, 10:82)



Lufta e Parë Botërore dhe Nëntoka Shtetërore Britanike

Një politikë e re osmane

Lufta e Parë Botërore ishte faza përfundimtare e politikës shekullore të Nëntokës Shtetërore Britanike për të ruajtur dhe zgjeruar sistemin e saj të shfrytëzimit botëror dhe për të eliminuar çdo kërcënim për sundimin e saj. Hapat e parë të kësaj strategjie ishin ekonomike, politike dhe diplomatike, si dhe më së shumti synuan dy perandoritë e mëdha që Britania i konsideroi rivalë gjatë shekullit të 19-të. E para ishte Perandoria Koloniale Gjermane. Gjermanët ishin duke u bërë shumë më të fuqishëm në Evropë, si dhe në tregjet koloniale të botës, duke dalë si rivali kryesor i Britanisë. E dyta ishte Perandoria Osmane, e cila kishte qenë prej kohësh shënjestër e magjepsjes britanike.

Rasti i Gjermanisë nuk ishte vërtet i komplikuar. Përparimi dhe rritja e Perandorisë duhet të ndalohej në një mënyrë apo në një tjetër.⁴⁷ Sidoqoftë, ishte një histori tjetër kur bëhej fjalë për Perandorinë Osmane. Nëntoka Shtetërore Britanike përfitoi nga vazhdimi i ekzistimit të Perandorisë, por, në të njëjtën kohë, ishte e shqetësuar për rritjen e saj. Perandoria Osmane ishte e rëndësishme strategjikisht dhe ekonomikisht për Britaninë. Lindja e Mesme, e cila më pas i përkiste Perandorisë Osmane, përfshiu toka të pasura si Mesdheun Lindor, Egjiptin, Suezin dhe Palestinën dhe mori rrugën deri në Indi, duke pasur kështu një rëndësi të madhe për hegjemoninë britanike. Për këtë arsye, Nëntoka Shtetërore Britanike ndjeu detyrimin për të menaxhuar dhe kontrolluar me kujdes çdo skenar që përfshinte Perandorinë Osmane.

Nëse Perandoria Osmane, e cila në atë kohë po kalonte ditë të vështira, do të gjente një mënyrë për t'u ngritur në këmbë, do të kishte qenë udhëheqëse e padiskutueshëm e një fuqie të pakonkurueshme botërore; Unionit Islamik. Por, Nëntoka Shtetërore Britanike e konsideroi kërcënim të madh dhe rival të mundshëm një Union Islamik të udhëhequr nga Perandoria Osmane. Nga ana tjetër, nëse Perandoria Osmane do të binte, kishte pak dyshim që Rusia Cariste ose Perandoria Gjermane, dy fuqitë e tjera të rëndësishme të kohës, do të kishin pretendime për të. Ky do të ishte një fund i papritur i ëndrrave ambicioz të Nëntokës Shtetërore Britanike për Lindjen e Mesme.

Për këto arsye, pas Traktatit të Berlinit të vitit 1878, Nëntoka Shtetërore Britanike bëri ndryshime të rëndësishme të politikës së saj drejtë Portës së Lartë, me fjalë të tjera, Qeverisë Qendrore të Perandorisë Osmane. Megjithëse tashmë kishte marrë kontrollin e Qipros dhe Egjiptit – të cilat ishin territore të Perandorisë Osmane - përsëri nuk donte që Perandoria të binte në një mënyrë të pakontrolluar. Nëntoka Shtetërore Britanike nuk donte asnjë zhvillim i cili mund të kërcënonte interesat e saj dhe ruajtja e integritetit territorial të Perandorisë Osman i përshtatej më së shumti. Ndërkohë, ajo rriti presionin e saj ekonomik dhe politik mbi Perandorinë Osmane për ta bërë atë më të varur nga Nëntoka Shtetërore Britanike, kjo ishte pjesë e procesit të saj të ndërtimit të kontrollit me shumë faza. Gjatë kësaj kohe, ajo vazhdoi të ruante marrëdhëniet “miqësore” ndaj osmanëve, por gjatë gjithë kohës vazhdoi me politikën e saj dinake dhe të mbrapshta prapa dyerve të mbyllura.

Nga fundi i shekullit të 19-të, Perandoria Osmane kishte kapërdirë mjaftueshëm mashtrime dhe hile të Nëntokës Shtetërore Britanike dhe zgjodhi të formonte aleancë me gjermanët. Kjo lëvizje ndryshoi gjithçka. Duke mos dashur të heqë dorë nga ëndrrat e tyre për tokat osmane, Nëntoka Shtetërore Britanike hodhi pretendimin se vetëm donte të ruante integritetin territorial të Perandorisë Osmane.

Copëtimi dhe pushtimi sistematik i tokave Osmane tani dukej e vetmja mundësi e pranueshme për Nëntokën Shtetërore Britanike. Kjo ishte mënyra e vetme për të arritur qëllimin përfundimtar të sundimit botëror. Sidoqoftë, vetëm një luftë masive, e planifikuar me kujdes dhe e sajuar nga fillimi deri në fund, duke i ditur rezultatet e luftës, mund të justifikonte okupimin ushtarak dhe arritjen e këtij qëllimi. Me fjalë të tjera, Lufta e Parë Botërore ishte mjete i fundit i Nëntokës Shtetërore Britanike kur pa se të gjitha mjetet e tjera, strategjike, ekonomike dhe politike, për të arritur qëllimin e saj shekullor, ishin shtuar.

Tani le të shohim nga fillimi hapat famëkeq që dërguan deri tek kampanja ushtarake.

Kurthi ekonomike nga britanikët për të shpejtuar

Rënien e Perandorisë Osmane: Traktati i Balta Limanit

Në shekullin e 19-të, Perandoria Osmane po përballej me peshën e rëndë të presionit ushtarak, politik dhe ekonomik të shteteve evropiane. Në vitin 1827, ndërsa kryengritja greke po rritej, flotat Britanike, Franceze dhe Ruse sulmuan dhe mundën trupat e marinës osmane në Navarino, ndërsa Rusët aneksuan Edirnen dhe u afruan kërcënueshëm pranë Stambollit gjatë luftës Ruso-Turke të vitit 1828-29. Përballë këtyre zhvillimeve, Sulltan Mahmud i II-të vendosi t'i japë fund luftës me Traktatin e Edirnes të vitit 1829. Shpallja e pavarësisë së Grekëve ndryshoi rrjedhën e ngjarjeve. Gjatë kryengritjes greke, Sulltan Mahmudi i II-të, premtoi se do t'i jepte qeverisjen e Moras së Egjiptit, Muhamed Ali Pashas nëse ai do të ndihmonte në shtypjen e kryengritjes. Sidoqoftë, kur grekët shpallën pavarësinë e tyre marrëveshja u prish. Kur Sulltan Mahmud i II-të gjithashtu refuzoi t'i jepte qeverisjen e Damaskut Muhamed Ali Pashas, pasoi i ashtuquajtur 'problemi i Egjiptit'. Francezët morën anën e Egjiptit, ndërsa Britanikët mbetën neutral. Këto zhvillime i shtynë Osmanët të nënshkruanin një pakt mos-sulmimi dhe aleance me Rusët në vitin 1833, që njihet si Traktati i Hunkar Iskelesit.

Të shqetësuar se mund të ishin duke i humbur osmanët nga rusët, Nëntoka Shtetërore Britanike kërkoi ndihmën e Francës për të protestuar ndaj traktatit. Madje shkoi aq larg deri në dërgimin e një flote britanike në Izmir. Me ndihmën e Austrisë, ajo arriti të bindë Carin Rus që të tërhiqej nga traktati dhe u premtoi Osmanëve mbështetjen e saj kundër Rusëve dhe Muhamed Ali Pashës. Me siguri, ky shërbim nuk do të vinte falas. Shërbimi i Nëntokës Shtetërore britanike u ofrua në këmbim të një 'marrëveshje të tregtisë së lirë' (Traktati i Balta Limanit) për të zgjeruar kushtet e marrëveshjes së fituar më parë. Veziri i madh anglofil Mustafa Reshid Pasha luajti një rol të rëndësishëm në bisedimet me Sulltanin, për nënshkrimin e traktatit, duke pasur parasysh se Sulltani ishte në atë kohë në shtratin e vdekjes.

Ky traktat, i cili u paraqit si një arritje e madhe nga britanikët në mes të parrullave të "perëndimit", "liberalizimit" dhe "zhvillimit", në të vërtetë shpalli rënien e Perandorisë. Me këtë traktat, Britania në fakt po tërhiqte Perandorinë Osmane, e cila tashmë ishte në gjysmë të rrugës për t'u bërë koloni, në një grupë ekonomike nga e cila nuk do të kishte mundësi të dilte përsëri. Me Traktatin e Balta Limanit, shteteve perëndimore, veçanërisht Britanisë, iu dhanë shumë privilegje dhe koncesione që shkuan përtej kufijve të marrëveshjes. Kjo e bëri Perandorinë Osmane një treg të hapur për britanikët dhe evropianët e tjerë.

Traktati ishte plot me klauzola të njëanshme dhe detyruese në kundërshtim me interesat e Osmanëve. Përveç kapitujve ekzistuese, subjekteve dhe anijeve të Britanisë së Madhe iu dhanë privilegje të reja, të cilat do të kishin efekt 'përgjithmonë'. Situata ishte aq e çuditshme sa që tregtarët turq paguanin 12% taksë, përderisa tregtarët britanikë paguanin vetëm 5% taksë. Nëse një tregtar britanik ose agjenti i tij do të blinte një produkt turk për eksport, ai tregtar ose agjent nuk do t'i nënshtrohej ndonjë kufizimi tregtar dhe do të mund të tregtonte falas.

Henry Palmerston, Sekretari i Shtetit Britanik për Punët e Jashtme, e quajti traktatin *Capo d'Opera* (një kryevepër) për shkak të përparësive të padëgjua që ju ofronte britanikëve.⁴⁸ Në ndërkohë, Nëntoka Shtetërore Britanike vazhdoi me hipokrizinë e saj klasike dhe sjellën "miqësore" ndaj Perandorisë Osmane, duke e vlerësuar dhe duke i dhënë komplimente për zbatimin e tregtisë së lirë me vendet e tjera. Prandaj, duke marrë parasysh atë që ndodhi në të kaluarën, është thelbësore të adaptohet një qasje e kujdesshme ndaj lavdërimeve ose premtimeve të bëra nga përfaqësuesit modernë të Nëntokës Shtetërore Britanike.

Me Traktatin e Balta Limanit, barrierat tarifore kundër tregjeve të huaja u hoqën dhe të gjitha regjistrimet në tregtinë e brendshme u fshinë. Ky zhvillim i dha një goditje serioze industrisë së re turke, e cila ende nuk ishte e gatshme për konkurrencën e huaj. Industritë që varen nga prodhimi vendas si pambuku, mëndafshi, leshi, përpunimi i lëkurës, minierat dhe bujqësia u prekën seriozisht dhe nuk kishin tjetër rrugë përveçse falimentimit. Pas një kohe, këto produkte nuk u përpunuan më dhe ju shitën të huajve si lëndë e parë me çmim shumë të ulët. Shumë produkte të industrisë lokale, të cilat para vitit 1838 plotësonin me lehtësi kërkesën e brendshme dhe madje eksportoheshin jashtë, tani mund të merreshin vetëm përmes importit nga viti 1850.

Nga ana tjetër, rënia e të ardhurave nga taksat të cilat fitoheshin nga tregtia e jashtme, për shkak të privilegjeve të dhëna përëndimorëve, të shoqëruara me deficitin shtetëror, i vunë një barrë të rëndë Perandorisë Osmane, duke e çuar në një krizë të madhe ekonomike. Tashmë duke u përballur me kostot nga Lufta me Krimenë në vitin 1854, Perandoria Osmane për herë të parë në historinë e saj iu drejtua vendeve të huaja për të kërkuar hua në përpjekje për të ngritur ekonominë e saj në këmbë. Britania me entuziazëm e mbështeti këtë masë. Si rezultat, osmanët huazuan një borxh total prej 3 milion paund nga Palmer në Londër si dhe nga Goldschmidt në Paris më 24 gusht të vitit 1854. Kredia u sigurua si përgjigje kundër taksave egjiptiane.

Kjo lëvizje shënoi fillimin e marrjes së huave në mënyrë të pandërprerë, e cila nuk mund të paguhej edhe shumë kohë pasi Perandoria Osmane u rrëzua. Vetëm në njëzet vite pas huasë së parë në vitin 1854, Perandoria shpalli një dështim total dhe falimentoi. Në prag të Luftës së Parë Botërore, Perandoria Osmane kishte marrë hua 243 milion Lira Osmane, që e bëri shumën totale të borxhit 409 milion Lira Osmane.

Pamundësia për të paguar huatë lejoi kreditorët të fitonin kontrollin e burimeve më të mëdha të të ardhurave të Perandorisë. Administrata e Borxhit Publik Osman (Düyun-u Umumiye) u krijua gjatë sundimit të Sulltan Abdul Hamidit të II-të. Edhe pse emri sugjeron që ai ishte një institut osman, ai kishte një administratë krejtësisht të huaj që përbëhej nga shtatë individë të cilët përfaqësonin kreditorët: britanikë, holandezë, francezë, gjermanë dhe italianë në mes të tjerëve. Ky komision që monitoronte borxhin e jashtëm të Perandorisë Osmane mori të ardhurat e tëra nga duhani, kripa, mëndafshi dhe peshku, të cilat përbënin më shumë se një të tretën e buxhetit të shtetit. Një arsye tjetër për zgjedhjen e këtyre artikujve të veçantë ishte se këto taksa ishin më të lehtë për tu mbledhur, pa përmendur arsyen se këto produkte ishin gjithashtu shumë të vlefshme.

Zyrtarët nga Administrata e Borxhit Publik Osman nën kontrollin Britanik shkonin dhe mernin prodhimet e fermerëve dhe mbledhnin taksa me ndihmën e forcave të xhandarmërisë. Raste të panumërta të trajtimit mizor nga duart e oficerëve të Administratës së Borxhit Publik Osman për të arritur qëllimet e tyre mund të gjenden në arkivat e historisë.

Republika e Turqisë e cila lindi nga hiri i Perandorisë Osmane mori përsipër këto borxhe masive që përshkruajnë fundin e Perandorisë. Sidoqoftë, vetëm pas një shekulli republika e re ishte në gjendje t'i shlyente plotësisht. Duhet të theksohet se në vitin 1838 kur u nënshkrua Traktati i Balta Liman me Britanikët, Perandoria Osmane nuk kishte borxhe ndaj vendeve tjera. Sidoqoftë, planet e liga të Nëntokës Shtetërore Britanike i bënë osmanët jo vetëm borxhlinj kronik por gjithashtu ia kthyen aleatët e saj të mëparshëm në kundërshtarë, me theks të veçantë Rusinë.

Borxhi i parë i jashtëm që Perandoria Osmane mori nga Britania me anë të mashtrimeve të Nëntokës Shtetërore Britanike shënojnë fillimin e fundit të Perandorisë. Traktati i tregtisë së lirë i imponuar në Perandorinë Osmane, dhe kriza pasuese dhe falimentimi, tregojnë qartë për planet e mbrapshta, të ndërlydhura dhe afatgjate të Nëntokës Shtetërore Britanike kur dëshiron t'i sjellë vendet në prag të kolapsit.

Si Nëntoka Shtetërore Britanike organizoi komplotin që dërgoi në luftë

Sipas shumë historianëve, data e vërtetë e rënies së Perandorisë Osmane ishte 20 dhjetori i vitit 1881, data kur u themelua Administrata Osmane e Borxhit Publik. Çuditërisht, edhe pse mund të kishte ndërmarrë, Nëntoka Shtetërore Britanike nuk ndërmori asnjë veprim ushtarak kundër Perandorisë Osmane për 37 vjet, derisa shpërtheu Lufta e Parë Botërore. Arsyja e vetme për të mos bërë këtë gjë ishte ngurrimi i saj për të ndarë tokat osmane me fuqitë e tjera të kohës si Franca, Gjermania dhe Rusia, të cilat gjithashtu kishin interes për ato toka.

Për këtë arsye, Nëntoka Shtetërore Britanike zgjodhi të priste një kohë më të përshtatshme, kur mund të hiqte qafe konkurrentët e saj dhe të fillonte një proces të pushtimi të tokave osmane, të cilat do të ishin ekskluzivisht nën kontrollin e saj. Data e caktuar ishte Lufta e Parë Botërore. Në fillimet e para të Luftës së Madhe, Nëntoka Shtetërore Britanike arriti të fuste Gjermanët në Fuqitë Qendrore dhe financoi Revolucionin Bolshevik për të mbajtur Rusët larg nga rruga e saj. Nuk ishte rastësi që Lordi Britanik Alfred Milner ishte një nga financuesit më të mëdhenj të Revolucionit Bolshevik. Siç do të kujtojnë lexuesit nga kapitulli i mëparshëm, Milner ishte kreu dhe organizatori i grupit 'Tryeza e Rrumbullakët', një nga fuqitë nëntokësore të Nëntokës Shtetërore Britanike. Lord Rothschild gjithashtu mbështeti këtë grup.⁴⁹

Siç u përmend më parë, para Luftës së Parë Botërore, pothuajse çdo vend në botë e konsideronte Perandorinë Osmane si një shtet të dështuar. Megjithatë, Nëntoka Shtetërore Britanike e konsideroi më të dobishme për interesat e saj ruajtjen e integritetit territorial të Perandorisë Osmane deri në goditjen përfundimtare. Për këtë strukturë nëntokësore, varësia e vazhdueshme e Perandorisë nga Britania, si dhe një prishje e ngadaltë dhe graduale, ishte më e dobishme sepse territoret osmane ishin thelbësore për interesat strategjikë dhe ekonomikë të Britanisë. Nga ana tjetër, zbulimi i rezervave të pasura të naftës në Mesopotami dhe Iran deri në fund të shekullit të 19-të po ngjallte urinë e Britanisë edhe më shumë, e cila për më tepër kishte një makineri të përparuar.

Kur Rusët pushtuan Ballkanin dhe zbritën në mënyrë të rrezikshme në Yeşilköy, duke dërguar në Traktatin pasues të Berlinit më 13 korrik të vitit 1878, politika britanike për ruajtjen e integritetit territorial të Perandorisë papritmas ndryshoi. Nga ai moment, Britania hoqi maskën e aleatit dhe mikut të Perandorisë dhe filloi fushatën e saj ushtarake, duke mos dashur të humbasë asnjë pjesë të tokave Osmane. Kjo fushatë filloi duke pushtuar ishullin e Qipros më 25 maj të vitit 1878, me pretendimin për ta përdorur atë si një bazë kundër rusëve dhe për të ndihmuar osmanët, në proces vendosi trupat e saj në ishull dhe mori kontrollin e tij. Sulltan Abdul Hamidi i II-të, nën presionin e Nëntokës Shtetërore Britanike, pa hezitim, dorëzoi Qipron para Britanikëve, të cilët e kishin përdorur këtë justifikimin për të ndihmuar Perandorinë Osmane kundër Rusëve.

Dhurata e Abdul Hamidit të II-të për Britaninë: Qipro

Një oficer britanik, kapiteni J. M. Kinneir shkruajti për rëndësinë e Qipros për Britaninë pasi bëri një vizitë në ishull në vitin 1814:

Zotërimi i Qipros do t'i jepte Anglisë një ndikim mbizotërues në Mesdhe dhe do të sillte në dispozicion të saj fatin e ardhshme të Levantit. Egjipti dhe Siria së shpejti do të bëheshin degë të saj, dhe ajo do të fitonte një pozitë mbizotëruese në lidhje me Azinë e Vogël, me të cilën Porta në çdo kohë mund të mbahej nën kontroll, dhe hyrjet e Rusisë, në këtë pjesë, do të parandaloheshin. Kjo do të rrisë tregtinë e saj në një shkallë të konsiderueshme; do ti sillte asaj fitimin nga shpërndarja e verërave të pasura, mëndafshit dhe prodhimeve të tjera të këtij ishulli të shkëlqyeshëm; pa harruar fitimet nga orizi dhe sheqeri i Egjiptit si dhe pambuku, opiumi dhe duhani i Anadollit.⁵⁰

Ish kryeministri britanik Benjamin Disraeli shprehu mendime të ngjashme dhe theksoi se Qipro ishte "Çelësi i Azisë Perëndimore"⁵¹ dhe vazhdoi duke thënë se çdo shtet që dëshironte të kontrollonte Lindjen e Mesme duhet të kontrollonte Qipron.

Nëntoka Shtetërore Britanike gjithmonë ka synuar Qipron, ishullin me pozicion të rëndësishëm strategjik, dhe ka pritur epokën e rënies së Perandorisë Osmane për të ndërmarrë këto veprime. Ishte i sigurt se Abdul Hamidi i II-të, një sulltan që e mbahej nën presion, do të dorëzohej në kërkesat e tyre. Pra, kur erdhi koha e duhur, ajo vuri në veprim planet e veta mashtruese.

Më 10 maj të vitit 1878, Lord Salisbury, Sekretari Britanik i Shtetit për Punët e Jashtme, udhëzoi Ambasadorin Austen Henry Layard që në Stamboll të fillojë procesin për Qipron. Layard, në përgjigje, u takua me Vezirin e Madh Mehmed Rushdi Pashan më 23 maj dhe e siguroi atë se Britania do të injoronte Traktatin e San Stefanos dhe një traktat i ri do të përgatitej në favor të interesave turke, ku britanikët do të parandalonin çdo përpjekje të re ruse për të pushtuar ndonjë vend përveç Karsit, Ardahanas dhe Batumit. Sidoqoftë, kishte një hile: Britanikët donin të ishin në krye të administrimit të Qipros.⁵² Ambasadori Layard u takua me Abdul Hamidin e II-të më 25 maj dhe pretendoi se Traktati i San Stefano ishte kundër interesave të Perandorisë Osmane, dhe se Britania donte të ndihmonte Portën por duhej të

dërgonte trupa të marinës nga Malta dhe Londra, për të cilat arsyje Qiproja duhet që përkohësisht tu lihej britanikëve.⁵³ Këmbëngulja u tregua e dobishme për Nëntokën Shtetërore Britanike dhe më 4 qershor të vitit 1878, para nënshkrimit të Traktatit të Berlinit, Konventa e Qipros u nënshkrua midis Britanikëve dhe Osmanëve. Sipas marrëveshjes, Britania e Madhe do të okuponte ishullin dhe do ta kontrollonte atë në emër të Sulltanit. Të ardhurat - pasi të zbriteshin shpenzimet e bëra nga britanikët - do të dërgoheshin çdo vit në thesarin osman, ndërsa autoritetet osmane do të vazhdonin të ishin në krye të drejtësisë, religjionit dhe instituteve arsimore. Kjo marrëveshje lejoi Britaninë të merrte kontrollin e ishullit, i cili mund të krahasohej me një luftanije në kërkimin e saj për të siguruar Kanalin e Suezit dhe rrugën vitale për në Indi.

Abdul Hamidi i II-të lejoi ushtrinë Britanike të pushtonte ishullin dhe ta sundonte atë gjatë asaj periudhe. Sidoqoftë, me kalimin e kohës u bënë tre shtesa të tjera në marrëveshje. Marrëveshja e parë shtesë e datës 1 korrik të vitit 1878, i dha Sulltanit të drejtën për të shitur tokat në ishullin që ai zotëronte dhe i detyroi Britanikët t'i blinin ato nëse tokat ishin të shtetëzuara. Në këtë mënyrë, paratë për tokat e shitura i dërgoheshin direkt Abdul Hamidit të II-të. Shtesat e mëvonshme kërquan që Britanikët të dërgonin taksat e mbledhura në Qipro në Perandorinë Osmane pasi të ishin zbritur shpenzimet e nevojshme administrative. Shumë historianë e interpretojnë këtë praktikë si dhënien me qira të Qipros nga Abdul Hamidi i II-të. Sidoqoftë, britanikët kurrë nuk i paguan paratë dhe thanë se ato ishin kompensim i borxheve osmane ndaj britanikëve.

Kur shpërtheu Lufta e Parë Botërore, Britania deklaroi se aneksoi zyrtarisht Qipron. Në Konferencën e Lozanës, Turqisë iu desh të pranonte zyrtarisht situatën në Qipro. Me fjalë të tjera, 'dhurata' e Qipros nga Sulltan Abdul Hamidi i II-të për Britanikët mund të konsiderohet hapi i parë në planin Britanik për të pushtuar Perandorinë Osmane.

Interesante, para dhe pas përpjekjes së dështuar të grushtit të shtetit në Turqi më 15 korrik të vitit 2016, Nëntoka Shtetërore Britanike rriti shumë praninë e saj ushtarake në bazën e saj në Qipron Jugore. Kur u pyetën për këtë vendim, britanikët shpjeguan arsyet e tyre për dërgimin e aeroplanëve luftarak, helikopterëve, anijeve zbarkuese dhe forcave speciale në rajon si 'shpëtim i shtetasve britanikë nëse Turqia pëson një përpjekje të dytë grushtit të shtetit'. Autoritetet britanike gjithashtu pretenduan se 'nëse do të ishte e nevojshme' forcat britanike të cilat do të hynin në tokën turke do të autorizoheshin të qëllonin.⁵⁴ Si publiku turk ashtu edhe media turke e konsideruan këtë si "një plan pushtimi".

Siç tregon edhe ky shembull, taktika e zakonshme e Nëntokës Shtetërore Britanike është së pari nxitja e trazirave në një vend përmes përpjekjeve të grushtit të shtetit, krizave ose luftërave civile në përpjekje për të dobësuar financiarisht, politikisht dhe ushtarakisht vendin. Faza e dytë është një fushatë ushtarake me pretendimin e 'mbrojtjes së qytetarëve të saj', 'ndihmës humanitare', 'ndërhyrjes humanitare' ose 'paqeruajtjes'. Një vështrim i shpejtë i ngjarjeve historike do të zbulojë qartë shembuj të kësaj strategjie të Nëntokës Shtetërore Britanike.

Çuditërisht, njëqind vjet më vonë Qipro ishte edhe një herë pika qendrore e planeve të Nëntokës Shtetërore Britanike për të pushtuar Turqinë. Kjo jep shumë arsye për të dyshuar se fazat e ardhshme të planeve të tyre sekrete do të jenë të ngjashme me ato të së kaluarës. Në të vërtetë, kjo është pikërisht ajo që ndodhi kur Nëntoka Shtetërore Britanike mori në fillim Qipron dhe më pas Egjiptin në vitin 1882.

Me ndihmën e Zotit, më 15 korrik, Presidenti i Republikës Turke, qeveria, forcat e sigurisë dhe më e rëndësishmja populli turk në mënyrë efektive kanë bllokuar planin djallëzor të Nëntokës Shtetërore Britanike. Sidoqoftë, kjo nuk do të thotë që rreziku është zhdukur dhe nuk është më prezent. Nëntoka Shtetërore Britanike po kërkon mënyra të reja për të realizuar planin e saj djallëzor. Për këtë arsye, është thelbësore që ne të jemi të vetëdijshëm se kërcënimi ende ekziston dhe të jemi në vëmendshëm në çdo kohë. Me lejen e Zotit, Nëntoka Shtetërore Britanike nuk do të jetë kurrë në gjendje të arrijë planin e saj të errët për Turqinë.

Planet e Nëntokës Shtetërore Britanike për të Pushtuar Egjiptin

Gjatë ditëve të para, Kanali i Suezit u bë jo vetëm një rrugë shumë e rëndësishme që lidhte Britaninë me kolonitë e saj në Lindjen e Largët; por gjithashtu shumëfishoi vlerën tregtare të Mesdheut Lindor. Për këtë arsye, pasi kanali u hap

në vitin 1869, britanikët e futën Egjiptin në një grackë borxhi përmes lojërave ekonomike dhe politike, si dhe e bënë atë të falimentonte dhe më pas përdorën falimentimin e saj si justifikim për pushtim. Ky ishte një plan tjetër i Nëntokës Shtetërore Britanike për pushtimin e tokave osmane.

Britania e dinte gjatë gjithë kohës që Rusia përparonte në tokat Osmane dhe kishte për qëllim të pushtonte Egjiptin në mënyrë që të mund të merrte nën kontroll Mesdheun Lindor. Në të vërtetë, Car Nicholasi i kishte propozuar Ambasadorit Britanik Hamilton Seymour që të ndajnë Perandorinë Osmane, duke e quajtur Portën 'njeri të sëmurë' si dhe propozoi që Kreta dhe Egjipti t'u liheshin atyre. Për këtë arsye, Nëntoka Shtetërore Britanike e dinte se duhej të vepronte shpejt dhe të bënte lëvizjen e parë. Kështu që filloi të mbillte farat e kryengritjes dhe ndarjes në mes të njerëzve të Egjiptit dhe me anë të provokimit dhe propagandës, arriti të bindte disa Egjiptianë të fillonin trazira kundër Perandorisë Osmane. Udhëheqësi i trazirave ishte koloneli Ahmed Urabi, i njohur gjithashtu si Arab Pasha, i cili ishte anëtar i Nëntokës Shtetërore Britanike.

Arab Pasha udhëhoqi rrethimin e Aleksandrisë, i cili ishte gjithashtu shtëpi për qindra njerëz britanikë, dhe me nxitjen e Nëntokës Shtetërore Britanike, masakroi mijëra njerëz në qytet dhe më pas dogji shtëpitë e tyre. Kjo ishte një pjesë e planit të Nëntokës Shtetërore Britanike e cila kishte nevojë për një justifikim për të pushtuar vendin. Pas masakrës së planifikuar nga Arab Pasha, Britania dhe Franca dërguan flotat e tyre në Egjipt me pretekstin 'për të shpëtuar qytetarët e tyre' dhe goditën pa pushim qytetin e Aleksandrisë për gjashtë orë e gjysmë, duke shkatërruar plotësisht qytetin. Nëntoka Shtetërore Britanike nuk u përmbajt nga vrasja e qytetarëve të saj, megjithëse fushata u fillua kinse për t'i shpëtuar ata.

Nëntoka Shtetërore Britanike luajti një lojë të pisët kontrolli për Kanalin e Suezit dhe as nuk u merakos kur u desh të sakrifikoje qindra qytetarë të saj për ta fituar atë. Në fund, pasi kishte shtypur rebelët, të cilët ishin tashmë nën kontrollin e saj, ushtria britanike mbajti një paradë zyrtare para ish-gubernatorit. Në paraqitje, Egjipti ishte ende nën sundimin osman, por në të vërtetë, ai ishte nën kontrollin e plotë britanik. Kur Porta ngriti kundërshtime, Nëntoka Shtetërore Britanike nxiti trazira në Serbi, Mal të Zi, Bullgari dhe më në fund çiti armenët për të shkaktuar dëme në Perandorinë Osmane në heshtje.

Skemat e Nëntokës Shtetërore Britanike për të parandaluar Unionin Islamik

Frika më e madhe e Nëntokës Shtetërore Britanike ishte Gjermania që mbështeste politikën osmane të 'Pan-Islamizmit'.⁵⁵ Nëse do të ekzistonte kjo frymë uniteti që osmanët kërkuan të rindiznin në vendet islamike, komplotet shekullore të Nëntokës Shtetërore Britanike do të shkatërroheshin. Qëllimi i Nëntokës Shtetërore Britanike ka qenë gjithmonë parandalimi i ngritjes së Unionit Islamik, i cili do të ishte kërcënimi më i madh për interesat e tyre.

Sistemi i *dexhallit* që aktualisht menaxhon tiraninë botërore dhe sistemin shfrytëzues të Nëntokës Shtetërore Britanike e konsideron Unionin e pamposhtur Islamik, përfaqësues të së vërtetës dhe drejtësisë Hyjnore, pra kërcënimin më të madh për mbijetesën e tij. Ky sistem është i vetëdijshme se Mehdiu (p.q.m.t), do të bashkojë dhe udhëheqë Unionin Islamik për të shkatërruar në mënyrë intelektuale sistemin e *dexhallit*. Katërqind vjet më parë, Profeti Muhamed (p.q.m.t) tregoi se si *Mehdiu* (p.q.m.t) do të shfaqen në Stamboll së bashku me të gjitha shenjat e kësaj ngjarjeje të bekuar. Kjo është arsyeja se pse Nëntoka Shtetërore Britanike është përqendruar në këtë rajon për dy shekujt e kaluar dhe pse ndarja e Turqisë dhe pushtimi i Stambollit është bërë një qëllim vendimtar për ta. Sidoqoftë, duhet të dihet se pa marrë parasysh sa të ndërlikuara, të ndërlidhura dhe me shumë faza mund të jenë planet dhe strategjitë e mbështetësve të *dexhallit*, ata nuk mund të shpëtojnë nga të qenit pjesë e fatit që dërgon në shfaqjen e Mehdiut (p.q.m.t). Në fund, me bekimin e Zotit, të gjitha këto zhvillime do t'i shërbejnë Mehdiut (p.q.m.t), ardhja e të cilit do të sjellë paqe dhe drejtësi në të gjithë botën.

Edhe pse mbështetësit e sistemit të *dexhallit* veprojnë me aftësi mbresëlënëse dhe burime të mëdha, si dhe me mbështetje të drejtpërdrejtë nga shejtani, ata shfaqin një nivel po aq të lartë të idiotësisë. Për shkak të kësaj, ata nuk mund

ta shohin mençurinë e pafund të Zotit dhe se planet e Zotit do të shfuqizojnë të gjitha planet e tjera. Për këtë arsye, sistemi i *dexhallit* është i destinuar të dështojë çdo herë. Gënjeshtra gjithmonë është mundur nga e vërteta dhe kështu do të jetë gjithmonë.

Ai e zbret shiun nga qielli, prandaj rrjedhin lumenjtë me masë dhe rrjedha bart mbeturinat mbi sipërfaqen e ujit. Edhe llumi, kur e shkrijnë njerëzit në zjarr që të bëjnë stoli ose vegla, është mbeturinë, si ajo. Kështu, Allahu jep shembullin e së vërtetës dhe të së pavërtetës: Mbeturinat hidhen, ndërsa ajo që u shërben njerëzve mbetet në tokë. Kështu, Allahu i shpjegon shembujt. (Kur'an, 13:17)

Lufta e Madhe po Ndërron

Para Luftës së Parë Botërore, Nëntoka Shtetërore Britanike rriti presionin dhe kërcënimet ndaj Perandorisë Osmane dhe në një mënyrë tinxare, nxiti qëllimisht tension. Kryeministri britanik Lord Salisbury, i njohur për urrejtjen e tij ndaj turqve, dëgjohet shpesh duke u thënë njerëzve në rrethin e tij të ngushtë se si duhej të ndaheshin tokat turke. Ai në shumë raste përpigjej të fyente Perandorinë Osmane me deklarata fyese duke e quajtur Perandorinë "shumë të kalbur për të mbijetuar" dhe ishte vetë ai që sugjeroi se tokat e Perandorisë duhet të ndaheshin nga shtetet e mëdha, veçanërisht Britania.

Letra e tij drejtuar Vezirit të Madh Osman Said Pashas më 28 qershor të vitit 1895, ishte plot me kërcënime:

*Çdo ditë rritet mendimi se shteti osman nuk do të qëndroj.*⁵⁶

*Ndjenjat e përgjithshme [në Britani] po rriten deri në bindje se Perandoria Osmane nuk do të vazhdojë të ekzistojë.*⁵⁷

Me fillimin e shekullit të 20-të, Nëntoka Shtetërore Britanike rivlerësoi aleancat dhe armiqtë e saj sipas planeve që bëri për epokën e pasluftës. Rusia nuk ishte më rival, por Gjermania po. Po shmangte me kujdes një qëndrim miqësor ndaj Perandorisë Osmane dhe ndoqi një politikë pasive. Prandaj, Eduard i VII-të i Britanisë dhe Nikolasi i II-të i Rusisë u takuan në Gjirin e Revalit më 8-9 qershor të vitit 1908 dhe nënshkruan një marrëveshje. Këto zhvillime ishin shenja të qarta se Nëntoka Shtetërore Britanike po fitonte terren e në veçanti me kërcënimin e Salisburit në letrën e tij që shkurante se 'Ajo që kontribuon në ekzistencën e Perandorisë Osmane, është fakti që Britania nuk është aleate me Rusinë. Nëse formohet një aleancë e tillë, Perandoria Osmane do të zhduket'⁵⁸

Të gjitha këto strategji të para luftës të Nëntokës Shtetërore Britanike u krijuan për të përcaktuar se kush do të ishte në anën e saj dhe kush do të ishte kundër saj gjatë luftës. E vetmja gjë që mbeti ishte shkrimi i skenarit për ngjarjet që do të fillonin luftën.

Politika e Nëntokës Shtetërore Britanike për të shpërfillur Perandorinë Osmane

Nëntoka Shtetërore Britanike ngriti me dinakëri bazën për Luftën e Madhe, duke krijuar arsye të vogla, por irrituese midis vendeve evropiane dhe perandorive. Në fund, situata u shndërrua në një bombë të kurdisur. Më në fund, përmes një atentati të ndyrë nga një vrasës, Nëntoka Shtetërore Britanike filloi Luftën e Parë Botërore.

Perandoria Osmane gjithmonë besonte se Fuqitë Aleate do të fitonin nëse lufta do të fillonte. Prandaj, ajo bëri përpjekje të shumta për t'u pajtuar me Britaninë, Francën dhe Rusinë dhe për të lidhur aleancë me ta. Qeveria Osmane e asaj kohe bëri kontakte dhe përpjekje të shumta përmes triumviratit të Enverit, Talatit dhe Kemal Pashas. Sidoqoftë, Britania nuk do të pajtohej kurrë me një aleancë të tillë, pasi një nga qëllimet kryesore të luftës ishte marrja e territoreve Osmane. Natyrisht, këto përpjekje rezoluan në dështim. Britania nuk pranoi asnjëherë aleancë me Osmanët sa herë që ata ofronin pakte bashkëpunimi apo mos-sulmimi.

E mbetur pa alternativa, Porta e Lartë u detyrua të bënte një aleancë me gjermanët dhe u bashkua në luftën në anën e tyre, pikërisht siç kishte planifikuar Nëntoka Shtetërore Britanike. Sapo Perandoria Osmane u bë pjesë e luftimeve, Nëntoka Shtetërore Britanik filloi projektin e saj për copëtimin e Perandorisë. Dy ditë para se Britania t'i shpallte zyrtarisht luftë Perandorisë Osmane, më 3 nëntor të vitit 1914, ajo njoftoi se aneksoi Kuvajtin. Më 5 nëntor, ajo njoftoi se pushtoi Qipron dhe më 18 dhe 19 dhjetor, njoftoi se aneksoi Egjiptin. Këto lëvizje jo vetëm që forcuan kontrollin e saj mbi Egjiptin dhe Mesdheun, por gjithashtu i mundësuan asaj të kontrollojë rrugët detare në Lindjen e Mesme.

Në ndërkohë, si pjesë e planit të saj për të shkatërruar Perandorinë Osmane nga brenda, ajo filloi të provokojë indianë, arabë dhe pakica të tjera kundër osmanëve. Në këtë mënyrë, ajo shpresonte, që shpërbërja e Perandorisë do të ishte më e shpejtë, më e lehtë dhe me më pak viktima nga radhët e saj.

Anëtarët e Nëntokës Shtetërore Britanike, filluan dredhitë e tyre duke nxitur ndjenjat nacionaliste midis pakicave osmane. Qëllimi kryesor i propagandës ishte parandalimi i indianëve myslimanë dhe arabëve që të bashkoheshin në luftë në anën e Perandorisë Osmane kur Kalifi shpalli 'Thirrjen për Armë'. Ajo gjithashtu dëshironte të ndalonte formimin e një ushtrie të mundshme islamike. Agjentët famëkeq të nëntokës shtetërore, si kapiteni T. E. Lawrence dhe Gertrude Bell, u përdorën në shumë raste për të nxitur arabët kundër Perandorisë Osmane.

Në përputhje me rrethanat, Nëntoka Shtetërore Britanike nënshkroi marrëveshje me Shejh Sayyidin e Sabias në Jemen më 30 Prill të vitit 1915, me Sheikun Saudit Abdul Aziz bin Saud më 26 Dhjetor dhe me Sheikun e Katarit më 3 Nëntor të vitit 1916. Si rezultat i Nëntokës Shtetërore Britanike, 'Thirrja për Armë' e Perandorisë Osmane e datës 23 nëntor të vitit 1914, u la në masë të madhe pa përgjigje.

Argumentet britanike që synonin të minonin 'Thirrjen për Armë' reflektonin një strategji shumë dinake dhe përçarëse. Një memorandum i dërguar nga një anije britanik e cila zbarkoi në det të Jedas më 4 qershor të vitit 1915, përfshinte akuzat e mëposhtme perfide:

- 'Thirrja për Armë' e Perandorisë Osmane ishte e pavlefshme, sepse ajo po bashkëpunonte me një vend të krishterë (Gjermaninë),

- Gjermania, duke përfituar nga pozicioni i vështirë i Portës, mashtroi qeverinë turke me premtime dhe para dhe i shtyu ata në një luftë të gabuar,

- Gjermanët i shtynë Osmanët të shpallnin luftë kundër Britanisë, për të provokuar miliona myslimanë që jetonin nën regjimin Britanik vetëm sepse ajo ishte armik i Gjermanisë,

- Nëse myslimanët do të pranonin thirrjen për luftën, ata do të bëheshin kurban të interesve të Gjermanisë,

- Myslimanët të cilët jetonin në Britani, Francë dhe Rusli ishin kundër politikave të gabuara turke.

Aga Khan, një nga udhëheqësit fetarë të Indisë në atë kohë i cili ishte gjithashtu një anglofil i njohur, veproi si avokat për interesat e Nëntokës Shtetërore Britanike dhe bëri akuzat e mëposhtme ndaj Perandorisë Osmane:

*Turqia e cila tashmë është treguar si vegël në duar të Gjermanëve, jo vetëm që ka shkatërruar veten por ka humbur edhe pozicionin e saj si Besimtare Myslimane dhe e keqja padyshim se do të kapërdij atë.*⁵⁹

Përmes argumenteve të tilla provokuese, shumë arabë dhe myslimane tjerë që ishin nën kupolën e Perandorisë Osmane u kthyen kundër Osmanëve dhe nuk ju përgjigjen thirrjes së Sulltanit për armë. Ky zhvillim i mundësoi Nëntokës Shtetërore Britanike që të manipulonte më lehtë këto pakica dhe t'i bënte ata të protestonin dhe të shpallnin pavarësinë. Tani, si pjesë e ndarë e Perandorisë, këto territore që dikur i takonin Perandorisë Osmane nuk mund ta mbronin veten nga rënia nën kontrollin e Nëntokës Shtetërore Britanike.

Britanikët arrijnë të nxisin disa prej Arabëve kundër Turqve

Hapi i parë në planin e Nëntokës Shtetërore Britanike ishte parandalimi i formimit të Unionit Islamik duke minimizuar Thirrjen e Perandorisë Osmane për Armë dhe duke ndarë arabët nga osmanët në mënyrë që të shtonte koloni të reja nën sundimin e saj. Arabët po jetonin në toka që ishin jo vetëm pikat më strategjike të kalimit në botë por gjithashtu toka të cilat ishin shtëpi të rezervave të pasura të naftës.

Përfaqësuesit e Nëntokës Shtetërore Britanike së pari vunë kontakte me Huseinin, udhëheqësin arab hashemit dhe Sharifin e Mekës, i cili u emërua në vitin 1909 dhe ishte i njohur për qëndrimin e tij rebel dhe kërcënues ndaj Perandorisë Osmane. Nëntoka Shtetërore Britanike i premtoi atij mbështetje të plotë dhe një mbretëri të madhe pas luftës, nëse ai do ti fillonte trazirat kundër Osmanëve. Sigurisht, ky premtim nuk ishte asgjë tjetër përveç një truku tjetër i Nëntokës Shtetërore Britanike, për manovrim të përkohshme. Në të vërtetë, britanikët tashmë i kishin ndarë këto rajone me Francën me Marrëveshjen e fshehtë të Sykes-Picot të nënshkruar në Prill të vitit 1916. Deklarata e Balfour e vitit 1917 gjithashtu thoshte se do të kishte një shtet hebre në Palestinë. Asnjë nga këto plane nuk përfshinte të ashtuquajturën 'Mbretërin e Madhe Arabe' të premtuar për Sharif Huseinit.

Sidoqoftë, Sharif Huseini, me ëndërrën për të qenë mbreti i një 'Mbretërie të Madhe Arabe', bëri një marrëveshje me Sir Henry McMahon, Komisionerin e Lartë Britanik në Kajro, dhe i nisi trazirat më 27 qershor të vitit 1916. Kryengritja u financua me ari britanikë, që arrin shumën afër 1 milion £.⁶⁰

Ambasadori britanik Reader Bullard në Jeddah e quajti Sharif Huseinin, sheik arab dinak, gënjeshtar, i dyshimtë, kokëfortë, i kotë, mendjemadh, injorant, lakmitar dhe mizor.⁶¹ Ai ishte me të vërtetë një anglofil që nuk u përmbajti të tradhtonte popullin dhe vendi e tij për ëndërrat e tij personale për të fituar pozicione të rëndësishme. Ai kishte të gjitha karakteristikat tipike të hipokritëve që Nëntoka Shtetërore Britanike i ka zgjedhur midis komunitetit myslimane gjatë gjithë historisë me qëllim të shkakimit të trazirave.

Duhet të theksohet këtu se në kundërshtim me besimin e përgjithshëm, jo të gjithë arabët u bashkuan në këtë tradhti dhe revoltë. Të dhënat zyrtare britanike i referohen kësaj trazire si 'Revolta e Madhe Arabe' dhe thonë se të gjithë Arabët morën pjesë në të. Ky është një dezinformim i qëllimshëm, një propagandë që synon të ushqejë armiqësinë turko-arabe në planin afatgjatë. Sipas autorit britanik Robert Lacey, kjo revoltë nuk ishte gjë tjetër veçse një tradhëti e përbashkët britanike-hashemite e organizuar kundër Perandorisë Osmane.⁶²

Për çudi, Nëntoka Shtetërore Britanike nuk kishte ndonjë problem për të gjetur hipokritë dhe servilë në mesin e arabëve për t'i shërbyer interesave të Nëntokës Shtetërore Britanike. Këta hipokritë që tradhtojnë kombet dhe vendet e tyre për përfitime të vogla, në të vërtetë nuk përfitojnë asgjë, sepse Nëntoka Shtetërore Britanike asnjëherë nuk i mban premtimet e dhëna atyre të cilët janë bërë me ta. Për më tepër, këta njerëz as nuk mund ta kuptojnë se e bëjnë veten të mjerë duke sakrifikuar dinjitetin dhe nderin e tyre, dhe përfundimisht mbesin në dy anët të përçmuar. Njerëz të tillë përshkruhen si më poshtë në një ajet të Kuranit famëlartë:

... Kushdo që e merr shejtanin për mbrojtës në vend të Zotit, ai ka humbur qartë gjithçka. Ai u bën atyre premtime dhe i mbush me shpresa të rreme. Por ajo që Shejtani u premtonte nuk është gjë tjetër veçse mashtrim. Vendstrehim i këtyre njerëzve do të jetë ferri. Ata nuk do të gjejnë asnjë mënyrë për të shpëtuar prej tij. (Kur'an, 4:119-121)

Në librin e tij 'Fahreddin Paşa'nın Medine Müdafaası' (Mbrojtja e Medinës nga Fahredin Pasha), Feridun Kandemir shpjegon pse do të ishte e gabuar t'i atribuohet revolta e Sharif Huseinit gjithë shoqërisë arabe:

Gjatë gjithë luftës, arabët luftuan përkrah turqve në çdo kufi, duke filluar nga Galipoli. Në të vërtetë, edhe gjatë Luftës sonë për Pavarësisë, shumë arabë së bashku me ushtarët turq luftuan kundër grekëve në frontin e Ajdinit ku shumë arabët mbetën dëshmorë. Në Luftën e Parë Botërore, nuk kishte asnjë arab të vetëm që u rebelua

kundër turqve në zonat me shumicë arabe, si Iraku, Siria, Libani, Jemeni ose Palestina. I vetmi që u revoltua ishte Huseini, Sharifi i Mekës... Arabët që Sharif rekrutoi për këtë revoltë ishin beduinë të varfër që jetonin si nomadë në shkretëtirat e Hejazit dhe të cilët mbijetonin nga plaçkitja. Jo vetëm që arabët në qytete si Meka, Taij, Jedah nuk kishin marrë pjesë në trazira; por Sharif Huseini as nuk u përpoq t'i rekrutonte. Sidoqoftë, sheikët e tjerë përkrahës të tij ishin të varfër dhe kërkonin vetëm financa. Britanikët ishin të vetëdijshëm për këtë ashtu si Sharif Hussein dhe përdorën fuqinë e parave për t'i tunduar dhe përdorur ata derisa revolta arriti qëllimin e saj.⁶³

Ky fakt përmendet gjithashtu në burimet britanike. Një diplomat britanik, Sir Henry McMahon, gjithashtu thekson se arsyeja pse provokuan Sharif Huseinin të ngritej në fron ishte të lëkundte besnikërinë e ushtarëve arabë që luftonin përkrah Osmanëve.:

Në ato momente një pjesë e madhe e forcave [turke] në Galipoli dhe gati e gjithë ushtria në Mesopotami ishin arabë, kështu që arabët ishin midis të dy palëve. A mund t'u japim atyre ndonjë garanci për ndihmë në të ardhmen për të justifikuar ndarjen e tyre me turqit? Më thanë ta bëja këtë veprim menjëherë dhe në atë mënyrë fillova lëvizjen arabe.⁶⁴

Siç e pranon qartë McMahon, Nëntoka Shtetërore Britanike zhvilloi një propagandë të ashpër dhe bëri premtime të rreme për të shkëputur arabët nga Perandoria Osmane. Përkundër kësaj, ata arritën të ndikojnë vetëm në një grup të vogël arabësh. Sidoqoftë, mbështetja e Nëntokës Shtetërore Britanike lejoi që kjo pakicë të fitonte epërsinë kundër Perandorisë Osmane.

Është e rëndësishme të përmendet një fakt historik: Kur shpërtheu Lufta e Parë Botërore, Egjipti ishte nën kontrollin e Britanisë. Sidoqoftë, Nëntoka Shtetërore Britanike e dinte mirë se egjiptianët do të kërkonin të bashkoheshin me osmanët në luftë, dhe për këtë arsye e përjashtuan Egjiptin nga përpjekjet e tyre të luftës. Me fjalë të tjera, Nëntoka Shtetërore Britanike e dinte mirë se një pjesë e madhe e nënshtetasve arabë të Perandorisë Osmane do t'i qëndronin besnik ndaj Perandorisë Osmane.⁶⁵

Figura kryesore prapa revoltës së Sharif Huseinit: Spiuni Britanik 'Lawrence'

Megjithë mbështetjen masive financiare dhe logjistike të Britanikëve, revolta dështoi të kthehej në një lëvizje që përfaqësonte të gjithë botën Arabe dhe ishte e kufizuar në pjesëmarrjen e katër deri në pesë mijë njerëzve të armatosur. Gjatë trazirave, një person luajti një rol veçanërisht të rëndësishëm duke ndihmuar Sharif Huseinin. Ai ishte Thomas Edward Lawrence arkeolog dhe agjent i shërbimit të inteligjencës britanike. Si përfaqësues i Nëntokës Shtetërore Britanike, Lawrence bashkëpunoi me Sharif Huseinin dhe një nga djemtë e tij, Faisalin, për të organizuar kryengritjen arabe hashemite kundër osmanëve.

Autori britanik David Garnett, i cili shkroi një biografi për agjentin Lawrence, thotë se ai ishte një person arrogant me kompleksin e viktimës.⁶⁶ Sipas Richard Aldington, Lawrence kishte 'egoizëm të theksuar, ishte 'njeri i shtirur' dhe 'homoseksual'.⁶⁷ Me fjalë të tjera, Lawrence shfaqti karakteristikat tipike të anëtarëve të Nëntokës Shtetërore Britanike.

Në këtë pikë, është e rëndësishme të mbani në mend se Nëntoka Shtetërore Britanike zgjedh me kujdes homoseksualë për të kryer ryshfetet e saj dhe veçanërisht për të përfunduar misione të rrezikshme.

I lindur më 16 gusht të vitit 1888, në Tremadog, Uells si një fëmijë jashtëmartesor, Lawrence filloi të interesohej për arabët në 1909. Dy vjet më vonë ai shkoi në Tripoli për gërmime dhe filloi të jetonte me fiset arabe, duke u veshur dhe duke vepruar si ata. Pavarësisht nga magjepsja e tij me arabët, Lawrence mbante një urrejtje të madhe për turqit. Në një letër që i dërgoi zonjës Reider në Oksford më 5 prill të vitit 1913, ai tregoi urrejten e tij ndaj tyre:

*Sa për Turqinë, **jam ngopur me turqit!** Zhdukja e tyre do të thoshte një shans për arabët, të cilët në asnjë rast nuk ishin të paafte për një qeveri të mirë.⁶⁸*

Në një letër tjetër që i dërgoi zonjës Rieder më 18 shtator të vitit 1914, ai shprehu qartë mendimet e tij mbi mundësinë e hyrjes së turqve në luftë:

Unë kam një frikë të tmerrshme se turqit nuk kanë ndërmend të hyjnë në luftë, sepse do të ishte një hap i mbarë nëse ata do të reduktoheshin në Azinë e Vogël dhe do ta vendosin edhe atë pjesë në komision.⁶⁹

Pasi shpërtheu Lufta e Parë Botërore, Lawrence u vendos si toger në zyrën e shërbimit të inteligjencës Britanike në Kajro, në dhjetor të vitit 1914. Ai do të merrte në pyetje robërit e luftës, do të vizatonte hartat e fushëveprimit, do të vlerësonte raportet nga agjentët që veprojnë përtej linjave turke dhe do të ndërtonte strategji me kontributin e arabëve në një përpjekje për të shkatërruar Perandorinë Osmane.

Ai më vonë mori përsipër 'Byronë Arabe' të sapo krijuar në Kajro. Urrejtja e tij e shfrenuar ndaj turqve nuk mund të përmbahej dhe do të shfaqej në shumë raste, përfshirë edhe në një letër që i dërgoi mikut të tij arkeolog D. G. Hogarth më 20 prill të vitit 1915:

***Turqia e vjetër dhe e varfër ka mbetur e varur.** Njerëzit flasin gjithmonë për shfaqje të shkëlqyera që ajo ka bërë kohët e fundit, por me të vërtetë është shumë e bukur vetëm në fjalë. **Gjithçka rreth saj është shumë e sëmurë ...**⁷⁰*

Pas një kohe të shkurtër, i dërguar në Irak me një mision sekret nga Zyra Britanike e Luftës, Lawrence u rishfaq në prill të vitit 1916 për të ndihmuar në shpëtimin e 13,000 trupave britanike nën komandën e Gjeneralit Townshend, të cilët u mbajtën nën rrethim nga turqit në Kut Al Amara. Së bashku me Kolonel Beach dhe një oficer tjetër britanik me emrin Aubrey Herbert, ai takoi gjeneralin turk Halil Pashan, me synimin për t'i ofruar atij 1 milion paund që në herën e parë, duke shpresuar që Halil Pasha të lirojë garnizonin britanik. Sipas planit, nëse ai do të refuzonte, ata do të dyfishonin shumën dhe në vend të kësaj do të ofronin 2 milion. Halil Pasha, plotësisht i neveritur, jo vetëm që refuzoi ofertën, por gjithashtu ekspozoi rryshfetin e tyre, duke i lënë të poshtëruar.

Në ndërkohë, përfaqësuesit e Nëntokës Shtetërore Britanike ishin thellë në negociata me Sharifin e Mekës, Huseinin, për rolin e tij në trazira kundër Perandorisë Osmane. Gjithashtu, Lawrence po përpiqej të bënte çmos për të bindur arabët irakianë që të bashkoheshin dhe të bashkëpunonin me ushtrinë britanike, duke u premtuar udhëheqësve shia, kalifatin. Edhe këtë here, ai dështoi.

Pasi Sharif Huseini filloi revoltën, Lawrence shkoi në Arabi në Tetor të të njëjtit vit, këtë herë si kapiten. Atje ai takoi Abdullahun, Aliun dhe Zaidin, djemtë e Sharif Huseinit si dhe Faisalit, të cilit më vonë do t'i ndihmonte në ngritjen e tij në fron në vitin 1921 në Irak. Së bashku me oficerët e tjerë britanikë, ai ndihmoi në furnizimin me armë dhe para për revoltën ndaj Perandorisë, e cila ishte në fazat e saja fillestare, dhe gjithashtu mlodhi së bashku dhe organizoi fiset revoltuese për të organizuar sulme ndaj caqeve të paracaktuara.

Pasi u bashkua me forcat e Faisalit si një oficer komunikimi, Lawrence vazhdoi aktivitetet e tij të spiunimit dhe mori pjesë në luftimet direkte kundër Turqve. Me taktikat godit dhe ik, ai shkaktoi dëme në njësitë osmane dhe linjat e furnizimit, gjatë përballjeve ai arriti të marrë nën kontroll edhe Portin e Aqabas, e cila i dha atij një medalje dhe titullin nënkolonel. Ai organizoi sulme në hekurudhën Hejaz. Qindra ushtarë osmanë u martirizuan në sulmet gjithnjë e më të ashpra ku britanikët fituan betejën. Lawrence nuk u përmbajt nga zbulimi i gjendjes së tij të mjegullt shpirtërore ndërsa mburrej për suksesin e tij:

*Dhe ne po i shtynim me mijëra nga ta në vdekjet më të tmerrshme, jo për të fituar luftën, por që misri, orizi dhe vaji i Mesopotamisë të ishin tonat. E vetmja nevojë ishte të mposhtnim armiqtë tanë (Turqinë nder ta), dhe kjo më në fund u bë me mençurinë e Allenby me më pak se katërqind të varrë, duke i përdorur për nevojat tona duart e të shtypurve në Turqi. **Jam krenar për tridhjetë luftimet e mia, sepse nuk pata asnjë gjakderdhje. Të gjitha provincat për mua nuk kanë vlerën e një anglezi të vdekur.**⁷¹*

Lawrence ishte forca kryesore shtytëse e revoltës arabe kundër turqve⁷² dhe ai gjithashtu do të pranonte më vonë se detyra e tij ishte e bazuar në hipokrizi dhe mashtrim:

Njerëzit e mi me siguri ju kanë thënë se detyra është të nxisni një rebelim arab kundër Turqisë, dhe për këtë, unë duhet të përpiqem të fsheh pjesën e jashtme franke dhe të jem sa më pak arab nga pamja. Pra, është një lloj skene e huaj, në të cilën luhet ditë e natë, me veshje të zbukuruara, në një gjuhë të çuditshme⁷³

Në sulmin e organizuar kundër Ushtrisë së 4-të Osmane në Shtator të vitit 1918, Lawrence urdhëroi njerëzit e tij të mos merrnin asnjë të burgosur. Si rezultat, me urdhër të Lawrence, 5000 ushtarëve osmanë ju prenë kokat në një masakër tronditëse.⁷⁴ Në fund të të njëjtit vit, së bashku me grupin e tij të vrasësve, ai hyri dhe terrorizoi Damaskun.

Në tetor të vitit 1918, Lawrence u nis për në Britani, para së cilës ai do t'i shkruante rreshtat vijues, majorit R. H. Scott më 4 tetor:

Ne ishim një grup i vogël dhe i çuditshëm, por besoj se ndryshuam rrjedhën e historisë në Lindjen e Mesme.⁷⁵

Në parathënien e Shtatë Shtyllave të tij të Urtësisë, Lawrence shpjegon se si Nëntoka Shtetërore Britanike, me të si përfaqësues të tyre, mashtrroi arabët me premtime të rreme në mënyrë që ata të bindeshin për të shkaktuar trazira kundër turqve:

Kabineti [Britanik] ngriti arabët për të luftuar për ne duke premtuar vetëqeverisje më pas. Arabët janë të prirur t'i besojnë personave dhe jo institucioneve. Ata panë tek unë një agjent të lirë të Qeverisë Britanike dhe kërkuan nga unë një miratim të premtimeve të tyre me shkrim. Kështu që unë duhej të bashkohesha me komplotin dhe për aq sa vlente fjala ime, i sigurova burrat për shpërblimin e tyre ... Ishte e qartë që nga fillimi se nëse do të fitonim luftën, këto premtime do të ishin letër e vdekur dhe nëse do të kisha qenë një këshilltar i singertë i arabëve do t'i kisha këshilluar që të shkojnë në shtëpi dhe të mos rrezikojnë jetën e tyre duke luftuar për gjëra të tilla: por e mbusha veten me shpresë...e vazhdova mashtrimin, me bindjen time se ndihma arabe ishte e nevojshme për fitoren tonë të lehtë dhe të shpejtë në Lindje, dhe se më mirë të fitojmë dhe ta thyejmë fjalën sesa të humbasim.⁷⁶

Emir Faisal, djali i Sharif Huseinit, i cili i filloi trazirat kundër Osmanëve ku si rezultat u derdh gjaku i myslimanëve, e kuptoi këtë mashtrim kur pa se asnjë nga premtimet e dhëna atij nuk u mbajt dhe ndonëse me vonë tha:

Unë nuk do të jem në gjendje të përballem me botën myslimane. I kërkova që të luftonin me Kalifin dhe të sakrifikonin. Por tani shoh që vendet evropiane, qëllimeve të të cilëve u shërbyem, po ndajnë vendet arabe.⁷⁷

Aleanca Sharif Hussein-Faisal-Lawrence i dha një nga dëmet më të mëdha botës islame. Politika për t'i bërë myslimanët të luftojnë njëri-tjetrin fillimisht filloi me këtë aleancë dhe tani përfaqëson pikën kryesore të planeve të krijuara me kujdes nga Nëntoka Shtetërore Britanik. Ky shembull tregon më së miri praninë e hipokritëve që gjithmonë kanë ekzistuar në mesin e komunitetit mysliman. Këta njerëz bien në gënjeshtat e Nëntokës Shtetërore Britanike dhe tradhtojnë vendet e tyre në shkëmbim të përfitimeve të vogla. Nëntoka Shtetërore Britanike do të jetë një rrezik për botën islame vetëm kur përdor hipokritë të tillë. Për këtë arsye dhe për hir të botës islame, është me rëndësi jetike që myslimanët të jenë jashtëzakonisht të kujdesshëm dhe të vëmendshëm ndaj hipokritëve që bëhen pjesë e lojrave satanike dhe kurthave të Nëntokës Shtetërore Britanike.

Myslmanët shia luftuan në krah me Kalifatin Osman

Britania supozoi se myslimanët shia të Irakut - të cilët sapo i kishte pushtuar - do të ishin në anën e saj dhe bëri planet e saj në përputhje me këto rrethana. Sidoqoftë, myslimanët shia iu përgjigjën 'thirrjes së armëve' të Kalifit Osman' dhe luftuan së bashku me Perandorinë Osmane. Telegrami që njoftoi fillimin e pushtimit britanik dhe lajmin se bota islame ishte nën kërcënimin e pushtimit u lexua në të gjitha xhamitë Shia në të gjithë Irakun. Al-Sejid Muhamed Kazim al-Yazdi, autoriteti më i lartë i Shia-ve u bëri thirrje të gjithë Shiave për të mbrojtur Al Kaaba Al Musharrafah (Qaben), Al-Masjid an-Nabawī (xhamin e Profetit (p.q.m.t) dhe varret e hoxhallarëve. Ai gjithashtu dërgoi djalin e tij Sejjid Muhamed në luftë. Sheiku i Shiave Ash-Shariati al-Esfahani e mbështeti thirrjen dhe tha se "ata që janë shumë dembelë për t'i ndjekur britanikët po bëjnë një mëkat të madh". Për më tepër, në qytetin Kadhimiya, Shejh Mahdi al-Khalissi lëshoi një fetva dhe tha se myslimanët duhet 'të shpenzojnë gjithçka që kishin për të mbrojtur Islamin derisa kërcënimin e pabesimtarëve të zhdukej plotësisht'. Shiat njoftuan se 'ata do të bashkonin forcat me Perandorinë Osmane për të përzënë pabesimtarët nga gjeografia

Islame dhe se Turqit ishin vëllezërit e tyre në fe dhe se ata do të ndihmonin Turqit për të përzënë Britanikët nga ato toka'. Emiri i Kuvajtit Muhammara ishte gati të dërgonte trupa për të mbështetur britanikët, por vendosi të mos e bëjë këtë gjë kur e pa trimërinë e madhe të Shiave. Grupet shia vazhduan pa frikë në fushëbetej në krah me forcat osmane, duke vazhduar përgjatë lumenjve Tiger dhe Eufrat disa me anije dhe disa në këmbë.

Dijetarët shia të cilët luftuan në frontin Qurna: Syed Mustafa al-Kashani, Syed Mehdi Heydari, Sheikh Ash-Shariati al-Esfahani dhe Syed Ali al-Damad

Dijetarët shia të cilët luftuan në frontin e Basrës Lindore: Shejh Mahdi al-Khalissi, Syed Muhamed, Shejh Jafar Radi dhe Sayed Kamal al-Khilli

Dijetarët shia që luftuan në frontin Esh-Shuajbah: Sayyed Mohammed Said, Sheikh Abdul Karim al-Jazairi, Sheikh Abdul Ridha Radi dhe Sayyid Muhsin al-Hakim.

50,000 vëllezër Shia ranë dëshmor në betejë në frontin Ash-Shuaybah. Tre mijë trupa tjerë u martirizuan. Për më tepër, Shiat luajtën një rol të rëndësishëm në fitoren Osmane në Kut Al Amara, e cila ishte fitorja më e rëndësishme Osmane e Luftës së Parë Botërore dhe humbja më e madhe e Nëntokës Shtetërore Britanike. Kjo fitore u bë e mundur vetëm sepse myslimanët qëndruan të bashkuar.

Luftanijet Osmane të rrëmbyera nga Britanikët dhe Pagesa që nuk u kthye kurrë

Në fazat e hershme të Luftës së Parë Botërore, Perandoria Osmane nuk kishte hyrë ende në luftë dhe porositi tre anije të mëdha të njohura si 'Dreadnoughts' nga Britania dhe i pagoi ato paraprakisht. Këto anije, të emërtuara 'Sulltan Osman', 'Sulltan Reshadije' dhe 'Fatih', kishin teknologji revolucionare për fillimin e shekullit të 20-të. Ata mund të lëviznin shpejt dhe ishin pothuajse si flota detare. Këto anije ishin vendimtar për përmirësimin e flotës osmane dhe për ta mbajtur atë nga pësimi i humbjeve në detë. Në fillim të viteve 1900, transporti tokësor nuk ishte aq i përparuar dhe aftësia ushtarake përcaktohej nga fuqia në det.

Perandoria Osmane po kishte vështirësi financiare dhe administrata shtetërore filloi kampanja për të ngritur fonde në të gjithë vendin për të financuar luftanijet. Vendet për mbledhjen e fondeve u ngritën në vende publike dhe madje edhe nxënës të shkollës kontribuan me paratë e xhepit. Donacionet e mëdha do të shpërbleheshin me një 'Donanma İlane Madalyası' (Medalja e Donacioneve për Marinën). Në mënyrë të ngjashme, 'Donanma-i Osmanî Muavenet-i Milliyye Cemiyeti' (Shoqata për Marinën Osmane) u krijua në vitin 1909 dhe organizoi kampanja për mbledhjen e fondeve dhe madje shiti produkte për të ndihmuar në mbledhjen e shumës së kërkuar për luftëanijet.

Luftanija 'Sulltan Osman' u quajt fillimisht 'Rio de Janeiro', sepse ishte porositur më parë nga Brazili. Sidoqoftë, kur Brazili nuk arriti të kryejë pagesën, prodhuesi britanik Armstrong nxori në shitje anijen dhe osmanët e blenë atë. Madje edhe komandati ishte vendosur: kapiteni legjendar i Hamidiye, Rauf Beu.

Më 27 korrik të vitit 1914, Rauf Beu, në emër të Perandorisë Osmane, shkoi në Newcastle, Angli për të marrë luftanijen 'Sulltan Osman'. Sidoqoftë, gjërat morën një kthesë të papritur. Pasi që Osmanët kishin vendosur që të ishin me Fuqitë Qendrore, përfaqësuesit e Nëntokës Shtetërore Britanike nuk donin t'i jepnin një anije luftarake kaq të përparuar një vendi që do të luftonte së shpejti kundër tyre.

Churchill ishte krejtësisht i vetëdijshëm se kërkesa për luftanije do të shkaktonte një skandal të madh diplomatik; megjithatë, më 3 gusht të vitit 1914, Britania deklaroi zyrtarisht se nuk janë në shitje dy anijet e njohura si 'Sulltan Osmani' dhe 'Reşadiye'. Me fjalë të tjera, britanikët rrëmbyen luftanijet e osmanëve, para se flamuri turk të ngrihej në to. Jo vetëm që i konfiskuan, por ata gjithashtu - plotësisht në mënyrë të paligjshme dhe të pajustifikueshme - refuzuan të kthejnë arin e paguar për to, i cili arrinte në **12 milion**. Paratë ishin dhënë paraprakisht. Për ta thënë më saktë, ata i vodhën pa turp paratë.

Rauf Beu (Orbay), i cili u quajt ndryshe si "Heroi i Hamidiyes" dhe që më vonë do të bëhej Kryeministri i 3-të i Republikës Turke, kujtoi incidentin me fjalët e mëposhtme:

Kësti përfundimtar, shtatëqind mijë lira ishin paguar. Ne donim t'i kryenim gjërat shpejt, kështu që vendosëm të kalonim disa teste për anijet dhe ramë dakord me fabrikën që anijet të na dorëzoheshin më 2 gusht 1914. Sidoqoftë, gjysmë ore para ceremonisë së ngritjes së flamurit, e cila ishte një ditë pasi ne paguam paratë, britanikët kërkuan 'Sulltan Osmanin'. Megjithëse ne protestuam duke u thirrur në procedurat e dakorduara, askush nuk u trazua...⁷⁸

Luftanija 'Sulltan Osman' u bë menjëherë pjesë e marinës britanike dhe u quajt 'Agincourt'. Luftëanija 'Reşadiye' u riemërua si 'Erin' por ditën e provës së saj më 22 gusht, u pa që pajisjet e saj të qitjes nuk funksiononin mirë. Meqenëse nuk mund të riparohesh plotësisht dhe askush nuk do ta blinte atë pas këtij zhvillimi, ajo u shkatërrua në vitin 1922.

Rauf Orbay shpjegon:

Në fillimin e Luftës Botërore, ishte çështja e kthimit të arit tonë në vlerë prej 12 milion £, të cilën ne e paguam për luftëanijet tona të emëruar si Sulltan Osman, Sulltan Reshad dhe Fatih. Ato u ndërtuan para se të hynim në luftë, por britanikët nuk na i dorëzuan edhe pse ne i kishim paguar plotësisht ato. Ky ishte qartazi borxh i britanikëve...⁷⁹

Ky ishte vërtet borxhi i britanikëve, por sipas nenit 58 të Traktatit të Lozanës, pala turke çuditërisht hoqi dorë nga kjo e drejtë, ndoshta nën presionin e Nëntokës Shtetërore Britanike. Artikulli 58 i traktatit shkruan si më poshtë:

Turqia, nga njëra anë, dhe Fuqitë e tjera Kontraktuese (përveç Greqisë) nga ana tjetër, heqin dorë reciprokisht nga të gjitha pretendimet monetare për humbjet dhe dëmin e pësuar përkatësisht nga Turqitë dhe Fuqitë e përmendura dhe nga shtetasit e tyre (përfshirë personat juridikë) midis 1 gushtit të vitit 1914 dhe hyrjes në fuqi të këtij Traktati, si rezultat i akteve të luftës ose masave të sekuestrimit, asgjësimit ose konfiskimit.⁸⁰

Në fakt, ky artikull nuk vlente për konfiskimin nga britanikët. Akti i vjedhjes u krye nën vëzhgimin e plotë të botës dhe ndodhi para se Osmanët të hynin në luftë. Nuk ishte asgjë më shumë se një aktivitet i zakonshëm tregtar midis dy vendeve dhe për këtë arsye nuk ishte një humbje e lidhur me luftën. Për këtë arsye, ky nen i Traktatit të Lozanës në të vërtetë nuk e mbulonte sekuestrimin e përmendur. Përkundër këtij fakti, Nëntoka Shtetërore Britanike ishte në gjendje ta bënte këtë rrëmbim të dukej sikur ishte një humbje lufte. Në fund, pala turke hoqi dorë nga paratë e paguara plotësisht për luftëanijet, të cilat ishin konfiskuar në mënyrë të paligjshme dhe të pajustificueshme nga qeveria britanike. Personi që ishte përgjegjës për operacionin e mashtrimit nuk ishte askush tjetër përveç Winston Churchillit; një nga anëtarët më të zellshëm dhe besnikë të Nëntokës Shtetërore Britanike.

Humbja më e madhe e Nëntokës Shtetërore Britanike: 'Fushata Gallipoli'

Siç u shpjegua më parë, Lufta e Parë Botërore ishte një projekt i hartuar me kujdes i Nëntokës Shtetërore Britanike dhe shkoi siç ishte planifikuar. Edhe para se të kishte ndonjë shkëndi lufte, Britania tashmë kishte përfunduar përgatitjet e saj. Ajo tregtonte anijet e saj me avull për ata që punonin me naftë, porositi 18 anije të reja dhe vendosi flotat e saj të nëndetëseve dhe avionëve. Edhe në fillim të vitit 1911, ajo filloi stërvitjet në mënyrë të plotë dhe e bëri flotën e saj të gatshme për luftë. Ajo siguroi mbështetjen franceze përmes mjeteve diplomatike. Në kohën kur shpërtheu Lufta e Parë Botërore, marina britanike - e rinovuar plotësisht - ishte më se e gatshme.

Planifikuesi i këtyre përgatitjeve ishte Winston Churchill, Lordi i Parë i Admiralitetit Britanik. Një Turkofob dhe Islamofob i famshëm, Churchill ishte një anëtar besnik i Nëntokës Shtetërore Britanike dhe ishte projektuesi kryesor i fushatës së Gallipolit. Para se Perandoria Osmane të bashkohej me luftën, Churchill i kishte paraqitur një projekt Kryeministrit të atëhershëm Britanik Herbert Asquith në shtator të vitit 1914 duke deklaruar se marina britanike duhet të kalonte ngushticën e Dardaneleve dhe të pushtonte Stambollin. Churchill ishte i bindur se posa të merrej Stambolli, Perandoria Osmane do të binte.

Në përputhje me planin, një flotë e madhe detare e aleatëve e përbërë nga 16 anije luftarake e udhëhequr nga Admirali John de Robeck më 18 Mars u përpoq të kalonte ngushticën e Dardaneleve. Mirëpo, minat e vendosura më parë nga ushtari turk Nusreti shkaktuan dëme serioze në luftëanijet aleate. Së bashku me bombardimet e vazhdueshme osmane që rrallë humbisnin cakun, ëndrrat britanike për të kaluar Galipolin morën fund. Humbja më 18 mars të vitit 1915, shkaktoi tronditje të madhe në Britani.

Megjithëse trupat britanike, franceze dhe anzake arritën të fitonin terren pas zbarkimit, rezistenca e paepur dhe sulmi i vazhdueshëm i forcave osmane i pengoi ata të merrnin gadishullin e Galipolit. Ata jo vetëm që nuk arritën të kalonin përmes mbrojtjes turke, por gjithashtu pësuan humbje të mëdha. Si rezultat i këtij zhgënjimi të madh si në betejat detare ashtu edhe në ato tokësore, Fuqitë Aleate vendosën të mbyllnin frontin e Galipolit. Gjeneral Majori Britanik Charles Monro dërgoi një raport në Londër pas inspektimeve të tij në terren dhe rekomandoi evakuimin e Galipolit. Si pasojë, forcat Britanike, Franceze dhe Anzake evakuuan Gadishullin e Galipolit në dhjetor të vitit 1915. Më 7 dhjetor u mor vendimi për të mbyllur frontin, më 10 dhjetor filloi evakuimi dhe deri më 27 dhjetor të vitit 1915, nuk kishte mbetur asnjë nga trupat aleate në Galipoli .

Humbjet e tmerrshme dhe masakra e Galipolit, e filluar nga britanikët përshkruhet si më poshtë në burimet e tyre:

Në nëntë muaj kasaphane të përgjakshme, rreth 58,000 ushtarë aleatë - përfshirë 29,000 ushtarë Britanikë dhe Irlandezë dhe 11,000 Australianë dhe ushtarë nga Zelanda e Re - humbën jetën gjatë operacionit me yll të keq për të marrë gadishullin e Galipolit; nga ana tjetër 87,000 trupa turke osmane vdiqën duke mbrojtur atdheun e tyre dhe të paktën 300,000 të tjerë nga të dy palët u plagosën rëndë.⁸¹

Individi i vërtetë përgjegjës për humbjen në Gallipoli: Winston Churchill

Si një nga mbështetësit më pasionant të imperializmit britanik, Winston Churchill besonte se rusët do të përparonin në Stamboll dhe do të merrnin kontrollin e ngushticave osmane sa më shpejt që të kishin mundësinë. Prandaj, ai donte të vepronte i pari, duke besuar se do të hynte në histori nëse do të merrte Stambollin.

Sidoqoftë, Churchill nënvlerësoi forcën shpirtërore të turqve dhe mendoi se sa më shpejt që anijet e frikshme britanike me armë moderne të hynin në ngushticën e Bosforit të Stambollit, turqit do të dorëzoheshin. Ky ishte një gabim i madh dhe Churchillit iu desh ta paguante atë me një humbje tronditëse, fillimisht në det e më pas edhe në tokë.

Jon Henley nga *the Guardian* vuri në dukje irracionalitetin e veprimeve të Churchillit në pjesën e tij "Duke kujtuar Galipolin: Duke nderuar guximtarët në kasaphanen e përgjakshme" dhe e quajti Churchill konceptuesin 'ambicioz' të fushatës së Galipolit e cila ishte 'planifikuar keq dhe ekzekutuar në mënyrë të tmerrshme'.⁸² Edhe nëse ai kishte të drejtë për ambiciet e kota të Churchillit, Henley duhet ta ketë ditur se Fushata e Galipolit rezultoi në disfatë për Britanikët, jo sepse u ekzekutua tmerrsisht, por për shkak të besimit dhe vendosmërisë së Mustafa Kemal Atatürkut dhe pasionit të popullit turk, që buron nga besimi i tyre i patundur në Zot.

Pas fiaskos së pësuar, Churchill dha dorëheqje si personi kryesor përgjegjës për humbjen e betejës në Galipoli (dhjetor 1915). Kur Lloyd George mori detyrën e Kryeministrit në vitin 1917, Churchill u emërua si Ministër i Municioneve dhe vazhdoi karrierën e tij politike pavarësisht ndërprerjeve të vogla. Është interesante që, edhe pas disfatës së Galipolit, Churchill gjeti rrugën për tu kthyer në skenën politike. Kjo ishte e mundur sepse ai ishte shumë besnik - siç e thanë britanikët - 'bulldog britanik'. Në fakt, gjatë Luftës së Dytë Botërore, i nxitur nga Nëntoka Shtetërore Britanike, Churchill ishte përsëri në skenë.

Pasi marina dhe ushtria britanike pësuan një disfatë të rëndë në Galipoli, shumë hetime kriminale filluan kundër Churchill. Ndërsa para disfatës, ai ishte i sigurt në aftësitë e tij dhe bëri deklarata arrogante duke thënë se së shpejti do të ulej në qendër të myslimanëve, në Stamboll, me uniformën e tij të marinës, por ai ndryshoi plotësisht tonin pas

disfatës, veçanërisht përballë akuzave drejtuar atij. Një ditë, i mbështetur në qoshe nga kritikantët, ai tha: "A nuk e kuptoni? Ne nuk luftuam Turqit në Galipoli. Ne luftuam Zotin dhe natyrisht humbëm."⁸³ (Sigurisht që Zoti i Plotfuqishëm është mbi përgojime të tilla.)

Gjenerali britanik Sir Ian Hamilton, i cili udhëhoqi forcat aleate gjatë fushatës së Galipolit, do të bënte një vërejtje të ngjashme:

Ne humbëm jo për shkak të fuqisë fizike, por për forcën shpirtërore të Turqve sepse ata nuk kishin më as barut. Por ne luftuam me fuqitë që vijnë nga qielli. Ishte sikur, edhe para se të vinim këtu fati ynë ishte vendosur dhe po zbatohej.⁸⁴

Kaltipet helmuese të përdorura kundër ushtarëve turq në betejën e Galipolit

Nëntoka Shtetërore Britanike kreu krime lufte duke përdorur kaltipe helmuese gjatë Betejës së Galipolit, të cilat i kishte prodhuar posaçërisht për ushtarët turq.

Këto armë ishin bërë nga katër gozhdë të mprehta, secila të lyera me helm dhe ishin ndërtuar për t'u siguruar që pavarësisht se si do të nguleshin në tokë, një gozhdë e mprehtë do të mbetej gjithmonë lartë.

Mijëra ushtarë turq, të cilët kishin veshur vetëm sandale me lëkurë në frontin e Galipolit, pasi shkelën mbi këto kaltipe të hedhura nga aeroplanët morën gangrenë. Për shkak të këtyre thonjve helmues, 12,000 ushtarëve turq u ishin prerë këmbët me sharra. Nëntoka Shtetërore Britanike e dinte mirë se ky akt ishte një krim lufte dhe krim kundër njerëzimit, por prapë nuk u përmbajt nga përdorimi i këtyre metode të ndyra kundër ushtarëve turq, sepse për shkak të mentalitetit të sëmurë darvinist, nuk i konsideronte turqit si qenie njerëzore. (Kombi fisnik turk është mbi pretendime të tilla).

Churchill planifikoi të përdorë gaz kimik mbi turqit në Galipoli

Sipas dokumenteve në Qendrën e Arkivave të Churchill, Churchilli, atëherë Sekretar i Shtetit për Luftë, pohoi se Turqit nuk ishin njerëz, por barbarë, dhe për këtë arsye gazi helmues mund të përdorej mbi ta.⁸⁵ Churchill kritikoi kolegët e tij për ngurtësinë e tyre në përdorimin e armëve kimike, duke thënë: 'Unë jam fuqimisht pro përdorimit të gazit helmues kundër fiseve të paqytetëruara.'⁸⁶ (Kombi fisnik dhe i respektuar turk është mbi pohime të tilla) Kur ai përballej me kundërshtime se një veprim i tillë do të ishte krim kundër njerëzimit, ai pretendonte se e vetmja mënyrë për të korrur fitore në betejën e Galipolit ishte përmes luftës kimike.

Në fund të Luftës së Parë Botërore, ai u përpoq shumë për përdorimin e gazit helmues. Pavarësisht nga viktimat e tmerrshme që shkaktoi lufta kimike në Frontin Perëndimor, ku vetë Churchill kishte qenë me detyrë për gjashtë muaj midis viteve 1915 dhe 1916,⁸⁷ të dhënat treguan se ai gjithmonë theksoi 'vlerën ushtarake' të luftës kimike pavarësisht nga dëmtimet e tmerrshme që shkaktoi. Në fakt, 'ai në çdo mënyrë donte të helmonte me gaz turqit në Galipoli'⁸⁸.

Për Churchillin, gazi kimik ishte vetëm një armë shtesë e përparuar që zotëronin Britanikët. Ai u tha kolegëve të tij se gazi mustardës mund të kishte një efekt shkatërrues dhe të ndihmonte në forcimin e pozicionit të tyre në luftën e Galipolit dhe shpresoi që "paragjykimi i paarsyeshëm kundër përdorimit të gazit nga ne mbi turqit do të pushojë". Ai madje mori parasysh stinën dhe pretendoi se era e fortë 'do të ofronte një mundësi të përsosur për të pasur më shumë efekt gazi..⁸⁹

Një dokument në arkiv i shkruar nga vetë Churchill zbulon se Churchilli kërkoi 'gazmaska' për trupat britanike në Galipoli. Në maj të vitit 1915, në kulmin e betejës së Galipolit, Churchill i tha Gjeneralit Britanik, Kitchener që të dërgonte veshje për prodhimin e gazit në Dardanele, pasi 'përdorimi i gazit në të dyja anët mund të ishte vendimtar.'⁹⁰ Churchill po diskutonte me Kitchener që gazi të përdorej në frontin e Galipolit pasi turqit ishin pa gazmaska.⁹¹

Me këtë qasje, Churchill mbështeti pikëpamjet e sëmurë të politikanit britanik dhe ish-kryeministrit William Ewart Gladstone, i cili i poshtroi turqit duke i quajtur ata një "mostër anti-njerëzore" jo vetëm për shkak të fesë, por për shkak të racës së tyre: unë përpiqem shumë shkurtimisht të skicoj... çfarë ishte raca turke dhe çfarë është... Ata ishin, në

tërësi, nga dita e zezë kur ata hynë për herë të parë në Evropë, një shembull i madh anti-njerëzor.⁹² (Kombi i respektuar turk është mbi pretendime të tilla)

Arkivat osmane tregojnë në detaje se si britanikët përdorën gaz kimik gjatë betejës së Galipolit. Ministria Osmane për Punë të Jashtme deklaroi se 'Forcat Aleate përdorën gaz helmues që shkaktonte ngulfatje' dhe bëri thirrje për një sqarim nga Britania.⁹³

Shkrimtari i njohur Noam Chomsky gjithashtu e zhvlerëson Churchillin për entuziazmin e tij për përdorimin e gazit helmues dhe e citon atë duke thënë: '*Gazi helmues do të ishte një armë e mirë kundër fiseve të paqytetëruar dhe arabëve të pabindur*'. (Arabët sigurisht që janë mbi pohime të tilla) Ai argumenton se Churchill konsideronte se armët kimike ishin thjesht 'zbatimi i shkencës perëndimore në betejën ushtarake' dhe se ai kishte miratuar përdorimin e gazit si eksperiment mbi afganët dhe arabët.⁹⁴

Pas Luftës së Parë Botërore, David Lloyd George emëroi Churchillin si Sekretar të Shtetit për Luftën. Në maj të vitit 1919, Churchill dha urdhër që trupat britanike të përdorin armët kimike gjatë kampanjës për të nënshtruar Afganistanin.⁹⁵

10 polemikat më të mëdha të karrierës së Winston Churchill' siç përshkruhet nga faqja e internetit e BBC zbuluan se si Churchill përdori gaz helmues kundër armiqve të tij: Churchill është kritikuar për avokimin e përdorimit të armëve kimike - kryesisht kundër kurdëve dhe afganëve. '*Unë nuk e kuptoj këtë ngurrim në lidhje me përdorimin e gazit*', shkroi ai në një memo gjatë rolit të tij si ministër për luftën në vitin 1919. 'Unë jam fuqimisht pro përdorimit të gazit helmues kundër fiseve të paqytetëruara'⁹⁶, vazhdoi ai..

Pjesa tjetër në vijim vazhdon të zbulojnë karakterin çnjerëzor dhe sadist të Nëntokës Shtetërore Britanike dhe Churchillit:

Dhe është e rëndësishme të theksohet se ai ishte në favor të përdorimit të gazit të mustardës kundër trupave Osmane në Luftën e Parë Botërore, thekson Warren Docket [një studiues në Universitetin e Kembrixhit dhe autori i librit 'Winston Churchill dhe Bota Islame']...⁹⁷

Britanikët qëllimisht verbuan të burgosurit turq të luftës në kampin e të burgosurve në Sidi Bashir të Egjiptit

Perandoria Osmane luftoi në shumë frone gjatë Luftës së Parë Botërore dhe Britanikët arritën të kapin shumë ushtarë turq në disa rajone. Një kamp i të burgosurve ku britanikët mbanin turqit rob lufte ishte kampi Sidi Bashir, i vendosur 15 km në veri-lindje të Aleksandrisë në Egjipt.

Komandanti i kampit ishte nënkoloneli britanik Coates. Nën mbikëqyrjen e mjekut ushtarak Kapitenit Gillespie, ishte caktuar një mjek armen, një atashe britanik dhe 5 infermierë britanikë të cilët ishin përgjegjës për shëndetin e të burgosurve.

Ky kamp mbajti trupat osmane të regjimentit të 48-të të divizionit të 16-të që u morën si të burgosur në Palestinë në vitin 1918. Për dy vite me radhë deri në 12 qershor të vitit 1920, këta ushtarë iu nënshtruan torturave, keqtrajttimeve, fyerjeve dhe poshtërimeve sistematike. Një burim zbulon se si ushtarët turq u martirizuan për shkak të trajtimit çnjerëzor të britanikëve:

Duke filluar nga 1 gushti i vitit 1919, britanikët filluan t'u jepnin mish kali dhe gomari të gjithë të burgosurve osmanë. Të detyruar të hanin mish gomari dhe kali të kalbur në vapën e egër të Egjiptit në mes të gushtit, shumë nga ta nuk mund t'i shpëtonin diaresë, ndërsa disa të tjerë morën një sëmundje të tmerrshme, të ngjashme me zgjebën, të cilën mjekët britanikë e quajtën Pellagra, para se të vdisnin..⁹⁸

Sidoqoftë, ky nuk ishte i vetmi trajtim i tmerrshëm që të burgosurit turq morën në kamp. Burimet historike raportojnë se britanikët qëllimisht verbuan rreth 15,000 ushtarë turq në kamp. Kjo dhunë tronditëse shkaktoi një zemërim

të madh gjatë gjithë kohës dhe u debatua gjerësisht në Parlamentin Turk dhe në mediat turke gjatë gjithë viteve 1919, 1920 dhe 1921. Këto pretendime ishin të bazuara në dy dokumente domethënëse. E para është vendimi i Parlamentit Turk të 28 qershorit 1921, i cili u nënshkrua nga Mustafa Kemal, Kryetari i Parlamentit Turk dhe njëmbëdhjetë ministra. Vendimi shkruan si më poshtë:

Deputetët e Parlamentit Turk, Sheref dhe Faik Beu paraqitën njoftimin e tyre në lidhje me trupat e mbajtur robër në Maltë, si dhe në lidhje me mjekët britanikë, komandantin e garnizonit dhe oficerët në Egjipt të cilët me qëllim verëbuan pesëmbëdhjetë mijë të burgosur të luftës, gjithashtu në Kabinetin e Ministrave, u paraqit e njëjta rezolutë si në Parlamentin Turk më 29.5.1921 me numrin 354/706. Mesazhi u lexua gjatë mbledhjes së Kabinetit më 28.6.1921 dhe u vendos që të kryhen kërkime shkencore ku më pas gjetjet do t'i paraqiten Ministrisë së Punëve të Jashtme së bashku me kopjen e njoftimit të mocionit. 28 qershor 1921.⁹⁹

Ky dokument është vendim i parlamentit turk për të filluar një hetim penal për veprimet e mjekëve, komandantit të garnizonit dhe oficerëve britanikë që në mënyrë të qëllimshme paaftësuan 15 mijë robë luftime në Egjipt. Një dokument tjetër është mocioni i paraqitur nga deputetët Faik dhe Sheref Bej gjatë seancës së 37-të të Parlamentit Turk më 28 maj të vitit 1921. Pjesa e fundit e mocionit u referohet të burgosurve turq të luftës të cilët u verbuan qëllimisht në kampe egjiptiane:

Në Egjipt, Britanikët kanë verbuar qëllimisht 15,000 bijë të kombit tonë duke i bërë ata të hyjnë në banjot të cilat përmbanin kresol më shumë se sa që duhej, me pretekstin për ti dezinfektuar ata. Me anë të kësaj ne kërkojmë që akterët e këtij krimi çnjerëzor, të cilët janë mjekët britanikë, komandanti i garnizonit dhe oficerët tjerë, të deklarohen si kriminelë luftime...¹⁰⁰

Pasi u lexua mocioni në Parlamentin Kombëtar Turk, Mehmet Sheref Beu u ngjiti në skenë dhe shpjegoi ngjarjet e tmerrshme:

... Kur britanikët burgosën bijtë e kombit tonë nga Anadulli dhe Rumelia, të cilët luftuan për dinjitetin dhe nderin e këtij vendi, ata u transferuan direkt në Egjipt. Ata u detyruan të hynin në banjot që ishin dizajnuar në mënyrë të veçantë... Kur ushtarët turq nuk donin të zhytnin kokën në aromën e banjove të kampeve të tyre, ushtarët britanikë vinin dhe i detyronin me bajonetat e tyre. Kur më të dashurit tanë detyroheshin të vinin kokën në tretësirë, të dy sytë ju verboheshin. Kështu britanikët verbuan 15,000 turq...¹⁰¹

Në fillimin e Luftës Turke për Pavarësi, lajmi se britanikët qëllimisht verbuan robërit turq të luftës ishin mbuluar gjerësisht nga Stambolli dhe mediat anadollake. Njerëzit e Konjës veçanërisht reagueshan me tone të ashpëra dhe një gazetë e Konjës, e njohur si *Öğüt* e vendosi lajmin në ballinë.

Si rezultat, një sentiment i ashpër anti-britanik u përhap në të gjithë Anadollin. Nuk vonoi shumë, derisa, me urdhër të gjeneralit britanik Milne, një prej komandantëve të Fuqive Aleate në Stamboll, *Öğüt* u detyrua të ndalonte përhapjen e lajmeve për të burgosurit e verbër të luftës. Jo vetëm që e ndaluan përhapjen e këtij lajmi; por gjithashtu gazeta u mbyll përgjithmonë.

Kjo ngjarje tërhoqi vëmendjen e Mustafa Kemalit, i cili shkoi në Ankara për të organizuar Luftën për Pavarësi. Sapo mësoi arsyen se pse u mbyll *Öğüt*, ai i dërgoi një telegram Guvernatorit të Konjës në emër të Komitetit Përfaqësues, ku dënoi presionin britanik dhe sulmet ndaj medias turke dhe tha që kjo ngjarje do të kundërshtohet fuqishëm me protesta.¹⁰²

Një burim tjetër që shpegon në detaje ngjarjet e përmendura është libri i Eyup Sabri Beut me titull *Bir Esirin Hatıraları* (Kujtimet e një të burgosuri luftime) i shkruar në vitin 1922. Eyup Sabri Beu ishte një banor në Gaziantep i cili më parë kishte punuar në Defter-i Hakamı (Drejtoria e Titullit). Në librin e tij, ai dha një përshkrim të hollësishëm se si robërit Turq të luftës u torturuan dhe u keqtrajtuuan nën mbikëqyrjen britanike. Eyup Sabri Beu kujton përvojat e tij personale kur ai ishte në kampin e burgosur të kontrolluar nga Britanikët në Heliopolis në Egjipt dhe shpjegon 'procedurën e qëllimshme të verbimit' që robërit turq të luftës iu nënshtruan:

Sidoqoftë, meqë atyre [mjekëve në spital] iu dha fuqia e plotë, këta njerëz të tmerrshëm ndiheshin të lirë të veprojnë siç dëshironin dhe verbuan sytë e bijve tanë të cilit ishin të pafuqishëm dhe të pafajshëm. Kush është

përgjegjës për këto vrasje? Unë mendoj se çdo person i ndërgjegjshëm do të pajtohet që përveç autorëve të vërtetë, e gjithë qeveria britanike duhet të mbahet përgjegjëse për këto krime.

Në spitalin Abbasiye, mjekët me shufra metalike në duar, me mëngë të mbledhura deri në bërryla, vazhdimisht operuan ushtarët turq dhe u nxorën sytë. Sipas rrëfimeve të shumë vëllezërve egjiptianë dhe të burgosurve lokalë, këto operacione ndodhën edhe në të kaluarën, por ato u intensifikuan sidomos pas armëpushimit, pasi britanikët ndiheshin krenarë me fitoren e tyre. Kur shkuam atje, unë personalisht pashë që po vazhdonte ky operacion me shpejtësi të plotë.¹⁰³

Këta shembuj të dhunës dhe brutalitetit drejtuar turqve tregojnë edhe një herë se Nëntoka Shtetërore Britanike është qendra e sistemit djallëzor. Megjithëse kjo dhunë shkaktoi zemërim si tek publiku ashtu edhe te qeveria turke, e gjithë koha dhe energjia e tyre duhej të përdorej për mbijetesën e shtetit dhe të kombit. Prandaj, nuk ishte e mundur të ndërmerreshin veprime reale për këto krime të egër.

Për fat të keq, kjo shtypje dhe dhunë më vonë u mohua dhe u fsheh nën qilim, ashtu si shumë krime të tjera të panumërta të Nëntokës Shtetërore Britanike gjatë historisë.

Megjithëse kishte bisedime në lidhje me shkëmbimin e robërve të luftës gjatë Konferencës së Lozanës, nuk ka asnjë tregues se situata e 15,000 ushtarëve turq të verbër u diskutua ndonjëherë. Kjo tregon aftësinë e Nëntokës Shtetërore Britanike për të fshehur krimet e saj dhe fytyrën e saj të vërtetë dhe se si ajo përdor kërcënime të ndryshme, dhe taktika të presionit për të arritur qëllimet e saj.

Fitorja turke të cilën britanikët dëshirojnë të harrojnë: Kut Al Amara

Humbja që pësuan britanikët në Kut Al Amara ishte disfata e dytë më e madhe e britanikëve gjatë Luftës së Parë Botërore pas betejës së Galipolit. Fiset kurde në veçanti, disa fise arabe si dhe besimtar shia, kontribuan shumë në këtë fitore të madhe. Shumë nga familjet kryesore Shia bashkëpunuan me Osmanët gjatë luftës.

Ndërsa Britanikët po përpiqeshin të pushtonin Galipolin me artillerin e tyre të frikshme, planet e tyre për të pushtuar pjesë të tjera të territorit të Perandorisë Osmane ishin gjithashtu në proces. Sidoqoftë, pas disfatës së tyre poshtëruese në Galipoli, ata e zhvendosën pjesën më të madhe të fokusit të tyre në Lindjen e Mesme, Afrikën e Veriut si dhe frontet e Irakut, veçanërisht në Bagdad, në zemrën e rajonit.

Në vitin 1914 ata pushtuan Basrën dhe hapën frontin Irakian. Më 24 korrik të vitit 1915, ushtria e udhëhequr nga gjenerali Townshend filloi të përparonte në Bagdad. Për t'iu kundërpërgjigjur ofansivës, njësitë osmane nën komandën e Nuretin Beut, komandantit të forcave të Irakut, u tërhoqën në Kut Al Amara më 28 shtator të vitit 1915. Trupat britanike arritën të rrethojnë qytetin e Kutit.

Menjëherë më pas, trupat britanike rifilluan ofansivën e tyre në Bagdad, këtë herë përmes dy rrugëve të ndryshme. Ata u detyruan të ndalonin në Salman Pak nga njësitë e drejtuara nga Nuretin Beu dhe të tërhiqeshin në Kut Al Amara. Trupat osmane me nxitim mbërritën në Kut Al Amara më 5 dhjetor. Tani të bllokuar në Kut, përplasjet midis trupave britanike dhe trupave osmane vazhduan gjatë gjithë dhjetorit, derisa trupat osmane i rrethuan plotësisht trupat britanike.

Pavarësisht nga ekspeditat e shumta që u erdhën në ndihmë britanikëve, përpjekjet e tyre dështuan. Meqenëse municionet dhe furnizimet me ushqim po mbaronin si dhe furnizimi përmes transportit nëpër lumenj ishte i pamjaftueshëm, ushtria britanike pësoi humbje të mëdha për shkak të urisë dhe sëmundjeve. Britanikët filluan një sulm tjetër më 8 Mars të vitit 1916, në Dujaila (Sabis) në Divizionin e 13-të të ushtrisë Osmane të udhëhequr nga kolonel Ali Ihsan Beu, por gjithashtu humbën 3,500 ushtarë në Betejën e Dujaila dhe u desh të tërhiqeshin.

Më 22 prill, njësitë britanike organizuan një tjetër sulm nën komandën e gjeneralit Townshend me 5,000 trupa por edhe një herë dështuan në përballje me 3,000 ushtarë. Ndërsa ngjarjet vazhdonin të zhvilloheshin, anëtarët e Nëntokës Shtetërore Britanike po përpiqeshin në të gjitha mënyrat për t'i dhënë fund rrethimit dhe madje paturpësisht u përpoqën

të jepnin ryshfet Halil Pashas. Ata ishin krejt të vetëdijshëm se nëse rrethimi vazhdonte më gjatë, ushtria britanike, tashmë e raskapitur dhe e molisur, do të shkatërrohej plotësisht.

Townshend tentoi t'i jepte Halil Pashas një çek prej një milion paund duke përfshirë edhe armët e tyre vetëm që ai dhe ushtria e tij të mund të ecnin të lirë. Halil Pasha u përgjigj se armët britanike nuk do t'u bënin dobi dhe hodhi poshtë ofertën e ryshfetit prej një milion paund duke e konsideruar 'shaka'. Kur turqit kapën një anije ushqimore dhe municioni të cilën ushtria britanike dërgoi për të furnizuar trupat e tyre të rrethuar, britanikët nuk kishin zgjidhje tjetër veçse të dorëzoheshin. Nëse anija do të kishte arritur destinacionin e synuar, rrethimi mund të kishte vazhduar për dy muaj të tjerë. Ushtarët turq e riemërtuan anijen e ndihmës në 'Kendi Gelen' (fjalë për fjalë do të thotë 'ajo që vjen vetë'). Anija kishte tre mitraloza dhe u bashkua me flotën osmane të transportit.¹⁰⁴

Pasi Townshend u dorëzua, Enver Pasha me mirësjellje e priti atë dhe u siguroi që ai të jetonte në një villë në ishullin piktoresk Heybeli derisa të mbaronte lufta.

Në një artikull në faqen e internetit të gazetës *The Telegraph* më 2 dhjetor të vitit 2015, Patrick Sawyer publikoi pjesë nga ditari i togerit Henry Curtis Gallup, i cili ishte në Kut Al Amara gjatë asaj kohe dhe më vonë u mor si rob lufte nga turqit. Sawyer shpjegon në fillim se britanikët kishin synim të pushtonin Irakun, si dhe tokat e tjera osmane dhe përmbodhi politikën dinake dhe dyftyresin e Nëntokës Shtetërore Britanike dhe rezultatet e kësaj mendësie:

Ajo që kishte filluar si mision për të mbrojtur naftën dhe për të çliruar Irakun nga Turqit përfundoi në pafytyrësi, me qindra ushtarë Britanikë dhe Indianë të cilët gjetën vdekjen si robër.¹⁰⁵

Siç e bën të qartë kjo deklaratë, Nëntoka Shtetërore Britanike nuk përmbahet kurrë nga mashtrimi i masave të pafajshme dhe fillimi i luftërave botërore me anë të mashtrimeve dhe hileve. Vetëm në atë periudhë të historisë, 9 milion njerëz vdiqën, 30 milion u zhdukën ose mbetën me aftësi të kufizuara, për shkak të veprimeve të Nëntokës Shtetërore Britanike. Edhe sot Nëntoka Shtetërore Britanike ruan të njëjtin mentalitet. 'Ideatori' i cili sulmon sot dhe vret miliona myslimanë në veçanti në Lindjen e Mesme duke hedhur bomba mbi ta, që krijon miliona të veja, jetimë, refugjatë me pretekstin e '**rojtarit mbrojtës**' dhe '**çliruesit të vendeve**', duke sjellë demokracinë dhe paqen për ta, është Nëntoka Shtetërore Britanike .

Artikulli vazhdon të shtjellojë humbjen në Kut Al Amara të Britanikëve duke u bazuar në ditarin e togerit Henry Curtis Gallup:

[Kut Al Amara] ishte një nga disfatat më të rënda të Ushtrisë Britanike gjatë Luftës së Parë Botërore, me ushtarët e tyre të uritur të detyruara të hanë kuajt e tyre dhe me mijëra të tjerë të vrarë gjatë një përpjekje shpëtimi.¹⁰⁶

Pjesët nga ditarit zbulojnë një prej metodave më të liga të Nëntokës Shtetërore Britanike: duke i bërë myslimanët të vrasin njëri-tjetrin:

*Ditari i Gallup paraqet detaje se si për arsye të ofensivës së vazhdueshme turke dhe kushteve të pavaforshme, përfundimisht u shkatërruan forcat britanike. Në dhjetor të vitit 1915 furnizimet me ushqim ishin jashtëzakonisht të ulta dhe mbetja pa ushqim po afrohej - duke i detyruar ushtarët të fillonin të hanin kuajt e tyre. Përpjekjet për të liruar trupat e rrethuara përfunduan në katastrofë, **me dy divizione indiane të dërguara nga britanikët dhe të ndaluar nga armiku [turqit], ku u shkaktuan më shumë se 23,000 humbje nga radha indiane.**¹⁰⁷*

Ndonëse duke ju referuar si 'humbja e trupave indianë' të britanikëve, në fakt ata njerëz ishin të gjithë myslimanë indianë. Me fjalë të tjera, britanikët nuk kishin rrezikuar ushtarët e tyre, por në vend të kësaj përdorën myslimanë të pavetëdijshme nga kolonitë britanike, të cilat i bënë ushtarë nën kërcënimin e armëve. Kjo strategji mizore dhe perfide e Nëntokës Shtetërore Britanike ishte arsyeja pse dhjetëra mijëra myslimanëve indiane u detyruan që të sulmonin vëllezërit e tyre turq myslimanë në Kut Al Amara ku edhe humbën jetën. Më në fund, duke pranuar humbjen, Britanikët iu dorëzuan ushtrisë Osmane, pas një rrethimi 6-mujor, më 29 Prill. Kjo fitore historike, e mirëpritur me gëzim në të gjitha frontet osmane, siguroi një ngritje të madhe të moralit për turqit përderisa shkaktoi tronditje të madhe në Evropë. Gazetat britanike do të pasqyronin fitoren turke në faqet e tyre të para duke e quajtur incidentin 'poshtërimi më i madh për britanikët pas Galipolit...'

Historiani britanik James Morris do ta quante humbjen në Kut si 'kapitullimin më të rëndë në historinë ushtarake të Britanisë'.¹⁰⁸ Christopher Catherwood, një tjetër historian britanik e quan këtë humbj si 'humbja më famkeqe e Aleatëve në Luftën e Parë Botërore'.¹⁰⁹

Fjalët e Halil Pashait në ditarin e ushtrisë të datës 29 Prillit të vitit 1916, përmbledhin më së miri fitoren në Kut Al Amara:

Ushtrisë sime;

Zemërluanëve!

1- *Sot shpirtrat e dëshmorëve tanë po ngjiten të lumtur dhe të gëzuar në qiellin me diell nën të cilin Turqit arritën një fitore të lavdishme ndërsa Britanikët pësuan një disfatë të rëndë. Ju uth në ballin tuaj të pastër dhe ju përgëzoj të gjithëve.*

2- *Falënderimi është për Zotin i Cili na ndihmoi të arrijmë suksesin, i cili ka qenë i pashembullt për 200 vitet e fundit. Dhe Zoti i Plotfuqishëm ju dha lavdinë të jeni ata që për herë të parë regjistruan një humbje të tillë në 1500 vite histori britanike.¹¹⁰ Nuk ka pasur një arritje të ngjashme në Luftën Botërore, e cila po vazhdon për dy vite tani .*

3- *Ushtria ime ka dhënë 350 oficerë dhe 10,000 civil si martirë në të dy betejat në Kut si dhe kur u përballen me ushtritë e panumërta, vrapuan për të shpëtuar Kutin. Por, si kthim, sot në Kut, po marr 13 gjeneralë, 481 oficerë dhe 13,300 trupa tjerë robër. Forcat angleze, të cilat erdhën për të shpëtuar këtë ushtri tani të dorëzuar, u kthyen me humbje prej 30,000 trupave.*

4- *Duke parë këto dy shifra, ajo që dikush mund të shohë është një ndryshim mahnitës. Historia do të ketë shumë vështirësi për të gjetur fjalë në regjistrimin e këtij episodi.*

5- *Ne pamë fitoren e parë në Galipoli dhe fitoren e dytë këtu ku turqit kanë thyer kokëfortësinë e anglezëve.¹¹¹*

6- *Kjo fitore që kemi arritur vetëm me anë të bajonetave dhe zemrave tona është fillimi i ndërmarrjeve tona të suksesshme në të ardhmen.*

7- *Unë e shpall këtë ditë 'Dita e Kutit'. Le të këndoj çdo anëtar i ushtrisë sime lutjet, Ya-Sin, dhe Fatiha për dëshmorët tanë dhe të festojnë këtë ditë, çdo vit. Ndërsa martirët tanë jetojnë në Parajsë, a munden më të dashurit tanë, (heronjtë e plagosur) të qëndrojnë bashkë me ne për fitoret tona në të ardhmen.*

Gjeneral brigade Halil Pasha

Komandant i Ushtrisë së 6-të

29 / Prill / 1916- Bagdad¹¹²

Është fakt interesant, deri në vitin 1952 kur Turqia u bë anëtare e NATO-s, Ushtria Turke festoi 'Ditën e Kutit' në çdo 29 Prill. Nëntokë Shtetërore Britanike me siguri nuk ka dashur të ketë kujtesë historike për këtë datë, sepse Fitorja e Kutit u hoq papritur nga programet shkollore me kërkesë të Britanikëve dhe festivali nuk u festua më asnjëherë. Ishte një përpjekje për të mbajtur brezat e rinj të mos mësonin për këtë fitore. Kjo tregon qartë se sa e rëndësishme është të kujtojmë dhe flasim vazhdimisht për Kut Al Amaran, disfatën masive të Nëntokës Shtetërore dhe fitoret e ngjashme, të realizuara me shumë zell dhe vendosmëri.

Detaje interesante në kujtimet e General Townshend

Komandanti i forcave britanike në Kut Al Amara, Gjenerali Townshend, shkroi rrëfimin e tij të titulluar 'Kampanja Ime' për luftën në Mesopotami, në vitin 1920 për të ofruar pikëpamjen e tij për këtë ngjarje.

Sipas Townshend, më shumë se një milion ushtarë indianë - disa ushtarë, disa ndihmës - luftuan për ushtrinë britanike gjatë Luftës së Parë Botërore, dhe prej tyre, 74,000 humbën jetën dhe 67,000 mijë u plagosën. Divizioni i 6-të Britanik përfshinte Indianë, Sikhs, Gurkhas, pashtunë myslimanë si dhe ushtarë nga

Bangladeshi. Townshend shpjegon se si ushtarët myslimanë në mesin e trupave të tij nuk dëshironin të luftonin me turqit gjatë 'Betejës së Kurnait'. Në librin e tij, ai shkruan se në betejat e tjera trupat myslimane në batalionet indiane vepruan në një mënyrë të ngjashme.¹

Burimet historike zbulojnë arsyen se pse myslimanët indianë ngurrnin të luftonin myslimanët turq të cilët i konsideronin ushtarë të Kalifatit. Pasi u hap fronti i Irakut, myslimanët indianë, përfshirë indianët shia, refuzuan të luftonin me turqit. Deri më tani, tre regjimente indiane refuzuan të merrnin pjesë në luftën pranë Ctesiphonit dhe në vend të kësaj zgjodhën të rebeloheshin masovikisht kundër Britanikëve.²

Sidoqoftë, revolta më e madhe indiane kundër britanikëve ndodhi në Singapor. Duke refuzuar të luftonin në krah me britanikët kundër myslimanëve osmanë, myslimanët indianë filluan një trazirë më 15 shkurt të vitit 1915, në Regjimentin e 5-të të Këmbësorisë së Lehtë që përbëhej nga myslimanë pashtunë, moghulë dhe rajput. Ushtarët myslimanë nuk dëshironin të shkonin në Evropë nën flamurin britanik dhe të detyroheshin të luftonin kundër ushtarëve osmanë. Sidoqoftë, trazirat u treguan joefektive, pasi oficeri që kishte marrë përsipër detyrën nuk ishte me përvojë. Si rezultat, administrata koloniale britanike në Singapor goditi kryengritësit me mbështetjen e aleatëve të tyre francezë dhe japonezë në rajon. U ngrit një 'gjykatë ushtarake' e cila dha verdiktin e saj me një shpejtësi tronditëse. Në fund, gjysma e regjimentit mysliman, i cili përfshinte 850 trupa dhe më shumë se 200 oficerë, u ekzekutua me pushkatim ose me varje. Pjesa tjetër u dënua me ndalim penal ose u dërgua në Kamerun dhe Afrikën Lindore Gjermane për të luftuar gjermanët. Në vitin 1917, këto njësi u detyruan të luftonin me Osmanët në Aden së bashku me Guides State Malays, të cilët ishin të njohur për qëndrimin e tyre pro-turk. Vetëm ky incident i zymtë është i mjaftueshëm për të treguar se si Nëntoka Shtetërore Britanike nuk përmbahet nga përdorimi i forcës për t'i bërë myslimanët të luftojnë me njëri-tjetrin. Ushtarët indianë që nuk dëshironin të luftonin myslimanët preferuan vdekjen përpara tradhtisë së tillë.³

Në këtë pikë, është e rëndësishme të theksohet se shumë detaje historike janë mbuluar me kujdes nga Nëntoka Shtetërore Britanike. Dihet qartë që gjatë Luftës së Parë Botërore, shumë myslimanë që ishin nën Kalifat refuzuan të luftonin me Turqit dhe në vend të kësaj pranuan vdekjen. Sidoqoftë, dokumentet në dispozicion sot të cilat u referohen atyre ditëve zakonisht janë të limituara në burime britanike. Prandaj, trazirat kundër britanikëve që ndodhën gjatë atyre ditëve u fshehën me kujdes në një përpjekje për të fshirë kujtesën e aleancës dhe vëllazërisë myslimane.

1. "İngiliz General'in Kut Anıları" (British General's Memories of Kut), Al-Jazeera, <http://appsaljazeera.com/interactive/kutul-amare/tr/ingilizin-anilari.html>

2. İsmet Üzen, "Türklerin Kut'ül Amare Kuşatması Sırasında İngiliz Ordusunda Bulunan Hintli Askerlerin Tutumu (December 1915 - April 1916)" (The Behavior of Indian Soldiers within the British Army during the Turks' Kut Al Amara Siege), *Akademik Bakış Magazine*, Vol. 2, No. 3, 2008, p. 81

3. Emre Gül, "Hintli Askerler Singapur'da Osmanlı İçin İsyân Etmisti" (Indian Soldiers Revolted in Singapore in favor of the Ottoman), *Dünya Bulletin*, July 25, 2014

Hapi i parë në dizajnimin e Lindjes së Mesme: Marrëveshja e Sykes-Picot

Shtatëmbëdhjetë ditë pas poshtërimit të Britanisë në Kut Al Amara, ndërsa Lufta e Parë Botërore po vazhdonte papushim, u nënshkrua fshehurazi marrëveshja Sykes-Picot në mes të Britanisë, Francës dhe Rusisë, më 16 maj të vitit 1916, për të përcaktuar se si territoret e Lindjes së Mesme të Perandorisë Osmane duhet të ndahet midis Britanisë dhe Francës. Marrëveshja u ekspozua ndaj publikut kur Rusia u tërhoq nga Lufta e Parë Botërore dhe marrëveshja në fjalë, si rezultat i Revolucionit Rus të vitit 1917. Me fjalë të tjera, me fillimin e revolucionit komunist për të cilin Nëntoka Shtetërore Britanike kishte punuar vite me radhë përmes provokimeve, spiunimit dhe inxhinierisë sociale, Rusia, një nga fuqitë më të mëdha e cila synonte tokat osmane, u la jashtë.

Sipas Marrëveshjes Sykes-Picot, Mesdheu Lindor, vija bregdetare e Sirisë dhe Libanit modern, Adana, Antepi, Urfa, Dijarbakiri dhe Mosuli, do t'i jepeshin Francës. Britania do të merrte portet Haifa dhe Aqqa në Mesdheun Lindor së bashku me Bagdadin, Baran dhe Mesopotaminë e Jugut. Një administratë ndërkombëtare do të ngrihej në Palestinë sepse ishte vend i shenjtë. Një pjesë e madhe e Irakut dhe Sirisë moderne do t'i dorëzohej gjithashtu Britanisë dhe Francës.

Sidoqoftë, kjo skemë e ndarjes së tokave me Francën nuk ju përshtat mirë Britanisë, për shkak të aspiratës së saj për t'u bërë fuqia e vetme në rajon. Lënia e Mosulit në Francë dhe humbja e Palestinës nuk ishte në përputhje me interesat e Nëntokës Shtetërore Britanike. Që nga fillimi i viteve 1900, britanikët kishin dërguar ekipe teknike në Mosul dhe ishin shumë të vetëdijshëm për rezervat e pasura të naftës në rajon. Për më tepër, ata ishin të bindur se nëse Britanikët do të merrnin Mosulin, rajoni mund të ishte një sferë e rëndësishme strategjike kundër një Bashkimi Islamik të mundshëm. Nëntoka Shtetërore Britanike gjithashtu e konsideroi të rëndësishme marrjen e Palestinës nën kontrollin e saj për të siguruar rrugën për në Indi.

Pasi kishin okupuar tashmë Gadishullin Arabik në vitin 1915, megjithatë, qëllimi më i rëndësishëm i Britanisë në atë kohë ishte ndërtimi i një shteti arab të varur nga Britania në tokat e Irakut dhe Palestinës duke mbështetur Sharif Huseinin e Mekës, të cilit ata e kishin ngarkuar me detyrën për të nisur revolta brenda osmanëve. Kishte tashmë një marrëveshje të fshehtë midis Sharif Husein dhe Komisionerit të Lartë Britanik në Egjipt, McMahon. Çuditërisht, britanikët po flisnin fshehurazi me rivalin e Huseinit, i njohur si Suud di i cili ishte udhëheqësi i Vehabistëve. Ndërsa Nëntoka Shtetërore Britanike po ndiqte axhendën e saj me plane të shumta rezervë, Franca pa që po lihej ngadalë jashtë lojës. Kjo është arsyeja pse ajo i bëri presion Britanisë të pranonte Marrëveshjen Sykes-Picot: në mënyrë që tokat të ndaheshin në mënyrë të barabartë.

Sidoqoftë, në të kaluarën, kur Britania mori Qipron dhe Egjiptin, nuk kishte nevojë për lejen e Francës dhe francezët as nuk menduan të kërkonin hise në ato territore. Madje edhe pse francezët hapën Kanalin e Suezit në vitin 1869, britanikët morën kanalin nën kontrollin e tyre kur morën Egjiptin në vitin 1882 dhe përgjigjja franceze nuk ishte asgjë tjetër veç paknaqësi e heshtur.

Gjërat ndryshuan kur britanikët u mundën rëndë në Galipoli dhe Kut Al Amara. Britania tani po përballej me një Francë më të guximshme, një Francë e cila po protestonte, reagonte dhe po bënte presion. Britania nuk donte ta sfidonte Francën në Sykes-Picot, pasi nuk do të ishte e levërdishme ti kishin edhe francezët armik, veçanërisht pas humbjes së së konsiderueshme të prestigjit dhe fuqisë.

Për këtë arsye, Britania e përkdheli Francën, ndonëse përkohësisht. Kështu u hartua Marrëveshja Sykes-Picot mbi bazën e një parimi të ndarjes së barabartë. Një ndarje më e orientuar nga Britania për ish-tokat Osmane mund të shtyhej për më vonë. Megjithëse Sykes-Picot nuk u zbatua asnjëherë zyrtarisht, pasi ishte një marrëveshje e fshehtë që disi u ekspozua, ajo ende u përdor gjerësisht si bazë në procesin e copëtimit të tokave Osmane. Pjesa e marrëveshjes së fshehtë që përfshinte territoret e Anadollit nuk mund të zbatohet kurrë sepse Mustafa Kemali kishte filluar Luftën për Pavarësinë e Anadollit. Edhe sot, Nëntoka Shtetërore Britanike dëshiron të kompensojë atë që humbi gjatë atyre ditëve duke përdorur grupin terrorist komunist PKK dhe komplete të ndryshme duke kërkuar të arrijë qëllimin e saj shekullorë.

Me Marrëveshjen Sykes-Picot, Nëntoka Shtetërore Britanike po hudhte poshtë premtimet e kaluara për rebelin Sharif Husein. Në planin e ri të ndarjes, asnjë tokë nuk iu dha Sharif Huseinit. Huseini, pra, është një shembull i rëndësishëm sesi Nëntoka Shtetërore Britanike mashtron hipokritët që rekruton në botën islamike me premtime dinake dhe boshe.

Nuk u desh shumë që britanikët të kompensojnë atë që kishin humbur me Marrëveshjen Sykes-Picot. Më 15 nëntor të vitit 1918, Britanikët pushtuan Mosulin duke përdorur si arsye artikullin e 7-të të Armëpushimit të Mudros. I ashtuquajtur i justifikim i tij përfshinte justifikimet e zakonshme si 'garantimi i sigurisë së të krishterëve në rajon' dhe se 'robërit britanikë u keqtrajtuuan'. Gjatë Konferencës së San Remos në Itali më 24-25 Prill të vitit 1920, Britanikët arritën të bindnin Francezët me 'taktikën e tyre të zakonshme' dhe morën tokat Franceze në Mosul dhe Palestinë në këmbim të Sirisë.

Bazat e kufijve modernë në rajon u përcaktuan nga Marrëveshja Sykes-Picot. Sidoqoftë, pas vitit 1919, kufijt u rishikuan me marrëveshje të ndryshme (të tilla si ato të bëra në Paris dhe San Remo). Figura kryesore në përcaktimin e kufijve ishte edhe një herë Nëntoka Shtetërore Britanike ku më pas rajoni u nda në pjesë të vogla në përputhje me planet e ardhshme të sistemit djallëzor.

Kjo është mënyra se si Nëntoka Shtetërore Britanike copëtoi komunitetet myslimane që kishin jetuar për shekuj me radhë në ato toka në paqe. Procesi që filloi me Sykes-Picot dhe u përshpejtua pas Deklaratës së Balfourit prezantoi kufijtë artificialë që injoronin plotësisht ndjeshmëritë politike dhe kulturore në rajon. Si rezultat, u krijuan shtete nën mandat si Iraku, Siria, Jordania, Kuvajti dhe Mbretëria e Hejazit.

Nëntoka Shtetërore Britanike gjithmonë e kishte parasysh se bota islamike do të ishte një fuqi e jashtëzakonshme, e cila të gëzonte një ndikim të pakonkurueshëm dhe do të bëhej një forcë e pandalshme nëse bashkohej në një trup. Prandaj, gjatë gjithë historisë së saj, Nëntoka Shtetërore Britanike e konsideroi një bashkim të tillë si kërcënimin më të madh për ekzistencën e saj. Ajo përdori nacionalizmin, përçarjet sektare dhe tribalizmin për kryengritje dhe krijoi me kujdes një atmosferë të paqëndrueshme konfliktesh, përplasjesh, luftërash dhe dhimbjesh që vazhdojnë edhe sot.

Me kalimin e kohës vendet e rajonit, pothuajse gjysmë koloni, u bënë skena të shtypjes, persekutimit dhe varfërisë së vazhdueshme nën sundimin e diktatorëve të kontrolluar nga Britanikët. Sidoqoftë, Nëntoka Shtetërore Britanike dhe bashkëpunëtorët e saj vazhduan të shfrytëzojnë pasurinë dhe burimet e ndryshme natyrore të atyre vendeve.

Për ta përmbledhur, rruga për në Projektin e Lindjes së Mesme të Madhe që u përmend për herë të parë në fillim të shekullit 21 si një plan për të ndarë botën Islame në copa edhe më të vogla para se ta shkatërronin përfundimisht, që nënkuptonte dorëzimin e saj tek Nëntoka Shtetërore Britanike, filloi me Marrëveshjen Sykes-Picot.

Fituesi i Vetëm i Luftës: Britania

Lufta e Parë Botërore përfundoi kryesisht në mënyrën e planifikuar nga Nëntoka Shtetërore Britanike dhe Britania ishte e vetmja palë që fitoi më shumë. Në fund të luftës, Britania kishte një fuqi të jashtëzakonshme ekonomike, për të mos përmendur faktin se tani ishte vendi më i fuqishëm Evropian. Perandoria Osmane dhe Perandoria Gjermane, të cilat Britania i kishte parë si rivalët kryesorë të saj, ishin shpërbërë. Perandoritë e tjera të mëdha, si Austro-Hungaria dhe Rusia, gjithashtu kishin rënë, tashmë ishin zëvendësuar nga shtete të dobëta, kombëtare.

Politikat, planet dhe strategjitë dinake të Nëntokës Shtetërore Britanike që përfshinin dekada për të siguruar që rusët dhe gjermanët të mos marrin kurrë asgjë nga ish-tokat osmane ishin të suksesshme. Në fund, Nëntoka Shtetërore Britanike arriti të merrte kontrollin e pikave më strategjike të ish-tokave osmane.

Në të njëjtën kohë, Nëntoka Shtetërore Britanike zëvendësoi sistemin e vjetër kolonial me 'sistemin e mandatve dhe protektorate', të cilat ishin versione më të lira dhe më praktike të kolonializmit. Kjo gjithashtu lejoi shfaqjen e 'kolonializmit sekret', një sistem i formuar në përputhje me rrethanat e shekullit të 20-të, por një sistem që vazhdon edhe sot.

Në fillim të shekullit të 20-të, Britania nuk dëshironte më të varej nga qymyri për industrinë, ushtrinë ose flotën e saj dhe nisi të përqendrohej në naftë. Sidoqoftë, që ky transformim për të qenë i mundur, asaj iu desh të arrijë kontrollin e naftës në Lindjen e Mesme. Lufta e përgjakshme botërore e ndihmoi atë të arrijë këtë qëllim.

Pas Luftës së Parë Botërore, Britania formoi politikën e Lindjes së Mesme, tani nën kontrollin e saj, për të qenë në përputhje me interesat e saj koloniale. Ajo u sigurua që dizajni i ri i tokave në mënyrë efektive të parandalonte myslimanët nga bashkimi dhe formimi i një Unioni Islamik.

Nëntoka Shtetërore Britanike u përpoq të ndajë botën myslimane përmes kufijve artificialë në mënyrë që të mund t'i vinte lehtësisht kundër njëri-tjetrit nëse paraqitej nevoja, përmes dallimeve në etni, sekte dhe fise. Ajo ndërtoi një mjedis të përshtatshëm në mënyrë që të mund të nxisë lehtësisht përplasje dhe konflikte, të cilat i mundësuan asaj të vendosë bazat për një "kontroll absolut dhe të plotë të Lindjes së Mesme", me fjalë të tjera, atë që e quante "Projekti i Lindjes së Mesme të Madhe".


Mbështetja e Nëntokës Shtetërore Britanike për Shtetin e Izraelit në Palestinë gjatë Luftës së Parë Botërore nuk ishte sepse përkrahte idenë e Izraelit ose të Hebrejve. Ajo mbështeti Izraelin sepse kjo ishte gjithashtu një pjesë e Projektit të Lindjes së Mesme të Madhe. Nuk ka dyshim që populli hebre duhet të jetojë në ato toka, sipas urdhërimeve në Kuran dhe Tevrat. Sidoqoftë, duhet të dihet se Nëntoka Shtetërore Britanike ndihmoi kauzën vetëm sepse ajo kauzë i përshtatej interesave të saj.

Në fund, Nëntoka Shtetërore Britanike ishte pala që përfitoi më së shumti nga Lufta e Parë Botërore, si pala që hartoi me kujdes të gjitha fazat e saj. Sidoqoftë, siç ka qenë gjithmonë zakon, çmimi duhej të paguhej nga vendet e tjera dhe popujt e tjerë të botës.

Për shekuj me radhë, satani dhe sistemi i *dexhallit* i kanë shkaktuar dëmin dhe shkatërrimin më të madh njerëzimit me anë të Nëntokës Shtetërore Britanike. Kjo nuk ndryshoi gjatë Luftës së Parë Botërore. Kjo luftë e udhëhequr nga Nëntoka Shtetërore Britanike la pas miliona të vdekur, dhjetëra miliona të sëmurë, miliona me aftësi të kufizuara, shumë njerëz të varfër, vende të shkatërruara, ekonomi të dëmtuara, familje të ndara, breza të humbur, kombe që luftonin me varfërinë, urinë dhe mjerimin për dekadat e ardhshme.

Në tërësi një shumë totale prej 65,038,810 trupash nga të gjitha vendet, Lufta e Madhe pati një numër zyrtar të vdekjeve prej 8,556,315, 21,219,452 të plagosur, 7,750,945 të zhdukur ose të zënë robër luftime. Kompensimet veçanërisht të rënda që palët humbëse u detyruan të paguanin shkaktuan kriza masive ekonomike në këto vende, të cilat nga ana tjetër shkaktuan kriza në vendet e tjera që kulmuan në Depresionin e Madh të vitit 1929. Jo vetëm që problemet politike midis kombeve nuk janë zgjidhur, por tensioni i shkaktuar nga marrëveshjet e ngarkuara me sanksione të rënda shkaktoi gjithashtu konflikte dhe polarizime të reja. Ideologji të tilla si fashizmi, nazizmi dhe komunizmi u forcuan dhe filluan të ndikojnë në zonat e mëdha. Të gjitha këto zhvillime dërguan në Luftën e Dytë Botërore, e cila u tregua edhe më shkatërruese.

Nëntoka Shtetërore Britanike është strukturë e aftë e cila tërheqë tërë botën në shkatërrim dhe luftë të plotë përmes planeve satanike. Kur po planifikonte Luftën e Parë Botërore, Nëntoka Shtetërore Britanike po bënte gjithashtu plane për ditët e sotshme dhe ëndërronte Lindjen e Mesme që do të përfshihej në luftë dhe konflikt të vazhdueshëm. Kjo po ndodh aktualisht. Në të vërtetë, kur dikush shqyrton nga afër shkatërrimin dhe tragjedinë e tmerrshme që po zhvillohet në Lindjen e Mesme, do të shohim lehtësisht se i përshtatet plotësisht interesave të Nëntokës Shtetërore Britanike dhe do të shohim se është me të vërtetë rezultati i planit të saj 100-vjeçar. Të gjitha zhvillimet historike ndodhin si rezultat i planeve të saj të rrënjësura thellë të cilat janë të ndërlidhura. Projektuesi i këtij plani ogurzi dhe arkitekti i tragjedive si lufta botërore është Nëntoka Shtetërore Britanike, sistemi i *dexhallit* i cili sundon botën.



E vërteta prapa rënies së Perandorisë Osmane

Një Perandori bie

Nga viti 1683, Perandoria Osmane kishte arritur kulmin e fuqisë së saj me një territor të gjerë që shtrihej për 24 milion kilometra katrorë. Njerëzit në qoshe të ndryshëm të botës po jetonin të lumtur nën sundimin osman që kishte bazën në Stamboll, vendi i cili në atë kohë ishte qendra e Kalifatit.

Ata flisnin gjuhë të ndryshme, praktikonin besime të ndryshme dhe i përkisnin etnive të ndryshme, por ruanin një harmoninë në mes vete. Sidoqoftë, Nëntoka Shtetërore Britanike nuk ishte e kënaqur me këtë pamje. Sundimi mbresëlënës i Perandorisë Osmane në të gjithë botën - dhe më e rëndësishmja, statusi i saj si përfaqësues i bashkësisë Islame - nuk ishte diçka që ajo ishte e gatshme të pranonte.

Kur filloi periudha e krizës së Perandorisë Osmane, Nëntoka Shtetërore Britanike ndërmori veprim. Në fakt, ishte Nëntoka Shtetërore Britanike ajo që përgatiti fazat që dërguan deri në këtë pikë. Me një seri manovrash strategjike, ajo arriti të merrte kontrollin e Perandorisë. Në fund të fundit, Perandoria Osmane humbi jo vetëm territorin e saj të gjerë por edhe, në një masë të madhe, vlerën e saj fetare dhe shpirtërore. Në një farë mënyre, Nëntoka Shtetërore Britanike zbatoi strategjinë e saj për 'krijimin e shoqërive të degjeneruara' në Perandorinë Osmane dhe hap pas hapi e dërgoi Perandorinë në shkatërrimin e saj.

Është e rëndësishme të studiohen me kujdes arsyet pas rënies së Perandorisë Osmane sepse vetëm atëherë do të bëhet e dukshme përfshirja e Nëntokës Shtetërore Britanike dhe hapat që dërguan deri në shembjen e Perandorisë do të kuptohen me të vërtetë. Ajo gjithashtu do të tregojë se si një shoqëri fetare u kthye në materialiste dhe se si një manovrat e dextrallit sollën shkatërrimin e shoqërisë përmes përdorimit të hipokritëve.

Tani le të shohim se çfarë e dërgoi Perandorinë Osmane drejt fundit të saj:

1. Koncesionet e dhëna për Britaninë dhe Borxhin e Parë

Magjepsja e Nëntokës Shtetërore Britanike me Perandorinë Osmane filloi gjatë sundimit të Mbretëreshës Elizabetës së I-rë të Anglisë. Kur Mbretëresha dërgoi anëtarin e Këshillit Privat William Harborne te Sulltan Muradi i III-të si i dërguar në 1579 dhe Harborne mori një qëndrim të përhershëm në Stamboll në vitin 1583, marrëdhëniet diplomatike filluan zyrtarisht. (Këshilli Privat është një organ zyrtar i këshilltarëve në Angli, anëtarët e të cilit emërohen nga Kryeministri dhe vepron nën ndikimin e Nëntokës Shtetërore Britanike). Harborne luajti një rol të rëndësishëm në marrëdhëniet diplomatike dhe siguroi leje për dy tregtarë anglezë për të kryer biznes në tokat osmane. Me kërkesë të Mbretëreshës, lejet u zgjeruan më vonë për të gjithë shtetasit anglezë. Ky ishte favoriti i parë që u dha britanikëve nga Perandoria Osmane dhe shënoi hapin e parë drejt kontrollit britanik mbi financat e osmanëve. Premtimi i Perandorisë Osmane për t'u dhënë leje Britanikëve për sa kohë që të dy shtetet vazhdonin të ekzistonin shënonte fillimin e fundit.

Nga ajo pikë e tutje, Nëntoka Shtetërore Britanike mbajti një marrëdhënie të njëanshme me Perandorinë Osmane, e cila funksionoi vetëm në avantazhin e Britanikëve, duke varfëruar Osmanët dhe duke i bërë Britanikët edhe më të pasur.

Për t'i vënë gjërat në perspektivë, gjatë sundimit të Sulltan Sulejmanit të Madhërishtëm, vetëm buxheti i provincës së Sivas ishte 20 milion monedha ari, ndërsa Franca kishte një buxhet total prej vetëm 4 milion dhe Anglia 6 milion. Pavarësisht pasurisë së saj mbresëlënëse, pas koncesioneve të dhëna britanikëve, Perandoria Osmane filloi të pësonte humbje të mëdha dhe nga shekulli i 19-të, sistemi i saj financiar kishte arritur në bllokad të madhe. Privilegjet e dhëna qytetarëve britanikë arritën kulmin me Traktatin e Balta Limanit. Në mënyrë shumë interesante, Sulltan Mahmudi i II-të nënshkroi këtë traktat në shtratin e tij të vdekjes, me nxitjen e anglofilin Mustafë Reshid Pasha, i cili ishte Ministri i Punëve të Jashtme në atë kohë.

Njëzet vite më vonë, shpërtheu Lufta e Krimesë dhe megjithëse dukej se Perandoria Osmane ishte në mesin e fitimtarëve, lufta pati rezultate shkatërruese për osmanët. Kur u themelua Administrata Britanike e Borxhit Publik Osman e kontrolluar nga Nëntoka Shtetërore Britanike gjatë sundimit të Sulltan Abdul Hamidit të II-të, Perandoria ra nën kontrollin e plotë financiar të fuqive Evropiane dhe humbi pavarësinë e saj ekonomike.

Një shqyrtim i thellë i arsyeve kryesore të Luftës së Krimesë do të zbulojë përfshirjen e Nëntokës Shtetërore Britanike, si nxitja e Rusëve për të filluar bombardimet, dhe më saktësisht se si ajo vendosi bazën e konfliktit. Gjatë krizës Osmano-Ruse në prag të luftës, Alexander Menshikov, kreu i delegacionit rus në Stamboll, deklaroi qartë se Mustafa Rehid Pasha parandaloi paqen sepse ishte nën presion nga Ambasadori Britanik Lord Stratford de Redcliffe. Ky skenar tingëllon çuditërisht i njohur sepse Nëntoka Shtetërore Britanike ka qenë gjithmonë e përfshirë në çdo mosmarrëveshje ruso-turke që ka ndodhur gjatë historisë. Prandaj, nuk duhet të na habitë fakti se, këshilltarët ushtarakë britanikë ishin në ushtrinë osmane gjatë Luftës së Krimesë dhe gjatë Luftës Ruso-Turke të viteve 1877-78. Në fakt, ishin këta këshilltarë që i bindën administratorët dhe komandantët osmanë të hynin në luftë. Këta këshilltarë e zhytën vendin në luftë, duke marrë angazhime të cilat vetëm dërguan përpara interesat e Nëntokës Shtetërore Britanike.

Arsyeja e vetme pse britanikët mbajtën anën e Perandorisë Osmane pas Luftës së Krimesë ishte dëshira e tyre për të marrë shpëtim për 'ndihmën' e tyre. Në të vërtetë, kjo është pikërisht ajo që ndodhi: Britanikët morën koncesionin e tyre më të madh pas kësaj lufte të tmerrshme.

Me Ediktin e Reformës të vitit 1856, të cilën Perandoria Osmane e miratoi në fund të Luftës së Krimesë, idetë liberale perëndimore gjetën terren në Perandorinë Osmane. Natyrisht se midis këtyre ideve ishte edhe Darwinizmi. Pra, kur përfundoi Lufta e Krimesë, Nëntoka Shtetërore Britanike kishte arritur qëllimin e saj: tani ishte më e lehtë për të shfrytëzuar financiarisht dhe ideologjikisht Perandorinë Osmane. Kjo do të thoshte që Perandoria ishte një hap më pranë rrëzimit.

Gjatë sundimit të Sulltan Abdul Hamidit të II-të, krizat financiare të Perandorisë Osmane arritën kulmin e tyre. Më 10 nëntor të vitit 1879, taksat e thesarit osman të mbledhura për kripë, duhan, alkohol dhe peshkim iu dorëzuan bankierëve nga Galata dhe bankave britaniko-franceze, të cilat ishin nën kontrollin e Nëntokës Shtetërore Britanike në atë kohë. Më 20 dhjetor të vitit 1881, me Dekretin e Muharremit, Abdul Hamidi i II-të hapi financat osmane për auditim ndërkombëtar, vendim i cili lejoi që për herën e parë të huajt të marrin kontrollin mbi mënyrën e trajtimit të financave osmane.

Si e Përdori Fenë Nëntoka Shtetërore Britanike

Kur Mbretëresha Elizabeta I e Anglisë i shkruajti letër Sulltanit të Perandorisë Osmane në lidhje me lejimet tregtare, ajo ishte e vetëdijshme se po shkëmbente letër me Kalifin e Myslimanëve. Prandaj, ajo u sigurua që të distancohej nga Evropa Katolike dhe deklaroi se **'adhuronte Zotin e vërtetë, i Cili ndëshkon idhujtarinë'** dhe pretendoi se ajo ishte kundërta e katolikëve të cilët i konsideronte si **'pagan'**.

Edhe pse Mbretëresha dhe të dërguarit Britanikë pretenduan në letër se ishin të afërt me myslimanët, ajo afërsi nuk ishte asgjë tjetër veçse një maskim. Në letrat e tyre personale dërguar Londrës, ambasadorët e përshkruanin Islamin si një fe të ligë dhe barbare (feja e lavdishme Islame është mbi pohime të tilla). Qëndrimi i tyre miqësor

ndaj myslimanëve ishte vetëm një gënjeshtër e thënë në emër të Zotit dhe, në letrat e tyre, ata shkruanin të bindur se Zoti do t'i falte gënjeshtret e tyre.

Ky qëndrim i rremë miqësor i Nëntokës Shtetërore Britanike ndaj myslimanëve vazhdoi për 450 vite dhe vazhdon edhe sot. Sayyeed Abdulhakim Arvasi, një dijetar islamik i cili jetoi në periudhën e vonë osmane, e shpjegoi për mrekulli, neverinë e tyre ndaj myslimanëve:

Britania është armiku më i madh i Islamit. Nëse e krahasojmë Islamin me një pemë, pabesimtarët e tjerë do ta copëtojnë atë në rastin e parë të mundshëm dhe myslimanët do ta dinë se ata janë armiq. Sidoqoftë, ajo pemë mund të rritet përsëri një ditë. Britanikët nuk janë të tillë. Ata i shërbejnë kësaj peme, e ujitin atë. Sidoqoftë, gjatë natës, kur askush nuk është përreth, britanikët vijnë dhe injektojnë helm në rrënjë. Pema thahet aq keq, sa nuk do të mund të rritet më kurrë. Dhe atëherë britanikët do të vijnë dhe do të thonë: 'Fatkeqësi, na vjen shumë keq dhe kështu i mashtrojnë myslimanët. Britanikët injektojnë helm në botën islame duke blerë hipokritë dhe tradhtarët në këmbim të kënaqësive të kësaj bote duke ju ofruar para, pozita apo gra dhe shkatërrojnë studimet, librat dhe informatat e vërteta islame.1 [Shteti dhe kombi britanik është mbi këto pohime.]

Kjo është një analizë e saktë. Siç është e ditur, Abdulhakim Arvasi nuk po i referohej njerëzve të pafajshëm britanikë, por Nëntokës Shtetërore Britanike. Siç u shpjegua më parë, administratat Britanike dhe Britanikët janë plotësisht të pafajshëm për krime të tilla.

1. M. Siddık Gümüş, ""M. Siddık Gümüş Sözleri ve Alıntıları"", Alıntısöz, <http://www.alintisoz.com/sozler/bu-kitab%C4%B1-dikkat-ile-okuyan-islam%C4%B1n-en-b%C3%BCy%C3%BCk-d%C3%BCC5%9Fman/49194>;

2. Vlerat morale bien teksa përhapet Darwinizmi

Në pjesën e parë të librit, lexuesit kanë parë se si teoria e evolucionit, gabimi më i madh shkencor në histori, u formua nga anëtarët e Nëntokës Shtetërore Britanike përpara se të imponohej tek njerëzit tjerë në botë. U shpjegua gjithashtu se dëshira për të fshirë ndjenjat morale, shpirtërore, familjare dhe patriotike në të gjithë botën në një përpjekje për të krijuar shoqëri të hapura të prirura për konflikt ishin arsyet e vërteta se pse Darwinizmi u mbështet kaq intensivisht. Nëntoka Shtetërore Britanike shpresonte se teoria darviniste do të ndihmonte në përhapjen e sistemit të saj djallëzor në të gjithë botën, gjithashtu do ti ndihmonte në shpërbërjen e komunitetit mysliman dhe në degjenerimin e komuniteteve të krishtera dhe hebrenjeve. E konsideroi këtë një metodë të thjeshtë për t'i tërhequr shoqëritë në konflikte dhe degradim morale.

Nëntoka Shtetërore Britanike, u sigurua të zgjidhte kohën e duhur për të futur kurthën e Darwinizmit në Perandorinë Osmane. Nga fundi i shekullit të 19-të Perandoria kishte humbur kryesisht fuqinë dhe ndikimin e saj. E maskuar si 'iluminizëm', fatkeqësia hyri dhe u përhap shpejt në tokat Osmane me ndihmën e njerëzve të caktuar që imagjinonin se nënshkrimi ndaj materializmit ishte ekuivalent me të qenit modern. Shoqatat, institucionet dhe shkollat që u hapën nën mbikëqyrjen e Nëntokës Shtetërore Britanike punuan për indoktrinimin e njerëzve në Darwinizëm. Si rezultat, kombi fisnik turk që përfaqësonte Kalifatin, si dhe të gjithë kombet myslimane, ranë në kthetrat e një lëvizjeje që pretendonte se "nuk ka Zot" (Zoti është mbi vërejtje të tilla)..

Pasi u injektua helmi, pjesa tjetër ishte e lehtë për Nëntokën Shtetërore Britanike. Ndërsa Darwinizmi u përhap në trup, synimi për krijimin e një Bashkësie Islame u harrua, bota Myslimane u nda dhe njerëzit humbën vlerat e tyre fetare dhe patriotike, të cilat tanimë zëvendësoheshin me sjellje hipokrite. Nga ajo pikë, Nëntoka Shtetërore Britanike ishte në gjendje të manipulonte lehtësisht shoqërinë Osmane me anë të spiunëve dhe mjeteve të saj propaganduese. Në fakt, në një moment, ishte në gjendje t'u diktonte politika të ndryshme burrështetasve dhe sulltanëve si Abdul Hamidit të II-të të cilët ata i mbanin nën presion.

Për këto arsye, do të ishte përfundim i saktë të thuhet se faktori kryesor për rënien e Perandorisë Osmane ishte Darwinizmi.

Si futi rrënjët Darwinizmi në Perandorinë Osmane?

Nga fillimi i shekullit të 19-të, ndjekja e vlerave perëndimore ishte bërë trendi kryesor midis inteligjencës dhe diplomatëve të Perandorisë Osmane. Së pari, zhvillimet shkencore dhe teknologjike, dhe pastaj modelet politike dhe ekonomike të botës perëndimore u futën në perandori për të rinovuar sistemin shtetëror osman. Madje edhe ushtria osmane kaloi një reformim të plotë që përfshinte ndryshime të hollësishme në uniforma dhe pajisje.

Megjithëse ky trend perëndimor ishte i dobishëm në disa zona, ai gjithashtu ndikoi negativisht në rendin shoqëror dhe mendësinë e publikut osman. Shumë njerëz filluan të besojnë se bota perëndimore ishte 'absolutisht më e mirë' në gjithçka, përfshirë filozofinë dhe shkencën. Ideologjitë ateiste si materializmi, pozitivizmi dhe Darwinizmi, tashmë të përhapura në Evropë, prekën shumë intelektualë Osmanë. Si rezultat, shumë nga ata arritën të besojnë se të qenit ateist, të mbështesësh pretendimet joshkencore të Darwinit dhe të kesh një botëkuptim materialist do të thoshte të ishte modern dhe i ngjashëm me Perëndimin. Disa politikanë të asaj kohe i ndërtuan politikat e tyre mbi Darwinizmin social, i cili pretendonte se vetëm shoqëritë e forta mund të mbijetonin në luftën për jetën. Në fund të fundit, kjo prirje darviniste që mohoi ekzistencën e Zotit u bë shkak për rënien e Perandorisë Osmane. Duke filluar nga gjysma e dytë e shekullit 19-të, pikëpamjet materialiste të Ernst Haeckel, Herbert Spencer, Auguste Comte, etj, u përhapën në mesin e disa prej intelektualëve osmanë. Gjatë kësaj kohe, më shumë se dyqind libra materialistë dhe darvinistë u përkthyen në turqisht dhe arabisht.

Gjatë kësaj kohe, librat materialistë qarkulluan gjerësisht në shkollat mjekësore, juridike, politike dhe ushtarake të Perandorisë Osmane, përmes së cilave u trajnuan shumë oficerë dhe qeveritar. Një turist i shekullit të 19-të me emrin Mac Farlane shkroi atë që pa pasi bëri një vizitë në shkollën e mjekësisë në Perandorinë Osmane në vitin 1847:

[Duke ju referuar bibliotekës mjekësore] Kishte kohë që nuk kisha parë një koleksion të tillë të materializmit të pastër. ... Një libër ishte i hapur në divan. Unë e mora atë. Ishte një kopje e një botimi të fundit në Paris të manualit të Ateizmit, "Système de la Nature", me emrin e Baronit d'Holbach në ballinë si autor. Vëllimi ishte përdorur dukshëm shumë; shumë nga pasazhet goditëse ishin shënuar, dhe veçanërisht ato që demonstrojnë matematikisht absurditetin e besimit në ekzistencën e një Zoti dhe pamundësinë e besimit në pavdekësinë e shpirtit.¹¹³ [Sigurisht, Zoti i Plotfuqishëm është mbi vërejtjet e tilla]

Me fjalë të tjera, mendimet darviniste që tërhiqnin studentët në ateizëm u përhapën shumë shpejt në shkollat e mjekësisë. Abdülaziz Khan urdhëroi që edukimi darvinist të ndalet menjëherë sapo ai erdhi në fron dhe shkarkojë nga detyra të gjithë ata që po argumentonin në favor të një edukimi darvinist / materialist.

Përhapja e Teorisë së Evolucionit në Perandori gjatë sundimit të Sulltan Abdul Hamidit të II-të

Indoktrinimi darvinist i cili përjetoi një ngecje gjatë sundimit të Sulltan Abdülazizit arriti kulmin e saj gjatë sundimit të Abdul Hamidit të II-të. Gazeta, libra dhe revista darviniste / materialiste u përhapën në të gjithë tokat e Perandorisë, dhe kryesisht në Stamboll, Liban, Egjipt dhe Siri. Në mënyrë shumë shqetësuese, Darwinizmi u përfshi në programin shkollor në shumë vende. Oficerët darvinistë / materialistë që u larguan nga detyrat e tyre nga Abdülaziz jo vetëm që u rivendosën në detyrë, por ata u ngritën në pozita kryesore në Ministrinë e Arsimit, Shtëpinë Botuese të Shtetit dhe madje edhe në mesin e vezirëve.

Vetë Abdul Hamidi i II-të urdhëroi që 20,000 kopje të *Traktatit Hamidian* të shkrimtarit libanez Husayn al-Jisr të shtypen dhe shpërndahen në Stamboll. Libri ishte plot me pretendime materialiste dhe darviniste dhe kishte për qëllim të mbillte farën e filozofisë ateiste në shoqërinë osmane. Pa ndonjë rastësi, libri u quajt *Traktati Hamidian*, si një përkujtim për Abdul Hamidin e II-të. Kur libri u bë i njohur, al-Jisr u ftua nga Abdul Hamidi i II-të në Stamboll dhe u prit në Rezidencën e Maltës dhe iu dha Urdhri i Klasës së Katërt të Osmanëve, së bashku me shumë dhurata të tjera. Abdul Hamidi i II-të e vlerësoi atë në shumë raste. Ai u ftua tre herë tjera nga Abdul Hamid i II-të në Stamboll dhe qëndroi si mysafir i Sulltanit.

Abdul Hamidi i II-të e ndihmoi përkthimin dhe botimin e *Traktatit Hamidian* në Turqisht dhe i kërkoi al-Jisrit që të hartonte një libër mbi parimet fetare për shkollat osmane.¹¹⁴

Abdul Hamidi i II-të me të vërtetë tregoi mbështetje për al-Jisrin mirëpo e vërteta ishte që al-Jisr dhe libri i tij ishin ndër arsyet kryesore që dërguan në rënien e Perandorisë Osmane. Nën urdhërin personal të Abdul Hamidit të II-të, libri u përhap gjerësisht në të gjithë Perandorinë. Në librin, të cilin ai ia kushtoi Abdul Hamidit të II-të, al-Jisr pohoi - megjithë mungesën e plotë të provave shkencore për të mbështetur idenë e tij - që mutacionet mund të ndihmonin organizmat të evoluonin dhe se kishte shumë forma kalimtare. Sipas al-Jisr, teoria e Darvinit nuk kundërshtonte fenë Islame.

*E vërteta është se mutacionet janë deformime të cilat janë të dëmshme në 99% të kohës dhe neutral në 1 % kohën e mbetur. Në fakt, studimet e fundit shkencore treguan se edhe 1% të pranuar si neutrale bëhen të dëmshme me kalimin e kohës. Për këtë arsye, ato tani quhen mutacione të heshtura. Me fjalë të tjera, shkenca ka provuar se mutacionet janë 100% të dëmshme. Për më tepër, pretendimi se 'ka një sasi të mjaftueshme të formave kalimtare' është një nga mashtrimet më të mëdha të teorisë së evolucionit. Më shumë se 700 milion fosile janë zbuluar deri më tani dhe as edhe një prej tyre nuk i përket një formës kalimtare. **Asnjë fosil i vetëm kalimtar nuk është gjetur deri më tani** që tregon se gjallesat evoluon nga një tjetër dhe është e pamundur që ndonjë të gjendet në të ardhmen. Secila prej qindra miliona fosileve të zbuluar deri më tani i përket krijesave të plota, të përsosura dhe të patëmeta që nuk kanë kaluar asnjë ndryshim. Edhe vetë Darvini pranoi në librin e tij se nëse nuk gjenden fosile të formës kalimtare, teoria e tij do të shembej:*

... Pse, nëse speciet kanë zbritur nga speciet e tjera me gradime të imëta, a nuk shohim kudo forma të panumërta kalimtare? Pse nuk është e hutuar e gjithë natyra, në vend që speciet, siç i shohim, të jenë të përcaktuara mirë? Por, ashtu si nga kjo teori, format e panumërta kalimtare duhet të kenë ekzistuar, pse nuk i gjejmë të ngulitura në numër të panumërt në koren e tokës...? Pse atëherë nuk është çdo formacion gjeologjik dhe çdo shtresë e plotë me lidhje të tilla të ndërmjetme? Gjeologjia sigurisht nuk zbulon ndonjë zinxhir organik të tillë të imët; dhe ky, ndoshta, është kundërshtimi më i qartë dhe më i rëndë që mund të nxitet kundër teorisë sime.¹¹⁵

Al-Jisr shkoi deri aty sa pohoi se kjo teori, e cila mohonte ekzistencën e Zotit, nuk binte në kundërshtim me Kur'anin. Traktati i tij Hamidian ishte plot me shpjegime pa bazë shkencore dhe Kur'anore, si përshembull pretendimi i gabuar se teoria e Darvinit nuk binte ndesh me besimin në Zot dhe se teoria e evolucionit mund të interpretohet në përputhje me fenë dhe se disa vargje mund të interpretohen në atë mënyrë. Ai dha shembuj të shkrimtarëve dhe studiuesve të kohës, të cilët kërkuan ta përhapnin këtë gënjeshtër midis njerëzve fetarë. Në të vërtetë, libri i tij u përkthye në shumë gjuhë, veçanërisht në Turqisht dhe Urdu, dhe shpejt u bë i njohur në mesin e shumë studiuesve në Sirinë moderne dhe Turqinë. Disa nga studiuesit në Universitetin e Al-Azharit, në veçanti, i kushtuan vëmendje të madhe librit. Al-Jisri ishte gjithashtu vetë i diplomuar në atë universitet.

Hasan Tahsini, i njohur gjithashtu si Hoxha Tahsin, ishte rektori i parë i Darülfünûn - Universiteti origjinal i Stambollit -, themeluar nga Sulltan Abdul Hamidi i II-të. Hasan Tahsini ishte ndër Darvinistët e parë në Perandorinë Osmane dhe u emërua në postin e rektorit të Universitetit nga Abdul Hamidi i II-të. Veziri i Madh Reshid Pasha e kishte dërguar personalisht në Evropë për të studiuar, nga ku ai u kthye si materialist. Në artikullin e tij 'Tarih-i Tekvin' (Historia e Krijimit), ai po fliste për të ashtuquajturat 'nivele të reja të ndryshimit që universi do të arrinte në të ardhmen si rezultat i rregullit të evolucionit që mbizotëron në të gjithë universin dhe ekzistencën'.¹¹⁶

Hasan Tahsini u përpoq jashtëzakonisht shumë të shpjegojë origjinën e universit dhe krijimin e njeriut, si dhe format e tjera të jetës përmes teorisë së evolucionit në librin e tij Varoluşun Tarihi veya Yaradılış (Historia e Qenies ose Krijimit). Ai gjithashtu punoi me përkushtim për të përhapur teorinë darviniste. Përkushtimi i tij i vendosur ndaj teorisë materialiste i dha atij nofkën 'Zotëriu Tahsin'. Ai solli Jamal al-Din al-Afganin, një të diplomuar evolucionist të Universitetit të Al-Azharit, në Stamboll dhe e ngarkoi atë të kryente propagandën evolucioniste në Universitetin e Stambollit. Afgani ishte një tjetër mbështetës i flaktë i librit të al-Jisrit. Hasan Tahsini "edukoi" shumë studentë para se të shkarkohej nga detyra e tij për arsyen e 'dëmtimit të besimit të të rinjve që ai mësoi'. Sidoqoftë, shumë nga studentët e tij tashmë ishin materialistë, si dhe po punonin nëpër tokat e Perandorisë dhe po ju mësonin të rinjëve të tjerë Darwinizmin, gjë që bëri që teoria të përhapet si zjarr i pandalshëm.

Librat dhe artikujt e Ahmed Midhat Efendiut, një tjetër evolucionisti, u përdorën gjithashtu gjerësisht si tekste në universitete. Revista Dağarcık (Reporteri) e botuar nga Ahmed Midhat Efendi në 1871 propagandoi shumë idenë e gabuar të evolucionit ndërsa dhjetëra mijëra kopje të saj ishin shpërndarë gjerësisht në të gjithë Perandorinë. Ai pretendoi se 'njerëzit kishin cilësi nga natyra të cilat i bëjnë të dhunshëm pasi njerëzit janë gjithashtu një lloj kafshe' ky pohim ishte bërë ngase ai mbrojti dhunën e Darwinizmit me fjalët si më poshtë:

Hakmarrja është një lloj drejtësie, është një drejtësi e dhunshme. E keqja bëhet rrallë për kënaqësi, por përkundrazi ndiqet nga lakmia, reputacioni dhe interesat. Atëherë, nga e dimë që sjellja e keqe, një pjesë e natyrës sonë, do të na dëmtojë? Nëse therra dhemb, kjo është për shkak se është krijuar në atë mënyrë.¹¹⁷

Në mënyrë të ngjashme, 'Shoqëria Osmane e Shkencës' e themeluar nga Munif Pasha, i cili ishte Ministri i Arsimit gjatë sundimit të Abdul Hamidit të II-të, synoi përhapjen e materializmit dhe evolucionit përmes revistave shkencore. Revista e tyre e parë, Mecmua-i Fünûn (Revista Shkencore) ishte e mbushur me propagandë evolucioniste. Sulltan Abdulaziz më parë kishte shkarkuar Munif Pashan për shkak të përhapjes së teorisë të evolucionit, por kur Abdul Hamidi i II-të u ngjiti në fron, Munif Pasha u bë përsëri Ministri i Arsimit.

Injektimi darvinist dhe materialist funksionoi, me rezultatet që u bënë të dukshme shpejt ndërsa inteligjenca osmane filloi të mblidhej rreth të ashtuquajturës Lëvizjes së Letërsisë së Re dhe botimit të revistes Servet-i Fünûn (Pasuria e Diturisë), e cila veprimi si qendër e materializmit dhe pozitivizmit. Abdulhak Hamid Tarhan dhe Rezaizade Mahmud Ekrem, poetët dhe autorët kryesorë të lëvizjes, krijuan pikëpamjet e shtrembëruara vijuese që pa dyshim do të dëmtonin vlerat morale të shoqërisë:

Qytetërimi islam kishte arritur fundin e jetës së tij.

Një civilizim i ri u ngrit në Perëndim, me mendime, sociale dhe teknika të reja.

Ky civilizim, herët a vonë, do të shkatërrojë Perandorinë Osmane.

Sami Frashëri (autor nën emrin Şemseddin Sami Efendi), dhe Ahmed Cevdet, kryeredaktorët e të përditshmeve Sabah (Mëngjesi) dhe Ikdam (Përpjekja), ishin gjithashtu evolucionistët kryesorë gjatë mbretërimit të Abdul Hamidit të II-të. Libri *Njeriu* (Qenie Njerëzore) i Sami Frashërit që ai shkroi në vitin 1878, Tekâmül Kanunları (Ligjet e Zhvillimit) të Ethem Necdet dhe Tarih-i Tedenniyat-ı Osmaniye i Celal Nuri: Historia e Rënies së Perandorisë Osmane: Dialektika e Historisë) janë vetëm disa nga librat darvinistë të botuar gjatë mbretërimit të Abdul Hamidit të II-të. Së bashku me librin Tercüman-i Hakikat (Interpretuesi i së Vërtetës) dhe shkrimtarin kryesor të saj Ahmed Midhat Efendiun, tre gazetatat kryesore të kohës ishin nën ndikimin evolucionist. Për më tepër, Ceride-i Havadis (Revista e Lajmeve), një gazetë tjetër e famshme e kohës dhe shkrimtari kryesor i saj Beşir Fuad gjithashtu kishin pikëpamje evolucionare. Këta njerëz zakonisht konsiderohen njerëzit e parë që përhapën ateizëm në Perandorinë Osmane. Ceride-i Havadis (Gazeta e Lajmeve) u botua nga gazetari britanik William Nosworthy Churchill si gazeta e parë gjysmë zyrtare e Perandorisë Osmane. Megjithatë nga jashtë u shfaq si revistë e shkencës dhe letërsisë dhe kështu mblodhi shkrimtarët e kohës nën kupolën e saj, qëllimi i tij i vërtetë ishte formësimi i opinionit publik në favor të interesave politike dhe ekonomike të britanikëve. Kjo pikë bëhet edhe më interesante duke pasur parasysh faktin se David Urquhart, i cili kishte shërbyer si sekretar i ambasadës britanike në Stamboll midis viteve 1835 dhe 1837, i raportoi familjes mbretërore se ai gjeti se Perandoria Osmane, kishte burime të pasura natyrore dhe treg të dobishëm për interesat britanike.

Me *Ceride-i Havadis*, William Nosworthy Churchill u përpoq me insitim ta bënte publikun osman të pranonte atë që ishte në favor të interesave britanike. Në të vërtetë, dy vjet më vonë, Perandoria Osmane filloi të plotësonte nevojat e lëndës së parë të industrisë britanike dhe shitjet e produkteve britanike u rritën në dëm të industrisë osmane. Shkencëtari qipriot turk Niyazi Berkes flet se si situata i hutoi Britanikët dhe se si ata talleshin me zyrtarët Osmanë për të naivitetin e tyre.¹¹⁸ (Zyrtarët shtetëror të asaj kohe janë pohime e tilla)

Për më tepër, shumë botime të tjera gjatë epokës së Abdul Hamidit të II-të si *İçtihad (Opinion)*, *Piyano Mecmuası (Revista e pianos)*, *Envar-ı Zeka (Drita e Inteligjencës)*, *Yirminci Asırda Zeka Mecmuası (Revista e Inteligjencës në Shekullin XX)*, *Güneş (Dielli)*, *Havran, Mecmua-ı Ulüm (Gazeta e Diturisë)*, *Saadet (Lumturia)*, *Afak (Horizonti) dhe Felsefe (Filozofia)*, kontribuan në përhapjen e gënjeshtërsë së evolucionit në Perandori. Si pasojë, shoqëria osmane pësoi një rënie të shpejtë morale.

Sistemi arsimor gjatë sundimit të Abdul Hamidit të II-të ngriti shumë materialistë të cilët punuan për të përhapur gënjeshtrën e evolucionit. Disa prej tyre, dhe disa nga vitet që pasuan, dhe pikëpamjet e tyre anti-islamike mund të shihen si më poshtë:

Ahmed Midhat Efendi: Një nga mbrojtësit e parë të teorisë së evolucionit në Perandorinë Osmane. Pavarësisht se ishte larguar më parë nga detyrat e tij nga Sulltan Abdülaziz, ai u ftua përsëri në Stamboll kur Abdul Hamidi i II-të u ngjiti në fron. Abdul Hamidi i II-të e urdhëroi atë të themelonte gazetën *Tercüman-ı Hakikat* (*Interpretuesi i së Vërtetës*), e cila u emërua si botimi gjysmë zyrtar i Pallatit. Gazeta u botua deri në vitin 1921, me shkrimtarët e famshëm darvinistë të kohës si Ahmed Cevdet dhe Ahmed Rasim si kolumnistë të saj të rregullt. Abdul Hamidi i II-të gjithashtu emëroi Ahmed Midhatin si drejtor të Shtëpisë Botuese Shtetërore.

Disa nga titujt e pjesëve të Ahmed Midhat Efendiut ishin, "Adem ve Orangutan" (Adami dhe Orangutani), "Hayvanatın Hissi" (Ndjenjat e kafshëve), "İnsan Tenha Yaşasa Ne Olur" (Çfarë do të ndodhte nëse njerëzit do të jetonin vetëm). Pjesa e fundit e përmendur pretendonte se njerëzit kishin një të kaluar shtazarake dhe se ata supozohej se kishin evoluar në kohë për të arritur gjendjen e tyre aktuale përveç nocioneve të tjera të çuditshme, të tilla si përshembull nëse një foshnjë njerëzore do të jetonte mes kafshëve, ajo do të ishte sjellur si një kafshë.

Një pjesë tjetër e Ahmed Midhat, "Dünyada İnsanın Zuhuru" (Shfaqja e Njeriut në Tokë) e cila u mësua në shkollë, filloi me fjalë të mëposhtme: 'Meqenëse njerëzit janë një lloj kafshë, natyrisht, ne jemi kuriozë ta dim se si mund të kenë ardhur në këtë botë'. Artikulli ishte plot përralla darviniste.

Një artikull tjetër nga Ahmed Midhat me titull "İntikam" (Hakmarrja) - gjithashtu i mësuar në shkollë - pretendonte gabimisht se dhuna ishte pjesë e natyrës njerëzore; me fjalë të tjera, ai po promovonte Darwinizmin shoqëror:

Hakmarrja është një lloj drejtësie, është një drejtësi e dhunshme. ... Atëherë nga e dimë që sjellja e keqe, një pjesë e natyrës sonë, do të na dëmtojë?

Shumë njerëz pretendojnë se Izraeli dhe shteti hebre ishin shkaktar që Perandoria Osmane humbi tokat e saj në Lindjen e Mesme. E vërteta qëndron se, retorika e tillë nuk është asgjë tjetër veçse një devijim i krijuar nga Nëntoka Shtetërore Britanike. Një vështrim i shpejtë në epokën post-osmane do të zbulojë se kush përfitoi më shumë nga kjo situatë. Pikërisht, Nëntoka Shtetërore Britanike dhe ashtu si në të kaluarën, ajo ende po shfrytëzon ndarjen aktual në Lindjen e Mesme. Pas rënies së Perandorisë Osmane, Palestina, Iraku, Katari, Kuvajti, Emiratet e Bashkuara Arabe, Egjipti, Arabia Saudite, Jemeni dhe Jordania u vunë nën kontrollin e drejtpërdrejtë të Britanisë. Megjithatë ishin nën sundimin e Francës, Libani, Siria, Libia dhe Algjeria ishin indirekt nën ndikimin e Britanisë. Megjithatë, nga miliona kilometra katrorë, hebrenjtë morën vetëm 14,000 km² ku jetonin 800,000 njerëz. Kjo ishte sipërfaqja më e vogël se sipërfaqja e përgjithshme e Kuvajtit dhe pak më e madhe se ajo e Katarit. Pas tre luftërave të mëdha arabo-izraelite, ky territor u rrit në 20,000 km², megjithatë është akoma më i vogël se qyteti i Ankarasë. Qartësisht, ishte vetëm Nëntoka Shtetërore Britanike e cila qëndronte pas shpërbërjes së Perandorisë Osmane.

Gadishulli Arab, Iraku, Siria dhe rajonet e Gjirit, të cilat Nëntoka Shtetërore Britanike i okupoj në Luftën e Parë Botërore në një përpjekje për të marrë pasuritë e mbetura të Perandorisë Osmane, janë shtëpia e gjysmës së rezervave të naftës në botë. Për këtë arsye, nga fundi i shekullit të 19-të, oreksi i Britanisë për Lindjen e Mesme vetëm ishte rritur.

Në të vërtetë, pasi Nëntoka Shtetërore Britanike siguroi kontrollin e këtij rajoni, ajo shfrytëzoi pasuritë e myslimanëve autoktonë për vite me radhë. Edhe pas rënies së Perandorisë Osmane, ajo mori pjesën më të madhe të naftës në vendet si Iraku, Arabia Saudite, Kuvajti dhe Emiratet e Bashkuara Arabe.

Zhvillimet e kohës duhet të jenë një mësim për myslimanët e shekullit 21 dhe t'i ndihmojnë ata të kuptojnë më mirë zhvillimet e kohës moderne. Ata të cilët i konsiderojnë vëllezërit dhe motrat e tyre të fesë si armiq për shkak të provokimeve sektare duhet të shohin atë që ndodhi njëqind vjet më parë dhe të kuptojnë mashtrimin. Ata duhet ta dinë se me këtë qëndrim, megjithatë pa e ditur, ata po ndihmojnë vetëm projektet e zhvilluara në Chatham House dhe në Këshillin e Privatësisë në Londër. Bota Islame vuan nga këto projekte për një shekull dhe vetëm myslimanët mund të parandalojnë që këto plane të errëta të realizohen.

Sot Libani, Iraku, Siria dhe Jemeni po merren me luftëra civile. Përplasjet sektare vazhdojnë të marrin jetën e myslimanëve çdo ditë. Nëntoka Shtetërore Britanike dhe Marrëveshja Sykes-Picot, e zbatuar fshehurazi me kalimin e kohës, solli vetëm shkatërrim dhe vdekje. E vetmja mënyrë për të rikthyer paqen është njohja e sistemit djallëzor kur vihet në veprim. Në qoftë se Nëntoka Shtetërore Britanike nuk mboshtet shpirtërisht dhe intelektualisht, paqja dhe prosperiteti do të jenë të pamundura për Lindjen e Mesme.

Prandaj, qëllimi duhet të jetë identifikimi dhe njohja e ideologjisë djallëzore të Nëntokës Shtetërore Britanike dhe ofrimi i një përgjigje të duhur intelektuale, gjatë gjithë kohës duke ditur që Zoti do t'u japë fitore mbështetësve të *Mehdiut*.

A mos mendojnë ata që bëjnë vepra të këqija, se do t'i shpëtojnë dënimit Tonë?! Sa keq që gjykojnë ata!
(Kur'an, 29:4)

Politika e Provokimit të Nëntokës Shtetërore Britanike

Kur Nëntoka Shtetërore Britanike vendosi të copëtojë Perandorinë Osmane, hapi i saj i parë ishte nxitja e trazirave rajonale. Spiunët dhe miqtë e saj të cilët u përmendën në kapitullin e mëparshëm luajtën rol të rëndësishëm në këto trazira. Është gënjeshtër fakti se pakicat që jetonin nën sundimin osman në të vërtetë morën pjesë në këto kryengritje. Përkundrazi, ato trazira u organizuan nga hipokritët dhe servilët të cilët ishin pjesë e grupeve të ndryshme etnike dhe zgjodhën të tradhtonin vendin e tyre për përfitime të vogla personale.

Nga fundi i shekullit të 19-të, Nëntoka Shtetërore Britanike arriti të shkëpusë Serbinë, Bosnjën Hercegovinë, Rumaninë, Bullgarinë dhe Malin e Zi nga Perandoria Osmane dhe më pas Maqedoninë, Salonikën (Selanikun modern)

dhe Manastirin (Bitolen moderne) në fillim të shekullit të 20-të. I njëjti provokim përmes 'pacticave' ishte edhe një herë aktiv, të njëjtët spiunë provokues britanikë ishin edhe një herë në skenë dhe kombet që kishin ekzistuar në harmoni për 600 vjet nën sundimin Osman u paraqitën si kombe që kundërshtuan Perandorinë Osmane. Me anë të spiunëve dhe mercenarëve të tyre, ata krijuan trazira civile dhe kriza në këto rajone. Gjatë kësaj kohe, afër 5 milion myslimanë në Ballkan u vranë, ndërsa 5 milion të tjerë u detyruan të largoheshin për në Anadoll. Nëntoka Shtetërore Britanike kreu masakër të madhe aty.

Greqia, Bullgaria, Serbia, Mali i Zi dhe Rumania, të cilat shpallën pavarësinë me ndihmën e Nëntokës Shtetërore Britanike u kthyen në kukulla. Pavarësisht se kanë jetuar në paqe për shekuj në Perandorinë Osmane, këto kombe, në emër të Nëntokës Shtetërore Britanike, sulmuan Perandorinë Osmane në Luftërat Ballkanike. Në mënyrë të ngjashme, Greqia pushtoi Anadollin para Luftës për Pavarësi.

Trazirat që patën efektin më vdekjeprurës në Perandori ishin trazirat arabe. Nxitur direkt nga spiuni britanik Lawrence, këto trazira arritën qëllimin e tyre për shkak të mbështetjes së servilëve anglofilë.

Trazirat armene, një faktor tjetër që kontribuoi në rënien e Perandorisë, do të shqyrtohen në detaje në vijim në pjesën tjetër të librit.

Politika e Nëntokës Shtetërore Britanike bazohet në vënien e kombeve kundër njëri-tjetrit. Brenda njëqind vjetësh, kombet ballkanike luftuan Perandorinë Osmane, armenët luftuan turqit, kurdët luftuan armenët, arabët luftuan njëri-tjetrin dhe turqit, kaukazanët luftuan njëri-tjetrin dhe armenët. Njësitë britanike të cilat sulmuan Perandorinë Osmane përbëheshin nga kombe të kolonizuara. Gjatë këtij procesi, Nëntoka Shtetërore Britanike kurrë nuk mori pjesë drejtpërdrejt, përkundrazi përdori spiunët e saj, mjetet e propagandës dhe mediat si dhe nxiti njerëzit e varfër.

Ndërsa Darwinizmi dhe korrupsioni moral po shkatërronin vlerat morale të shoqërisë osmane, borxhet po dëmtonin ekonominë e Perandorisë dhe hipokritët po punonin për shkatërrimin e vetëdijes patriotike. Kjo humbje shkaktoi një dëm katastrofik jo vetëm për Perandorinë Osmane, por edhe për kombet e përmendura më lartë. Nga kjo pikë e tutje, këto rajone u zunë në grackën e Nëntokës Shtetërore Britanike dhe u kthyen në marioneta duke bërë që trazirat civile të vazhdojnë ende.

Kryengritja Greke dhe Lord Bajroni

Gjatë kryengritjes greke, ushtria osmane luftoi jo vetëm trupat greke, por edhe Nëntokën Shtetërore Britanike. Çuditërisht, poeti homoseksual britanik Lord Bajron luftoi përkrah grekëve, pothuajse më me entuziazëm se vetë ata. Ai madje ngriti një njësi mercenare të quajtur 'Brigada e Bajronit' dhe vdiq duke e drejtuar atë. Ai gjithashtu e bindi Ali Pashën e Janinës, me të cilin kishte një marrëdhënie homoseksuale, të fillonte një kryengritje kundër Perandorisë Osmane, duke e detyruar ushtrinë Osmane të luftonte në dy fronte në të njëjtën kohë.

Ushtria osmane ishte gati të shtypte kryengritjen greke, por nën udhëheqjen e Nëntokës Shtetërore Britanike, marina britanike, franceze dhe ruse sulmuan flotën osmane në Navarino dhe fundosën më shumë se 70 anije të flotave osmane dhe egjiptiane. (Roli i Nëntokës Shtetërore Britanike në sulmin e Navarinos do të shpjegohet më tej në faqet vijuese.) Sidoqoftë, edhe shkatërrimi i flotave osmane dhe egjiptiane nuk ishte i mjaftueshëm për të siguruar një fitore greke. Shteti Grek nuk mund të krijohej deri pas Luftës Ruso-Turke (1828-29). Të gjitha këto zhvillime ndodhën përmes manipulimit të kujdesshëm të Nëntokës Shtetërore Britanike. Në fund, grekët fituan pavarësinë me ndihmën e Nëntokës Shtetërore Britanike.

Komandanti grek Kolokotronis shkruajti në kujtimet e tij se si ata martirizuan 32,000 turq në qytetin e Tripolitsa. Historiani britanik Walter Alison Phillip theksoi më poshtë lidhur me masakrën:

Për tre ditë, banorët e mjerë [turq] iu nënshtruan epshit dhe mizorisë së një turme të egër. As gjinia dhe as moshja nuk u morën në konsideratë. Gratë dhe fëmijët u torturuan para se të vriteshin. Kaq e madhe ishte masakra, sa vetë [udhëheqësi i guerilës greke] Kolokotronis thotë se, nga porta deri në kala, thundrat e kalit të tij nuk e preknin kurrë tokën. Rruga e tij e triumfit ishte e mbështjellë me kufoma. Në fund të dy ditëve, të

torturuanit mysliman u mblodhën qëllimisht, rreth dy mijë shpirtra të mjerë, të çdo moshe dhe gjinie, por kryesisht gra dhe fëmijë, të cilët u dërguan tek një përroskë në malet fqinje dhe atje u therrën si bagëti.¹⁵⁷

William St. Clair shkroi tregimet e dëshmitarëve okularë dhe përshkrimet e oficerëve të pranishëm gjatë masakrës:

Mbi dhjetra mijëra turq u vranë. Të burgosurit që dyshohej se kishin fshehur paratë e tyre u torturuan. Krahët dhe këmbët e tyre ishin prerë dhe ata ishin pjekur ngadalë në zjarre. Gratë shtatzëna u prenë në bark, kokat e tyre u prenë në mes dhe koka të qenve ju futën në mes të këmbëve. Nga e Premtja në të Dielë ajri u mbush me tinguj britmash ... Një Grek mburrej se ai personalisht vrau nëntëdhjetë njerëz. Kolonia hebraike u torturua në mënyrë sistematike ... Për javë të tëra më pas, fëmijë turq të uritur që vraponin të pafuqishëm nëpër rrënoja u prenë dhe u qëlluan nga grekët e ekzaltuar ... Puset u helmuan nga trupat që ishin hedhur.¹⁵⁸

Kryengritja greke të cilën Nëntoka Shtetërore Britanike e nxiti për të çuar përpara interesin e saj nuk u bëri dobi as grekëve. Pasi u themelua një shtet i pavarur Grek, filloi një migrim i grekëve drejt territoreve osmane dhe 60,000 njerëz u larguan nga Greqia midis viteve 1834-36, dhe shumia zgjodhën ishullin e Kretës, i cili më pas drejtohej nga krerët e Egjiptit, Mehmed Ali Pasha (i njohur ndryshe si Muhamed Alia i Egjiptit).

E Vërteta prapa Kryengritjes Greke

Motivi kryesor prapa kryengritjes Greke ishte përzënia e Turqve nga Evropa. Në të vërtetë, projekti që filloi me këto trazira vazhdoi për 100 vjet të tjera derisa i dha fund plotësisht pranisë 500-vjeçare turke në Ballkan. Si rezultat, popullësia myslimane ra ndjeshëm. Historiani amerikan Justin McCarthy vlerëson se midis vitit 1821 dhe vitit 1922, afër 5.5 milion myslimanë u dëbuan nga Evropa dhe 5 milion të tjerë humbën jetën direkt ose indirekt si rezultat i sëmundjeve ose urisë gjatë ikjes.

Kryengritja Bullgare

Kryeministri britanik i asaj kohe, William Ewart Gladstone, e bazoi fushatën e tij të shpifjeve kundër Perandorisë Osmane dhe Turqve në zhvillimet që ndodhën në Bullgarinë e sotme moderne. Së bashku me *The Times*, ai organizoi fushatën anti-turke anembanë Londrës për ditë me radhë, ndërsa libri i tij *Tmerret Bullgare dhe Pyetja e Lindjes*, i shtypur në 200,000 kopje, ofronte tregime të mbivlerësuara të incidenteve që synonin ta ushqenin Turkofobinë. Në të vërtetë, ai po përdorte trazirat Bullgare, të cilat ishin nxitur nga Nëntoka Shtetërore Britanike për të mbështetur fushatën e zezë propagandistike që ai do të niste kundër Perandorisë Osmane.

Kryengritja Bullgare ishte vetëm një nga një mori kryengritjesh të filluara me provokimin e Nëntokës Shtetërore Britanike ndërsa Perandoria Osmane hyri në epokën e saj të rënies. Çuditërisht, pas disa shekujsh bashkëjetese paqësore në tokat Osmane, grupet e pakicave papritmas filluan të ktheheshin kundër Perandorisë. Sidoqoftë, një vështrim më i detajizuar zbulon origjinën e këtyre trazirave dhe kryengritjeve të nxitura nga spiunët, ushtarakët, oficerët dhe ambasadorët e Nëntokës Shtetërore Britanike. Grupet rebele në këto pakica u armatosën personalisht nga Nëntoka Shtetërore Britanike, në mënyrë që të krijojnë një ndjenjë antiturke dhe të ngrihen kundër Perandorisë. Kryengritjet filluan me incidente të tmerrshme ku qindra, dhe në disa raste, mijëra, turq myslimanë u vranë. Kur ushtria osmane ofroi përgjigjen e nevojshme, provokatorët e Nëntokës Shtetërore Britanike filluan fushatën me shpifje së bashku me thirrjet 'turqit janë vrasës'. Kjo ishte metoda kryesore e Nëntokës Shtetërore Britanike kur dëshironte të nxisë trazira dhe konflikte brenda Perandorisë Osmane.

Historiani Süleyman Kocabaş shkroi në lidhje me kryengritjen e Nëntokës Shtetërore Britanike e cila synonte të shkaktonte një kryengritje bullgare:

Britania përsëriti veprimet e saja në kryengritjen Greke për të nxitur trazirat Bullgare. Britania, e cila në të kaluarën kishte kundërshtuar kryengritjet sllave për të ruajtur integritetin territorial osman, filloi të mbrojë bullgarët në vitet 1870 për të ashtuquajturin qëllim për t'i shpëtuar ata nga ndikimi rus. Lejoi [Panslavistët] të krijonin komitete në Londër, lejoi këto grupe të provokonin sulme kundër Turqve dhe kundërshtoi ndalimin e bandave nga Turqit.¹⁵⁹

Këto trazira të mbështetura nga Nëntoka Shtetërore Britanike sollën komunitetet osmane, të cilat kishin bashkëjetuar në paqe për shekuj, në konflikt me njëra-tjetrën. Për çudi, rrethanat politike që pasuan ju shërbyen vetëm interesave të Nëntokës Shtetërore Britanike. Edhe një herë për hir të saj, miliona myslimanë, të krishterë, hebrenj, turq, bullgarë, armenë, grekë, boshnjakë, arabë, çerkezë dhe civilë shqiptarë - gra, fëmijë apo të moshuar - u therën pa dallim.

Viktima nga radha bullgare gjatë kryengritjes ishte 1,400 persona sipas raporteve zyrtare Osmane. Rreth 1.000 qytetarë myslimanë osmanë u therën gjatë së njëjtës kohë. Sidoqoftë, media evropiane ishte e shpejtë për të fryrë numrat e të vdekurve, duke përmendur se janë deri në 200,000 viktima. Sidoqoftë, sot edhe autoritetet bullgare deklarojnë se janë 30,000 viktima. Nga ana tjetër, raportet e përgatitura nga autoritetet neutrale të Belgjikës, e zbritën numrin në 4,500 persona. Është e tepërt të thuhet, mirëpo persona të pafajshëm humbën jetën dhe kjo është shumë më e rëndësishme se çdo debat mbi numrat. Pika kyqe është se Nëntoka Shtetërore Britanike edhe një herë shkaktoi humbjen e civilëve të pafajshëm. Duke thënë këtë, hendeku befasues në numër është një tjetër shenjë e përfshirjes së Nëntokës Shtetërore Britanike. Është një fakt i njohur se Nëntoka Shtetërore Britanike zakonisht i rrit numrat kur dëshiron të krijojë një trazirë.

Një nga arsyt kryesore prapa kryengritjes Bullgare ishte dëshira për të vendosur bazat për grushtin e shtetit të vitit 1876 që shënoi fillimin e fundit për Perandorinë Osmane. Vetëm një muaj e gjysmë pas kryengritjes Bullgare, një grup pro-britanik udhëhoqi një grusht shteti, martirizoi Sulltan Abdülaziz Khanin, e shpalli Muratin e V-të, njeri të çmendur dhe solli Abdul Hamidin e II-të në fron me forcë. Të gjitha këto zhvillime ndodhën në përputhje me planet e Nëntokës Shtetërore Britanike. Më pas, Nëntoka Shtetërore Britanike bëri presion mbi Abdul Hamidin e II-të dhe e bindi atë të veprojë në përputhje me kërkesat e tyre. Në mënyrë mjaft interesante, vërejtjet antiturke të Kryeministrit Britanik Gladstone u ndalën papritmas pasi Abdul Hamidi i II-të u ngjiti në fron.

Kryengritja e Prillit ka qenë faktori kryesor prapa incidenteve që arritën kulmin me grushtin e shtetit. Nga 20 prilli i vitit 1876, kur filloi kryengritja, deri më 31 gusht, kur Abdul Hamidi i II-të u bë Sulltan, Nëntoka Shtetërore Britanike bëri një fushatë të egër kundër turqve. Në mënyrë misterioze, shumë qarqe që akuzuan turqit për kryerjen e masakrave inegzistente në atë kohë heshtën çuditërisht përpara masakrave të Nëntokës Shtetërore Britanike në Afrikë (Zulus), Australi (Aborigjenëve), SH.B.A. (Indianëve) dhe Lindjen e largët (Indianëve dhe Kinezëve), megjithë provat e qarta.

Kryengritja e Jemenit

Konfrontimi i parë serioz ushtarak midis Britanisë dhe Perandorisë Osmane ndodhi kur Nëntoka Shtetërore Britanike korruptoi disa sheikë lakmitarë në mënyrë që të fitonte një vend në qytetin Aden të Jemenit, një provincë e rëndësishme dhe e vlefshme e Perandorisë Osmane. Duke kërkuar të forconte më tej praninë e saj, Nëntoka Shtetërore Britanike filloi të kërkonte për një fortesë të besueshme në Jemenin verilindor. Historiani Süleyman Kocabaş përshkruan hapat e fshehtë që çuan në pushtimin e Jemenit:

Pasi Britania hyri në Aden, ajo vazhdoi të përparonte në drejtimin verilindor dhe ndërmori të gjitha metodat e imagjinueshme për të arritur qëllimin e saj për të kapur tokat pjellore. Ata kishin veshur rroba arabe, flisnin arabisht, si dhe mashtruan arabë me premtime për pavarësi; të gjitha për hir të interesave të ishullit të tyre.¹⁶⁰

Kjo ishte arsyeja prapa kryengritjeve famëkeqe të Jemenit që ndodhën ndërsa ishte nën sundimin osman. Perandoria dërgoi trupa dhe madje ushtri të vogla për të shtypur trazirat, por pavarësisht përpjekjeve masive, ajo humbi Jemenin. Edhe një herë, disa sheikë, të cilët shikonin interesin e tyre personal mbi interesin e vendit të tyre, preferuan të ishin shërbëtor të Nëntokës Shtetërore Britanike. Tradhtia e tyre e tmerrshme shkaktoi vrasjen e mijëra njerëzve.

Zhvillimet në Afrikën e Veriut

Në shekullin e 16-të, Perandoria Osmane - një fuqi e pandalshme detare - pushtoi Afrikën e Veriut. Perandoria arriti në brigjet e Italisë në veri, kontrolloi të gjithë Mesdheun Lindor dhe mori Egjiptin dhe Marokun në jug. Me fjalë të tjera, Mesdheu u bë një liqen turk. Ushtritë koloniale të Francës, Spanjës, Britanisë dhe Holandës u desh të kalonin Oqeanin Atlantik për të arritur Afrikën e Jugut dhe Perëndimit.

Edhe një herë, Britania nuk ishte e gatshme të pranonte situatën. Për udhëheqësit e Nëntokës Shtetërore Britanike, tokat që duhej të ishin nën kontrollin britanik kontrolloheshin nga një perandori myslimane. Për shkak të armiqësisë së tyre të thellë ndaj Islamit dhe Turqve, kjo nuk ishte diçka që ata mund të praninin. Si rezultat, gjatë shekullit të 18-të, Nëntoka Shtetërore Britanike shkëputi tokat myslimane në Afrikë nga Perandoria Osmane, një nga një, dhe përdori taktika të zakonshme dhe metoda provokative gjatë gjithë kohës.

Maroku

Marrëdhëniet e Nëntokës Shtetërore Britanike me Marokun filluan në shekullin e 16-të. Ashtu si me Perandorinë Osmane, Mbretëresha Elizabeta e I-rë e Anglisë arriti të merrte privilegje tregtare nga Perandori Marokiene dhe filloi tregtinë në rajon për llogari të Anglisë. Kompania Angleze e Barbarisë, me statutin e dhënë nga Mbretëresha, bleu një pjesë të prodhimeve vjetore të sheqerit Marokien në këmbim të armëve dhe materialeve Angleze. Duhet të mbahet mend se Kompania e Turqisë operoi në një mënyrë të ngjashme dhe zhvilloi biznes për 300 vjet duke siguruar monopol.

Në fillim të shekullit të 20-të, Nëntoka Shtetërore Britanike nxiti fshehurazi dy incidente në Marok, në vitin 1906 dhe vitin 1911, të njohura si Krizat Marokene. Duke përdorur luftën për pushtet si pretekst, Franca vendosi trupat e saj në Marok. Gjermania nuk donte të lihej jashtë dhe dërgoi flotën e saj detare në rajon. Si rezultat, Gjermania dhe aleanca Britanike-Franceze iu afruan dy herë luftës. Këto dy kriza zakonisht shihen si faktorë thelbësorë kontribues në Luftën e Parë Botërore.

E vërteta është se të gjitha këto zhvillime ishin 'të planifikuara'. Në këtë mënyrë, Britania ishte në gjendje ta bëjë Francën më të varur nga ajo dhe arriti ta kthente publikun Britanik kundër Gjermanisë. Të gjitha këto zhvillime nxituan fillimin e Luftës së Parë Botërore, e cila ishte planifikuar dhe orkestruar nga Nëntoka Shtetërore Britanike. Për më tepër, ndërsa rivalët e Britanisë po kalonin kohë në Marok, Britania ishte e zënë me marrjen e Egjiptit nën kontrollin e saj. Në fund, mijëra myslimanë marokienë që u vranë në incidente të ndryshme duhej të paguanin çmimin e kësaj loje për pushtet të nxitur nga Nëntoka Shtetërore Britanike.

Krizat rezultuan në krijimin e një protektorati të plotë mbi Marokun nga Franca në vitin 1912 dhe për dyzet vitet e ardhshme.

Ishte vendimtare për Britaninë që Maroku të ishte nën kontrollin e një prej aleatëve të saj, sepse lejoi Nëntokën Shtetërore Britanike të kontrollonte njërën anë të ngushticës së Gjibraltarit, portën për në Mesdhe.

Konfliktet e mbështetura nga Britanikët në Saharanë Perëndimore

Maroku ka qenë në luftë me Frontin separatist Polisario në Saharanë Perëndimore për tridhjetë vitet e fundit. Nga ana tjetër, Britania ka qenë duke i furnizuar fshehurazi me armë të dyja palët e përfshira në konflikt. Në Saharanë Perëndimore, ku jetojnë vetëm 500,000 njerëz, ekziston një ushtri marokene me 100,000 njerëz. Britania shet automjete të blinduara, pushkë snajperësh, raketa tokësore, dhe armantime tjera të rënda në Marok për t'u përdorur në këtë rajon. Në dy vitet e fundit, ajo ka dorëzuar armë të lehta me vlerë më shumë se 1 miliard dollarë. Për shkak të konkurrencës midis Algjerisë dhe Marokut, Algjeria gjithashtu mbështet dhe furnizon me armë lëvizjet separatiste në Saharanë Perëndimore. Kohët e fundit, Maroku ka nënshkruar një marrëveshje të re me SHBA-të për 150 tanke.

Nëntoka Shtetërore Britanike sigurisht që nuk dëshiron paqe në rajon. Jo vetëm që Kombet e Bashkuara nuk e njohin pavarësinë e Saharasë Perëndimore, por gjithashtu nuk e njohin sovranitetin e Marokut, mbi rajonin i cili ka qenë i përfshirë në luftë për një kohë të gjatë. Siç mund të pritej, kjo ishte një pjesë e planeve të Nëntokës Shtetërore Britanike e sajuar 100 vjet më parë për të copëtuar Perandorinë Osmane. Plani duket se po funksionon pa problem.

Tunisia

Në vitet 1850, Tunizia po drejtohej nga 'Bejtë' e emëruar nga Osmanët. Sidoqoftë, ajo më vonë nisi një lëvizje të ashtuquajtur 'modernizimi', e cila ishte në të vërtetë një politikë imperialiste e Nëntokës Shtetërore Britanike e maskuar, dhe e krijuar për të paralizuar vendet ekonomikisht, shoqërisht dhe kulturor. Si rezultat, Tunizia i pagoi shuma të mëdha Britanisë për shpenzimet e saj të mbrojtjes dhe pjesa tjetër e "pagesës" i erdhi më pas, siç bëhet gjithmonë sa herë që përfshihet Nëntoka Shtetërore Britanike. Të gjymtuar ekonomikisht, vendi u bë më i varur nga Britania, huazoi më shumë para dhe falimentoi në mënyrë të pashmangshme. Për shkak të normave të interesit astronomik, qeveria tuniziane, e cila kishte marrë hua vetëm 30 milion franga, iu desh ta kthente atë pas një kohe të shkurtër me interes në shumën prej 70 milion franga. Në fakt, populli turk është shumë i njohur me këtë kurth ekonomik. Ishte ndër arsyet e rënies së Perandorisë, ky kurth është gjithmonë projekt i Nëntokës Shtetërore Britanike. Një metodë e ngjashme ishte duke u përdorur për Egjiptin pothuajse njëkohësisht, ashtu si në Indi në të kaluarën.

Pasi mori huanë e saj të parë në vitin 1863, qeverisë tuniziane iu desh të vendoste taksa të reja vitin e ardhshëm. Njerëzit, të cilët ishin tashmë shumë të varfër, nuk mund ta duronin presionin dhe u rebeluan në vitin 1864. Megjithëse funksionoi një përgatitje qeveritare, borxhet e reja sollën taksa të reja, të cilat shkaktuan trazira të reja. Ky cikël vicioz vazhdoi derisa Tunizia u bë një protektorat francez.

Tunizia, tashmë me prodhimtari të dobët bujqësore, u detyrua të eksportojë shumicën e prodhimeve të saj për të paguar borxhet e saj, gjë që shkaktoi urinë dhe koleran. Si rezultat vdiqën 10,000 tunizianë.

Kur shteti falimentoi, u krijua një institucion i ngjashëm me Administratën Osmane të Borxhit dhe ekonomia tuniziane iu besua Britanikëve dhe Francezëve. Në fund të fundit, Tunizia iu la Francës në këmbim të Qipros, të okupuar pa një përpjekje ushtarake. Kjo nuk ishte as marrëveshja e parë dhe as e fundit në të cilën Nëntoka Shtetërore Britanike po ndante tokat osmane.

Vetëm 18 vite pasi u ble borxhi i parë i jashtëm, Franca, me 36,000 trupat e saj, pushtoi Tunizinë në vitin 1881. Kur Beu i Tunizisë Muhamedi i III-të as-Sadiq e kuptoi se ai nuk do të ishte në gjendje të luftonte, nënshkroi një traktat që i cili e ktheu Tunizinë në një protektorat francez.

Nga ajo datë deri në vitin 1956, kur ata fituan pavarësinë e tyre nën udhëheqjen e Habib Bourguibas, Tunizia ishte përfshirë në konflikte të vazhdueshme, luftëra civile dhe terror. Pushtimi nga nazistët u pasua nga fitorja e Aleatëve. Francezët aplikuan masa të rrepta për të shtypur nacionalizmin tunizian dhe gjatë kësaj kohe, dhjetëra mijëra myslimanë u vranë nga francezët.

Në ato vite, Britania kishte fjalën e fundit në shpërndarjen e pushtetit në botë. Asnjë vend nuk mund të pushtonte një vend nëse nuk lejohet nga Britania. Siç u shpjegua më parë, Franca ishte në gjendje të okuponte rajone vetëm në përputhje me planet e Nëntokës Shtetërore Britanike. Kjo lejoi Britaninë që të kontrollonte tokat e mëdha përmes aleatëve të saj dhe të mbante nën kontroll një fuqi të rëndësishme si Franca.

Algjeria ishte një vend tjetër që vuante nga presione të ngjashme të Nëntokës Shtetërore Britanike.

Algjeria

Për 300 vjet, Algjeria ishte qendra kryesore e pushtetit Osman në Magreb. Guvernatorët e emëruar nga Sulltani e drejtuan provincën derisa Franca e pushtoi atë në vitin 1827, duke përdorur një përplasje të vogël me Konsullin Francez si një justifikim. Kur një takim midis guvernatorit të Algjerisë Hussein Dey dhe Konsullit Francez u tensionua, Dey e goditi Konsullin Francez tre herë me grushta. Franca menjëherë e bëri këtë incident një justifikim për pushtim, pas së cilës Husein Dey u internua.

Tani kur u bë koloni franceze, sistemi arsimor i vendit u ndryshua, administratorëve vendas iu hoqën fuqitë dhe rendi shoqëror erdhi në një pikë thyerjeje. Tokat e pasura të myslimanëve u morën atyre dhe iu dorëzuan kolonialistëve francezë. Algjeria u bë qendra administrative e kolonive franceze në Afrikë. Gjatë gjithë viteve, myslimanët e Afrikës Veriore dëshmuuan fytyrën e tmerrshme të imperializmit evropian ndërsa myslimanët u persekutuan atë. Sundimi francez nuk solli asgjë përveç vdekjes së myslimanëve të Algjerisë. 175,000 algjerianë luftuan për Francën gjatë Luftës

së Parë Botërore, por 40,000 prej tyre nuk u kthyen më. Gjatë Luftës Algjeriane për pavarësi, 1.000.000 myslimanë humbën jetën, ndërsa 3.000.000 u burgosën në kampe.

Sidoqoftë, edhe pas shpalljes së pavarësisë, dhuna në Algjeri nuk mbaroi. Përkundrazi, vendi u zhyt në një luftë civile të përgjakshme në fund të shekullit të 20-të dhe pas një grushti të shtetit kundër Frontit Shpëtimtarë të Myslimanëve (FIS) në vitin 1991, 150,000 myslimanë u vranë nga duart e myslimanëve të tjerë. Grupi Islamik i Armatosur i Algjerisë (GIA), themeluar në vitin 1993, filloi të vras Algjerianët nga të gjitha prejardhjet, përfshirë myslimanët e lidhur me FIS. Nëntoka Shtetërore Britanike ishte përsëri prapa GIA-s, e cila kishte një revistë me qendër në Londër, të quajtur *Al-Ansar*, që synonte të rekrutonte myslimanë që mund të bëheshin gueril. Britania i lejo këto aktivitete, ofroi disa herë mbështetjen e saj dhe ndonjëherë ndihmonte në përgatitjen e mjedisit për aktivitete të tilla.

Tregu i Preferuar i Arëve të Nëntokës Shtetërore Britanike: Afrika

Me rezervat më të mëdha të gazit natyror në botë dhe tokën e saj të mëdha pjellore, Algjeria është një vend i bekuar. Sidoqoftë, për shkak të konfliktit të vazhdueshëm, një pjesë e madhe e të ardhurave të saj shpenzohen për armë. Deri më tani, vetëm Algjeria përbën 30% të importit të armëve në Afrikë, e ndjekur nga Maroku me 26%. Midis viteve 2011 dhe 2015, Algjeria bleu 4 anije luftarake, 190 tanke, 42 helikopterë, 14 aeroplanë dhe 2 nëndetëse. Dhe Maroku duket se është objektivi i vetëm i synuar i kësaj përgatitje ushtarake.

Në të vërtetë, shihet qartë se Nëntoka Shtetërore Britanike është përfshirë edhe një herë, duke kryer plane të mbrapshta si gjithmonë, të cilat zakonisht synojnë myslimanët. Si rezultat i këtyre kompleteve, myslimanët sillen në një pozitë ku ata shpenzojnë burimet e tyre të vlefshme për të luftuar me njëri-tjetrin gjithashtu edhe një here tjetër, pala e vetme që përfiton nga situata është Britania. Nëntoka Shtetërore Britanike vazhdon edhe sot përpjekjet e saja për të shfrytëzuar Afrikën, duke përdorur burimet e Afrikës për të krijuar konflikte.

Egjipti

Arsyeja më e rëndësishme për transferimin e Egjiptit nën sundim britanik ishte borxhi i jashtëm që Midhat Pasha miratoi gjatë mandatit të tij të parë si vezir i madh. Në 15 vitet e ardhshme, ekonomia u shemb dhe Britania pushtoi Egjiptin saktësisht siç ishte planifikuar nga Nëntoka Shtetërore Britanike.

Egjipti mori hua me gjobë të madhe për të ndërtuar Kanalin e Suezit në vitin 1869 me francezët. Gjashtë vite më vonë, në pamundësi për të paguar kamatën, iu desh të transferonte pjesën e saj të Kanalit tek Britanikët. Tre vite më vonë, auditorët e kreditorëve, Franca dhe Britania, filluan të marrin pozicione në qeverinë egjiptiane. Brenda nëntë viteve, britanikët morën kontrollin e Egjiptit dhe më pas pushtuan vendin katër vite më vonë.

Ngjarjet që çuan në pushtimin e Egjiptit nuk ishin krejtësisht të ndryshme nga ato që pamë në territoret e tjera Osmane. Të nxitur nga Nëntoka Shtetërore Britanike, trazirat antikristiane filluan në Aleksandri, gjatë së cilës anijet e marinës britanike dhe franceze ishin të pranishme në portin e Aleksandrisë. Britanikët përdorën trazirat si një justifikim për të sulmuar qytetin, dhe më pas vazhduan për një pushtim të plotë të Egjiptit dhe e kthyen atë në një protektorat *de facto*, i cili u bë zyrtar në vitin 1914. Nëntoka Shtetërore Britanike më pas nxiti një kryengritje të ngjashme në Sudan, e cila në atë kohë ishte pjesë e Egjiptit. Ushtria egjiptiane nën komandën e gjeneralit britanik Herbert Kitchener shtypi trazirën, e cila bëri që Sudani të administrohej në mënyrë efektive si një koloni britanike. Sudani mbeti i tillë deri në vitin 1956.

9. Propaganda

Propaganda ka qenë gjithmonë një nga mjetet më efektive të Nëntokës Shtetërore Britanike. Kapitujt e mëposhtëm do të trajtojnë në detaje metodat e propagandës dhe dominimin e mediave; megjithatë, le të shqyrtojmë së pari shkurtimisht se si u përdor propaganda për të përshpejtuar shpërbërjen e Perandorisë Osmane.

Kur ideologjia darviniste u përhapë gjerësisht në Perandorinë Osmane, Nëntoka Shtetërore Britanike e kishte më të lehtë për ta ushtruar propagandën e saj. Siç u shpjegua në fillim të këtij kapitulli, ideologjia darviniste shkaktoi jo vetëm erozion shpirtëror, por gjithashtu dëmtoi vetëdijen patriotike. Natyrisht, përhapja e propagandës në një shoqëri kryesisht të privuar nga vetëdija patriotike, formësimi i opinionit publik përmes keqinformimit dhe nxitja e trazirave dhe inateve u bë shumë më e lehtë.

Situata nuk ishte e ndryshme në pjesët e tjera të botës. E nxitur nga ideologjia darviniste dhe propaganda e pamëshirshme e Nëntokës Shtetërore Britanike, Turkofobia u përhap në një botë që ishte përfshirë tashmë në luftëra dhe përplasje. Fjalimet me urrejte, komentet raciste dhe librat propagandues krijuan një front të frikshëm kundër Perandorisë Osmane, veçanërisht në Evropë. Diplomatët britanikë, shumica e të cilëve në të vërtetë ishin spiunë, i mashtruan shtetet evropiane me gënjeshtëri se Perandoria Osmane nuk ishte gjë tjetër veçse 'grup turqish barbarë që masakronin të krishterët' (kombi turk është mbi pretendime të tilla).

Në shekullin e 19-të, Nëntoka Shtetërore Britanike shënjestroi jo vetëm Perandorinë Osmane, por edhe fenë Islame. Provokimet e saj përfshinin sulme ndaj fesë sonë sepse Nëntoka Shtetërore Britanike e konsideroi si thelbësore dobësimin e botës islame. Siç u shpjegua më parë, frika më e madhe e Nëntokës Shtetërore Britanike ka qenë gjithmonë rritja e ndikimit të Islamit dhe aleanca e pakushtëzuar e myslimanëve. Fuqitë nëntokësore të përmendura më lartë bënë gjithçka që kishin mundësi për të parandaluar një aleancë të tillë dhe synuan Perandorinë Osmane për këtë qëllim. Ata ishin të bindur se një Bashkim Islamik mund të arrihej me iniciativën shpirtërore të Turqve.

Politikanët, shkrimtarët, poetët, historianët, gazetarët dhe gazetaret britanike u përdorën gjerësisht për propagandën antiturke dhe anti-islame. Disa shembuj të kësaj tendence mund të gjenden në vijim. (Feja jonë e lartësuar dhe kombi fisnik turk janë mbi këto gënjeshtër të shëmtuara.)

Provokatorët britanikë synojnë turqit

Edward Augustus Freeman

Edward Augustus Freeman, një politikan anglez, filloi të përhapte gënjeshtëri se Islami ishte një fe strikte dhe jotolerante dhe shkoi deri atje sa të bënte pretendime të tilla të pabazuara mizore se Islami bekoj despotizmin dhe skllavërinë si dhe i shpalli luftë besimeve të tjera. Freeman gjithashtu krijoi pikëpamje të përdredhura, duke pretenduar se myslimanët gjithmonë kishin nevojë për armiq dhe se po të mbeteshin pa armiq, ata do të sulmonin vëllezërit e tyre nga sekte të ndryshme.

Si një pedagog i Universitetit të Oksfordit, Freeman, duke kërkuar ndihmën e studentit të tij Arthur Evans, u bë mbështetësi më i zjarrtë anglez i kryengritjes Ballkanike të Bosnjës dhe Hercegovinës. Për më tepër, pas Kryengritjes së Prillit nga Bullgarët, ai ka qenë një nga emrat më të zëshëm të propagandës antiturke.

Freeman ishte në të vërtetë një racist vrasës, i cili dikur tha pohimet e mëposhtme për SHBA-të:

Amerika do të ishte vend i lavdishëm nëse çdo irlandez do të vriste një zezak dhe më pas të varej për këtë gjë.¹⁶¹

Charles Dickens

Charles Dickens, një shkrimtar britanik i shekullit të 19-të, gjithashtu kontribuoi në përhapjen e Turkofobisë. Në poezinë e tij 'Një fjalë në stinë' që shkroi në vitin 1844, ai, në mënyrën e tij, akuzoi Turqit për shkatërrimin e pamëshirshëm të figurës së gjallë të Zotit. Në poezinë e tij, ai pretendoi se Turqit po jetonin në injorancë dhe varfëri barbare dhe për këtë, ata ishin shumë të ndryshëm nga kombi anglez që ndërtoi një civilizim të lartë.

Kardinali Newman (John Henry Newman)

Kardinali Newman, i Kishës Katolike në Angli, ishte një nga Turkofobët dhe Islamofobët më të zellshëm. Një nga shpifjet e tij të shumta për turqit ishte si më poshtë:

...fuqia barbare [turqia] e cila ka qenë për shekuj me radhë në zemrën e botës së vjetër, e cila ka në tufën e saj barbare vendet më të famshme të antikitetit klasik dhe fetar, dhe shumë nga rajonet më të frytshme dhe të bukura të tokës;... Dhe e cila, duke mos pasur histori të veten, është trashëgimtare e emrave historikë të Konstandinopojës dhe Nikesë, Nikomedisë dhe Cezaresë, Jeruzalemit dhe Damaskut, Ninivës dhe Babilonisë, Mekës dhe Bagdadit, Antiokisë dhe Aleksandrisë, duke mbajtur me injorancë gjysmën e historisë së të gjithë botës.¹⁶² (kombi fisnik turk është mbi pohime të tilla)

Charles Darwin

Charles Darwin, i cili prezantoi gënjeshtren e evolucionit në botë dhe përhap Darwinizmin shoqëror, duke siguruar kështu një bazë ideologjike për Luftën e Parë Botërore dhe Luftën e Dytë Botërore, ishte një figurë tipike turkofobe dhe anti-osmane. Citati në vijim është i rëndësishëm sepse tregon fytyrën e vërtetë të Darvinit:

Unë mund të ju paraqes luftën mbi përzgjedhjen natyrore ngase jam duke bërë më shumë për përparimin e civilizimit sesa jeni të prirur të pranoni. Mos harroni se në çfarë rreziku ishin kombet e Evropës, jo shumë shekuj më parë, për t'u sunduar nga Turqit dhe sa qesharake është një ide e tillë tani!

Racat më të civilizuara të ashtuquajtura Kaukaziane kanë mundur humnerën Turke në luftën për ekzistencë. Duke parë botën jo shumë larg nga tani, çfarë numri i pafund i racave më të ulëta do të jetë eliminuar nga racat më të larta dhe më të civilizuara në të gjithë botën.¹⁶³

Edwin Pears

Pears kaloi 40 vite në Stamboll para se të kthehej në Londër, ku menjëherë u bë i famshëm për urrejtjen e tij ndaj turqve. Ai duhet ta ketë bërë mirë punën e tij; punën të cilën iu dha nga Nëntoka Shtetërore Britanike, sepse kur u kthye në vendin e tij, ai u bë kalorës. Për çudi, artikulli i tij botuar në Daily News në vitin 1876 mbi masakrat e pretenduara në Bullgari, shkaktoi protesta të gjera anti-turke.

Pears u bë gjithashtu kalorës nderi në Greqi dhe Bullgari. Në librin e tij me titull "Turqia dhe Populli i Saj", Peras tha për Armenët, "Ata janë popull i lashtë me të njëjtën racë Indo-Evropiane si ne ..." Në librin e tij, ai shkoi aq larg sa të thoshte gënjeshtër të tilla si, "Dënimi për të folur [në gjuhën armene] ishte që të shqyhej gjuha ". E vërteta është se armenët jetuan në Perandorinë Osmane për më shumë se 500 vjet në bashkëjetesë paqësore dhe flisnin gjuhën e tyre lirshëm. Për shembull, deri në vitin 1897, numri i shkollave armene në Perandori kishte arritur në 922.

Vërejtjet vijuese të Edwin Pears në artikullin e tij për Daily News të vitit 1918 me titull 'Konstandinopoja, Romanca e Qytetit', treguan qartë armiqësinë e ngulitur thellë për Turqit:

Epo, duket sikur Turqia do të shpëtohet dhe nëse është kështu do të ketë një këngë triumfi që duhet të dëgjohet nga çdo racë e krishterë në Botë, një Te Deum në të cilin të gjithë adhuruesit e civilizimit duhet të marrin pjesë. Për shekuj me radhë të krishterët në Perandorinë Osmane janë mbështetur nga shpresa, duke mbajtur besimin se megjithëse jeta ishte e gjatë dhe e lodhur, pushimi do të vinte: nata e errët e persekutimit do të kalonte dhe dita do të agonte.¹⁶⁴

William John Hamilton

Gjeologu anglez William John Hamilton udhëtoi në Anadoll midis viteve 1835 dhe 1842 përpara se të shkruante librin e tij *Hulumtime në Azinë e Vogël, Pontus dhe Armeni*. Libri studioi gjithçka brenda kufijve Otoman, nga gjeografia deri në histori, nga topografia te bimësia dhe gjeologjia nga një pikëpamje inteligjente. Hamilton gabimisht besonte se për shkak të fesë islame, arritjet e ardhshme të popullit turk do të kufizoheshin dhe nuk hezitoi të shfaqte neveritjen e tij ndaj Islamit në çdo mundësi.¹⁶⁵ Në të vërtetë, Hamilton ishte vetëm një spiun tjetër i Nëntokës Shtetërore Britanike i ngarkuar me detyrën për të studiuar Anadollin dhe për të siguruar raporte për eprorët e tij kundër turqve.

Stratford Canning

Stratford Canning kaloi një kohë të gjatë në Perandorinë Osmane si ambasador. Duke qenë spiun i Nëntokës Shtetërore Britanike, i aftë të ndikonte në politikat e jashtme osmane, ai u bë mik i ngushtë me anglofilin Mustafa Reşid Pasha dhe arriti të bëhej burrështetasi më i fuqishëm i huaj në Stamboll gjatë Epokës së Reformës. Kur shpërtheu konflikti Osman-Rus në vitin 1853, ai parandaloi paqen dhe kontribuoi në fillimin e Luftës së Krimesë.

Civinis Efendi ishte zyrtari kryesor i inteligjencës që raportonte te Canning. Lindur në ishullin e Mykonos, ai jetoi në Shën Petersburg dhe arriti të ishte në shërbim të Perandores Ruse. Pasi u martua me vajzën e një oficeri që punonte në pallat, ai vodhi disa prej bizhuterive të Perandores dhe u largua. Pasi kaloi kohën në Anadoll i maskuar si një hoxhë duke ligjëruar në xhami, Civinis Efendi më vonë u bë një italian i pasur, duke lundruar në detin Egje në jahtin e tij, me një emër të ri: 'Comte de Rivoroso'. Ky mjeshtër, me rrënjët e tij greke dhe me një frëngjishte, anglishte dhe rusishte të rrjedhshme, arriti të tërheqë shumë vëmendje dhe u takua me Vezirin e Madh Mustafa Reşid Pasha nga Canning. Veziri i madh e bëri kolonel dhe e bëri shef të njësisë së inteligjencës osmane. Duhet të theksohet se, në atë kohë, shërbimi inteligjent osman duhej të vepronte nën vëzhgimin e ngushtë të Nëntokës Shtetërore Britanike. Në një kohë të shkurtër, ai ngriti ekipin e tij dhe filloi të spiunonte jetën private të tregtarëve dhe pashallarëve të famshëm dhe i ktheu thashethemet që mblodhi në raporte. Me fjalë të tjera, një spiun i Nëntokës Shtetërore Britanike u bë kreu i njësisë së inteligjencës osmane, e cila u themelua nga vetë anëtarët e Nëntokës Shtetërore Britanike.¹⁶⁶

Një tjetër qytetar britanik, William Nosworthy Churchill, botoi gazetën e parë gjysmë-zyrtare në Perandorinë Osmane gjatë komisionit të Mbrojtjes. Kjo gazetë promovuese e tregut të lirë, e quajtur *Ceride-i Havadis (Gazeta e Lajmeve)*, mbronte politikat që synonin të vinin financat osmane nën kontrollin britanik.

Canning u bë anëtar i Këshillit Privat në vitin 1820, kur ishte vetëm 34 vjeç. Madje kishte bisedime për ta bërë atë Mbret Grek si një haraç për rolin aktiv që ai luajti gjatë kryengritjes Greke. Në Betejën e Navarinos, në të cilën flota osmane / egjiptiane u dogj, ai siguroi bashkëpunimin e marinës britanike dhe ruse. Para Luftës së Krimesë në vitin 1851, Canning i kishte bindur oficerët osmanë të refuzonin ofertën e paqes të Rusisë. Kryeministri britanik Gladstone ia kushtoi *Tmerret e tij Bullgare dhe Çështjen e Lindjes* Canning-ut, ku argumentoi se turqit duhej të dëboheshin nga Evropa.

Canning shkoi aq larg sa të thoshte se burimi i së keqes në Perandorinë Osmane ishte Islami (feja jonë e lartësuar është mbi pohime të tilla). Sipas Canning, Islami ishte baza e padrejtësisë dhe dobësisë dhe Perandorisë Osmane iu desh ta linte Islamit për t'u zhvilluar dhe prosperuar.

Richard Cobden

Burrështetasi anglez Richard Cobden pohoi se ishte e pamundur për Perandorinë Osmane të ruante pavarësinë e saj dhe integritetin territorial në një fjalim që mbajti në Dhomën e Komuneve pas një vizite në Turqi. Ai pretendoi se Britania do të ishte më mirë të kishte përfaqësues të krishterë të Perandorisë si aleatë të saj, sesa myslimanë, të cilët ai pretendonte se po shkonin drejt shkatërrimit:

... Muhamedanizmi (me siguri feja Islame dhe Profeti ynë i Dashur (p.q.m.t) janë mbi deklarata të tilla) nuk mund të mbahet, dhe mua duhet të më vijë keq që të i shoh këto vende duke luftuar për mirëmbajtjen e Muhamedanizmit ... Ju mund ta mbani Turqinë në harta e Evropës, ju mund ta quani shtetin Turqi nëse dëshironi, por mos mendoni se mund të mbani sundimin Muhomedian [Islam] në vend.¹⁶⁷

150 vite më vonë, në kundërshtim me pritjet e Cobden, Anadulli është shtëpia e miliona myslimanëve dhe numri vazhdon të rritet vazhdimisht. Thirrjet për lutje nuk kanë të ndalur dhe nuk do të ndalen kurrë. Myslmanët nxitojnë të mbushin xhamitë me gëzim dhe besim, duke shkatërruar ëndrrën më të madhe të Nëntokës Shtetërore Britanike, e cila ka qenë dhe gjithmonë do të jetë e pamundur të realizohet. Të gjitha përpjekjet e tanishme të Nëntokës Shtetërore Britanike për të arritur këtë qëllim do të kthehen në dështim dhe këto toka, ku Islami është ngulitur thellë, do të kurorëzohen me një Bashkim të madh e paqësor të Islamit..

Zoti e forcon të vërtetën me fjalën e Tij, edhe pse këtë e urrejnë keqëbërësit. (Kur'an, 10:82)

Ata dëshirojnë ta fikin dritën e Zotit me gojën e tyre, por Zoti e përsos dritën e Tij, edhe nëse këtë gjë e urrejnë pabesimtarët. (Kur'an, 61:8)

Winston Churchill

Winston Churchill, i cili shërbeu si Sekretar i Brendshëm, Lord i Parë i Admiralitetit, Sekretar i Shtetit për Luftën, Sekretar i Shtetit për Kolonitë, Kancelari i Thesarit dhe më në fund Kryeministri i Mbretërisë së Bashkuar, shprehu shumë fjalë nënçmuese, nëse jo ofendime të drejtëpërdrejta, në lidhje me fenë Islame dhe myslimanët. Shprehjet e tij janë domethënëse pasi ato tregojnë qartë qëndrimin anti-islam të Nëntokës Shtetërore Britanike dhe perspektivën e Churchill, i cili ishte një anëtar i shquar i kësaj strukture. Disa nga deklaratat e tij mund të gjenden më poshtë (feja jonë e lartësuar Islami dhe Profeti ynë i dashur (p.q.m.t) janë mbi të gjitha këto shprehje):

Fakti që në ligjin e Muhamedit çdo grua duhet t'i përkasë një burri si pronë e tij absolute, qoftë si fëmijë, grua apo konkubinë, vonon zhdukjen përfundimtare të skllavërisë derisa besimi Islam të pushojë së qenurit një fuqi e madhe midis burra.

Myslimanët individualisht mund të tregojnë cilësi të shkëlqyera, por ndikimi i fesë paralizon zhvillimin shoqëror të atyre që e ndjekin atë. Nuk ka fuqi më retroaktive në botë. Larg nga të qenit pranë zhdukjes, Muhamedanizmi është një besim luftarak dhe prozelizues. Ai tashmë është përhapur në të gjithë Afrikën Qendrore, duke ngritur luftëtarë të patrembur në çdo hap; dhe po të mos ishte se krishterimi është strehuar në krahët e fortë të shkencës, shkencës kundër së cilës kishte luftuar kot, civilizimi i Evropës moderne mund të binte, siç ra civilizimi i Romës antike.¹⁶⁸

Lord Cromer

Evelyn Baring, i njohur gjithashtu si Lord Cromer, veproi si Konsull i Përgjithshëm në Egjiptit e sunduar nga Britanikët midis viteve 1883 dhe 1907. Fjalët e tij të mëposhtme tregojnë qartë ëndrrat imperialiste britanike për të sunduar botën myslimane:

Veçanërisht, myslimanët e Indisë duhet të pranojnë që, me rënien e fuqisë turke në Evropë, një rend i ri i gjërave ka lindur, se ndryshimi që ka pësuar qëndrimi i Anglisë ndaj Turqisë është pasoja e domosdoshme e këtij kolapsi....¹⁶⁹

Opinionet e Lord Cromer mbi Islamin dhe Shoqëritë Myslimane

Lord Cromer ishte një shembull famëkeq i zyrtarëve të Nëntokës Shtetërore Britanike që e shndërruan botën në një koloni në shekullin e 19-të përmes metodave më barbare. Ai ishte një Darwinist arrogant me mendime raciste, duke pasur pikëpamje të sëmura siç ishte përfaqësuesi i një race të supozuar superiore. Le të lexojmë nga vetë Cromer për të kuptuar më mirë mentalitetin që kërkon të shkatërrojë botën myslimane.¹ (feja jonë e lartësuar Islame është mbi vërejtje të tilla):

Britania nuk do ta lejonte Egjiptin të qeverisej sipas fesë Islame

Është absurde të supozohet se Evropa do të shikojë si një spektator pasiv ndërsa qeveritë retrograde të bazuara në parime muhamediane dhe ide orientale të vendosen në Egjipt. Interesat materiale në fjalë janë shumë të rëndësishme... brezi i ri i Egjiptianëve duhet të bindet ose të detyrohet të përqafojë brezin e ri të civilizimit Perëndimor.

Mendimet e tij të vërteta për të drejtat e grave

Ndërsa Lord Cromer u përpoq të ju mbante ligjërata myslimanëve mbi të drejtat e grave, ai ishte anëtar dhe president i 'Lidhjes së Burrave të Mbretërisë së Bashkuar për Kundërshtimin e Zgjedhjeve të Grave' në fushatën

kundër dhënies së votës grave britanike. Përgjigja e përsosur për njerëzit e tillë, të cilët gabimisht e konsideronin veten të ishin në një pozicion për të ju mbajtur ligjërata myslimanëve, erdhi nga Mustafa Kemal Atatürk. Atatürku ju dha drejtën e votës grave në vitin 1934, shumë më parë se disa vende tjera evropiane.

Lordi Cromer shpjegoi se çfarë donte të thoshte me 'autonomi për Egjiptin':

Merrni parasysh se çfarë nënkuptohet përgjithësisht nga evropianët kur flasin për vetëqeverisjen egjiptiane. Nëse do të thoshin që egjiptianët duhet të lejohen të qeverisin vetë sipas traditave të tyre të vrazhda, detyra e edukimit të tyre në artin e vetëqeverisjes nuk do të kishte qenë thjesht e lehtë; nuk do të kishte pasur nevojë që ajo të ishte ndërmarrë. ... Çfarë nënkuptojnë evropianët kur flasin për vetëqeverisjen egjiptiane është që egjiptianët, larg nga të qenit të lejuar të ndjekin prirjen e tyre të përeformuara, duhet të lejohen të qeverisin vetë pas mënyrës në të cilën evropianët mendojnë se duhet të qeverisen.

Krijimi Britanik i një klase të re Elite të 'Myslimanëve' Sekularë për të qeverisur Egjiptin

E vërteta është se, duke kaluar nëpër mullirin arsimor Evropian, myslimani i ri egjiptian humbet islamizmin e tij

Por për sa kohë që shoqëria egjiptiane është në një gjendje fluksi, rezultati natyror ka qenë të prodhohet një klasë individësh, shumë prej të cilëve janë, në të njëjtën kohë, myslimanë të de-myslimanizuar dhe evropianë pakurrizor.

*Në trajtimin e çështjes së futjes së civilizimit evropian në Egjipt, nuk duhet harruar kurrë se Islami nuk mund të reformohet; që do të thotë, **Islami i reformuar nuk është Islami më; është diçka tjetër.***

Myslimanët të cilët marrin 'trajnim britanik' duke parë me lartësi Islamin dhe dijetarët islamikë

Fjala vjen, egjiptiani i evropianizuar në shumicën e rasteve është mysliman. Në realitet, ai është përgjithësisht agnostik. ... Një evropian i zhytur në mendime jo vetëm që do ta shikojë me interes "Alimin" si përfaqësuesin e një besimi të lashtë, i cili përmban shumë dhe që meriton shumë respekt; ai do të dojë, nëse "Alimi" është një shembull i denjë i klasës së tij, që ta simpatizojë atë sepse ai është fetar, megjithëse feja e tij nuk është ajo e Krishtit. Nga ana tjetër, egjiptiani i evropianizuar, shpesh do ta shikojë "Alimin" me gjithë krenarinë e një përfituesi intelektual. Nga piedestali i njohurive të tij empirike, ai do ta konsiderojë "Alimin" si një të braktisur shoqëror, i cili duhet të tolerohet, madje edhe herë pas here, për qëllime politike, për t'u përdorur, por që nuk duhet të respektohet.

'Myslimanët' e rijnë jotolerantë ndaj të krishterëve

Megjithëse Egjiptiani i Evropianizuar nuk është një Mysliman i vërtetë, ai shpesh është aq jotolerant, dhe nganjëherë edhe më jotolerant ndaj krishterimit sesa myslimani i vjetër tradicional, i cili nuk ka marrë asnjë arsimim evropian. Ai shpesh i urren të krishterët me një urrejtje të hidhur, dhe e bën këtë pjesërisht sepse shumë prej të krishterëve me të cilët ai është vënë në kontakt meritojnë të urrehen, dhe pjesërisht sepse i krishteri, në aftësinë e tij për të qenë evropian, është një rival i cili zë pozicione, të cilat Egjiptiani i Evropianizuar mendon se duhet të zërë ai vetë.

1. Abdullah Al Andalusi, "Lord Cromer on the British Colonial Project for Egypt", 23 December 2013, <https://abdullahandalusi.com/2013/12/23/a-brief-word-by-lord-cromer-on-the-british-colonial-project-for-egypt/>

Mësime të rëndësishme në histori

Në mesin e pasuesve të Librit ka të tillë të cilët e besojnë Zotin dhe atë që ju është shpallur juve dhe çfarë u është shpallur atyre, dhe që janë të përlulur para Zotit. Ata nuk i shesin ajetet e Zotit për fitim të pakët. Njerëzit e tillë do ta kenë shpërblimin e tyre te Zoti i tyre. Vërtetë Zoti është i shpejtë bë llogarit. (Kur'an, 3:199)

Fjalimi i Mesrobit të II-të Mutafyanit të Konstandinopojës, Patriarku i 84-të i Armenëve të Turqisë

Mesrobi i II-të Mutafyani, Patriarku i 84-të i Armenëve të Turqisë shprehu ndjenjat e tij gjatë një fjalimi të mbajtur në organizimin e mbajtur në Hotel Hilton më 22 maj të vitit 1999:

... Në vitin 1461, vetëm tetë vite pasi Sulltan Mehmed i njohur si 'Pushtuesi' mori Stambollin, ai lëshoi një dekret dhe themeloi Patriarkanën e Stambollit. Ky ishte një tregues i qartë se sa vizionarë ishin Sulltan Mehmedit i II-të dhe Sulltanët e tjerë Osmanë dhe qëndrimi i tyre për qafues ndaj besimeve të tjera. Në të vërtetë, Sulltan Mehmedi i II-të ishte sunduesi i parë dhe i fundit në histori që krijoi një institut udhëheqës shpirtëror për anëtarët e një feje tjetër... Ndërsa hyjmë në mijëvjeçarin e ri me të gjitha luftërat dhe konfliktet që ndodhin në të gjithë botën, ne mund ta vlerësojmë më mirë rëndësinë të këtij incidenti që ndodhi 538 vite më parë dhe ta kuptojmë më mirë rëndësinë e dashurisë dhe respektit për besime dhe kultura të ndryshme.

Shkrimet e Mateos të Edessa [Urfa]

Historiani i njohur armenë nga Urfa, Mateos përshkroi qasjen selxhuke ndaj armenëve: 'Zemra e Malik-Shahut ishte plot dhembshuri dhe mirësi për të krishterët. Ai i trajtoi fëmijët e Jezuit me shumë dashamirësi. Ai solli paqe, pasuri dhe lumturi në popullin armen.'

Mateos gjithashtu shkroi si në vijim pas vdekjes së Sulltan Kilij Arslanit:

Vdekja e Kilij Arslanit i trishtoi thellë të krishterët. Ky Sulltan kishte një karakter fisnik dhe donte të ndihmonte.¹

Këta shembuj tregojnë qartë atmosferën paqësore që armenët gëzonin për shekuj duke jetuar në harmoni me turqit.

'Territori Armen' si mjet propagandues

Çështja armene, e cila përdoret edhe sot nga Nëntoka Shtetërore Britanike si mjet propagandues, bazohet në pretendimet se Anadollit Lindor ka qenë gjithmonë territor që u përkiste vetëm armenëve. Para se të sqarojmë se pse ky pretendim është i pabazë, duhet të theksojmë se shteti modern i Armenisë me kufijtë e tij aktual është shtet fqinj dhe mik i Turqisë dhe qytetarët e tij kanë qenë vëllezër dhe motra të popullit turk për gati 1.000 vite. Turqia respekton ekzistencën, kufijtë dhe të drejtat ndërkombëtare të Armenisë, siç bënë njësojë me fqinjët e tjerë. Më e rëndësishmja është se Turqia dëshiron që të gjitha këto vende të jenë të qëndrueshme dhe të forta.

Sidoqoftë, pretendimet e mësipërme të bëra nga qarqe të caktuara se rajoni i Anadollit Lindor të Turqisë është vetëm i armenëve bie në kundërshtim me faktet historike.

Sipas pretendimeve nga Nëntoka Shtetërore Britanike, turqit kanë qenë forcë okupuese në tokat armene duke filluar me selxhukët dhe më pas me osmanët, dhe madje i përsekutuan ata. Këto pretendime sugjerojnë se e ashtuquajtura shtypje vazhdon edhe sot. Sidoqoftë, një shqyrtim i afërt i historisë së përbashkët turko-armene do të zbulojë natyrën e pabazë të këtyre akuzave. Duhet gjithashtu të theksohet se armenët nuk kishin pretendime të tilla deri në Luftën e Parë Botërore, kur Nëntoka Shtetërore Britanike filloi propagandën e saj për këtë çështje.

Së pari, pretendimi se rajoni i Anadollit Lindor të Turqisë është ekskluzivisht tokë armene nuk pasqyron fakte historike. Rajoni në fjalë, ku armenët dikur jetonin në grupe të mëdha, ishte një provincë perse nga viti 521 deri në vitin 344 pes, para se të bëhej pjesë e Perandorisë Maqedonase nga viti 344 deri në vitin 215 para Krishtit dhe më pas një pjesë e Perandorisë Seleukide. Më vonë u transferua disa here midis Perandorisë së Romës dhe Perandorisë Parthiane, pastaj u bë provincë Sasanide dhe më në fund tokë Bizantine. Pas shekullit të 7-të, rajoni u kontrollua nga Kalifati Umajjad, i ndjekur nga sundimi Abasid që vazhdoi deri në fund të shekullit të 10-të, kur Perandoria Bizantine rimori tokat. Pas shekullit të 10-të, turqit mbërritën në këtë rajon.

Armenët janë popull i lashtë, i civilizuar i cili ka ekzistuar në atë rajon që nga antikiteti. Përgjatë historisë, ata ose jetuan nën sundimin e kombeve të tjerë të ndryshëm ose shtetet e tyre kanë vepruar si një zonë tranzite midis perandorive të mëdha të kohës dhe iu nënshtuan ndërhyrjeve të shpeshta. Armenët me siguri do të vazhdojnë të jetojnë në Anadollin Lindor, i cili do të jetë gjithmonë shtëpia e tyre. Mirëpo siç tregojnë në mënyrë të padiskutueshme të dhënat historike, do të ishte e pasaktë të pohojmë se Anatolia Lindore është një rajon ekskluzivisht armenë ku nuk ka jetuar asnjë popull tjetër.

Historiani armen Kevork Aslan e shpejgon këtë të vërtetë me fjalët vijuese:

Armenët jetonin si shtete feudale. Ata nuk kanë një lidhje të bazuar në ndjenjën e një toke të përbashkët. Poashtu nuk kanë as lidhje politike. Ata u përgjigjen vetëm shteteve feudale ku ata banojnë, dhe për këtë arsye ndjenjat e tyre të patriotizmit janë rajonale. Lidhjet e tyre nuk janë të bazuara në politikë, por më shumë janë për shkak të fesë dhe gjuhës së tyre të përbashkët.²¹⁷

□□□□□□□□□□□□□□□□

Adnan Oktar: Le ta rindërtojmë vëllazërinë tonë me armenët. Le të hapim kufijtë me Armeninë, të përqafojmë njëri-tjetrin. Ata ishin një nga ne, vëllezërit tanë në epokën Osmane. Është përsëri njësoj; asgjë nuk ka ndryshuar. Ata janë 'njerëzit besnikë'. Ata janë njerëz të mirë, të sjellshëm. [Çdo gjë që është në të kundërt] është e gabuar; është mëkat. Ne nuk do të lejojmë askënd të vendosë një pykë midis nesh.

(Excerpt from Mr. Adnan Oktar's interview on A9 TV on December 18, 2011)

Adnan Oktar: Ata [zyrtarët e dy vendeve] kanë arritur një marrëveshje për vizat dhe pas një kohe, nuk do të ketë më nevojë për pasaporta. Ata po diskutojnë detajet përfundimtare. Por sigurisht, është e rëndësishme të shmangni një gjuhë që mund t'i turpërojë ata [armenët]. Ata janë njerëz të mirë që presin dhembshuri dhe dashuri. Ata duan që kohërat e vjetra të cilat ishin shumë të mira të kthehen. Armenët janë 'populli besnik', 'milet-i sadika'. Ne u besuam ushtarëve tanë pashallarët armenë dhe u dhamë atyre pozicione kryesore në administratat tona. Është e rëndësishme të kemi një qasje të dhembshur. Krahasimi i kockave, numërimi i kockave dhe kafkave, na shpie në situatë të rrezikshme. Është pozitive që pasi tërhiqem vërejtjen se sa e gabuar është kjo qasje edhe ata e ndaluan këtë qëndrim. Duke falënderuar Zotin, është arritur ky hap i mirë. Ne duhet të përqendrohemi vetëm te dashuria. Unë thashë që ata do të tërhiqeshin nga Nago-Karabaku dhe vërtet po e bëjnë atë. Unë gjithashtu thashë që 'Insha'Allah ata do të hapin korridorin Lachin' dhe me të vërtetë po hapet tani. Ai do të sigurojë lidhje midis Turqisë dhe Azerbajxhanit. Për shembull, kur Presidenti ynë shkoi në Armeni, atë ditë, ata shuan zjarrin e përjetshëm në memorial. Kështu që ata po mendojnë për këtë, ata e dinë dhe besoj se do të bëjnë gjithçka që është e nevojshme. Ata duan vetëm dashuri dhe dhembshuri të sinqertë. Është thelbësore që të shmangen deklaratat e ashpëra dhe akuzuese. Personalisht, kur jam dëshmitar i një gjuhe të tillë, unë vihem në siklet. Ata janë njerëz të bllokuar në një vend shumë të vogël. Sigurisht, ne do t'i shpëtojmë ata. Me lejen e Zotit, bashkimi ynë i bazuar në dashuri të sinqert do të përfshijë Izraelin, Kinën, Azerbajxhanin, Turkistanin, Kazakistanin, Libinë, Marokun, Tunizinë dhe Algjerinë.

(Pjesë nga konferenca për shtyp e Z. Adnan Oktar më 17 shtator 2009)

Nëntoka Shtetërore Britanike fillon të manipuloj disa armenë

Një shqyrtim i thellë i politikës britanike për pjesën e Lindjes në gjysmën e dytë të shekullit të 19-të do të zbulojë lidhjet e ngushta që Britania i ndërtoi me njerëzit autoktonë. Është e qartë se këto lidhje nuk u ndërtuan për të ndihmuar këta njerëz, por përkundrazi për t'u siguruar që ata mund të manipulohen për t'i shërbyer politikave britanike në mënyrat më "efikase". Qindra britanikë u dërguan në rajon për këtë qëllim dhe kryen aktivitete të maskuar si 'arkeologë, studiues fetarë, historianë ose mësues'. Disa mbollën dhe ushqyen mendime përçarëse në shoqëri, ndërsa të tjerët provokuan figurat kryesore të komuniteteve kundër administratës qendrore. Armenët, të cilët janë një nga bashkësitë më të lashta të Anadollit, u bënë një shënjestër kryesore e spiunëve të shumtë të dërguar në këtë rajon nga Britania në atë kohë.

Traktati i Berlinit, i nënshkruar më 13 korrik të vitit 1878 nën presionin e britanikëve, i detyroi osmanët të futnin reforma në Rumelia (tokat osmane në Evropë) dhe rajonet ku jetonin armenët. Këto reforma, të cilat në sipërfaqe po i sillnin të drejta dhe liri shtesë njerëzve të rajonit, në të vërtetë shënuan fillimin e kontrollit të Nëntokës Shtetërore Britanike mbi armenët, një komuniteti të përbërë nga krishterët ortodoks. Sidoqoftë, nuk ishte një detyrë e lehtë për të bindur armenët ortodoksë të lidhnin aleancë me britanikët protestantë. Në të vërtetë, konvertimi në fjalë zgjati shumë vite, u angazhuan shumë spiunë britanikë, misionarë sektarë dhe u ushqye propagandë intensive përmes mediave perëndimore.

Emilius Clayton, i cili ishte në atë kohë shërbente si Nënkonsull Britanik në Van, dërgoi një raport në Londër më 29 nëntor të vitit 1879 që argumentonte se shteti armen ose nuk duhej themeluar fare, ose nëse do të vendosej, kontrolli rus mbi atë territory nuk duhet të lejohet. Nënkonsulli besonte se Perandoria Osmane do të shembet dhe kështu që reformat duhet të drejtohen për të lejuar krijimin e një shteti armen të kontrolluar nga britanikët. Ai shkroi, *'Armenët së pari do të përparonin dhe do të forcoheshin si një protektorat britanik ose evropian dhe do të bëheshin gati politikisht. Pastaj, armenët në rajone të tjera do të transferoheshin në Anadollin Lindor për të rritur popullsinë armene. Sidoqoftë, pa marrë parasysh madhësinë e migracionit, ata gjithmonë do të mbeten një pakicë. Pra, si një hap dytësor, popullsia turke do të dëbohej gradualisht nga Anadollin Lindor. Vetëm kurdët dhe asirianët duhet të mbeten. Asirianët do të linin mënjandryshimet e tyre sektare me Armenët dhe do të përziheshin me ta. Nga ana tjetër, kurdët 'nën kërcënimin e armëve' dhe do të detyroheshin të jetonin së bashku me armenët. E gjithë kjo do të ndërmerrej nën sundimin osman, si pjesë e zbatimit të reformave. Dhe kur të vijë koha dhe Perandoria Osmane të shembet, për armenët do të themelohej*

*një shtet i pavarur. Por meqenëse ky shtet i improvizuar nuk mund të mbijetojë më vete, ai do të duhej të jetonte nën 'mbikqyrjen britanike'.*²¹⁸

Plani dukej se po funksiononte. Me pretendimin për mbikëqyrjen e zbatimit të të drejtave të krishterëve, Britania dërgoi disa konsuj në provinca të ndryshme osmane. Zakonisht u përzgjedhën ushtarë të rangut të lartë, të maskuar si konsuj kryenin punë jashtë kufijve të detyrave të tyre dhe merreshin me detyra tjera në rajon. Për më tepër me informacion të rremë, ata provokuan, organizuan dhe armatosën qytetarët armenë, para se t'i nxitnin një pjesë të tyre që të rebeloheshin.

Në fillim kishte çështje serioze të besimit dhe komunikimit midis konsujve britanikë dhe komunitetit armen për shkak të dallimeve sektare. Në mënyrë që konsujt / spiunët e përmendur të fitonin mbi armenët, armenët së pari duhej të bëheshin protestantë. Për këtë qëllim, disa misionarë amerikanë u dërguan në rajon, kryesisht në Mardin. Këto përpjekje zemëruan vendorët dhe Kishat Ortodokse Lindore. Nga ana tjetër, konsujt britanikë u ofruan mbrojtje të dy këtyre misionarëve dhe të konvertuarve të rinj protestantë. Siç dihet tashmë, kjo mbrojtje nuk u ofrua për respekt të besimit të tyre, por për shkak të qëllimeve strategjike në lidhje me rajonin.

Kjo sigurisht nuk ishte hera e parë që kjo strategji zbatohet në tokat osmane. Ahmed Hamdi, oficeri i atëhershëm i rrethit Tekirdağ, bëri paralajmërimin vijues për rrezikun e afërt:

*Komuniteti protestant në Tekirdağ deklaroi se ata ishin të mbrojtur britanikë. Konsulli Britanik, ndërkohë, vazhdon të përzihet në gjithçka, pretendon se protestantët janë nën mbrojtjen e vendit të tij dhe dëshiron t'i ketë ata nën kontrollin e tij. Meqenëse qëndrimi i tij po shkakton probleme dhe konfuzion në qytet, mund të thuhet se nëse nuk merret një masë paraprake, bashkësia armene do të vijë nën sundimin britanik pasi të konvertohet në protestantizëm. Meqenëse dëshira e Konsullit është ta bëjë bashkësinë armene besnike ndaj vetvetes dhe meqenëse një zhvillim i tillë do të jetë i dëmshëm për vendin tonë në çdo mënyrë, ne kemi shumë nevojë për udhëzimet urgjente të Kryeministrit se si duhet të veprojmë në lidhje me këtë çështje. Ju lutemi na këshilloni me mirësi se si të veprojmë në lidhje me komunitetin protestant.*²¹⁹ (21 gusht 1858, oficer i rrethit Tekirdağ, Ahmed Hamdi)

Baza e Nëntokës Shtetërore Britanike për trazirat armene: Qipro

Para Traktatit të fshehtë të Qipros të vitit 1878, i cili gjoja transferoi përkohësisht sundimin e Qipros te Britanikët, 45,000 myslimanë dhe rreth 100,000 jomyslimanë po jetonin në ishull. Armenët, grekët, hebrejtë dhe një numër i vogël i nazarenasve përbënin popullsinë jomyslimane. Disa individë britanikë, kinse misionarë, punuan në mënyrë aktive në ishull për të ndikuar në këtë popullsi të krishterë. Kur britanikët arritën të merrnin kontrollin e ishullit, ata hapën një shkollë për armenët që të përfitonin nga ta. Ky akt shënoi hapin e parë drejt ambicies së Nëntokës Shtetërore Britanike për të përdorur Qipron si bazë për çështjen armene. Aq më tepër, lëvizjet e rezistencës Dashnak dhe Hunchak - që ishin aktive pas shumë trazirave - u organizuan në Qipro. Shoqëria për Miqtë e Armenisë dhe Komiteti i Fondacionit Armen për Refugjatët ishin me qendër në Qipro, ndërsa grupe të caktuara armene të Anadollit që u bashkuan në trazira po drejtoheshin dhe menaxhoheshin gjithnjë e më shumë nga Qiproja. Sivasliyan, i cili ishte kreu i Partisë Revolucionare Hunchak me seli në Britani dhe një avokat i vendosur në Famagusta, po nxitnin Armenët e ishullit kundër Perandorisë Osmane dhe u përpoqën t'i nxisnin të merrnin pjesë në trazirat tjera.

Qiproja nuk ishte vetëm një qendër kulturore dhe shoqërore e përdorur për të nxitur grupe të caktuara armene; ishte gjithashtu një qendër e rëndësishme logjistike për të organizuar kryengritjet. Armenët osmanë dhe armenët evropianë që mbështetën trazirat po komunikonin përmes Qipros. Në mënyrë të ngjashme, armenët të cilët ishin pro trazirave që ikën jashtë ose që planifikuan të ktheheshin në Anadoll mund ta bënin këtë fshehurazi përmes Qipros. Pasi morën pjesë në trazirat në Alepo, Dijarbakir, Bitlis, Hakkari dhe Van, rebelët armenë do të hipnin në anije në Iskenderun dhe Mersin dhe do të lundronin për në Qipro. Ata ndryshuan lehtësisht identitetet, duke përfituar nga sundimi britanik dhe më pas u larguan për në Evropë ose SHBA.

Armët e blera nga grupe të caktuara armene në Evropë u dërguan gjithashtu kryengritësve armenë përmes Qipros. I gjithë operacioni ishte organizuar, kontrolluar dhe udhëhequr nga Nëntoka Shtetërore Britanike. Qipro nuk ishte vetëm afër Anadollit; ishte gjithashtu një kërcënim për qytete të ndryshme osmane në Sirinë moderne dhe kufijtë e Libanit, për shkak të pranisë së disa rebelëve armenë, të cilët përdorën këtë ishullin për strehim. Sidoqoftë, Osmanëve u mungonte infrastruktura e nevojshme për të parandaluar këtë qarkullim apo edhe për të monitoruar zhvillimet.

Le të vëmë re edhe një herë që njerëzit e përmendur këtu ishin kryengritës armenë që po vepronin nën kontrollin e Nëntokës Shtetërore Britanike. Është e vërtetë që disa nga qytetarët tanë armenë u ndikuan nga Nëntoka Shtetërore Britanike dhe zgjodhën një rrugë të gabuar. Sidoqoftë, shumica e qytetarëve tanë armenë në atë kohë i qëndruan besnikë vendit të tyre, Perandorisë Osmane, dhe nuk pranuan të binin në gënjeshttrat e Nëntokës Shtetërore Britanik. Këta njerëz të denjë vazhduan të jetojnë në Turqi në paqe dhe siguri pas themelimit të Republikës së Turqisë dhe janë akoma një pjesë e vlefshme e vendit tonë.

Trazirat rajonale para Luftës së Parë Botërore

Mbrojtja e interesave të Nëntokës Shtetërore Britanike në Anadollin Lindor varet nga një strategji e mobilizimit të disa grupeve nga komuniteti armene kundër osmanëve. Ky është një fakt i konfirmuar sot tashmë nga shumë historianë perëndimorë dhe armenë. Fillimisht, përpjekjet e Nëntokës Shtetërore Britanike dështuan sepse armenët nuk kishin asnjë ankesë për administratën osmane, pasi ata kishin jetuar për shekuj në paqe. Prandaj, shumë organizata të krijuara për të provokuar kriza dështuan dhe u zhdukën me kohë. Ato u bënë aktive dhe korrën sukses në vende të tjera jashta Perandorisë Osmane.

Louise Nalbandian, një udhëheqës modern i propagandës për çështjen armene, përshkroi qëllimin e grupeve të tilla rebele me fjalët vijuese: "*Nevojiteshin agjitacion dhe terror për të 'ngritur shpirtin e popullit (armen)' ... Njerëzit duhej gjithashtu të nxiteshin kundër armiqve të tyre dhe duhej të 'përfitonin' nga veprimet hakmarrëse të po këtyre armiqve ... Partia synonte sulmet terroriste ndaj qeverisë osmane...*"²²⁰ Me fjalë të tjera, një grup armenësh që Nëntoka Shtetërore Britanike nixti për fillimin e trazirave në Anadoll zgjodhën 'terrorin' si metodën e tyre. Në të vërtetë, pas krijimit të grupeve të tilla rebele, trazirat shpërthyen në të gjithë Anadollin dhe si pasojë shumë njerëz të pafajshëm vendas - turq, kurdë, asirianë dhe armenë - humbën jetën ndërsa Anadollit humbi paqen shekullore.

Armenët ishin një popull i lirë që kryesisht merreshin me arte dhe tregti nën sundimin osman. Ata gëzonin liri të plotë fetare, kishin kishat e tyre, adhuronin ashtu siç dëshironin dhe kishin manastiret e tyre ku trajnonin klerikët e tyre. Ata ishin të liruar nga shërbimi ushtarak. Me fjalë të tjera, Perandoria Osmane u kishte siguruar atyre për shekuj me radhë paqe dhe siguri të paparë. Sidoqoftë, ndërsa Perandoria Osmane hyri në periudhën e saj të rënies, një rol u nda gjithashtu për ta nga Nëntoka Shtetërore Britanike. Disa grupe nga komuniteti armenë supozohej të rebeloheshin kundër Perandorisë Osmane. Nëntoka Shtetërore Britanike e dinte mirë se populli armenë nuk kishte ndërmend të rebelohej dhe kështu duhej të gjente një mënyrë për t'i provokuar ata.

George H. Hepworth, një gazetar Amerikan që udhëtoi në Anadollin Lindor, kujton në ditarin e tij atë që i thanë armenët:

*Ah, ne ishim një popull i lumtur dikur. Ne ... kishim fitime të mëdha nga biznesi, ishim të kënaqur dhe të begatuar. Por Traktati i Berlinit! Dhe ndërhyrja e Anglisë! Nëse Evropa na lenë të qetë, ne ende mund të kemi një të ardhme...*²²¹

Ndërsa Perandoria filloi të humbte forcën, atmosfera paqësore filloi të prishej dhe la në vend të saj një mjedis armiqësie dhe trazirash të ushqyera nga Nëntoka Shtetërore Britanike. Armenët, të cilët nuk janë prekur kurrë nga lëvizjet rebele dhe nacionaliste deri në atë moment, u provokuan nga Nëntoka Shtetërore Britanike, e cila futi në lojë besimin dhe etnitetin e tyre. Në mënyrë që të provokonte bashkësinë e krishterë armene kundër myslimanëve, Nëntoka Shtetërore Britanike filloi të përhapte propagandën se armenët po shtypeshin dhe se trazirat e tyre do të ishin ngritja e të ashtuquajturit 'popull i dërrmuar'. Përplasjet dhe gjakderdhjet do të vinin natyrshëm si pjesë e këtij plani tinëzar.

Gjenerali Mayewski, Konsulli i Përgjithshëm i Rusisë në Van dhe Bitlis, kujton kryengritjen dhe provokimin e paturpshëm nga Nëntoka Shtetërore Britanike:

Evropa duhej të shihte që të krishterët e Turqisë - kësaj here armenët - po shtypeshin dhe tiranizoheshin nga turqit. Kjo është ajo që ndodhi me Serbinë dhe Bullgarinë më parë dhe plani ishte që të përdoren armenët në të njëjtën mënyrë... Propaganda ishte e tillë: 'Vetëm me gjak, armenët mund të jenë të lirë. Derdh gjak, Evropa do të të mbrojë ty'. Ata ishin të bindur se duhej të derdhej gjak. Ata ishin pozitivë që sapo të derdhej gjaku armen, Evropa do të nxitonte për të mbrojtur armenët. Nëse nuk do të kishte qenë kështu, nuk do të kishte pasur kaq shumë dhunë. Nëse dëshira për autonomi nuk do të ishte e fortë, a do të flijoheshin mijëra jetë me urdhër të Londrës?'²²²

Politika përçarëse e Nëntokës Shtetërore Britanike u bë më e qartë dhe më e dukshme me kalimin e kohës. Kryeministri britanik Gladstone, i cili mori detyrën në vitin 1880, deklaroi se "t'i shërbesh armenëve do të thotë t'i shërbesh civilizimit" dhe la të kuptohej për politikën e Nëntokës Shtetërore Britanike kur ai deklaroi se armenëve duhet t'u jepej pavarësia që Lindja të përparonte dhe të arrinte ndriçimin. Nuk duhet të na habis fakti se qeveria Gladstone mblodhi armenët së bashku, i ndihmoi ata të organizoheshin dhe i nxiti duke premtuar mbështetje britanike për shtetin e tyre të ri.²²³ Sidoqoftë, shqetësimi i tyre nuk ishte as mbrojtja e armenëve dhe as sjellja e "ndriçimit" në Lindje. Qëllimi i vërtetë ishte ndarja e Lindjes së Mesme në pjesë më të vogla, duke shpresuar se atëherë do të ishte më e lehtë për t'u kontrolluar.

Historiani Süleyman Kocabaş e përshkroi këtë fakt të njohur me fjalët vijuese:

Dhuna armene shpërtheu në Anadollin Lindor. Sipas dëshmimeve të dëshmitarëve të huaj, rebelët armenë po komunikonin fshehurazi me konsujt britanikë në rajon. Gjenerali Mayewski, i cili ishte Konsull i Rusisë në Van, shkroi për këtë fakt. Gazetari amerikan George H. Hepworth, i cili udhëtoi në Anadollin Lindor në vitin 1896, që shënoi kulmin e trazirave armene, gjithashtu përmendet në lidhjet e tij britanike-armene. Ai shkruan se arsyeja kryesore prapa konfrontimeve të përgjakshme midis myslimanëve dhe armenëve në rajon kishin qenë rebelët armenë që erdhën nga vendet e tjera dhe thotë: "Në ndërkohë, revolucionarët po bëjnë çfarë të munden për të bërë të krijuar kriza të reja. Ata arsyetojnë se nëse ata mund të nxisin turqit të vrasin më shumë armenë, Evropa do të detyrohet të ndërhyjë, dhe atëherë mbretëria armene do të rivendoset... Anglia i ka lavdëruar ata, i ka nxitur ata të bëjnë përpjekje të reja. Ata përvidhen nën hijen e natës, nxisin fshatarë, duke deklaruar se nëse njerëzit përfshihen në një revoltë të hapur, Fuqitë do të jenë aty për të ju ndihmuar."²²⁴

Në të vërtetë, rebelët armenë organizuan një tubim të madh në vitin 1896 në Liverpool, ku Gladstone mbajti një fjalim tjetër të zjarrtë duke i nxitur Armenët për kryengritje.²²⁵

Sipas William L. Langer, i cili ishte ish-kryetar i departamentit të historisë në Universitetin e Harvardit, "Anglia është më përgjegjëse për vrasjet [në Turqi] që janë afruar shfarosjes së Armenëve sesa të gjitha kombet e tjera të bëra bashk".²²⁶

Trazirat armene të menaxhuara dhe mbikëqyrura nga konsujt britanikë në Anadoll arritën kulmin e tyre në korrik dhe gusht të vitit 1895. Trazirat armene që shpërthyen në vitin 1895 ishin si më poshtë: 29 shtator në Divriği, 2 tetor në Trabzon, 6 tetor në Egin, 7 tetor në Develi, 9 tetor në Akhisar, 21 tetor në Erzincan, 25 tetor në Gümüşhane, 25 tetor në Bitlis, 26 tetor në Bayburt, 27 tetor në Maraş, 29 tetor në Urfa, 30 tetor në Erzurum, 2 nëntor në Diyarbakir, 2 nëntor në Siverek, 4 nëntor në Malatya, 7 nëntor në Harput, 9 nëntor në Arapgir, 15 nëntor në Sivas, 15 nëntor në Merzifon, 16 nëntor në Antep, 18 nëntor në Maraş, 22 nëntor në Muş, 3 dhjetor në Kayseri dhe 3 dhjetor në Yozgat.

Ndikimi i të ashtuquajturëve Misionarë në komunitetin armen

Konsujt britanikë vazhdimisht u tregonin të pavërteta qytetarëve tanë armenë për administratën osmane dhe i portretizonin britanikët si shpëtimtarët e tyre. Për këtë qëllim, vizitonin fshatrat armene dhe përhapnin propagandën e tyre. Një telegram i dërguar nga provinca e Adanës, Ministrin të Punëve të Brendshme përshkruan shumë qartë aktivitetet e tilla separatiste të konsujve britanik:

Kapiten Cooper, ZëvendësKonsull i Britanisë në Adana, ishte ngarkuar me mbikëqyrjen e qytetarëve Britanikë sipas urdhëresës perandorake të lëshuar nga Shteti Britanik. Sidoqoftë që nga dita e parë që ai mbërriti këtu, ai po portretizon veten si një mbrojtës i të shtypurëve. Ai u ka kërkuar njerëzve të cilët kanë humbur në gjykata të shkojnë tek ai, pranon peticionet dhe sugjerimet e tregtarëve dhe ankuesve, duke premtuar t'i ndihmojë ata. Ai më pas shkon dhe pyet prokurorët për vendimet e tyre dhe kërkon llogari duke pyetur se pse gjykata e mori këtë vendim, shpif për Perandorinë Osmane para ankuesve dhe përpiqet të fitojë zemrat e tyre duke lavdëruar drejtësinë në shtetin Britanik. Veprimet e tij kanë kaluar kufijtë e normales. Këtu kanë filluar thashethemet se ky vend do t'u lihet britanikëve ashtu si Qipro e cila ju është dorëzuar atyre dhe kjo është arsyeja pse konsulli erdhi në radhë të parë, dhe se Kozan, Zeytun, Dërsimi dhe Van do t'i besoheshin administrimit autonom të një guvernatori armen që do të quhej Armeni si në Bullgari. Nuk ka nevojë të shpjegohet se sa i rrezikshëm është ky zhvillim për pavarësinë dhe juridiksionin e Perandorisë Osmane dhe si do të dëmtojë rendin dhe sigurinë e vendit. Nëse situata vazhdon, opinionet e qytetarëve do të ndryshojnë plotësisht dhe gjërat do të bëhen edhe më të rrezikshme. Të mos kem ndonjë udhëzim se si duhet të veprojmë në lidhje me këto zhvillime më lënë në një gjendje konfuzioni pasi dëshira ime për të mbrojtur dinjitetin e qeverisë më kërkojnë të ndërmarr masa. Ju lutemi më dërgoni udhëzime më të hollësishme për atë se se çfarë duhet të bëhet. ²²⁷ (15 dhjetor 1879).

Pas një kohe, aktivitetet e përmendura në telegramin e mësipërm filluan ti përfshijnë disa armenë. Ndërsa shumë nga qytetarët tanë armenë i qëndruan besnikë shtetit, disa prej tyre - megjithëse të paktë - u ndikuan nga Nëntoka Shtetërore Britanike. Për planin e saj për të shkatërruar Perandorinë Osmane, Nëntoka Shtetërore Britanike kërkonte inteligjencë nga Anadulli. Këta rebelë armenë që punonin nën kontrollin e Nëntokës Shtetërore Britanike vepruan si dega e pestë e operacioneve të inteligjencës britanike midis viteve 1890 dhe 1922. Gjatë fushatës së Galipolit, si dhe incidenteve armene në Adana dhe trazirave të vitit 1915, inteligjenca britanike dhe grupet rebele armene punuan ngushtë së bashku, sepse ata rebelë armenë, që kishin jetuar në Anadoll që një kohë shumë të gjatë, ishin aq të njoftuar për Anadollin sa edhe Turqit. Me fjalë të tjera, kryengritja armene i siguroi inteligjencën e nevojshme Nëntokës Shtetërore Britanike për luftën e saj të plotë ndaj Perandorisë Osmane. Ky shfrytëzim dhe rekrutim i disa armenëve që Nëntoka Shtetërore Britanike arriti të përgadiste nuk ishte asgjë tjetër përveç zbatimit të një plani që ishte zhvilluar me hollësi gjatë një periudhe prej gati 100 vite.

Kampanja përçmuese nga mediat Britanike

Faza e parë në problemin e prodhuar artificialisht midis turqve dhe armenëve, të cilët kishin jetuar vëllazërisht së bashku për shekuj, ishte provokimi i komunitetit armene kundër Perandorisë Osmane. Gjatë Kongresit të Berlinit të vitit 1878, palët diskutuan për mbrojtjen e Armenëve si levë kundër Ruisë dhe Lord Salisbury propozoi sigurimin e të drejtave të Armenëve dhe një përmirësim urgjent të situatës së tyre. Këto sugjerime u bënë klauzola e 61-të e Traktatit të Berlinit. Natyrisht se përmirësimi i jetesës së të gjitha komuniteteve, jo vetëm i armenëve, është dhe duhet të jetë dëshira dhe ambicia e çdo personi të ndërgjegjshëm. Mirëpo Nëntoka Shtetërore Britanike nuk shqetësohet për mirëqenien e armenëve ose të ndonjë populli tjetër. Ajo shqetësohet vetëm për interesat e saja.

Në të njëjtën kohë, përpjekjet e lobimit u shpejtuan në Britani dhe shkrimtarët armenë u inkurajuan të shkruanin kundër osmanëve dhe të bashkoheshin në propagandën anti-osmane.

Për shembull, një armen me emrin Agopyan, duke vepruar sipas udhëzimeve të Lord Salisbury, filloi të botonte një gazetë në Londër të quajtur *Haiasdan*, ndërsa gazetat e famshme si *e Vërteta*, e cila ishte në pronësi të Henry Labouchère,

filluan të përhapnin lajmin e rremë se Armenët ishin të shtypur nga Osmanët për shkak të identitetit të tyre të krishterë. Megjithëse qeveria Osmane aplikoi në gjykatat lokale për të parandaluar lajme të tilla, fushata e shpifjes vazhdoi nën pretendimin e lirisë së shprehjes.

Këto ishin veprime të qëllimshme që synonin të ndërtonin opinion publik negativ kundër Perandorisë Osmane në një përpjekje për të rritur presionin mbi Qeverinë. Disa politikanë britanikë, veçanërisht Gladstone, bënë fjalime populliste në Dhomën e Komunave kundër Osmanëve dhe pretenduan pa ndonjë provë se 'të krishterët po përndiqeshin'. Gjithashtu, *The Times* filloi të përhapte gënjeshtër se të krishterët janë duke u vvarë, kishat dhe ndërtesat e tjera të krishtere janë duke u plaçkitur dhe gjërat po përkeqësohen nga dita në ditë.

Diplomati osman Salih Münir Pasha, në raportin e tij dërguar Zyrës së Administratës së Madhërisë së Tij në Pallatin Yıldız, përshkroi propagandën si më poshtë:

Kur zhvillimet aktuale shqyrtohen me kujdes, bëhet e qartë se Britania po punon shumë për të arritur qëllime të caktuara që do të dëmtojnë Perandorinë Osmane. Veprimet e partisë së Gladstone dhe botimi i gazetave të lidhura me grupin Salisbury janë krijuar qëllimisht për t'i bërë synimet e tyre të liga të pranueshme në sytë e publikut.²²⁸ (Londër, 4 shtator 1889, Salih Münir)

Nëntoka Shtetërore Britanike gjithashtu përdori trazirat në Sasun të filluara nga disa armenë në vitin 1894 për të forcuar propagandën e saj të zezë. Papritmas, mediat evropiane u mbushën me artikuj që përhapnin gënjeshtër e masakrës armene të kryer nga turqit. Tubimet antiosmane dhe anti-myslimane filluan të shpërthejnë në qytete të ndryshme evropiane, si rezultat i këtij lajmi të njëanshëm dhe të pasaktë. Publiku evropian po familjarizohej me të ashtuquajturën ide të 'shpëtimit të armenëve nga turqit'. Sidoqoftë, faktet e vërteta u mbajtën larg nga syri i publikut: Nëntoka Shtetërore Britanike po planifikonte të rrëzonte Perandorinë Osmane dhe të ndante Anadollin dhe Lindjen e Mesme në pjesë më të vogla që shpresonte se do të ishin më të lehta për t'u kontrolluar. Të gjitha këto përpjekje ishin shërbim të kësaj kauze.

Makina britanike e propagandës sigurohej që të përfitonte nga çdo incident. Incidentet e vogla u përhapën shumë dhe çdo çështje u kthye në lajm me ekzagjerime dhe interpretime të pasakta. Gazetat britanike si Times, Standard, Daily Telegraph dhe Daily Chronicle ishin plot me komente dhe artikuj të njëanshëm kundër Perandorisë Osmane dhe Turqve. Nga ana tjetër, Gladstone, me fjalimet e tij të zjarra por boshe, vazhdoi të nxiste politikanët britanikë dhe publikun kundër Osmanëve.

Raportet e Gerald H. Fitzmaurice, i cili punonte si përkthyes në ambasadën britanike të asaj kohe, pretendohet se bazoheshin në vëzhgimet e tij gjatë udhëtimit të tij nëpër Anadoll dhe u përdorën si municion imagjinar për luftën e propagandës së zezë. Raportet e tij, - shumica e të cilave ishin fiktive - të botuara në emër të diplomacisë britanike, po ndiknin edhe në disa ambasadorë të tjerë të huaj. Tani Nëntoka Shtetërore Britanike po fitonte mbështetjen e jo vetëm publikut të vet, por edhe vendeve të tjera evropiane, duke i futur në lojë për zbatimin e planit të saj. Një shekull më vonë, metoda të ngjashme të provave të rreme do të shfaqeshin përsëri në okupimin e Irakut, si një mënyrë tjetër për të formuar opinionin publik në favor të mobilizimit të forcave ushtarake ndërkombëtare.

Kapitulli në lidhje me "aftësitë propagandistike të Nëntokës Shtetërore Britanike dhe rrjetin e saj global-mediatik" do të shqyrtojë më tej sesi Nëntoka Shtetërore Britanike e ktheu çështjen artificiale armene në propagandë mediatike.

Trazirat e shekullit 19 dhe afrimi i luftës

Trazirat armene në Perandorinë Osmane u organizuan nga tre grupe rebele: Partia Armenakan e themeluar nga Mekertich Portukalian në vitin 1885, Federata Revolucionare Armene (Partia Dashnak) dhe Partia Socialdemokratë Hunçake (e njohur edhe si Partia Hunchak) e themeluar nga Avetis Nazarbekian. Partitë Dashnak dhe Hunchak ishin grupe të majta, dhe Hunçakët veçanërisht i bazuan parimet e tyre në Manifestin Komunist të Karl Marksit. Përderisa partitë Armenakan dhe Dashnak ishin të vendosura në Perandorinë Osmane, Hunchak ishte me seli në Londër.

Me një mentalitet revolucionar gjakftohtë, Partia Dashnak nxiti trazirat armene. Ajo ishte gjithashtu përgjegjëse për trazirat e Sasun dhe Van, sulmin ndaj Bankës Osmane në Stamboll si dhe masakrat e shumta në Anadollin Lindor. Ata

gjithashtu themeluan shoqërinë famëkeqe të Kryqit të Zi për të vranë çdo armen që nuk i mbështeste trazirat e tyre. Simbolika e përzgjedhjes së emrit tregonte veprimtarinë e tyre, anëtarët e bandës vranë armenë paqedashës dhe më pas ju vizatuan kryqe në ballin e tyre. Për më tepër, ishte Partia Dashnak që organizoi katër brigadat e Armenëve Osmanë që luftuan për Ushtrinë Ruse gjatë Luftës së Parë Botërore. Pasi Ushtria e Kuqe mori kontrollin e Armenisë Sovjetike, me urdhër të Stalinit, dhjetëra mijëra Armenë Dashnakistë u vranë nga skuadrat e pushkatimit ose u internuan. Siç e kanë parë lexuesit shumë herë gjatë gjithë librit, Nëntoka Shtetërore Britanike solli vdekjen kudo që shkeli andaj dhe armenët nuk ishin ndryshe nga të tjerët.

Kryengritja e parë armene që filloi nga kryengritja e Nëntokës Shtetërore Britanike ishte kryengritja e Zeitun e vitit 1879. Përzgjedhja e Zeitunit si vend ishte veçanërisht e rëndësishme pasi ishte një zonë malore e njohur për bandat e saj. Është e rëndësishme të theksohet se bandat e përmendura ishin banda kriminale të cilët nuk përfaqësonin armenët paqësorë që jetonin në tokat Osmane.

Thomas Davidson Christie, një misionar amerikan, shkroi në letrën e tij në janar të vitit 1879 se shumica e armenëve që jetonin në zonën e Zeitunit ishin gangsterë:

Zeituni ka një popullsi prej 8-10 mijë banorë. Njerëzit në Zeitun janë të njohur për brutalitetin dhe egërsinë e tyre... si dhe ata i urrejnë Turqit. Dymbëdhjetë vite më parë (1867), kur Z. Montgomery shkoi për herë të parë në Zeitun, prifti i Zeitunit nxiti njerëzit e tij dhe misionari Montgomery së bashku me shokët e tij u rrëzuan nga kuajt, u rrahën dhe u vranë me gurë. Ishte edhe një njeri tjetër në Zeitun i cili u rrah për shkak se u kthye në Protestantizëm. Banditët nga Zeituni nuk treguan sjellje të mirë as nën sundimin turk. Në fund ata u dorëzuan, por deri në atë kohë ka pasur raste kur ata i detyruan ushtarët turq të tërhiqeshin. Sidoqoftë, ato trazira nuk ishin për liri. Ata nuk e donin lirinë e ligjshme. Drejtuesit e tyre ishin udhëheqës të bandave të pacivilizuara. Ata plaçkitën pronat turke dhe të krishtera. Ata luftonin edhe në mes tyre dhe këto luftime ishin gjithmonë të përgjakshme.²²⁹

Është e qartë se këta banditë rebelë nuk përfaqësonin armenët e devotshëm dhe besnikë, të cilët jetuan paqësisht nën sundimin osman për shekuj me radhë dhe ishin të lumtur dhe të angazhuar në artë dhe tregti. Në anën tjetër, këta kriminelë të armatosur u siguruan mercenarëve të gjitha gjërat të cilat Nëntoka Shtetërore Britanike kishte nevojë të përdorte kundër Perandorisë Osmane.

Zeituni dëshmoi dy trazira të mëdha, një gjatë luftës Ruso-Turke (1877-78), dhe një menjëherë pas luftës në vitin 1879. Papa i Kishës Armene të Izmirit pohoi se një kishë armene do të ngrihej në Zeitun bazuar në rezolutat e Kongresit të Berlinit dhe që britanikët do t'u dërgonin para dhe armë për të arritur këtë qëllim. Kjo retorikë luajti një rol në trazirat e dyta. Sait Pasha 'anglezi', i cili ishte Ministri i Marinës në atë kohë, shkroi në kujtimet e tij se Patrick Henderson, Konsulli Britanik në Alepo, kishte qenë orkestrues i këtyre trazirave.

Gjatë trazirave të Zeitunit, bandat e armatosura shënjestruan fshatrat myslimane dhe lajmet për masakra vinin rregullisht nga rajoni. Rreth 600 myslimanë vendorë, të cilët kishin dëgjuar mjaft për këto sulme, u nisën për t'u përballur me rebelët në një përpjekje për të mbrojtur myslimanët në Zeitun. Duke parë që po përgatitej një luftë civile, Porta e Lartë dërgoi trupa në rajon për të shtypur trazirat. Për të kuptuar më mirë se çfarë ka ndodhur, le të analizojmë se çfarë i shkruajti udhëheqësi i banditëve Babek, Konsullit Britanik në Alepo, Hendersonit. Mazha Pasha, Guvernatori i Marashit e kishte marrë letrën e cila ishte një provë e vlefshme për situatën e përmendur.

Konsullit Britanik në Alepo,

Shkëlqësia e tij, Konsulli, i cili erdhi në Zeitun për eksplorim,

Ne jemi gati të fërkojmë fytyrat tona për këmbët tuaja dhe t'i puthim këmbët tuaja... Vetëm Zoti në Qiell dhe ne në Tokë e dimë për takimin që kemi pasur me ju. Ne kemi ende kohë që të përfitjome nga minutat e takimeve që ju kemi siguruar në dhomën e Patriarkut Serkis. Ne jemi akoma duke pritur. Ne bëme gjithçka që ju urdhëruat. Ju gjithashtu e dini që ne kurrë nuk iu bindëm urdhërimeve tuaja. Ju na thatë: 'Pasi të largohem, le të vijmë anëtarët e bandës dhe të ulen këtu lirshëm dhe të mos vuajnë në male. Nëse ndonjë zyrtar qeveritar vjen dhe guxon t'i kapë, duhet të rezistoni dhe të më tregoni në mënyrë që të informoj të tjerët për rezistencën tuaj. 'Por

sapo që burrat tanë po largohen nga Zeituni, ata po vriten. Ju lutemi na dërgoni një përgjigje urgjente. Çfarë duhet të bëjmë?...

Në letrën tuaj, juna informuat për komisionimin e një oficeri të rrethit të krishterë dhe që zyrtarët qeveritarë do të zgjidheshin midis nesh. Sidoqoftë, sipas asaj që kemi dëgjuar, oficerët e rinj do të jenë myslimanë. Nëse kjo është e vërtetë, ne do ti bëjmë përgatitjet tona në përputhje me rrethanat. Ne nuk duhet të lihemi në terr informativ si më parë. Le të jetojmë sipas udhëzimeve tuaja. Ju lutemi bëni diçka që anëtarët tanë të arrestuar të lirohen sa më shpejt që të jetë e mundur. Ne e pranojmë çdo kusht. Të gjithë fshatrat tona janë në anën e kombit tuaj... Siç keni urdhëruar, ne kemi dorëzuar armët që kemi marrë nga qeveria te Patvili Effendi A duhet të veprojmë ashtu si kemi vepruar më parë, apo të mbajmë një profil të fshehtë? Ju lutemi na tregoni urgjentisht.²³⁰

Masat efektive nga Sait Pasha 'anglezi' i dhanë fund trazirës në Zeitun. Për më tepër, një amnisti e përgjithshme u shpall për të gjithë armenët, duke përfshirë udhëheqësit e trazirave, ndërsa shteti kompensoi të gjitha humbjet personale. Vlen të përmendet se Pasha, përgjegjës për masat që çuan në amnisti edhe për ata që vranë shumë njerëz, kishte pseudonimin 'Anglezi'. Sidoqoftë, Sait Pasha hamendësoj sakt se ky nuk do të ishte fundi i këtyre trazirave:

Njerëzit në Zeitun po veprojnë si rebelë sepse evropianët vazhdimisht i favorizojnë të krishterët dhe veçanërisht sepse britanikët i mbrojnë armenët dhe i shohin myslimanët si fajtorë. Është e qartë nga letra që Z. Henderson, i cili është Konsull Britanik në Alepo, i dërgoi gangsterëve në Zeitun se ata po i inkurajoi rebelët. Armenët përreth Van dhe në Alepo janë duke u rebeluar dhe duke bërë ankesa ambasadorëve të huaj; pa dyshim që kjo është qartë për qëllimin e ndërtimit të një krahine autonome në të ardhmen. Kjo nuk do të ndodhë brenda natës. Sidoqoftë, nëse nuk bëjmë diçka për ta parandaluar atë tani, Evropa do të na kërkojë të caktojmë një guvernator armen në Van. Pastaj, do të na duhet të caktojmë një guvernator armenë atje siç bëmë në Liban dhe Kretë.²³¹

Parashikimet e Pashait u bënë të vërteta. Bedros Kapamajian u bë kryebashkiaku i parë armenë i Vanit në vitin 1912 dhe në vitin 1915 rusët emëruan armenin Aram Manukian si guvernator.

Le të kujtojmë edhe një herë në këtë pikë: Ne jemi gjithmonë krenarë që kemi pasur guvernatorë armenë. Ne kemi pasur shumë pasha armenë dhe vezirë të mëdhenj gjatë gjithë historisë sonë. Si anëtarët e vlefshëm të kombit tonë - armenët, kurdët, boshnjakët, çerkezët etj, morën pozicione të rëndësishme në administratë dhe turqit kanë qenë gjithmonë krenarë për këtë gjë. Sidoqoftë, në këtë rast, ishte thjesht një taktikë dinake e përdorur nga Nëntoka Shtetërore Britanike dhe kjo është arsyeja pse ata po kritikohen këtu. (Duhet të theksohet se mbështetja e rusëve për bandat armene ishte gjithashtu plan i Nëntokës Shtetërore Britanike). Shumica e guvernatorëve të emëruar ishin të punësuar si agjentë në operacione për të shpëputur rajone të caktuara nga Perandoria Osmane. Ky ishte një komplot i hapur dhe i qartë. Për më tepër, rebelët armenë të lartpërmendur nuk kanë qenë kurrë qytetarë besnikë të Perandorisë, por zgjodhën të ishin servil të Nëntokës Shtetërore Britanike. Me sa duket, Nëntoka Shtetërore Britanike nuk kishte asnjë problem për të gjetur marioneta në mesin e komunitetit armen, ashtu si nuk pati problem për të gjetur të tillë brenda Perandorisë Osmane.

Kampanja e Kaukazit në Luftën e Parë Botërore

Megjithëse është plotësisht e gabuar, gjatë kohës së luftës, shumica e luftëtarëve e konsiderojnë çdo mjet të pranueshëm me qëllim për ti mbrojtur njerëzit e tyre. Luftërat mund t'i bëjnë njerëzit e arsyeshëm dhe racional të paarsyeshëm dhe iracional, ndërsa lakmia për fitore ose kërkimi për të mbrojtur njerëzit e vet mund t'i shtyjë ata të kryejnë mizori. Kjo është ajo që u ndodhi turqve dhe armenëve përderisa dy kombet vëllazërore bënë gabim tragjik dhe u kthyen kundër njëri-tjetrit gjatë Luftës së Parë Botërore.

Historiani dhe demografi amerikan Justin McCarthy raporton se midis viteve 1821 dhe 1922, pesë milion myslimanë evropianë u dëbuan nga vendlindjet e tyre dhe një numër i ngjashëm u masakruan në të ashtuquajturat luftërat për pavarësi, të sponsorizuara nga Evropa. Kjo masakër etnike e myslimanëve ndodhi gjatë lëvizjeve për pavarësi serbe dhe greke, gjatë luftës Ruso-Turke të viteve 1877-78, luftës Ballkanike në 1912, trazirave armene në Anadollin Qendror,

pushtimit Grek dhe së fundmi Luftës Turke për Pavarësisë. Në raportin e tij për Carnegie Endowment, Michael Mann shkruan se masakra etnike e asaj kohe ishte aq tronditëse, saqë asgjë me madhësi të ngjashme nuk kishte ndodhur kurrë më parë në Evropë.²³² Historiani Maria Todorova në mënyrë të ngjashme thekson se më shumë se një milion myslimanë u larguan nga Ballkani gjatë tre dekadat e fundit të shekullit të 19-të dhe u zhvendosën në Turqi.²³³ Shumë nga të vrarët nuk dihen as sot. Plani i Nëntokës Shtetërore Britanike për ti përzënë turqit nga Evropa për në Azi solli një egërsi tronditëse.

Disa armenë të mashtruar nga Nëntoka Shtetërore Britanike u bënë pjesë e rëndësishme në planin për të dëbuar turqit. Historiani Justin McCarthy thekson se numri i të vdekurëve gjatë asaje kohe ishte 260,000 myslimanë, ndërsa Kemal Karpat raporton se numri i dëshmorëve arriti në 300,000. Disa armenë të mbështetur nga Nëntoka Shtetërore Britanike u bënë mbështetësit më të mëdhenj të ushtrisë ruse në Kaukaz. Nëntoka Shtetërore Britanike e konsideroi shpërbërjen e Perandorisë Osmane më të dobishme për interesin e saj dhe për këtë arsye 'doli nga rruga e Rusëve' përpara se ti ndërsyente Turqit kundër Rusëve dhe Turqit kundë Armenëve. Në fund të këtyre luftërave dhe masakrave të tmerrshme, Nëntoka Shtetërore Britanike ishte e vetmja që doli fitimtare.

Ndërsa anijet luftarake britanike dhe franceze filluan sulmin e tyre në Galipoli në vitin 1915, ushtria ruse kishte filluar pushtimin e Anadollit Lindor. Duke bashkëpunuar me ushtrinë ruse, disa grupe armene u inkurajuan nga Nëntoka Shtetërore Britanike për të sulmuar ushtarët osmanë. Si rezultat, ushtrisë osmane iu desh të luftonte jo vetëm me ushtritë e rregullta, por edhe me rebelët armenë. Kur 80,000 ushtarë të Ushtrisë së 3-të u vranë në Sarıkamış Erzurum në dimrin e vitit 1915, mbrojtja turke u dobësua, duke mundësuar që Ushtria Ruse dhe rebelët armenë të përparonin. Partitë Dashnak, Armenakan dhe Hunchak, të cilat po vepronin nën kontrollin e drejtpërdrejtë të Nëntokës Shtetërore Britanike, organizonin vazhdimisht trazira. Sipas raportit të *New York Times* të 14 nëntorit të vitit 1922, numri i armenëve që luftuan në anën e aleatëve arriti pothuajse 200,000.

Udhëzimi vijues i udhëheqësisë së Dashnak për ndjekësit e tyre hedh dritë mbi politikën që disa armenë rebelë e ndoqën gjatë luftës:

*Sapo rusët të kenë kaluar kufijtë dhe ushtritë osmane të kenë filluar tërheqjen, ju duhet të nisi revolucionin kudo. Ushtritë osmane kështu do të vendosen midis dy zjarreve: nëse ushtritë osmane përparojnë kundër rusëve, ushtarët armenë duhet të bashkohen me rusët...*²³⁴

Kryengritja armene në shkurt të vitit 1915 rezultoi në vrasjen e pothuajse të gjithë popullsisë myslimane të qytetit të Muşit. Sipas të dhënave të Ushtrisë Turke, numri i dëshmorëve arriti në 20,000. Pas kësaj dhe shumë trazirave të tjera, Perandoria Osmane thirri Patriarkun Armen, anëtarët e parlamentit Armen dhe figurat kryesore të komunitetit Armen dhe u kërkoi atyre të bënin përpjekjet e nevojshme për t'i dhënë fund trazirave.

Sidoqoftë, në vend që të ndaleshin, gjërat u përkeqësuan. Sidomos në Mars të vitit 1915, masakrat Mahmudiye, Saray dhe Perakal në Van, si dhe trazirat në Zeitun dhe Bitlis, e bënë situatën në rajon jashtëzakonisht të paqëndrueshme. Sidoqoftë, ajo që ndodhi në Van ishte kashta e fundit. Në prill, rreth 30,000 armenë u rebeluan në rajon dhe kur ushtarët osmanë nuk arritën të shtypnin rebelimin, rebelët i dorëzuan çelësin e qytetit gjeneralit rus Yudenich në maj.

Infermierja Käthe Ehrhold përshkruan incidentet e Pranverës të vitit 1915, gjatë së cilës ajo po punonte në jetimoren e drejtuar nga At Johannes Spörri dhe gruaja e tij Irene Spörri:

20 mijë njerëz atëherë jetonin në Van. Ndërsa rusia u afrua (20 prill 1915), armenët morën armët që fshihnin dhe filluan të luftonin. Një luftë e madhe civile, një luftë e vëllezërve, shpërtheu në qytet. Luftimet në rrugë zhvilloheshin për ditë me radhë. Kur rusët iu afruan qytetit, turqit vendosën të evakujnë qytetin; të dy palët civilë dhe ushtarak u desh të largoheshin nga qyteti brenda një nate. Vetëm gratë, të moshuarit dhe të sëmurët kishin mbetur. Ditën tjetër, kur bandat armene dhe rusët pushtuan qytetin, armenët masakruan gratë, të moshuarit dhe turqit e sëmurë, të cilët nuk ishin në gjendje të shpëtonin. Si të krishterë të devotshëm, atyre u duhej ta falënderonin së pari Zotin që u dha atyre atë fitore. Por ata nuk e bënë këtë; Unë i konsideroj vrasjet që ata i kryen në ditën e parë të pavarësisë si një mëkat të madh.

Armenët morën pronat e mbetura të turqve dhe filluan t'i përdorin ato sikur të ishin prona të tyre. Tani, në vend të fshatarëve armenë, gratë turke nga fshatrat fqinje filluan të vijnë në jetimoren time. Ne i morëm grate e

*mbledhura nga rusët nën mbrojtje të jetimorës sonë. Përndryshe ato gra të varfra do të keqpërdorëshin vazhdimisht. Ne nuk ishim në gjendje t'i ndihmonim ato gra sa duhet, sepse të keqtrajtuara dhe të dhunuara nga rebelët, ato ishin të traumatizuara.*²³⁵

Hans Freiherr von Wangenheim, Ambasadori i Gjermanisë në Stamboll, raportoi incidentet në Ministrinë e Jashtme gjermane:

*Armenët që jetojnë në provincën Van u rebeluan dhe sulmuan fshatrat myslimane dhe kështjellën Turke. Njësia turke në kala humbi 300 ushtarë dhe pas luftimeve qytetin e morën rebelët. Më 17 maj të vitit 1915, rusët pushtuan Vanin, armenët kaluan në anën e armikut dhe filluan therjen e muyslimanëve. Për momentin, 80,000 myslimanë po largohen në drejtim të Bitlisit.*²³⁶

Nëntoka Shtetërore Britanike solli shkatërrimin më të madh tek armenët

Para se të fillojmë të shqyrtojmë zhvendosjen masive armene që ndodhi pas këtyre trazirave, le të kujtojmë shkurtimisht atë që ndodhi në shekullin e kaluar:

Kur shpërthyen trazirat greke në vitin 1826, Porta e Lartë caktoi politikanë, oficerë ushtarakë dhe burokratë armenë në pozicionet e lëna nga grekët. Aq sa në shekullin e 19-të, nëntëmbëdhjetë ministra armenë ishin në qeverinë osmane dhe njëzet e nëntë armenë osmanë shërbyen si pashallarë, gradë e cila ishte më e lartë në burokraci. Tridhjetë e tre armenë u zgjodhën si anëtarë të parlamentit, ndërsa shtatë ambasadorë armenë dhe njëmbëdhjetë konsuj armenë përfaqësuan Sulltantin Osman në pjesë të ndryshme të botës. Qindra burokratë armenë zunë poste kyçe në Ministrinë e Punëve të Brendshme, Punëve të Jashtme, Dhomës së Llogarive, Monedhave dhe Postës. Ata ishin të krishterë që jetonin lirshëm si armen në tokat osmane. Ata gëzonin jetë të rehatshme pa ndonjë kërcënim, presion apo asimilimi dhe ishin në pozitë më të larta në administratën turke. Shumicën e kohës, trupat turke iu besuan pashallarëve armenë.

Gjatë atyre viteve, Kisha Armene në Perandorinë Osmane kishte një fuqi të madhe. Shkollat dhe pronat e tyre të paluajtshme ishin nën mbrojtjen e shtetit. Sidoqoftë, armenët që jetuan në Rusi gjatë së njëjtës kohë nuk gëzuan të drejta të tilla. Përkundrazi, Rusia Cariste kishte mbyllur 320 shkolla armene, ndërsa qeveria ruse mori të gjitha pronat e kishës armene. Në vitin 1909, deri në 4,000 Armenë po vuanin në burgjet cariste me akuza politike dhe rreth 3,000 të tjerë u internuan.

Para se Nëntoka Shtetërore të fillonte zbatimin e planeve të saja të mbrapshta, Perandoria Osmane për shekuj me radhë kishte qenë një vend paqeje dhe sigurie për vëllezërit dhe motrat tona armene. Ata praktikuan lirshëm besimin e tyre dhe bënë jetë të pasur përmes tregtisë. Ata ishin pjesa e krishtere e Perandorisë Osmane dhe nuk ishin të ndryshëm nga qytetarët e tjerë Osmanë. Sidoqoftë, gënjeshtra e '*pakicave të përndjekura*' që Nëntoka Shtetërore Britanike e propagandoi pasi vendosi të rrëzonte Perandorinë Osmane, arriti të ndikojë në vëllezërit tanë Armenë për shkak të propagandës dhe provokimit intensiv. Siç do ta shohin lexuesit në kapitullin tjetër, Nëntoka Shtetërore Britanike, si një mjeshtere e aftë e manipulimit dhe propagandës, arriti të manipuloj masat duke përdorur mediat në të gjithë botën. Gjatë atyre viteve, Perandoria Osmane nuk kishte asnjë fuqi për t'iu kundërvënë kësaj propagande të zezë, pasi ajo po copëtohej vazhdimisht. Shteti i dobësuar u dha mundësinë e nevojshme atyre të cilët kërkonin të na ndanin nga vëllezërit dhe motrat tona armene.

Fakte për zhvendosjen masive të armenëve

Qëllimi themelor i lëvizjeve të rezistencës - kryesisht socialiste - Hunchak dhe Dashnak, të themeluara rreth vitit 1890 ishte të fitonin pavarësinë për armenët përmes revolucionit. Kur Perandoria Osmane vendosi të hyjë në Luftën e Parë Botërore së bashku me Gjermaninë në vitin 1914, disa armenë nën ndikimin e këtyre lëvizjeve, aleate me rusët,

britanikët dhe francezët filluan trazira në tridhjetë e tre rajone të ndryshme, gjatë të cilave mijëra turq, kurdë dhe asirianë humbën jetën. Këto trazira e kthyen perandorinë në një vend me plot trazira.

Sapo humbi Ballkanin në vitin 1912, Perandoria Osmane gjatë atyre ditëve po përballej me probleme të shumta në fronte të ndryshme: masakrat dhe dëbimet masive ishin duke u zhvilluar në Bullgari dhe Kaukaz dhe vetëm në vitin 1914, më shumë se një milion turq u detyruan të largoheshin nga Jerevani dhe Tiflisi. Vetëm 702,000 do të ktheheshin më pas.

Më 24 Prill 1915, Porta e Lartë urdhëroi arrestimin e 253 drejtuesve të bandave armene që ishin përgjegjës për trazirat në rajon si dhe 180 prej tyre u dërguan në burgje të ndryshme. Administrata Osmane vendosi që popullata armene të zhvendoset në zona të ndryshme të largëta që nuk ishin të lidhura me konflikte. Shumë gra, fëmijë dhe të moshuar që jetonin në zona të konfliktit kishin probleme në marrjen e ushqimit, ujit të pastër ose ndihmës mjekësore për shkak të trazirave, ndërsa shumë të tjera humbën jetën në sulmet e bandave. Për këtë arsye, armenët që jetonin afër zonave të konfliktit u zhvendosën në Siri, një territor jugor osman.

Vendimi i Këshillit Osman të Ministrave i datës 30 maj të vitit 1915 është një dëshmi e qasjes së drejtë të administratës Osmane drejt kësaj çështjeje. Vendimi prezantoi disa masa për të ndihmuar qytetarët e zhvendosur, duke përfshirë mbrojtjen e kujdesshme të jetës dhe pronës të tyre, alokimet nga fondi i refugjatëve për nevojat e tyre, dhënien e pronës dhe tokave në varësi të rrethanave, ndërtimi i shtëpive nga qeveria, furnizimi me ndihma humanitare përfshirë ushqimin, pajisjet, furnizimet mjekësore, kontrollet e përditshme mjekësore, transportin me tren për gratë, fëmijët dhe individët e sëmurë etj. Për më tepër, u deklarua se çdo përpjekje për të sulmuar armenët civil do të dënohej në mënyrën më të ashpër në gjykatën ushtarake.

Çështja armene u prodhua si një propagandë e Nëntokës Shtetërore Britanike, e cila ishte në luftë me Perandorinë Osmane në atë kohë. Sot, për arsye të ngjashme politike, gënjeshtria po mbahet ende gjallë. Një propagandë dhe gënjeshtër e tillë e përhapur me anë të mediave dhe agjentëve sekretë do të trajtohet më hollësisht në kapitullin tjetër.

Armenët janë vëllezërit, motrat dhe miqtë tanë; ata janë qytetarë tanë. Nëntoka Shtetërore Britanike e luajti një lojë shumë të pistë gjatë kohës së luftës dhe vuri vëllaun kundër vëllaut. Asnjëherë nuk ishim të kënaqur me faktin që njerëzit armenë duhej të linin këto toka edhe nëse ishte një kusht i status quo-së. Në këtë pikë, është edhe e rëndësishme dhe e dëshirueshme që nipërit e mbesat e vëllezërve dhe motrave tona që u desh të largoheshin gjatë atyre ditëve, të kthehen përsëri në Turqi për të jetuar edhe një herë të lumtur me njerëzit e tyre. Ne dëshirojmë të shohim ditët kur hapet kufiri Turko-Armen dhe vëllezërit dhe motrat tona të humbura prej kohësh të kthehen për të rifilluar jetën e tyre në Turqi në tokat e tyre, që të vazhdojnë të shfaqin përsosmërinë e tyre në art dhe tregti si dikur. Kur kjo të ndodhë, jo vetëm që do të ribashkohemi, por planete ndyra të vazhdueshme të Nëntokës Shtetërore Britanike do të prishen.

'Rregullorja e 10 qershorit 1915 mbi zhvendosjen e armenëve dhe detaje të tjera të rëndësishme' si pjesë e ligjit për zhvendosjen, jetesën dhe rivendosjen, e miratuar më 27 maj të vitit 1915

Kjo rregullore sqaron çështjet në lidhje me akomodimin dhe furnizimet e armenëve që u zhvendosën në rajone të tjera për shkak të luftës dhe rrethanave të tjera të jashtëzakonshme politike.

Neni 1:

Zyrtarët vendor do të jenë të ngarkuar me transportin e atyre që konsiderohen të nevojshëm për t'u zhvendosur.

Neni 2:

Armenët e zhvendosur do të jenë të lirë të marrin me vete të gjitha sendet e luajtshme dhe bagëtinë e tyre.

Neni 3:

Oficerët lokalë të vendosur në pikat kontrolluese gjatë rrugës për në destinacione të ndryshme do të jenë përgjegjës për mbrojtjen e jetës dhe pronave të armenëve të zhvendosur, strehimin e tyre, furnizimet si dhe për t'i ndihmuar ata të marrin trajnimin e nevojshëm. Nëse zbulohet ndonjë neglizhencë në lidhje me detyrat e tyre, të gjithë oficerët do të mbajnë përgjegjësi.

Neni 4:

Në varësi të situatës, armenët që arrijnë në vendet e caktuara do të vendosen në shtëpitë në fshatrat ekzistues ose në qytete ose fshatra që do të ndërtohen për ta në zonat e përcaktuara nga autoritetet lokale. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet për të siguruar që fshatrat të kenë kushte të mira sanitare dhe të ndërtohen në vende të përshtatshme për bujqësi dhe zhvillim.

Neni 5:

Nëse nuk ka zona të zbrazët dhe të përshtatshme për fshatarët, fshatrat dhe qytetet në pronësi të shtetit mund të caktohen si zona të vendbanimeve.

Neni 6:

Fshatrat dhe qytetet ku armenët do të vendosen dhe fshatrat që do të ndërtohen për armenët duhet të jenë të paktën 25 km larg nyjeve hekurudhore të Bagdadit dhe hekurudhave të tjera.

Neni 7:

Armenët që do të vendosen në fshatrat dhe qytetet ekzistuese dhe Armenët që do të vendosen në fshatrat e sapo ndërtuara, duhet të regjistrohen siç duhet për qëllimet e regjistrimit shtetëror. Regjistrat duhet të përfshijnë emrat e familjes, moshën, profesionin, origjinën dhe vendndodhjen e re, si dhe të gjitha detajet e tjera të rëndësishme të familjes.

Neni 8:

Individët e vendosur në zona të caktuara nuk lejohen të udhëtojnë në vende të tjera pa lejen e komisionit përkatës dhe autoriteteve lokale të sigurisë.

Neni 9:

Autoritetet lokale do të mbulojnë të gjitha shpenzimet e armenëve derisa të marrin vendbanimet e tyre të përhershme dhe gjithashtu çdo shpenzim që ata mund të pësojnë, derisa të ndërtohen shtëpitë e tyre, të gjitha shpenzimet do të paguhet përmes fondit të refugjatëve.

Neni 10:

Komisionet e refugjatëve, të përfaqësuar nga administratorë të lartë civilë dhe drejtorë në fushat përkatëse do të jenë përgjegjëse për plotësimin e nevojave të armenëve, qoftë në lidhje me zhvendosjen apo jetesën. Ata gjithashtu do të jenë përgjegjës për mbrojtjen e shëndetit të tyre dhe sigurimin e komoditetit. Për zonat, ku nuk ka komisione refugjatësh, ato duhet të krijohen në përputhje me Komunikatën e Refugjatëve.

Neni 11:

Me kusht që të merren lejet nga Ministria, qiramarrësit dhe guvernatorët do të jenë përgjegjës për kryerjen e procedurave të zgjidhjes, sigurimin e një sigurimi në një mënyrë të shpejtë, dhe gjithashtu për emërimin e zyrtarëve përgjegjës për zhvendosjen dhe jetesën.

Neni 12:

Të gjitha familjeve që do të zhvendosen do t'u jepen toka të mjaftueshme duke marrë parasysh gjendjen e tyre të mëparshme financiare dhe nevojat aktuale.

Neni 13:

Komisionet e refugjatëve do të jenë përgjegjëse për zgjedhjen dhe shpërndarjen e tokave.

Neni 14:

Pasi të përcaktohet zona dhe kufijtë e tokave të caktuara, ato do t'u dorëzohen pronarëve të tyre të rinj në këmbim të një dokumenti të përkohshëm dhe do të regjistrohen në dokumentin e pronësisë në mënyrë të rregullt.

Neni 15:

Fermerëve dhe punëtorëve të aftë, do t'u jepet sasi e përshtatshme e kapitalit ose pajisjeve.

□□□□□□□□□□□□□□□□

Adnan Oktar: Armiqësia midis armenëve dhe nesh, turqve, është shumë e panevojshme. Ato ngjarje kanë ndodhur vite më parë. Të dyja palët vuajtën jashtëzakonisht shumë. Njerëzit kanë vuajtur shumë. Është fati i Zotit. Askush nuk duhet t'i afrohet njëri-tjetrit me ndjenja hakmarrëse dhe inatë. Ne nuk duam hakmarrje. Ne nuk duam dëmshpërblim. Ne thjesht duam të jemi vëllezër, të jemi miq. E kaluara është histori. E kaluara është e kaluar. Tani është një brez i ri; ka të rinj përreth. Biseda për të kaluarën do të na mbajë mbrapa. Ne do t'i përqafojmë me dhembshuri. Ne duam që ata të jenë të pasur dhe paqësorë. Kjo [qasje e dashur] do ta zgjidhë problemin njëherë e përgjithmonë. .

(Pjesë nga intervista e Z. Adnan Oktar në Agjencinë e Lajmeve APA, 16 gusht 2008)

Faktet flasin të vërtetën

Ka shumë historianë dhe politikanë që thonë të vërtetën për atë që ndodhi gjatë zhvendosjes armene. Sidomos, shumë vëzhgues të paanshëm që ishin të pranishëm në rajon gjatë asaj kohe, ata zbuluan se si qeveria Osmane veproi jashtëzakonisht me kujdes për këtë çështje. Edward Nathan, Konsulli i SHBA-ve në Mersin deklaroi, "*Megjithëse ka disa probleme për shkak të turmës, qeveria po e ndërmerret këtë çështje me shumë kujdes, në një mënyrë sistematike, nuk lejon dhunë ose çrregullim, siguron bileta të mjaftueshme për migrantët, dhe ndihmon ata që kanë nevojë për ndihmë*".²³⁸ Sidoqoftë, lajmi që iu dha publikut përfundimor ishte shumë i ndryshëm nga të vërtetat. Përkundër këtyre rrëfimeve të paanshme të dëshmitarëve, Henry Morgenthau, Ambasadori Amerikan në Stamboll, raportoi ngjarjet në vendin e tij në një mënyrë krejtësisht të shtrembëruar dhe disa media amerikane e përdorën këtë kundër Turqve.

Është e qartë, trazirat dhe ngjarjet armene që çuan në zhvendosjen e armenëve u orkestruan nga Nëntoka Shtetërore Britanike. Shumë njerëz të arsyeshëm janë të vetëdijshëm për këtë fakt dhe bënë deklaratatë të qarta në përgjigje të akuzave të pabazuara kundër Perandorisë Osmane:

Historiani i njohur Britanik Norman Stone

Krerët e partive Dashnak dhe Hunchak janë përgjegjës për të gjitha këto incidente. Ata komplotuan konspiracione si personazhi kryesor në "Demonët" e Dostojevskit në një përpjekje për të siguruar interesa politike. Sidoqoftë, ata sollën vetëm shkatërrim në popullin armen.

*Sidoqoftë, e vërteta e mëposhtme duhet të mbahet parasysh: kishte shtatë milion turq në Kaukaz, Krime dhe Ballkan dhe shumica e tyre humbën jetën. Nuk i kujtojmë fare. Për shkak të kësaj, ne po bëhemi bashkëpunëtorë të racizmit.*²³⁹

Letra e Ambasadorit Britanik Sir Philip Currie drejtuar Zyrës për Marrëdhënie me Jashtë, 28 Mars 1894

Qëllimi i revolucionarëve armenë është të nxisin trazira, të bëjnë osmanët të reagojnë ndaj dhunës dhe kështu të bëjnë që Fuqitë e huaja të ndërhyjnë ...

Qëllimet e bandave revolucionare janë që të nxisin pakënaqësinë e përgjithshme dhe të bëjnë që qeveria turke dhe populli turk të reagojnë me dhunë, duke tërhequr kështu vëmendjen e fuqive të huaja ndaj vuajtjeve të imagjinuara të popullit armen, duke i shtyrë ata që të veprojnë për të korrigjuar situatën.²⁴⁰

Admirali Mark Lambert Bristol, Komisioneri i Lartë Amerikan në Turqi dhe Komandant Batalioni në Marinën Amerikane midis viteve 1919-1927

... Shoh se raportet po qarkullojnë lirshëm në Shtetet e Bashkuara se Turqit masakruan mijëra Armenë në Kaukaz. Raporte të tilla përsëriten sa here përsëriten më vlon gjaku. Near East Relief i ka siguruar raportet nga Yarrow dhe vetë populli ynë Amerikan që tregojnë absolutisht se raporte të tilla Armene janë absolutisht të rreme. Qarkullimi i raporteve të tilla të rreme në Shtetet e Bashkuara, pa asnjë përgënjeshttrim, është një gabim dhe sigurisht që u bën armenëve më shumë dëm sesa dobi. Unë mendoj se ne duhet ti dekurajojmë armenët për këtë lloj sjellje, jo vetëm sepse është e gabuar, por sepse ata po dëmtojnë veten²⁴¹

Hovhannes Katchaznoui, Kryeministri i Parë i Republikës së Parë të Armenisë dhe Drejtuesi i Partisë Dashnak

... Ne e kishim përqaftuar Rusinë me gjithë zemër, pa asnjë ndërhyrje. Pa ndonjë bazë pozitive, ne besonim se qeveria Tzariste do të na jepte një vetëqeverisje pak a shumë të gjerë në Kaukaz dhe në vilajetet armene të çliruara nga Turqia si një shpërblim për besnikërinë tonë, përpjekjet dhe ndihmën tonë. Ne kishim krijuar një atmosferë iluzioni në mendjet tona. Ne kishim ngulitur dëshirat tona në mendjet e të tjerëve; ne kishim humbur ndjenjën tonë të realitetit dhe u morëm me ëndrrat tona. ...

Sidoqoftë, është e rëndësishme se ne nuk mund të gjenim masa të përshtatshme për të përmirësuar gjendjen tonë nga brenda dhe nga jashtë, para dhe pas Luftës ne morëm pjesë në luftë për premtimet e dhëna (Lufta e Parë Botërore). ... Ne nuk mund të merrnim masat administrative për të vendosur rregull në rajonet që pushtuam dhe u detyruam të rrokim armët. Ne dërguam ushtri, dogjëm, shkatërruam dhe masakruam²⁴²

H. A. Arslanian

Në mënyrë demonstrative, zotimet britanike në lidhje me Armeninë, si ato që dikur iu dhanë arabëve në lidhje me Sirinë, Mesopotaminë dhe Palestinën, ishin kryesisht një mjet për të inkurajuar armenët për luftë, për të bërë përshtypje të favorshme në vendet neutrale dhe për të siguruar që armiku, Perandoria Osmane, të binte nga brenda duke apeluar ndaj aspiratave kombëtare të pakicave etnike që jetojnë nën kontrollin e saj.²⁴³

Deklarata e Dijetarëve Amerikanë dhe Historianëve e adresuar në Dhomën e Përfaqësuesve të SHBA-ve (19 maj 1985)

Pesha e provave të zbuluara deri më tani tregon pikat në drejtim të luftës serioze ndër-komunale (e kryer nga forca të parregullta myslimane dhe të krishtera), e komplikuar nga sëmundjet, uria, vuajtjet dhe masakrat në Anadoll dhe zonat fqinje gjatë Luftës së Parë Botërore. Në të vërtetë, gjatë gjithë viteve në fjalë, rajoni ka qenë skenë e një lufte pak a shumë të vazhdueshme, jo ndryshe nga tragjedia e cila ka ndodhur në Liban për dekadën e fundit. Numri i vdekjeve që rezultojnë midis të dy komuniteteve myslimane dhe të krishtera të rajonit është i pamasë.²⁴⁴

Mesazhi i Z. Rexhep Tajip Erdogan për ngjarjet e vitit 1915 (23 Prill 2014)

Miliona njerëz të të gjitha feve dhe etnive humbën jetën në Luftën e Parë Botërore. Të kesh përjetuar ngjarje që patën pasoja çnjerëzore - të tilla si zhvendosja - gjatë Luftës së Parë Botërore, nuk duhet të pengojë Turqit dhe Armenët të vendosin dhembshuri dhe qëndrime reciprokisht njerëzore ndaj njëri-tjetrit.²⁴⁵

Mesazhi i Z. Rexhep Tajip Erdogan për Kryepeshkopin Aram Ateshian, Vikari i Përgjithshëm i Patriarkanës Armene të Turqisë (23 Prill 2016)

Në tokat e Anadollit, ku detyrat humanitare kurrë nuk lihen pas dore dhe lumturia dhe pikëllimi ndahen sinqerisht, ndjenja e ndërjegjes dhe e drejtësisë mbahet mbi të gjitha.

Në përputhje me këtë kuptim, si dhe ndjenjën tonë të historisë dhe vizionit humanist, ne do të vazhdojmë të përqafojmë kujtimet e armenëve osmanë.

Ne gjithmonë do të kujtojmë dhe mbajmë në mend kulturën e bashkëjetesës midis turqve dhe armenëve e cila ka një histori gati një mijë vjeçare.

Ne kurrë nuk do të heqim dorë nga puna për miqësi dhe paqe kundër atyre që përpiqen të politizojnë historinë përmes një retorike të hidhur urrejtjeje dhe armiqësie dhe përpiqen të tjetërsojnë dy kombet fqinje, të cilët janë të lidhur me historinë e tyre të përbashkët dhe traditat e tyre të ngjashme.²⁴⁶

Fjalimi i Shkencëtarit Izraelit Tal Buenos në Parlamentin Shtetëror të Uellsit të Ri Jugor të Australisë (24 nëntor 2014)

*Duke u nisur nga faktet ekzistuese, ajo që ndodhi mund të karakterizohet si një tragjedi sepse armenët u vendosën për një rënie të madhe të dhimbshme nga **britanikët** dhe nga udhëheqësit e supozuar armenë, **të ashtuquajturit përfaqësues armenë të cilët u takuan me zyrtarë britanikë - të kryesuar nga Bryce - në hotelet e Londrës** dhe vepruan në mënyrë të papërgjegjshme ndaj shumë armenëve të pafajshëm të cilët - si rezultat - kishin fat të vuanin pasojat e veprimeve të këtyre të ashtuquajturve përfaqësues armenë. Këta përfaqësues u ushqyen nga **britanikët** ndërsa përpiqeshin të çonin përpara kërkimin politik për një shtet të pavarur armenë në tokën osmane, ambicien e tyre personale për të qenë udhëheqës të këtij shteti, por kryesisht në emër të **agjendës imperialiste britanike**. Nuk ka dyshim që këto veprime, përkatësisht **bashkëpunimi me britanikët** dhe rënia dakord për të udhëhequr një trazirë të intensifikuar, nënkuptonin shitjen e sigurisë së popullit armenë në Anadollin lindor të cilët nuk ishin shumicë në asnjë nga provincat atje dhe do t'i nënshtroheshin një përshkallëzimi të dhunshëm të ngjashëm me atë që karakterizoi fushatat e mëparshme të Bryce për të nxitur trazirat armene në vitet 1890.²⁴⁷*

□□□□□□□□□□□□□□□□

Adnan Oktar: Është e rëndësishme që Azerbajxhani dhe Armenia të hapin kufijtë e tyre në të njëjtën ditë dhe në të njëjtën kohë. Për shembull, në një të Premte, pas një lutje të së Premtes, të dy portat duhet të hapen në të njëjtën kohë, duke thënë 'Ya Allah, Bismillah'. Kjo është e tëra. Pa pasaporta. Pa viza. Vetëm ID-kartela duhet të jetë e mjaftueshme.

(Pjesë nga intervista e Z. Adnan Oktar në Gazetën Yeni Musavat të Azerbajxhanit, 11 shkurt 2009).

Një armen me një medalje të pavarësisë: Berç Keresteciyan Türker

Pas shpërbërjes së Perandorisë Osmane, Nëntoka Shtetërore Britanike vazhdoi politikën e saj për një shtet të pavarur armene në Anadollin Lindor. Kjo propagandë bëri që disa nënshtetas armenë të Perandorisë Osmane të aspirojnë për një shtet-komb dhe të rebelohen kundër Perandorisë Osmane. Sidoqoftë, shumë qytetarë të tjerë osmanë me origjinë armene e kuptuan se ky ishte vetëm një komplot i Nëntokës Shtetërore Britanike dhe nuk pranuan të ishin pjesë e tij. Berç Keresteciyan, i cili më vonë mori mbiemrin Türker me sugjerim nga Atatürk, ishte një nga heronjtë e Luftës Turke për Pavarësi.

Para nisjes së Mustafa Kemalit në SS Bandırma për në Samsun, Keresteciyan shkoi te Sadettin Ferit, i cili ishte avokati i Mustafa Kemalit dhe i tha: "Unë besoj se ju jeni avokati i tij dhe një bashkëpunëtor i afertë. Një silur britanik do të fundosë anijen e Pashait jashtë Bosforit. Unë po ju paralajmëroj. Ju lutemi tregoni Pashait dhe vazhdoni në vijën bregdetare. "Me këtë mesazh shumë të rëndësishëm, ai shfaqti një besnikëri shembullore ndaj vendit dhe popullit të tij, dhe u bë pothuajse po aq i rëndësishëm sa ata njerëz që ndezën zjarrin e Luftës Turke të Pavarësisë.

Për më tepër, si Nënkyetar i Shoqërisë Hilal-i Ahmer (tani e njohur si Gjysmëhëna e Kuqe Turke), ai personalisht u kujdes për dërgimin e ilaçeve në Anadoll duke përdorur varka të vogla me vela. gjithashtu është fakt i regjistruar që gjatë pikave më kritike të Betejës së Sakarya, me kërkesë të Mustafa Kemal, ai tërhoqi 15 mijë Lira nga llogaria e tij personale dhe i dhuroi në mënyrë që të bliheshin pajisjet e qitjes së topave. Për këto shërbime shembullore, ai më vonë u dekorua me Medalje të Pavarësisë në Shiritin e Bardhë.¹

1. Fehmi Akın, *Afyonkarahisar milletvekilleri: yaşam öyküleri ve meclisteki faaliyetleri* [Afyonkarahisar MPs: Life Stories and Parliamentary Works], IQ Kültür Sanat Yayıncılık, 2009, pp. 107-108

Zgjidhja e vetme për çështjen armene është Dashuria dhe Uniteti

Me siguri, askush nuk mund ta vlerësojë më mirë shkatërrimin e shkaktuar nga incidentet që ndodhën gjatë Luftës së Parë Botërore, ose pasojat e tmerrshme të luftës vëllazërore, sesa armenët dhe turqit. Të dy palët pësuan humbje të mëdha. Në të vërtetë, varre masive ende ekzistojnë në rajon. Kjo është për shkak se këto dy kombe vëllazërore, për shkak të kompleteve të liga të Nëntokës Shtetërore Britanike, u futën në përplasje me njëri-tjetrin.

Disa mosmarrëveshje që vazhdojnë edhe sot nuk mund të zgjidhen me ndërhyrjet dhe manipulimin e individëve të interesuar për veten, të mbështetur nga Nëntoka Shtetërore Britanike, të cilët nuk kanë njohuri për dhimbjet e pësuar gjatë Luftës së Parë Botërore. Vetëm Turqia dhe Armenia mund ta zgjidhin këtë problem. Shumë incidente tragjike ndodhën dhe nuk ka dyshim që prekën thellë të dyja palët. Kursi më i mirë i veprimit tani është lënia pas e dhimbjeve të së kaluarës dhe fashimi i plagëve tona së bashku me lidhjen tonë të miqësisë dhe vëllazërisë. Të dy vendet duhet të bashkohen, t'i japin një shembull pjesës tjetër të botës, të hapin kufijtë e tyre, të heqin vizat dhe kërkesat për pasaportë. Ata duhet të qëndrojnë pranë njëri-tjetrit me dashuri. Kjo është e vetmja mënyrë për të zgjidhur këtë problem.

Kur të dy vendet të bashkohen me një lidhje të sinqert dashurie, pa asnjë ndërhyrje të huaj, komplotet e Nëntokës Shtetërore Britanike dhe degëve të saj të liga do të prishen. Për më tepër, atyre do t'u jepet një mësim i shkëlqyeshëm dhe bota do të shohë se dashuria është e mundur dhe do të triumfojë përgjithmonë.


Vëllëzërit dhe motrat tona armene duhet të vijnë në tokat turke kurdo që dëshirojnë. Duhet të kemi më shumë qytetarë armenë këtu; ata duhet të hapin shkolla në Turqi, të përhapin kulturën e tyre dhe të forcojnë kulturën e përbashkët tashmë ekzistuese që ne kemi. Nismat e fundit të qeverisë turke në lidhje me kishat armene janë të lavdërueshme. Përpjekje të tilla duhet të intensifikohen dhe vëllëzërit dhe motrat tona armene duhet të jenë në gjendje të praktikojnë fenë e tyre të qetë kur të kthehen në këtë vend. Duhet të sigurohen më shumë mundësi biznesi për ta, duke

përfshirë iniciativa për tregti dhe zanate, ku ata mund të zhvillojnë veprimtarinë e tyre në Turqi si qytetarët tanë. Kjo do të jetë përgjigjja më e mirë për ata që kërkojnë të krijojnë armiqësi midis dy popujve. Komplotet e kaluara të Nëntokës Shtetërore Britanike nuk duhet të lejohen të parandalojnë këtë unitet të bukur dhe të fortë. Humbjet e të dy palëve duhet të përkujtohen së bashku, e kaluara duhet të lihet pas dhe të dy popujt duhet të japin një shembull për të gjithë botën në vendosjen e paqes. Sidoqoftë, kjo lidhje dashurie nuk mund të krijohet me parakushte, manovra politike ose një qasje egoiste. Bashkimi i singert duhet të jetë zgjidhja e vetme. Kjo mund të jetë e mundur vetëm me mesazhet e dashurisë nga njerëz paqësorë dhe të arsyeshëm. Kur kjo të ndodhë, ata që janë të uritur për urrejtje nuk do të dëgjohen më, pasi zërat e tyre do të mbyten nga zëri i dashurisë.

Për ta arritur këtë, nuk duhet të ketë kushte ose parakushte. Nëse gjuha e politikës bazohet në një gjuhë egoiste, politikat do të jenë në mënyrë të pashmangshme territoriale dhe të orientuara nga interesi. Sidoqoftë, lidhja që duhet të ndërtohet me Armeninë nuk është një lidhje politike, por më tepër e një dashurie dhe miqësie. Ne ia kemi borxh bashkëjetesës sonë mijëra vjeçare.

Gjithçka mund të zgjidhet në një atmosferë të dashur dhe miqësore. Për sa kohë që ka dashuri, problemet territoriale nuk do të jenë çështje. Sidoqoftë, paraqitja e kushteve, pa ofruar ndonjë siguri për bashkëjetesë, do të portretizojë pa dashje një pamje egoiste dhe do të dëmtojë besimin e ndërsjellë. Për shembull, mbajtja e një qëndrimi jo fleksibël në lidhje me çështjen e Nago-Karabakut mund të shkaktojë një ngërç. Në mënyrë të ngjashme, është e rëndësishme që edhe pala armene të braktisë të gjitha kushtet dhe parakushtet e saja. Bota është e ndërtuar mbi dashurinë. Prandaj, ne duhet të përqendrohemi tek dashuria. Nuk ka asnjë problem që dashuria nuk mund ta zgjidhë.

Ky është lajmi i mirë që Zoti u jep besimtarëve të cilët besojnë dhe bëjnë vepra të mira. Thuaj: "Unë nuk ju kërkoj nga ju kurfarë shpëblimi - përveçse që ju ta doni farefisn tuaj. Atij që bënë vepra të mirë, Ne do t'i shtojmë shpërblimin. Allahu me të vërtetë është Falës dhe Mëshirues. (Kur'an, 42:23)



Mjeshtëria e Propagandës të Nëntokës Shtetërore Britanike dhe Rrjeti Global i Medias

Inxhiniria Sociale

Strukturat e thella nëntokësore, në përpjekjen e tyre për të shfrytëzuar shtetet dhe masat, formojnë opinione publike të cilat ndikojnë në të gjithë botën, duke i konsideruar luftërat, fushatat ushtarake, trazirat civile dhe ndërhyrjet politike si metoda të domosdoshme. Sidoqoftë, ata besojnë se që këto metoda të jenë me të vërtetë efektive dhe të kenë rezultate të qëndrueshme, duhet të shoqërohen me përgatitjen psikologjike të shoqërive përkatëse. Për ta, formimi dhe fitimi i opinionit publik është thelbësor për arritjen e qëllimeve imperialiste. Përpjekjet e inxhinierisë sociale, të cilat përbëhen nga metoda propagandistike dhe operacione perceptuese, konsiderohen jetike për këtë ndërmarrje.

Inxhinieri sociale është një përpjekje gjithëpërfshirëse e krijuar për të ndikuar në mendimet dhe sjelljet e masave me qëllim për të manipuluar dhe kontrolluar emocionet, dëshirat, ambiciet, reagimet dhe inatet e masave.

Operacionet e perceptimit të përdorura për këtë qëllim i shërbejnë qëllimit të vendosjes së fuqisë globale dhe sundimit imperialist, heqjes së pengesave në rrugën e tyre dhe indoktrinimit të shoqërive në pranimin e ideve, nocioneve, rregullave dhe parimeve të paracaktuara. Paraqitja e miqëve si armiq, ose anasjelltas, ose paraqitja e pushtimit apo manipulimit të një vendi apo edhe një sulmi kundër atij vendit si 'dorë ndimëse' janë shembujt më të zakonshëm të këtyre përpjekjeve.

Në botën e propagandës së zezë, mashtrimet, gënjeshttrat, shpifjet dhe komplotet konsiderohen të gjitha metodat legjitime. Propaganduesit e zinjë shtrembërojnë të vërtetat, prodhojnë prova të rreme dhe fillojnë fushata shpifjeje dhe dezinformimi kundër armiqve të pretenduar në një përpjekje për të dobësuar dhe ndërtuar opinionin publik kundër individëve, shoqërive, administratave ose vendeve. Përhapja e lajmeve të rreme, shpifjet dhe thashethemet janë metoda të zakonshme që ata përdorin për të krijuar një atmosferë dyshimi dhe mosbesimi. Për shembull, duke përdorur metoda të tilla propagandistike, forcat pushtuese dhe fuqitë imperialiste mund të paraqiten si miq të besueshëm, shpëtimtarë dhe përfaqësues të paqes dhe demokracisë.

Shoqëritë e vëna nën ndikimin e operacioneve të tilla të perceptimit, nxiten të mbështesin, pëlqejnë, të besojnë dhe të bashkohen me fuqitë e thella që qëndrojnë prapa propagandës. Në të njëjtën kohë, strukturat e thella nëntokësore kërkojnë ndihmën e individëve të caktuar me karakter hipokrit dhe të vrullshëm, të cilët kanë sy për spiunim. Të marrë nën krahët e strukturave të thella, këta servilë tradhtarë do të promovohen si njerëz të besueshëm dhe do të kompensohen financiarisht duke ju premtuar siguri, fuqi dhe prestigj. Në ndërkohë, njerëz të guximshëm, besnikë dhe patriotë që veprojnë kundër dëshirave të strukturave të thella nëntokësore i nënshtrohen fushatave të shpifjes, dhe nganjëherë do të përshkruhen si rebelë ose armiq të demokracisë. Kjo është një mënyrë se si këto institucione të fshehta përdorin metoda të zeza propagande për të minuar njerëz kaq të guximshëm në sytë e publikut. Për më tepër, këto struktura do të kërkojnë të justifikojnë përndjekjen, trajtimin e padrejtë, torturën dhe madje edhe vrasjen e këtyre njerëzve të guximshëm, me shpresën për t'i penguar ata që të rezistojnë ndaj fuqive perandorake.

Ky është një përmbledhje e shkurtër e politikave të inxhinierisë sociale që strukturat e thella nënokësore e përdorin në vendet që i synojnë. Kjo metodë është përdorur gjerësisht gjatë historisë dhe madje u ka mundësuar disa strukturave të thella të fitojnë kontroll mbi të tjerët. Nëntoka Shtetërore Britanike, e cila i ka marrë nën kontroll të gjitha nëntokat e tjera shtetërore, ka tejkaluar të gjithë të tjerët në zbatimin e strategjive të tyre të mbrapshta.

Aktivitetet e Inxhinierisë Sociale të Nëntokës Shtetërore Britanike

Nëntoka Shtetërore Britanike ka përdorur në mënyrë të qartë ose të fshehtë metodat e inxhinierisë sociale që nga shekulli i 16-të. Kjo ia mundësoj asaj që të bënte shumë vende të botës koloni të saj dhe në disa raste, të fitonte kontrollin e plotë të këtyre vendeve.

Nga mesi i shekullit të 19-të deri në fillim të shekullit të 20-të, Nëntoka Shtetërore Britanike e ka përqendruar përpjekjet e saj të inxhinierisë sociale në Perandorinë Osmane. Gjatë dhe pas Luftës së Parë Botërore dhe Luftës së Dytë Botërore, fokusi i saj ishte përsëri kryesisht në ish territoret osmane në Lindjen e Mesme, Afrikën e Veriut dhe botën Islame në përgjithësi sepse besonte se këto zona do të ishin ato që do të sfidonin interesin e saj global.

Përveç kësaj, kishte një përfitim të shtuar përmes kontrollit të burimeve më të pasura natyrore të botës, fuqisë punëtore, rrugëve tregtare, kryqëzimit të besimeve dhe civilizimeve, tokave të shenjta dhe më e rëndësishmja, tokave, vendeve dhe kombeve të myslimanëve, armikut kryesor të *dexhallit*. Ata gjithmonë e dinin se nëse e lënë në gjendje që të zhvillohet, Bashkimi Islamik do të dilte nga ky rajon, që do të ishte fundi i mbretërimit imperialist të Nëntokës Shtetërore Britanike dhe rrjetit global të tyre. Për këto arsye, kontrolli i rajonit duket një çështje jetë e vdekjeje për Nëntokën Shtetërore Britanike dhe *dexhallin* që fshihet pas kësaj strukture.

Kjo është arsyeja e magjepsjes së Nëntokës Shtetërore Britanike me rajonin për shekuj me radhë. Duke drejtuar tërë fuqinë e saj propaganduese mbi rajonin, ajo rifilloi strategjinë e saj "përça dhe sundo" për Lindjen e Mesme, e cila ishte iniciuar, por u la e papërfunduar nga marrëveshja Sykes-Picot. Kjo strategji funksionoi për vende si Iraku, Siria, Egjipti dhe Libia dhe i bëri këto vende të varura nga nëntoka shtetërore. Trazirat e vazhdueshme civile në këto shtete shkaktuan përplasjen dhe ndarjen e tyre, gjë që ishte edhe plani origjinal i strukturave nënokësore. Në ndërkohë, propaganda e zezë kundër vendeve që kishin potencialin për të udhëhequr Bashkimin Islamik u intensifikua. Turqia dhe Irani ishin shënjestrat kryesore.

Nëntoka Shtetërore Britanike deklaroi qartë pozicionin e saj si mbështetëse kryesore, promovuese dhe mbrojtëse e grupit terrorist PKK, i cili është arma e saj më e rëndësishme në përpjekjen e saj për të përçarë Turqinë. Perandoria mediatike e nëntokës shtetërore, e cila në të kaluarën kontribuoi kryesisht në copëtimin e Perandorisë Osmane, luajti rolin më të madh në ndarjen e shumë vendeve dhe veprimi si një mbështetëse e shquar e grupeve terroriste si PKK.

Mjeti më i rëndësishëm i inxhinierisë sociale: Media

Shumë njerëz tashmë janë të vetëdijshëm se mjetet globale të komunikimit, veçanërisht mediat, janë mjetet më të rëndësishme të operacioneve të inxhinierisë sociale. Media është transmetimi vizuel-audio i informacionit dhe ideve tek një gamë e gjerë e njerëzve përmes mjeteve të ndryshme të komunikimit. Ai përfshin media të shtypura (gazeta, libra, revista, etj.), Kanale televizive, filma, radio, internet dhe platforma të rrjeteve sociale. Për shkak të potencialit të saj për të ndikuar në masa, media është përdorur shpesh si një mjet i rëndësishëm në operacionet e propagandës dhe perceptimit. Natyrisht, ajo është një nga armët më efektive si të fuqive globale imperialiste ashtu edhe të nëntokave shtetërore.

Nëntoka Shtetërore Britanike gjithashtu ka përdorur disa kanale mediatike për qëllime të ngjashme duke ju ofruar informacione të rreme për ti nënshtruar në inxhinierinë sociale. Ajo shkoi deri në atë masë sa të përmbyste qeveritë e ligjshme të vendit të saj. Prandaj, është e rëndësishme të thuhet edhe një herë se populli britanik dhe qeveria britanike nuk janë në asnjë mënyrë përgjegjëse për veprimtaritë e Nëntokës Shtetërore Britanike ose të mediave përkatëse të saj. Përkundrazi, qeveria britanike, zyrtarët qeveritarë dhe qytetarët britanikë kanë qenë shpesh të zënë në komplotet e

nëntokës shtetërore. Qeveritë britanike dhe njerëzit e saj kanë qenë gjithmonë viktimat e operacioneve të tilla të inxhinierisë sociale dhe janë plotësisht të pafajshme nga veprimet e nëntokës shtetërore.

Strukturat e thella që sundojnë mbi super fuqitë e botës, si Mbretëria e Bashkuar, Shtetet e Bashkuara, Rusia dhe Kina, në përpjekjen e tyre për të manipuluar si shoqëritë e tyre ashtu edhe njerëzit e botës në përgjithësi, kanë përdorur shpesh inxhinierinë sociale. Për shembull, Gjermania e Hitlerit e përdori atë në masë të madhe para Luftës së Dytë Botërore dhe si pasojë e saj. Në një mënyrë të ngjashme, Lufta e Ftohtë u dëshmuar për zbatimin e gjerë të strategjive të ngjashme.

Lufta e Vietnamit ofron një nga shembujt më bindës se si është përdorur inxhinieria shoqërore për të shtrembëruar të vërtetën. Në vitin 1975, lufta kishte përfunduar me një rezultat shkatërrues për Vietnamin. Numri i vdekjeve arriti në 3 milion, 300,000 njerëz ishin zhdukur dhe 4 milion të tjerë u plagosën. Viktimat ishin pothuajse të barabarta me 17% të popullsisë së përgjithshme të vendit. Nga ana tjetër, SHBA-të patën një humbje totale prej 60,000 personave.

Sidoqoftë, fushata e egër kundër Vietnamit nga media amerikane jo vetëm që shfajësoi Shtetet e Bashkuara edhe pasi ajo shqeu një vend mijëra milje larg dhe theri miliona qytetarë të saj, ajo gjithashtu dha arsytimin e nevojshëm për një embargo 18-vjeçare të SHBA-ve në Vietnam. Leslie H. Gelb, një analist i politikës së jashtme në New York Times madje i quajti Vietnamezët "të jashtëligjshëm" për vrasjen e Amerikanëve.²⁴⁸

Duhet të kihet parasysh se mënyra e vetme për të luftuar komunizmin është përmes përpjekjeve intelektuale. SHBA nuk arriti të shihet që Vietnami dhe Lindja e Largët në përgjithësi kishin rënë në kthetrat e komunizmit për shkak të edukimit të gabuar dhe nuk mund të përceptonin se vetëm me edukim korrekt mund të shpëtoheshin. Sot, SHBA dhe pjesa tjetër e botës vazhdojnë të mbajnë këtë qasje të gabuar ndaj komunizmit dhe ideologjive të tjera të dëmshme. Dhuna konsiderohet ende si e vetmja përgjigje ndaj ideologjive të dëmshme, e cila shkakton edhe më shumë dhunë dhe telashe. Mirëpo një gjë dihet qartë, kjo është pikërisht ajo që dëshiron Nëntoka Shtetërore Britanike. Siç u shpjegua më herët, qëllimi i Nëntokës Shtetërore Britanike është të krijojë trazira dhe kriza në të gjithë botën, të nis luftëra - nganjëherë edhe përmes mbështetjes së grupeve terroriste - për të ndarë botën dhe për të vendosur lehtësisht hegjemoninë e saj.

Humbja e madhe e jetës së myslimanëve gjatë pushtimit të Afganistanit dhe Irakut pas sulmit të 11 shtatorit nga administrata e Bushit u prezantua krejtësisht ndryshe për publikun botëror me ndihmën e inxhinierisë sociale të medias. E ashtuquajtura 'luftë kundër terrorizmit' shkaktoi vrasjen e miliona civilëve të pafajshëm myslimanë ndërsa u portretizua si një përpjekje amerikane për të sjellë të drejtat e njeriut, lirinë dhe demokracinë në ato vende. Media ishte aktori kryesor në këtë operacion perceptimi. Plani i vërtetë ishte ndarja e Irakut dhe krijimi i hegjemonisë së Nëntokës Shtetërore Britanike në atë rajon Sidoqoftë, miti i 'demokrazimit të Irakut' preku thellë opinionin publik botëror dhe si rezultat, sulmet u përceptuan si të pranueshme.

Raporti Chilcot i korrikut të vitit 2016, botuar nga 'Iraq Enquiry', i cili u organizua për të hetuar rolin e MB në këtë luftë, mund të konsiderohet si një raport i rrëfimeve. Tony Blair, Kryeministri i atëhershëm i Mbretërisë së Bashkuar, pranoi se inteligjenca në lidhje me të ashtuquajturën prani të armëve të shkatërrimit në masë në Irak - arsyeja e pretenduar e pushtimit - kishte qenë e gabuar, por pushtimi megjithatë ndodhi. Ai gjithashtu tha se pas ndërhyrjes, situata u bë më armiqësore, më e përgjakshme dhe më e zgjatur nga sa mendohej. Ky rrëfim pas kaq shumë vitesh dhe pas kaq shumë jetësh të humbura është pa dyshim domethënëse. Ne do të kuptojmë në ditët në vijim nëse këto fjalë pasqyrojnë pendim të vërtetë, ose nëse janë vetëm një lëvizje për një lojë tjetër të Nëntokës Shtetërore Britanike.

Shtetet e Bashkuara dhe fuqitë e ngjashme botërore kanë qenë gjithmonë vetëm instrumente të Nëntokës Shtetërore Britanike, e cila zgjedh të qëndrojë pas dhe të drejtojë punët në mënyrë të fshehtë; organizatori i vërtetë ka qenë gjithmonë Nëntoka Shtetërore Britanike.

Ngritja e Strukturës së thellë Mafioze Britanike

(Kombi fisnik turk është mbi të gjitha këto shpifje dhe akuza.)

Propaganda e zezë fillon teksa Perandoria Osmane fillon të humb terren

Në fillim të këtij kapitulli, u shpjegua se si Nëntoka Shtetërore Britanike zgjodhi Perandorinë Osmane dhe Turqit si shënjestrat kryesore duke filluar nga mesi i shekullit të 19-të. Gjatë atyre viteve, Nëntoka Shtetërore Britanike filloi një luftë sistematike propagandistike kundër Perandorisë Osmane. Përgjegjësimi i ushtrisë osmane me përralla imagjinare të dhunës dhe fyerja e Sulltan Abdul Hamidit të II-të me emra të parespektueshëm duket e quajtur, 'Sulltani i Kuq' ishin ndër metodat më të përdorura.

Sidoqoftë, propaganda më e gjatë dhe më e ashpër e shënjestroi popullin turk, udhëheqësit qeveritar dhe sundimtarët e Perandorisë Osmane. Figurat kryesore britanike të kohës u përpoqën të përgatisnin kolonializimin e popullit turk dhe për këtë arsye e quajtën kombin turk duke e quajtur 'të prapambetur, barbar dhe primitiv'.

Sipas Cyrus Hamlin, themelues dhe president i parë i Kolegjit Amerikan Robert në Stamboll, propaganda antiturke e Britanikëve filloi para Luftës së Parë Botërore. 'Zyrë për propagandë' u krijua në vitin 1870 në Londër, me detyrën e përhapjes së lajmeve kundër Turqisë në vendet e tjera dhe menaxhimin e propagandës përkatëse.²⁴⁹ Kjo propagandë ishte hapi i parë drejt ëndrrës së Nëntokës Shtetërore Britanike për 'një Perandori Osmane të ndarë'.

William Ewart Gladstone, i cili shërbeu si Kryeministër Britanik nga viti 1880 deri në vitin 1885, ishte një ndër krijuesit e kësaj politike. Gladstone shqiptoi fyerje të shumta kundër kombit turk dhe u përpoq t'i përdorte ato fyerje për të mbështetur projektet e tij imperialiste që përfshinin aspirata të tilla si dëbimin e Turqve në stepat e Azisë Qendrore. Si pretendoi se veprimet e mbrapshta të turqve mund të eliminohen vetëm kur ata të eliminohen.²⁵⁰ (Kombi Fisnik Turk është mbi pretendime të tilla).

Ahmet İhsan, një anëtar i Komitetit të Bashkimit dhe Progresit, gjithashtu përmendi qasjen e Gladstone në kujtimet e tij:

Famëkeqi Gladstone mbajti një Kur'an në parlamentin Britanik dhe tha se për sa kohë që Turqit ecin me këtë Libër, ata janë të dëmshëm për civilizimin.²⁵¹ (Kur'ani është mbi vërejtje të tilla).

Përveç vërejtjeve të tilla të sëmura, Gladstone nuk u ndal nga prodhimi i materialit propagandistik kundër turqve. Në librin e tij *Tmerret Bullgare dhe Pyetja e Lindjes* që u përhap gjerësisht në Londër, ai në mënyrë aktive u përpoq të provokonte popullin britanik kundër kombit turk. Për shembull, ai tha, "Lërin Turqit tani të kryejnë abuzimet e tyre në mënyrën e vetme të mundshme, domethënë abuzuar me veten."

Propaganda anti-turke ishte aq e fortë, madje qeveria Konservatore që kishte qenë më parë miqësore me Turqinë, ndryshoi qëndrimin e saj. André Maurois shkruan në librin e tij *Një Histori e Anglisë*, "Gladstone ndezi mendimin Britanik kundër tyre [Turqve] duke pamfletuar dhe duke bërë fjalime ..." ²⁵²

Gladstone mbeti në pushtet midis viteve 1880-1885 si Kryeministër dhe gjatë mandatit të tij, ndjenja antiturke u përhap shumë. Mediat, në veçanti, kryen një indoktrinim intensiv në lidhje me identitetin turk dhe osman. Lajmet e rreme të 'barbarisë turke' dhe 'dhunës turke' u përhapën si flakë zjarri. Sir Ellis Ashmead-Bartlett, deputeti britanik që vëzhgoi luftën turko-greke të vitit 1897 në fushëbetejë, përmend politikën armiqësore që britanikët lëshuan papritmas kundër turqve në kujtimet e tij:

Denoncimet më të dhunshme dhe epitetet më të pëshkira ndodhën gjatë dhjetë muajve pas dhjetorit, të vitit 1894 dhe u bazuan në trillime gazetareske... Këto histori ose nuk kishin ekzistuar asnjëherë, ose kishin fakte të rreme.

Andaj, dua të them dy gjëra: së pari, kemi të bëjmë me akuza kundër një kombi të cilat nuk qëndrojnë, gjithashtu për nëntë muaj Sulltani, Qeveria Turke, Ushtria Turke dhe Populli Turk u poshtëruan dhe sulmuan në Angli

*për mizori të pretenduara... e cila nuk kishte ekzistuar fare. ... Këto mizori të tmerrshme nuk kanë ekzistuar kurrë; historitë ishin absolutisht trillime...*²⁵³

Ndërsa britanikët u përpoqën ti paraqisnin osmanët si një shoqëri barbare, të prapambetur, primitive dhe të dhunshme duke përdorur gënjeshtër absurde, ata po krijonin gjithashtu nënvetëdjën se Perandoria Osmane duhej rrezuar. Kryeministri Herbert Henry Asquith tha në një fjalim se Perandoria Osmane ishte në shtratin e saj të vdekjes dhe pohoi se Perandoria e sëmur nuk do të ringjallej përsëri.²⁵⁴

I gjithë ky operacion propagandistik u krye së bashku me operacionin e Nëntokës Shtetërore Britanike për të copëtuar Perandorinë Osmane. Në vitin 1898, Kryeministri Britanik Lord Salisbury i dërgoi një telegram ambasadorit Britanik në Shën Petersburg duke sugjeruar një 'ndarje të epërsisë'²⁵⁵ midis Rusisë dhe Britanisë në Perandorinë Osmane që konfirmonte ekzistencën e kësaj strategjie.

Nën këtë propagandë të paepur antiosmane të Nëntokës Shtetërore Britanike qëndronte e vërteta e qartë se ata nxitën armiqësinë ndaj turqve. Udhëheqësit e Nëntokës Shtetërore Britanike, si pasqyrim i mënyrës së tyre imperialiste të menduarit, u përpoqën të justifikonin veprimet e tyre duke etiketuar kombet që ata synonin si "të prapambetura, primitive dhe barbare". Një letër e shkruar nga Britaniku Sir Edward Gray në 11 Gusht të vitit 1908, pas shpalljes së Periudhës së Dytë Kushtetuese, pasqyron qartë këtë ndjenjë:

*Ajo që ka ndodhur tashmë në Turqi është aq e mrekullueshme sa që mendoj se nuk është e pamundur që ajo të krijojë një Kushtetutë, por mund të jetë që zakoni i qeverisjes së egër dhe të korruptuar të jetë shumë i fortë për reforma dhe se gjenetika e racës ... përsëri do të prodhojë dhunë dhe çrregullime.*²⁵⁶

Lord Salisbury shkroi si më poshtë për Turqit në një dokument konfidencial të vitit 1911:

*Edhe Z. Buxton duket se e njeh absurdin e një kombi në këtë gjendje barbarie që pretendon të trajtohet si një Shtet Evropian dhe të menjanoj kapitullime...*²⁵⁷

Nëntoka Shtetërore Britanike dëshironte rezultate më të shpejta dhe rriti presionin psikologjik mbi Perandorinë Osmane dhe Turqit dhe intesifikoi propagandën e saj të zezë kundër tyre. Për këtë ata iu drejtuan administratës amerikane dhe medias amerikane për mbështetje dhe nxitën ndjenjat e tyre antiturke te populli amerikan. Fjalët e mëposhtme të senatorit amerikan Henry Cabot Lodge shfaqin qartë këtë urrejtje dhe fanatizëm:

*Në ditët e suksesit të tyre [turqit osmanë] ishin një fatkeqësi për Evropën dhe krishterimin. Në shekujt e gjatë të kalbjes së tyre ata kanë qenë dëmtuesi dhe mallkimi i Evropës, burimi i luftërave të panumërta dhe xhelatët në masakra të panumërta ... Një qeveri e tillë është mallkim për civilizimin modern. Shpresa ime e singertë është që midis rezultateve të luftës ... një nga rezultatet e shkëlqyera për të cilat lutem do të jetë zhdukja përfundimtare e Perandorisë Turke në Evropë.*²⁵⁸

Kur koloneli House sugjeroi Henry Morgenthau si ambasador në Turqi në vitin 1912, Presidenti i ShBA-ve Woodrow Wilson tha, "Nuk do të ketë më Turqi", së cilës House u përgjigj, "Atëherë lere të shkojë ta kërkojë".

Wilson zbuloi qëndrimin mbizotërues antiturk në ShBA gjatë atyre ditëve kur ai tha se ajo që publiku amerikan do të miratojë do të ishte mbrojtja e armenëve dhe kombeve tjera kundër turqve.²⁵⁹

Nga ana tjetër, historiani francez Albert Sorel theksoi si në vijim:

*Kjo është politika që ndjekin disa civilizime në Lindje. Ata rrëmbejnë pjesë të tokave turke, indiane, kineze, u rrëmbejnë pasurinë, i vrasin dhe më pas u thonë 'mos u zemëroni, ne nuk po luftojmë me ju. Ne jemi miqtë tuaj më të mirë.'*²⁶⁰

Ahmed Rıza në librin e tij *La Crise de L'Islâm* (Krizat e Islamit) shpjegoi propagandën e zezë të Nëntokës Shtetërore Britanike kundër turqve me fjalët e një perëndimori:

*Ta duroj praninë e turqve në Evropë, të cilët ruajnë karakterin e tyre klasik barbar dhe tiranik, është njollë për civilizimin evropian; Turqit duhet të dëbohen nga Evropa.*²⁶¹ (Kombi Fisnik Turk është mbi këto akuza).

Le të kujtojmë në këtë pikë se para Luftës së Parë Botërore, Nëntoka Shtetërore Britanike ishte përqendruar shumë në Shtetet e Bashkuara dhe e kishte manipuluar lehtësisht në favor të qëllimeve të saj. Turkofobia që u zhvillua në Shtetet e Bashkuara gjatë kësaj kohe ishte për shkak të përpjekjeve të Nëntokës Shtetërore Britanike dhe propagandës përkatëse të medias në vend.

Sidoqoftë, kishte shumë njerëz të arsyeshëm në atë kohë, të cilët refuzuan të futeshin në këtë trend racist në Britani dhe Evropë dhe mund të vlerësonin drejt popullin Turk. Për shembull, oficeri britanik Frederick Gustavus Burnaby i cili udhëtoi në Turqi në fund të shekullit të 19-të është një nga këto personalitete të rralla. Përshkrimet e tij në librin e tij *Mbi kalin nëpër Azinë e Vogël* japin një llogari të paanshme dhe të saktë të Perandorisë Osmane në atë kohë. Në një kohë kur Turkofobia ishte në kulmin e saj në Britani, ky oficer britanik ishte në Anadoll dhe shpjegoi atë që pa:

Njerëzit në këtë vend që abuzojnë me kombin turk dhe i akuzojnë ata për çdo gjë që ndodh, do të ishte mirë të udhëtonin pak në Anadoll ... shumë shkrimtarë që e quajnë veten të krishterë mund të marrin një mësim nga Turqit në Azinë e Vogël.²⁶²

Po kështu, shumë korrespondentë të huaj, të cilët kishin qenë në Turqi gjatë luftërave Ballkanike, shkruajtën të vërtetën për Turqit:

Meqenëse ka në Evropë filozofë kolltukësh që shkruajnë se ushtarët turq janë plaçkitës dhe vrasës, është detyra jonë të protestojmë me energji. Ne gjithmonë i kemi gjetur Turqit duke treguar një qëndresë dhe përmbajtje të hatashme; kurrë nuk kemi qenë dëshmitarë të ndonjë veprimi mizorie.²⁶³

Byroja e propagandës e Nëntokës Shtetërore Britanike: 'Wellington House'

Nëntoka Shtetërore Britanike përdori propagandën në mënyrën më efektive gjatë Luftës së Parë Botërore. Lufta po bëhej jo vetëm në fushëbetë, por edhe në titujt e gazetave. Operacionet e propagandës së zezë duke hedhur baltë mbi armikun dhe duke shfajësuar aleatët kontribuan në suksesin e britanikëve në Luftën e Parë Botërore. Fushata ogurzeze e propagandës i dha një nga goditjet më vdekjeprurëse Perandorisë Osmane. Është e rëndësishme të zbulohen politikat e mbrapshta që Nëntoka Shtetërore Britanike ndoqi gjatë Luftës së Parë Botërore, sepse vetëm atëherë mund të kuptojmë strategjitë e përdorura sot. Nëntoka Shtetërore Britanike vazhdon të udhëheqë një propagandë të fortë duke përdorur mediat dhe organizata të ndryshme për të sjellë vendet që synon më afër rrëzimit, për të përhapur gënjeshtër dhe për të shtuar vende të reja në perandorinë e saj të kolonive. Një gjë është e sigurtë, rrjeti i përmendur i propagandës është më efektiv dhe më i përhapur sot se kurrë më parë.

Byroja e propagandës së Britanisë, nën drejtimin e Nëntokës Shtetërore Britanike, hartoi me kujdes propagandën antiturke gjatë Luftës së Parë Botërore. Institucionet dhe udhëheqësit amerikanë gjithashtu u bashkuan në proces, të nxitur nga e njëjta organizatë e fshehtë. Duket të kihet parasysh se përpjekjet e ngjashme propagandistike të institucioneve amerikane gjatë atyre ditëve u kryen kryesisht me nxitjen e Nëntokës Shtetërore Britanike. Gjatë dy luftërave botërore, ShBA-të morën informacionin dhe inteligjencën e tyre vetëm përmes burimeve britanike. Kjo i mundësoi Nëntokës Shtetërore Britanike të përcaktojë miqtë dhe armiqtë e ShBA-ve për të.

Gjatë Luftës së Parë Botërore, Zyra e Jashtme Britanike ishte përgjegjëse për operacionet propagandistike të Nëntokës Shtetërore Britanike. Madje, zyra e Jashtme ngriti një 'Byro të Propagandës së Luftës' në ndërtesën e Shtëpisë së Uellingtonit në Buckingham Gate në Londër në vitin 1914 dhe caktoi Charles Masterman nga Dhoma e Lordëve si drejtor të saj. Nga ajo pikë e tutje, megjithëse struktura e saj institucionale dhe vetë udhëheqësit ndryshuan, propaganda e Nëntokës Shtetërore Britanike vazhdoi përmes 'Wellington House'.

Që nga ajo kohë, shumë njerëz dhe agjenci kanë punuar në përputhje me udhëzimet dhe direktivat e Wellington House, duke përfshirë politikanë, biznesmenë dhe madje edhe drejtues të mediave. Njerëzit që kryenin propagandën pas dyerve të mbyllura u quajtën 'qeveria e padukshme'. Qëllimi ishte manipulimi i masave në përputhje me drejtimin e

dëshiruar të propagandës. Për ta arritur këtë, fjalët, frazat dhe retorika u zhvilluan me kujdes për t'u tërhequr emocioneve, besimeve dhe pritjeve të njerëzve. Gënjeshtret përsëriteshin sikur të ishin të vërteta të thjeshta.

Wellington House jo vetëm që manipuloi opinionin publik britanik gjatë Luftës së Parë Botërore, por realizoi projekte edhe për njerëzit e vendeve të tjera. Më 19 Shtator të vitit 1916, Kryeministri Britanik Lloyd George konfirmoi këtë të vërtetë me fjalët e mëposhtme:

*Publiku e di vetëm gjysmën e historisë. Ata lexojnë për fitoret; kostoja është e fshehur.*²⁶⁴

Gjatë Luftës së Parë Botërore, Byroja e Propagandës së Wellington House botoi 400 artikuj në javë, të shtypura në 17 gjuhë të ndryshme dhe prodhoi libra, broshura dhe artikuj të panumërt. Në qershor të vitit 1915, numri i materialeve të shtypura dhe të shpërndara arriti në rreth shtatë milion. Kur mbaroi lufta, byroja kishte shpërndarë 106 milion materiale. Wellington House kurrë nuk kishte ndonjë problem buxhetor pasi Nëntoka Shtetërore Britanike e mbështeti gjithmonë me fondet. Ndërsa buxheti fillestar ishte vetëm 10,000 mij paund kur zyra u krijua për herë të parë, ajo u rrit me shpejtësi dhe arriti në 145,000 në vitin 1917.²⁶⁵

Kah fundi i luftës, disa deputetë britanikë filluan të kritikojnë këtë shfrytëzim të mediave. Për shembull, burrështetasi britanik Austen Chamberlain tha që shtypi humbi lirinë e tij dhe me lirinë e tij, ai gjithashtu humbi fuqinë e vërtetë.²⁶⁶

Gjatë Luftës së Parë Botërore, shënjestrat kryesore të kësaj propagande të shëmtuar ishin gjermanët dhe turqit. Pas përfundimit të luftës, të dy autoritetet britanike dhe ato të Belgjikës mohuan raportet se ushtarët gjermanë kishin varur priftërinjtë nga këmbanat e kishës në Holandë, ose se ata kishin goditur foshnjat me bajoneta.²⁶⁷ Burimi i kësaj propagande ishte përsëri Wellington House

Wellington House nuk shpërndau vetëm botime të ngarkuara me propagandë. Ajo vepronte gjithashtu si një autoritet mbikëqyrës për mediat tjera. Për shembull, lajmet nga fushëbeteja mund të mbërrinin në publik vetëm pasi filtroheshin nga sistemi i censurës së Wellington House. Ata caktonin dy fotografë zyrtarë dhe disa piktorë për të përshkruar situatën në luftë. Puna e tyre duhej të ishte në përputhje të plotë me direktivat e Wellington House. Asnjë fotograf ose piktor tjetër nuk u lejua të siguronte materiale; Wellington House e kishte ndaluar atë veprim.

Disa gazetarë dhe gazeta britanike u zgjodhën të raportonin lajmet në përputhje me udhëzimet e zyrës së propagandës. Natyrisht, këta njerëz shkruanin siç ju kërkua, duke paraqitur vetëm fotot e miratuara. Kushdo që guxonte të dilte nga këto rreshta për të interpretuar dhe fotografuar luftën në ndonjë mënyrë tjetër u sanksionua.²⁶⁸ Me fjalë të tjera, media britanike e paraqiti botën në mënyrën se si e përshkroi Nëntoka Shtetërore Britanike. Sot, situata nuk është shumë e ndryshme përveç se media e ndikuar nga Nëntoka Shtetërore Britanike është zgjeruar dhe është përhapur në të gjithë botën, me më shumë gazetarë që udhëheqin propagandën e saj.

Aktivitetet anti-turke të Wellington House përfaqësojnë një rrjet të gjerë të propagandës së zezë që vazhdon edhe sot. I ashtuquajtur 'gjenocidi armen' ky institucion i sajuar gjatë Luftës së Parë Botërore, u përdor veçanërisht për të provokuar opinionin publik amerikan kundër turqve dhe për të siguruar pjesëmarrjen e ShBA-ve në luftë si një aleat britanik. Këto pretendime dhe propaganda e Wellington House përdoren ende si levë kundër Turqisë.

Tani, le ti shqyrtojmë arsyet pse u fabrikua një gënjeshtër si 'gjenocidi armen':

Aleanca Britanike me Rusinë gjatë Luftës së Parë Botërore nuk ishte diçka që ShBA-të ishin të gatshme të praninin. Rusia ishte armike në atë kohë dhe publiku amerikan ishte mosbesues ndaj saj. Sidoqoftë, Britania duhej të mbante mbështetjen e Rusisë ndërsa bëri që Shtetet e Bashkuara të bashkohen me luftën. Për këtë, duhej të gjente një të përbashkët që mund t'i bashkonte këta dy gjigandë së bashku. Sipas planit, një armik i ri do të falsifikohesh dhe ai armik duhet të dukej sikur kishte kryer krime edhe më të mëdha se Rusia. Ky armik i përbashkët ishte Perandoria Osmane. Politikani turk Onur Öymen shpjegon situatën:

Kjo ishte një nga arsyet më të rëndësishme se pse zyra e propagandës britanike Wellington House përdori të ashtuquajturin pretendim të gjenocidit turk të armenëve si një nga pikat kryesore të propagandës. Në fakt, turqit vlerësoheshin shumë në botën islame në atë kohë. Britanikët vendosën të përdorin këtë pretendim për gjenocid për të njiollësuar imazhin e Perandorisë Osmane në botë dhe në botën Islame. Cili vend do të ndiqte një

udhëheqës që supozohej se masakroi më shumë se një milion njerëz? Kjo është ajo që britanikët kishin planifikuar.²⁶⁹

Kjo propagandë e zezë që Wellington House e nisi kundër Turqisë dha rezultatet që dëshironte Nëntoka Shtetërore Britanike. Si rezultat i një fushate sistematike, propaganda arriti të ndërtojë një opinion publik antiturk në ShBA. Çuditërisht, ashtu si sot, disa njerëz nga Turqia i dhanë mbështetje kësaj propagande të zezë, duke shkëmbyer vendin e tyre për fitime të vogla të ofruara nga Nëntoka Shtetërore Britanike, duke mos u interesuar aspak nëse bëhen tradhtarë apo jo.

Propaganda e Zezë kundër Turqve gjatë Luftës së Parë Botërore

Wellington House nisi një luftë të ashpër propagandistike kundër Turqisë, ashtu siç kishte bërë shumë herë më parë kundër të tjerëve. Shumë shkrimtarë dhe politikanë të famshëm u mobilizuan për këtë qëllim dhe u shkruan shumë libra, artikuj dhe broshura, përfshirë atë të historianit të njohur britanik dhe ekspertit të marrëdhënieve ndërkombëtare, Arnold J. Toynbee. Qëllimi ishte paraqitja e turqve si njerëz mizorë, shtypës, të lig dhe akuzimi i Perandorisë Osmane me akuzat krejtësisht të pabazuara.

Trajtimi i armenëve në Perandorinë Osmane, viteve 1915-1916, i njohur gjithashtu si Libri i Kaltërt, i shkruar nga Toynbee dhe James Bryce, një historian dhe politikan britanik, ishte material i pastër propagandistik i ngarkuar me gënjeshtër dhe shpifje kundër Turqisë. I krijuar për të shkaktuar ndjenja urrejtjeje dhe zemërimi të lexuesit, libri përbëhej nga histori imagjinare se si Turqit supozohet se masakruan Armenët.

Sidoqoftë, nuk u ofrua asnjë provë për pretendimet dhe historitë e përmendura dhe nuk kishte asnjë provë të fortë për ato akuzat. Onur Öymen shkruan si në vijim në lidhje me njerëzit, që pretendohet të jenë burimet e shumë pretendimeve në libër:

Personat e përmendur [në libër] quhen X, Y dhe Z etj. Kush janë këta X, Y, Z? Hetimet e hollësishme të studiuesit amerikan Prof. Justin McCarthy më në fund i dhanë një përgjigje të kënaqshme kësaj pyetjeje. Shumica e tyre ishin misionarë amerikanë që ishin aktivë në Turqi gjatë atyre viteve, të cilët hodhën baltë mbi Turqinë në çdo mundësi që patën. Disa të tjerë ishin anëtarë të grupeve të dhunshme rebele armene,⁵⁹ nga 150 llogari u shënuan nga misionarët, 52 prej tyre u dërguan nga armenët. Raportet e partisë armene Dashnak, të cilët konsideronin osmanët si armiqtë e tyre kryesorë, u përdorën gjithashtu në libër. Pjesa tjetër u mor nga gazetatat që simpatizojnë kazasin ose çështjen armene. Me fjalë të tjera, gazetatat armene të asaj kohe u përdorën gjithashtu si një armë propagandistike.²⁷⁰

Një libër tjetër i botuar nga Wellington House gjatë të njëjtave ditë ishte një libër i quajtur 'Armenia Martyred' ku libër pretendohet të jetë shkruar nga Faiz El-Ghusein. El-Ghusein u paraqit si një burokrat dhe oficer rrethi që punonte në Perandorinë Osmane. Sidoqoftë, historianët nuk gjetën asnjë gjurmë të një personi me atë emër dhe titull në asnjë periudhë të historisë Osmane.²⁷¹ Ky libër, i shkruar nga një emër imagjinar, ishte thjesht më shumë material propagandistik i Nëntokës Shtetërore Britanike.

Siç u shpjegua në kapitullin e mëparshëm, është e vërtetë që disa armenë u provokuan nga Nëntoka Shtetërore Britanike gjatë Luftës së Parë Botërore kundër Perandorisë Osmane. Si pasojë, disa morën një qëndrim anti-turk për shkak të nxitjeve të tillë. Sidoqoftë, do të ishte gabim t'ua përshkruajmë këtë qasje të gjithë vëllezërve tanë armenë. Në të vërtetë, Hovhannes Katchaznoui, i cili ishte anëtar i Partisë Dashnak dhe kryeministri i parë i Republikës së Armenisë, tha gjatë një fjalimi në Kongresin e Partisë Dashnak në vitin 1923 se partia Dashnak ishte drejtpërdrejt përgjegjëse për katastrofën që pësoi Armenia. Ai tha se armenët, të përgatitur nga rusët, masakruan popullsinë myslimane gjatë atyre ditëve dhe së bashku me Dashnakët ndërtuan një diktaturë në Armeni ndërsa terrorizmi armen u vu në lëvizje për të fituar opinionin publik perëndimor. Ai gjithashtu përmendi se përballë të gjitha këtyre zhvillimeve, Turqia veprroi me një ndjenjë të justifikuar të vetëmbrojtjes. Sipas tij, nuk ka kush të fajësohet përveç administratës Dashnak.²⁷²

Nëntoka Shtetërore Britanike përdori në mënyrë të përsëritur historinë të cilën e sajoi kundër turqve. Ky komplot që u shpik në fillim të Luftës së Parë Botërore po përdoret ende si levë kundër Turqve në çerekun e parë të shekullit 21.

Arma më efektive për t'iu kundërvënë këtij komploti është 'dashuria'. Nëse ne i duam dhe u qëndrojmë pranë vëllezërve tanë armenë më shumë se kurrë, nëse sigurohemi që ata të ndihen si në shtëpinë e tyre në Turqi dhe të ndërtojmë marrëdhënie të ngushta me shtetin armen, ky komplot i lig i Nëntokës Shtetërore Britanike do të prishet njëherë e përgjithmonë.

Një pikë tjetër e rëndësishme është rreziku i ngatërrimit të misionarëve të përmendur këtu me klerikët e vërtetë të ngarkuar me përhapjen e krishterimit. Të krishterët e vërtetë janë njerëz me zemër të mirë dhe të sinqertë, plot dashuri. Ata kurrë nuk do ta lejojnë veten të përdoren në një propagandë kaq të ndyrë, që ka për qëllim të mbjellë farërat e urrejtjes. Misionarët në fjalë ishin spiunë të së vërtetës të lidhur drejtpërdrejt me Wellington House. Ata hynë në tokat osmane me maskën e misionarëve dhe kryen veprimtari spiunazhi dhe provokimi. Deklaratat në raportet e përgatitura nga këta të ashtuquajtur misionarë vërtetojnë qartë këtë fakt:

Në të gjitha shkrimet e misionarëve, ... Turqit e urrenin arsimimin dhe gjithmonë përndjeknin të shkolluarit. Asnjë i krishterë nuk kishte qenë kurrë pjesë e qeverisë osmane. Turqit kishin nevojë për të krishterë sepse turqit ishin gjenetikisht të paaftë për të qenë "mjekë, dentistë, rrobaqepës, marangozë, çdo profesion apo tregti që kërkon aftësinë më të vogël". Dhe misionarët shkruan se, tani që Turqit kishin vrarë Armenët, Perëndimorët do të duhej të qeverisnin Perandorinë Osmane, sepse Turqit e kishin çliruar veten nga i vetmi popull me tru, Armenët dhe Turqit nuk mund të drejtonin vetë vendi.²⁷³

Këta misionarë dërguan një duzinë raportesh me përmbajtje të ngjashme si të Toynbee, të cilat më pas u dërguan në ShBA përmes Uellington House. Duhet të theksohet se raportet përmbajnë udhëzimin, "Në asnjë rrethanë mos zbuloni burimin."²⁷⁴

Mbështetësit Turq të Wellington House

Çuditërisht, retorika e urreyer anti-turke e zhvilluar gjatë Luftës së Parë Botërore gjeti mbështetje në mes të disa gazetarëve osmanë të njohur për natyrën e tyre anglofile. Këta njerëz pranuan t'i shërbenin Nëntokës Shtetërore Britanike dhe të tradhtonin vendin e tyre në këmbim të fitimeve të vogla, të cilat ndonjëherë nuk ishin asgjë tjetër veçse të ishin të lidhur me Nëntokën Shtetërore Britanike. Njerëz të tillë kanë ekzistuar gjithmonë gjatë historisë së kësaj strukture dhe ato ekzistojnë edhe sot. Për shembull, një gazetar turk Refi Cevat Ulunay nga Alemdar shkroi fjalinë tronditëse më 21 Prill të vitit 1919: "*Ne jemi duke pritur për Britanikët. Turqit nuk mund të udhëheqin vetë*". Dhe më 14 korrik të vitit 1919 ai bëri vërejtjen vijuese:

Është e domosdoshme që Turqia të mbështesë veten tek një vend i huaj. Dhe ky vend nuk mund të jetë askush tjetër përveç Britanisë. Nuk ka asnjë rrezik për botën islame nëse dorëzon çelësat e Islamit në duart e britanikëve.²⁷⁵

Disa vjet pas botimit të *Librit të Kaltërt* dhe librave të tjerë anti-turq nga Wellington House, disa organizata mediatike që mbështetën Armëpushimin e Mudros filluan të bërtisnin në unison se dorëzimi i vendit në duart e britanikëve është gjëja e duhur për tu bërë. Gjatë viteve të okupimit të Stambollit, ata vazhduan të lavdëronin Britanikët. Sot, disa grupe mediatike dhe gazetarë me një mendim të ngjashëm dhe që veprojnë nën krahët e Nëntokës Shtetërore Britanike e vazhdojnë këtë mision.

Provokimi i të ashtuquajturëve misionarë dhe disa armenëve të dhunshëm e rebelë u bazua në pretendimet e pabazuara se armenët dhe të krishterët u persekutuan nga Perandoria Osmane dhe se ata trajtoheshin si qytetarë të klasit të dytë. Sidoqoftë, është një fakt i njohur historik që popullata jomyslimane e Perandorisë Osmane gëzonte tërësisht të njëjtat të drejta si myslimanët, veçanërisht pas Ediktit të Reformave. Nga fundi i shekullit të 19-të, jomyslimanëve iu dha e drejta e votës, u përfaqësuar në Parlament dhe mbajtën poste të rëndësishme administrative. Për shembull, gjatë mandatit të Ali Pashës si Vezir i Madh, Ministri i Punëve Publike ishte një Armen me emrin Krikor Agaton dhe Ohannes Gümüshyan ishte gjithashtu një Armen i cili u caktua në të njëjtën zyrë. Shumë armenë shërbyen si ministra të ngarkuar me tregtinë, pylltarinë dhe minierat. Pas shpalljes së kushtetutës në vitin 1876, Parlamenti Osman kishte 46 deputetë jomyslimanë dhe 9 prej tyre armenë. Në parlamentin e ngritur pas shpalljes së kushtetutës së dytë, 11 deputetë armenë

shërbyen ndërsa 12 shërbyen në Parlamentin e vitit 1914. Katër nga ata deputetë armenë ishin anëtarë të Hunchak dhe dy anëtarë të partive Dashnak. Në mënyrë të ngjashme, Parlamenti i vitit 1908 kishte 13 anëtarë grekë dhe 5 hebrenj.²⁷⁶

Për më tepër, më shumë se 25% e stafit në Ministrinë e Jashtme dhe më shumë se 10% e stafit në Ministrinë e Drejtësisë të Perandorisë Osmane ishin jomyslimanë. Për më tepër, midis 1880 dhe 1912, 7% e studentëve të Shkollës së Shkencave Politike, që dihet se është shkolla e administratorëve të ardhshëm, ishin përsëri jomyslimanë.

Historiani Justin McCarthy ekspozon Wellington House

Profesori i famshëm i historisë amerikane Justin McCarthy, i cili është ekspert për Perandorinë Osmane, Turqit dhe Lindjen e Mesme, ofron detajet e mëposhtme të rëndësishme në lidhje me Wellington House dhe aktivitetin e saj propagandues antiturk:

Wellington House tërhoqi disa nga mendjet më të dalluara në qeverinë britanike. Historiani Arnold Toynbee ishte këshilltar i Wellington House nga vitit 1914 dhe qëndroi deri në vitin 1917 në komitetin që mbledhje çdo ditë dhe vendoste politika propagandistike. Figura të tjera private dhe publike dhe anëtarë të organizatave patriotike gjoja joqeveritare bashkëpunuan ose vepruan nën drejtimin e propaganduesve zyrtarë.¹ Universitetet Britanike ofruan broshura dhe pamfleta propagandistike.

Sipas standardeve të kohës, përpjekja për propagandë britanike ishte një ndërmarrje kryesore. Deri në vitin 1917, Wellington House kishte një staf prej 54 personash dhe mund të thërriste ndihmë nga departamentet dhe ministritë e tjera. ...

Raporti i parë (qershor, 1915) i Wellington House renditi shpërndarjen e rreth 2.5 milion kopjeve të librave, pamfleteve dhe propagandave të tjera të shkruara në 17 gjuhë. Raporti i dytë (shkurt, 1916) renditi 7 milion kopje të qarkulluara. Në vitin 1914, Propaganda Britanike shpërndau 45 botime të ndryshme; më 1915, 132; më 1916, 202; në vitin 1917, 469.2 Fatkeqësisht nuk ekziston asnjë rekord i shpërndarjes përtej vitit 1917. Mund të supozohet se numrat vazhduan të rriten. E gjitha u bë në fshehtësi dhe u bë në mënyrë kreative.

Përkrahimi i Wellington House ishte i thjeshtë, i njëjtë me të gjithë propagandistët. Ata duhej t'i bënin armiq të dukeshin sa më keq dhe të bënin që miqtë e tyre, e posaçërisht vetë britanikët, të dukeshin sa më mirë. Fokusi i tyre kryesor ishte Gjermania, por shumë përpjekje u bë edhe kundër turqve.

Ata shkatërruan të gjitha të dhënat e Zyrës së Propagandës menjëherë pas luftës. Kjo e ka bërë të vështirë rindërtimin e veprimtarive të zyrës së propagandës në kohën e luftës. [Sidoqoftë], disa të dhëna të Wellington House u dërguan në zyra të tjera në Qeverinë Britanike. Megjithëse origjinalet u shkatërruan, kopjet ndonjëherë mbaheshin në departamentet përkatëse të Zyrës së Jashtme, veçanërisht në regjistrat e Zyrës së Jashtme për Shtetet e Bashkuara. Numri i dokumenteve është modest, por ato tregojnë një pjesë të vogël të operacioneve të Wellington House kundër Turqve.

Pavarësisht nga përpjekja për të fshirë të dhënat historike, ekziston një burim i mirë i botimeve aktuale të Wellington House: Regjistrimi i librave propagandistikë të shpërndarë nga Wellington House u mbajt në një libër të shkruar me dorë, të lidhur me kujdes. ... Këto libra u dërguan në Bibliotekën e Zyrës së Jashtme, e cila përfundimisht u hap për studiuesit. ... Libri kryesor siguron një pamje të aktiviteteve të zyrës së propagandës britanike. ...

Botimet e shënuara në libër janë vetëm libra ose pamfleta të mëdha. Ato nuk përfshijnë njoftime për shtyp, artikuj dhe materiale të tjera. Temat e përgjithshme të propagandës janë konsistente nga puna në punë: [Kombi fisnik turk është mbi vërejtje të tilla]

- Turqit janë sundimtarë jolegjitimë të cilët kanë shkatërruar të gjitha tokat në të cilat kanë sunduar. Sundimi evropian mbi Lindjen e Mesme do të ishte më i përshatshëm.

- Turqit janë myslimanë që urrejnë të gjitha fetë e tjera, veçanërisht krishterimin. Ata gjithmonë i kanë trajtuar keq të krishterët.

- Turqit janë fajtorë për mizoritë çnjerëzore ndaj të krishterëve, përfshirë vrasjet masive dhe krimet e tmerrshme seksuale.

- Gjermanët qëndrojnë prapa veprave të liga turke, ose sepse ata i urdhëruan veprat ose sepse kishin fuqinë t'i ndalonin ato dhe nuk pranuan ta bënin këtë gjë.

- Masa e njerëzve të Perandorisë Osmane u drejtohet britanikëve për shpëtim. Kjo përfshin myslimanët, të cilët vlerësojnë qeverinë e mirë që britanikët u kanë ofruar myslimanëve në Egjipt dhe Indi.

Propaganda britanike bëri përpjekje të mëdha për të lidhur gjermanët me turqit. Kjo ishte një dredhi inteligjente, veçanërisht në Shtetet e Bashkuara, ku kishte shumë ndjenja pro-gjermane, por myslimanët mbaheshin të përbuzur. Propaganda britanike "ofroi prova" se gjermanët nuk mund të ishin evropianë të vërtetë, sepse ata bashkoheshin me myslimanë të këqij [myslimanët janë mbi pretendime të tilla] dhe turq aziatikë. ...

Lista e botimeve në Librin kryesor është e gjatë, por për Lindjen e Mesme ka një numër më të kufizuar të librave. Tabela jep vetëm ato vëllime, por ofron një ide të gjerësisë dhe fushëveprimit të interesave të Wellington House. Ato përfshijnë Palestinën, Hebrenjtë dhe Sionizmin, dhe veçanërisht Turqit.³

1. George G. Bruntz, *Propaganda e Aleatëve dhe Rënia e Perandorisë Gjermane*, New York: Arno Press, 1972, f. 42

2. M. L. Sanders dhe Philip M. Taylor, *Propaganda Britanike gjatë Luftës së Parë Botërore*, 1914-18, Londër: Palgrave, 1982, f. 108

3. Justin McCarthy, "Wellington House dhe Turqit", Universiteti i Louisville, Departamenti i Historisë / SHBA

Propaganda e Zezë Antiturke e Destinuar për Myslimanët e Tjerë

Përpjekjet për të paraqitur *Librin e Kaltërt* të autorit Toynbee si një burim realist vazhduan për një kohë të gjatë. Bryce pohoi se njerëzit e paraqitur si burime në këtë libër nuk ishin në dijeni të njëri-tjetrit dhe u përpoq të ofronte prova se burime të pavarura siguronin informacion të besueshëm. Sidoqoftë, hulumtimet e historianit amerikan Justin McCarthy treguan se të ashtuquajturit misionarë krahasuan shënimet e tyre përpara se t'i dërgonin në Wellington House, ose për ta thënë më saktë, ata i krijuan ato së bashku. Me fjalë të tjera, *Libri i Kaltërt* nuk ishte asgjë tjetër veçse një skenar i përgatitur nga agjentë specialë.

Një tjetër libër anti-turk i botuar nga Wellington House propagandoi gënjeshtren se Turqit kishin masakruar 2 milion Armenë. Sidoqoftë, gjatë asaj kohe, numri i përgjithshëm i popullsisë armene që jetonte në Perandorinë Osmane ishte rreth 1 milion.²⁷⁷

Propaganda anti-turke u përhap jo vetëm në Britani dhe ShBA por edhe në vende të tjera. Propaganda e destinuar për myslimanët indianë ishte veçanërisht e rëndësishme. Deri në atë moment, myslimanët indianë e konsideronin Turqinë si një vend mik dhe një udhëheqëse e tyre. Mirëpo, Nëntoka Shtetërore Britanike e shikonte këtë simpati si një kërcënim serioz për interesin e saj. E dinte që në rast të një lufte me turqit, këta njerëz pa dyshim do të zgjidhnin anën e turqve. Gjithashtu, myslimanët indianë nuk do ta pranonin kurrë presionin britanik ndaj turqve dhe Nëntoka Shtetërore Britanike do të humbte ndikimin e saj në këtë rajon të rëndësishëm. Ky ishte një rrezik i madh që Nëntoka Shtetërore Britanike nuk mund ta merrte, veçanërisht në Indi, e cila kishte qenë një koloni e tyre për një kohë të gjatë. Prandaj, myslimanët dhe arabët indianë duhet të bindeshin se turqit ishin 'myslimanë të këqij'. Përpjekjet e mëvonshme propagandistike u hartuan në përputhje me rrethanat aktuale.

Tonybee përmbodhi pikëpamjen e Nëntokës Shtetërore për botën Islame duke thënë se Islami i Jugut (nga Maroku në Arabi), ose shkolla Ashari, nuk ishte më një kërcënim pasi dikush thjesht mund të blinte një sheik dhe t'i kontrollonte të gjithë. Por ai e konsideroi Islamin e Veriut (rajoni turk nga Stambolli në Bukhara), ose shkollën Maturidi, një kërcënim sepse ata ishin në paqe me shkencën dhe për këtë arsye, një revolucionar si Atatürku mund të dilte në çdo kohë, për këtë arsye, tha ai, masa paraprake duhet të merren paraprakisht.²⁷⁸

Qartazi, Atatürku prishi plotësisht planet e mbrapshta të Nëntokës Shtetërore Britanike për Turqinë.

Pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore, të gjitha provat që ekspozonin faktet në lidhje me përpjekjet propagandistike të Wellington House u shkatërruan. Kjo është shumë e dyshimtë, veçanërisht duke marrë parasysh se Britania mban një arkivë sistematik mbi historinë, e cila përdoret zakonisht për qëllime kërkimore. Natyrisht, botimet e Wellington House duhej shkatërruar në një mënyrë misterioze. Wellington House kishte dërguar disa dokumente në ministri dhe institucione të ndryshme gjatë luftës për qëllime propagandistike. Aktualisht, informacioni i vetëm në lidhje me aktivitetet e Wellington House përbëhet nga këto dokumente shumë të kufizuara. Mirëpo, edhe ky informacion i kufizuar zbulon se u botuan rreth dyzet libra, të cilat përfshinin pretendime të rreme se turqit shfarosën hebrenjtë, sllavët, shqiptarët, arabët dhe veçanërisht armenët.²⁷⁹

Pas luftës, Arnold Toynbee udhëtoi në Turqi si gazetar, studioi rajonin dhe dëshmoi humbjet e Turqisë për shkak të luftës. Ajo që pa e bëri atë të ndryshojë mendim plotësisht dhe ai pranoi se *Libri i Kaltërt* ishte një libër mashtrues i shkruar për qëllime propagandistike. Këtë herë, ai shkroi libra me pikëpamje të favorshme për popullatën turke. Sidoqoftë, *Libri i Kaltërt* i cili është plot gënjeshtër është ende i popullarizuar edhe sot.

Në vitin 2005, qeveria turke, me mbështetjen nga partia kryesore e opozitës, kërkoi që Britania e Madhe t'i kërkojë falje Turqisë për *Librin e Kaltërt*. Qeveria turke theksoi pikat e mëposhtme për këtë kërkesë:

- * ky libër përfshinte akuza të pabazuara dhe u përdor për propagandë të zezë gjatë Luftës së Parë Botërore,
- * u prodhua nga komisioni Bryce,
- * shumë njerëz, përfshirë vetë Toynbee, më vonë pranuan se ky libër ishte prodhuar qëllimisht si propagandë kundër Turqisë.

Në mënyrë mjaft interesante, qeveria britanike kërkoi falje për propagandën e saj të zezë kundër Gjermanisë, por kurrë nuk i dha të njëjtën mirësjellje qeverisë turke. Falja ndaj Gjermanisë arriti në një pranim se Wellington House kishte qenë një institut propagandistik, por një kërkim falje e tillë nuk iu bë qeverisë turke, e cila duhej të ishte e para që do ta merrte atë përgjigje.²⁸⁰ Pavarësisht nga të gjitha përpjekjet, kjo falje nuk erdhi kurrë dhe *Libri i Kaltër* mbajti popullaritetin e tij midis qarqeve të caktuara.

Siç u shpjegua më parë, çështja armene ishte një komplot i Nëntokës Shtetërore Britanike i përgatitur si levë kundër turqve. Është e rëndësishme të kujtojmë se planet e Nëntokës Shtetërore Britanike për ti përçarë osmanët nuk kanë pasur sukses plotësisht dhe tokat turke ende po shënjestrohen me politika të ngjashme. Për këtë arsye, Nëntoka Shtetërore Britanike, në përpjekjen e saj për të dobësuar, përçarë dhe kontrolluar Turqinë, nuk do të tërheqë kurrë skenarin e saj dhe as nuk do t'i japë fund propagandës së saj ndaj turqve. Mënyra më e mirë për të prishur plane të tilla do të jetë forcimi dhe kultivimi i lidhjeve tona vëllazërore dhe miqësore me armenët.

Shumë njerëz të guximshëm që ishin dëshmitarë të ngjarjeve që ndodhën gjatë kësaj epoke të propagandës intensive folën pa frikë të vërtetën. Për shembull, një oficer francez i cili ishte i pranishëm në rajon gjatë incidenteve me armenët, dha rrëfimin vijues:

Ata na mashtruan me histori bandash. Në të vërtetë, nuk kishte pasur kurrë një gjenocid armenë... Turqit, në pozicionin e vetëmbrojtjes, u duhej të merrnin disa masa paraprake... Për një komb ndërluftues, kauza më fisnike është përpjekja për të shpëtuar vendin dhe kjo bëri që turqit të merrnin masa. U mashtruam. Turqit janë njerëz të mirë. Bisedat e gjenocidit janë thjesht mite të shpikura për të na joshur dhe për të na provokuar kundër osmanëve.²⁸¹

Një tjetër autor francez, Claude Farrère, kritikoi shtypin francez që dha gjykime nën ndikimin e Nëntokës Shtetërore Britanike dhe u dërgoi mesazhin vijues të rinjve turq:

Turqit nuk kanë frikë nga plumbat ... Por unë po u bëj thirrje të rinjve turq. Ata duhet ta dinë se nuk po luftojnë me armikun vetëm në fushën e betejës. Ndonjëherë ka një luftë shumë më të rëndësishme sesa ajo që bëhet nga ushtritë. Është luftë politike. Armiqtë e turqve po përpiqen të mashtrojnë, duke u përpjekur të mashtrojnë publikun evropian ... Hapni sytë dhe ruhuni nga kjo propagandë.²⁸²

Është një befasi e këndshme që kishte të huaj të ndjeshëm që thanë të vërtetën për atë që kishte ndodhur kur kishte njerëz edhe në Perandorinë Osmane që zgjodhën të mbështesnin propagandën anti-turke të Nëntokës Shtetërore Britanike. Kjo tregon se kritikën këtu nuk drejtohen ndaj vendeve të përmendura ose popujve të tyre, por vetëm shteteve të thella mafioze të pranishme në ato vende. Kombet janë të pafajshëm ato kanë qenë dhe do të jenë gjithmonë miqtë tanë. Kritika ndaj Nëntokës Shtetërore Britanike ka për qëllim vetëm të demaskojë komplotet e përmendura, për të treguar irracionalitetin e asaj që është bërë dhe për t'i nxitur ata njerëz dhe institucionet e tyre të bëjnë gjënë e duhur.

Ndikimi i Wellington House në ShBA

Gjatë Luftës së Parë Botërore, Nëntoka Shtetërore Britanike preu kabllon e telegramit që lidhte Gjermaninë me ShBA-të. Për këtë arsye, publiku amerikan po merrte të gjitha lajmet nga burimet britanike dhe përmes një filtri britanik. Në mënyrë të ngjashme, britanikët censuruan llogaritë e gazetarëve amerikanë në Evropë. Edhe pse administrata amerikane ishte pjesërisht e vetëdijshme për censurimin, populli amerikan nuk ishte plotësisht i vetëdijshëm se e gjithë kjo ishte pjesë e përpjekjes së propagandës së Nëntokës Shtetërore Britanike. Propaganda e mbështetur nga metoda të tilla i dha mbështetje serioze Nëntokës Shtetërore.

Kështu shpjegon Sir Gilbert Parker, kreu i fushatës propagandistike, efektet e përpjekjeve të tij:

Ne kemi një organizatë jashtëzakonisht të përhapur në Shtetet e Bashkuara, por që nuk e di se është një organizatë. Është punuar tërësisht nga shoqatat personale dhe e frymëzuar nga përpjekja vullnetare, e cila është rritur në mënyrë entuziaste dhe është fuqizuar me kalimin e kohës ... Më në fund duhet të vërehet se asnjë sulm nuk është bërë ndaj nesh në asnjë lagje të Shteteve të Bashkuara dhe që në sytë e popullit amerikan natyra e qetë dhe nëntokësore e punës sonë ka pamjen e patriotizmit dhe ndërmarrjes private...²⁸³

Është e qartë, propaganda mashtruese e Nëntokës Shtetërore Britanike krijoi efektin e dëshiruar në publikun amerikan. Amerikanët me qëllime të mira dështuan të shohin planet e mbrapshta të propagandës dhe u drejtuan në drejtimin e formësuar nga Nëntoka Shtetërore Britanike.

Raportet e Viscount Bryce, një nga bashkëautorët e famshëm të *Librit të Kaltërt*, u përgatit me qëllimin specifik të krijimit të një ndjenje antiturke në publikun amerikan. Këtu janë disa nga vërejtjet e Bryce kundër Turqve në Raportin e tij:

Qeveria turke ka qenë gjëja më e keqe që e ka goditur njerëzimin gjatë pesëmbëdhjetë shekujve të fundit. Turqit kanë qenë gjithmonë siç i quante një historian i shquar evropian i gjeneratës së fundit - "asgjë më shumë sesa një bandë grabitëse të vendosur në territore të cilat ata kishin pushtuar dhe shkatërruar". Ata kurrë nuk janë bërë të civilizuar, kurrë nuk kanë ngulitur ose provuar të zbatojnë ndonjë nga parimet mbi të cilat duhet të zbatohet qeveria e civilizuar. Deri më tani nga përparimi me progresin e viteve, ato kanë shkuar vetëm duke u përkeqësuar. Egërsira ishin kur zbritën në Azinë Perëndimore nga fushat e Turkistanit, egërsira ishin kur Edmund Burke [burrështetas dhe autor britanik] i përshkroi kështu njëqind e tridhjetë vjet më parë, dhe qeveria e tyre ende mban karakterin e saj të egër dhe të pamëshirshëm.²⁸⁴

Bryce më pas shkruajti një libër me titull *Trajtimi i Armenëve në Perandorinë Osmane* dhe vazhdoi fushatën e tij shpifëse përmes këtij libri. Historiani McCarthy shpjegoi se autori i vërtetë i librit ishte Toynbee. Sipas McCarthy, të gjitha teknikat e dukshme në raportin e përmendur armenë ishin identike me raportin e falsifikuar më vonë që detajonte dhunën gjermane në Belgjikë. Ky raport gjithashtu përfshiu informacione anonime të mbledhura nga burime jo të besueshme, por nuk kishte prova përfundimtare që njerëzit e përmendur në raport vërtet i kishin thënë ose shkruar ato gjëra.²⁸⁵

Me kalimin e kohës, u zbulua se asnjë nga rrëfimet e dhunës që përfshinte raportin e Bryce mbi gjermanët nuk ishin të vërteta. Kjo është ajo që autori H. C. Peterson shkruan për raportin e përmendur:

Raporti i tij [Bryce] është një nga shembujt më ekstremë të përkufizimit të propagandës si "vrasje me fjalë". Ishte në vetvete një nga mizoritë më të këqija të luftës.²⁸⁶

E njëjta metodë u përdor kundër turqve; e njëjta fushatë e zezë propagandistike u drejtua kundër atyre duke përdorur të njëjtat metoda nga të njëjtët njerëz. Gjermania vite më vonë mori një kërkim falje nga Britania për padrejtësinë e bërë, por turqit ende duhet të merren me të njëjtën fushatë propagandistike.

Nëntoka Shtetërore Britanike dërgoi pikat kryesore nga Raporti Bryce në gazetat Amerikane për botim. Kjo është ajo që McCarthy shkruante për gazetat Amerikane:

Gilbert Parker reported "The New York Times, Philadelphia Public Ledger, and the Chicago Herald ... devoted much space to the advance sheets of 'these Armenian horror stories.'" Current History a monthly magazine feature of the New York Times made the Bryce Report the centerpiece of a series on anti-Turkish articles, quoting the entire lengthy introduction of the Bryce Report and summarizing supposedly the most ghastly portions of the book. The New York Times itself devoted three pages to extracts from the Bryce Report. The New Republic praised Bryce on his selection of sources and evidence, without mentioning that most of the sources were anonymous, then went on to summarize the material and condemn the Turks. Other papers and magazines did the same, summarizing or quoting directly from the report.²⁸⁷

Me fjalë të tjera, asnjë burim nuk u dha në botimet e Nëntokës Shtetërore Britanike dhe Turqit u vunë në shënjestër padrejtësisht pasi këto pretendime të rreme ju plasuan publikut Amerikan. Duhet të mbahet mend se objektivi i vërtetë i propagandës së Nëntokës Shtetërore Britanike ishte masa që nuk ishte në dijeni të së vërtetave rreth Luftës së Parë Botërore dhe Lindjes së Mesme. Pothuajse të gjitha raportet e lajmeve të lexuara nga publiku amerikan dhe britanik gjatë atyre ditëve ishin shkruar nga propaganduesit e Nëntokës Shtetërore Britanike. Njerëzit britanikë dhe amerikanë u mashtruan nga këto lajme të pavërteta. Kjo është mënyra se si historiani amerikan McCarthy, i cili ekspozoi trajtimin e padrejtë të turqve, shpreh habinë e tij që propaganda mashtruese e përmendur vazhdon edhe sot:

Më mahnitës është fakti që propaganda britanike kundër turqve është injoruar në botimet shkencore mbi propagandën e kohës së luftës. Çdo studim serioz shkencor i propagandës britanike gjatë Luftës së Parë Botërore me të drejtë etiketon propagandën britanike kundër gjermanëve si një sulm i ndërtuar me kujdes ndaj së vërtetës në interes të fitores. Të njëjtat studime nuk marrin parasysh as propagandën britanike kundër turqve, përveç kur ishte gjithashtu një sulm ndaj gjermanëve. Ajo që propagandistët britanikë u bënë gjermanëve ata i bënë edhe turqve, megjithatë askujt nuk i ka interesuar. Propaganda kundër gjermanëve është dënuar ndërkohë që lajmet kundër turqve vazhdojnë të botohen. Raporti famëkeq i Bryce mbi Armenët ribotohet dhe citohet... Ai ka fituar një rregull të respektit si një "Burim i Pranuar dhe i Besueshëm", ndërsa Raporti i Bryce kundër gjermanëve qëndron siç duhet i palexuar në raftet e pluhurosura të bibliotekave. Bibliografitë e shënuara mbi Luftën e Parë Botërore ose mbi gjenocidin si një temë shfaqin në mënyrë të dukshme botime propagandistike britanike të drejtuara kundër Turqve, pa ndonjë identifikim të tyre për atë se a është e vërtetë apo jo. Rregullat e përbashkëta të kritikës historike, të cilat përfshijnë verifikimin e burimeve, nuk janë marrë parasysh. Në fakt, Raporti i Bryce për Armenët Osmanë duhet të dërgohet në të njëjtën kosh plehrash historike si Raporti i Bryce për Gjermanët. Ai paraqet vetëm një burim mbi historinë e propagandës, jo mbi historinë e Lindjes së Mesme.²⁸⁸

Luftë në mes të propagandave: Lufta e Dytë Botërore

Ashtu si në rastin e Luftës së Parë Botërore, aftësitë propagandistike të Nëntokës Shtetërore Britanike patën një ndikim të madh në rrjedhën e Luftës së Dytë Botërore. Përpjekje të tilla dhanë kontributin më të madh në suksesin e Britanisë. Media britanike, veçanërisht shtrirjet e saj në BBC, luajtën rolin e tyre me shkathtësi gjatë dhe pas luftës. Për më tepër, BBC ende vazhdon detyrën e saj sot si një makinë propagandistike e Nëntokës Shtetërore Britanike.

Edhe Partia Naziste Gjermane, e cila ngriti një ministri propagande dhe që përdori në mënyrë efektive metodat e propagandës të ngarkuara me gënjeshtër, nuk mund t'i afrohej aftësive të Nëntokës Shtetërore Britanike në propagandën e zezë. Joseph Goebbels, i cili ishte ministri i propagandës së Hitlerit, përkroi Kryeministrin Churchill, anëtarin e rëndësishëm të Nëntokës Shtetërore Britanike, me fjalët e mëposhtme në artikullin e tij 'Fabrika e Gënjeshtërve të Churchill':

Është e habitshme që Z. Churchill... i përmbahet gënjeshtrove të tij, dhe në fakt i përsërit ato derisa ai vetë t'i besojë ato. ... Ata e përdorën mjeshhtërisht mashtrimin gjatë Luftës Botërore, dikur opinioni botëror e besonte atë, gjë që nuk mund të thuhet sot. Anglezët ndjekin parimin se kur dikush gënjen, duhet të gënjetet në superlativ dhe t'i përmbahet asaj. Ata vazhdojnë gënjeshtrot e tyre, madje edhe duke rrezikuar të duken qesharakë.²⁸⁹

Siç dihet, është e rëndësishme të mbash të ngritur moralin publik gjatë kohës së luftës. Sidoqoftë, politika efektive e propagandës dhe manipulimi i shtypit nga Nëntoka Shtetërore Britanike gjatë Luftërave të Parë dhe të Dytë Botërore është i rëndësishëm në atë që tregon se si është në gjendje të kontrollojë median dhe të paraqesë gënjeshtrot si fakte, sa herë që e gjykon të arsyeshme. Në fakt, edhe pas përfundimit të luftës, ndikimi i Nëntokës Shtetërore Britanike në media vazhdoi, veçanërisht në lidhje me ndotjen e vendeve të caktuara. Si rezultat, trazirat, luftërat civile dhe grushtet e shtetit ndodhën në shumë vende të pavarura.

Kështu, Nëntoka Shtetërore Britanike arriti të vendoste ndikimin e saj mbi vendet e tjera, dhe kryesisht për shkak të kësaj politike të zezë propagandistike, administratat e shumë vendeve u bënë vartëse të strukturave të thella. Arma propagandistike, e cila ishte faktori kryesor kontribues për fitoren e Britanisë në minutën e fundit në Luftën e Dytë Botërore, ka qenë dhe është ende një nga forcat më të shquara dhe shkatërruese të Nëntokës Shtetërore Britanike.

Propaganda e shëmtuar vazhdon

Propaganda e Nëntokës Shtetërore Britanike, e cila arriti kulmin e saj gjatë luftërave botërore, vazhdon, megjithëse përmes metodave të ndryshme. Efektet e propagandës së Wellington House nuk kanë qenë të kufizuara në atë periudhë, por vazhdojnë edhe sot. Botimet propaganduese të Wellington House gjatë Luftës së Parë Botërore u ribotuan në mënyrë sistematike dhe shumë libra dhe kërkime iu referuan atyre për citime. Shumë prej atyre librave u postuan në Internet dhe u përhapën në të gjithë botën.


Sot, librat e Wellington House sugjerohen ende si libra shkollorë për klasat e historisë në kolegjet dhe universitetet amerikane dhe evropiane. Çështja e Turqisë dhe Armenisë ka qenë një temë me interes të veçantë për Wellington House dhe shumë botime të saj, përfshirë ato të Toynbee dhe El-Ghusein (një person imagjinar), përdoren nga shumë historianë dhe shkencëtarë të caktuar armenë si libra themelore të referencës historike. Botimet e reja të materialit mashtrues propagandistik nga Lufta e Parë Botërore, si *Libri i Kaltërt*, shtypen dhe shpërndahen në të gjithë botën sikur të jenë fakte historike. Propaganda e shëmtuar britanike e Nëntokës Shtetërore Britanike vazhdon sikur asgjë mos të ketë ndodhur, sikur komplotet e saja nuk u zbuluan kurrë. Qëllimi i tyre është të mashtrojnë ata që nuk kanë dëgjuar ende dhe nuk janë të vetëdijshëm për këtë propagandë të zezë.

Një pjese të madhe të publikut botëror aktualisht i është shpërlarë truri me këto histori të sajuara. Gjithçka që njerëzit mësojnë nga këto burime nuk është fakt, por gënjeshtër e zyrës së propagandës së Nëntokës Shtetërore Britanike.

Gjerësia e gënjeshtrove dhe shpifjeve të Nëntokës Shtetërore Britanike gjatë asaj kohe ishte kaq e shprehur, madje disa figura britanike u ngritën në protestë:

Ministri i Jashtëm Britanik Chamberlain pranoi në fjalimin e tij në Dhomën e Komunave në Dhjetor të vitit 1925 se të gjitha këto ishin gënjeshtrot propagandistike. Katër vjet pas luftës, belgët njoftuan se të gjitha pretendimet në botimet e përmendura ishin të pavërteta. Deputeti britanik Arthur Ponsonby dha një llogari të detajuar të raporteve të lajmeve të rreme të përgatitura nga zyrat e propagandës britanike gjatë Luftës së Parë Botërore. Në vitin 1938, autori dhe diplomati britanik Harold Nicolson tha fjalën në vijim gjatë fjalimit së tij në Parlament: 'Ne kemi gënjer shumë gjatë luftës'.²⁹⁰

Më shumë informacione në Librin e Kaltërt, erdhën nga Henry Morgenthau, i cili kishte qëndruar vetëm 26 muaj në Stamboll gjatë Luftës së Parë Botërore si ambasador Amerikan. Në librin e tij, Morgenthau tha gënjeshtren se Osmanët po përndjeknin Armenët. Vite më vonë, Associated Press i deklaroi të pavërteta këto pretendime në librin e Morgenthau. Profesori amerikan Heath W. Lowry tha se libri ishte një rekord i "gjysmë të vërtetave të papërpunuara dhe gënjeshtrove të plota".²⁹¹



Okupimi i Stambollit

Rëndësia e Stambollit

Libri i parë i shkruar ndonjëherë nga Nëntoka Shtetërore Britanike mbi planet e tyre në lidhje me tokat Osmane dhe Turke ishte libri i William Ewart Gladstone *Tmerret Bullgare dhe Pyetja e Lindjes*, botuar më 5 shtator të vitit 1876. Ky libër ishte veçanërisht i rëndësishëm sepse autori i tij kishte shërbyer si Kryeministri i Mbretërisë së Bashkuar katër mandate të ndara, për një periudhë 15 vjeçare në total. Ky nuk ishte pozicioni i vetëm i Gladstone. Ai gjithashtu veprroi si anëtar i Këshillit të Privatësisë - një nga institucionet kryesore nën ndikimin e Nëntokës Shtetërore Britanike që vepronte si një organ këshilldhënës për Mbretëreshën - dhe kaloi 57 vite në atë pozicion. Lordi Curzon, Lloyd George dhe Horace Rumbold, për të cilët do të tregohet më shumë në kapitujt vijues, ishin gjithashtu anëtarë të këtij Këshilli. Në librin e tij famëkeq prej 64 faqesh, Gladstone paraqiti planin e tij për të thyer Perandorinë Osmane dhe paraqiti planin e tij me pretendimin e shqyrtimit të "*Çështjes së Lindjes*".

Në librin e tij, Gladstone siguroi taktika të fshehta për të shpërbërë perandoritë nga brenda. Në të vërtetë, menjëherë pas botimit të librit, politikanët britanikë zhvilluan një dashuri të papritur për pakicat që jetonin nën sundimin osman. Duke i mbështetur ata me ambicie për pavarësi, ata provokuan pakicat kundër sundimit osman. Gladstone doli në krah të Bullgarëve, Lloyd George në krah të Grekëve dhe Armenëve, Lord Curzon në anën e Kurdët dhe Winston Churchill në anën e Arabëve. Duhet të theksohet se nuk ka asgjë të keqe me politikanët dhe udhëheqësit që krijojnë marrëdhënie miqësore me grupet etnike. Përkundrazi, kjo formon një pamje të mirë. Mirëpo, për fat të keq, këto miqësi të reja nuk ishin reale dhe kishin për qëllim vetëm të çonin përpara interesat britanike dhe të prishnin Perandorinë Osmane. Andaj, nuk është për t'u habitur, posa interesat britanike pushuan së ekzistuari, ashtu pushoj e ashtuquajturat miqësi e sinqertë.

Libri i Gladstone ishte mishërimi i propagandës së zezë (Kombi i nderuar Turk është mbi të gjitha akuzat e bërë nga Gladstone). Në këtë libër, ai u referohej turqve si '*një ekzemplar anti-njerëzor i qenieve njerëzore*' dhe shpresonte që ata të pastroheshin nga tokat ku sundonin. Gladstone nuk u përmbajt nga urrejta ndaj turqve dhe tha, '*Asnjë Qeveri nuk është më e pafuqishme në reformim se Turqit*'.²⁹² Arsyeja e vetme prapa gjithë këtyre shpifjeve ishte se Gladstone ishte një nga emrat më të fuqishëm të Nëntokës Shtetërore Britanike, i cili dëshironte copëtimin Perandorinë Osmane.

Plani sekret që filloi me betejën e Gallipolit

Nëntoka Shtetërore Britanike e konsideroi fushatën e Galipolit si fazën e fundit të planit të saj për të shkatërruar Perandorinë Osmane. Sidoqoftë, beteja që u zhvillua në Galipoli hyri në histori si një shembull epik i heroizmit të vërtetë. Ushtria e Perandorisë Osmane, të cilën evropianët e quajtën 'të sëmurë', mbrojti me trimëri ngushticën e Galipolit në shkëmbim të jetës së tyre, pavarësisht nga sulmi i plotë i Fuqive Aleate. Si rezultat, Forcat Aleate, të cilat përbëheshin nga Anzakë, Britanikë, Afrikanë të Veriut, Indianë dhe Francezë, u desh të tërhiqeshin midis një disfate poshtëruese. Kjo arritje e pabesueshme ushtarake e detyroi Nëntokën Shtetërore Britanike të shtynte planet e saj për copëtimin e Perandorisë Osmane deri në vitin 1918, kur u nënshkrua Armëpushimi i Mudros.

Ky sukses ushtarak ishte veçanërisht i rëndësishëm sepse vetëm katër vite më parë, ushtritë e shteteve të Ballkanit, të cilat më parë ishin të Perandorisë Osmane, kishin mundur rëndë Perandorinë. Në të vërtetë, po të mos kishte qenë ethet e tifos dhe epidemia e kolerës, ushtria bullgare do të kishte pushtuar Stambollin. Natyrisht, ushtritë Aleate kishin

besim se sukcesi i tyre do të ishte i shpejtë dhe i lehtë në Galipoli. Sidoqoftë, ushtria turke, me trimërinë e 250,000 dëshmorëve të saj, nuk i hapi dyert e Galipolit. Nxënës të shkollës ushtarake nga Stambolli dolën vullnetarë të bashkohen në luftë, duke pranuar me dëshirë sakrificën. Në të vërtetë, në vitet 1915 dhe 1916, Shkolla e Mesme Galatasaray nuk kishte asnjë të diplomuar, sepse studentët ishte vrarë në fushëbetejë. Në vitin 1917, kishte vetëm 5 studentë të diplomuar. 50 studentë të Shkollës së Mesme të Stambollit ishin vrarë në vetëm një betejë, e cila u zhvillua më 19 maj të vitit 1915. Shkolla e Mesme Vefa dhe Shkolla Mësimore Çapa për Djem gjithashtu nuk kishin asnjë të diplomuar gjatë po atyre viteve. Shkolla e Mesme Balıkesir dhe Shkolla Mësimore Balıkesir për Djem kishin vetëm 2 të diplomuar nga 1914 deri në 1918. Studentët në shumë shkolla në Traki, pasi më parë kishin humbur baballarët e tyre në luftërat Ballkanike, nuk hezituan të dilnin vullnetarë për të luftuar në Betejën e Galipolit dhe të bëhen edhe vetë dëshmorë. Edhe shkollat nga qytete të largëta si Sivas, Trabzon, Konya, Erzurum dhe Kastamonu humbën të diplomuarit e tyre 1916-1917 si martirë të nderuar dhe fisnikë të Galipolit. Efektet e humbjes së këtij brezi të arsimuar do të ndjeheshin rëndë si gjatë Luftës Turke për Pavarësi ashtu edhe gjatë viteve të para të Republikës. Megjithatë, ishte trimëria dhe gjaku i atyre të rinjve të pafajshëm martirë turq jo më të vjetër se 18 vjeç që prishën planet e mbrapshta të Nëntokës Shtetërore Britanike. Sot, situata nuk është shumë e ndryshme. Edhe një herë, për shkak të PKK-së terroriste, kemi shumë dëshmorë që kishin qenë ushtarë, oficerë, polici dhe mësues. Zoti e bekoji vendin tonë me shumë dëshmorë; Anadulli është atdheu ynë sepse toka e saj është e lagur me gjakun e dëshmorëve tanë të nderuar.

Armëpushimi i Mudros që u nënshkrua pas Luftës së Parë Botërore i dha fund luftës për Perandorinë Osmane. Ky Armëpushim gjithashtu i mundësoi Nëntokës Shtetërore Britanike të vinte në lëvizje planin e saj të copëtimit. Duke përdorur si shtirje klauzolën '*Aleatët të kenë të drejtë të pushtojnë çdo pikë strategjike në rast të ndonjë situatë që paraqet kërcënim për sigurinë e Aleatëve*', ata filluan zbatimin e planit të tyre të copëtimit, të cilin Britanikët e quajtën si '*zgjidhja e çështja e Lindjes*'. Synimi më i rëndësishëm në planet e tyre ishte pushtimi i Stambollit. Nuk është për t'u habitur, vetëm Stambolli midis kryeqyteteve të Fuqive Qendrore të mundura u pushtua pas Luftës së Parë Botërore. Dhe ishte ideja e vetë Lordit Curzon.²⁹³

Okupimi i Stambollit do të nënkuptonte arritjen e objektivave të shumta të Nëntokës Shtetërore Britanike

Trimëria turke gjatë Betejës së Galipolit e poshtëroi plotësisht Nëntokën Shtetërore Britanike në arenën ndërkombëtare. Ata ishin të bindur se nëse do të okuponin kryeqytetin e botës islame, do të kishin marrë hakun e tyre. E vërteta është që të gjithë politikanët e përfshirë në planifikimin, deklarin dhe zbatimin e fushatës së Galipolit, ishin duke ndjekur urdhrat e Nëntokës Shtetërore Britanike dhe natyrisht, pas disfatës, ata ranë nga pozita e tyre. Ata shpresonin se pushtimi do t'u siguronte ndikimin dhe fuqinë e humbur. Ky kishte qenë qëllimi i tyre kryesor.

Stambolli nuk ishte vetëm kryeqyteti i Perandorisë Osmane, por edhe kryeqyteti i botës islame. Ishte qyteti ku jetonte Kalifi i Myslimanëve. Për Nëntokën Shtetërore Britanike, një kryeqytet i pushtuar do të ishte një arritje e madhe e britanikëve, veçanërisht përse i përket ndikimit tek myslimanët që jetonin nën sundimin britanik, veçanërisht në Indi. Ata shpresonin që pushtimi do të frenonte çdo ndjenjë të mundshme anti-britanike ose lëvizje të pavarësisë, si dhe do të parandalonte myslimanët nga bashkimi nën një flamur të vetëm dhe se rregulli britanik do të respektohej në mënyrë absolute.

Vendimi për të pushtuar Stambollin përfshinte kontrollin e dy ngushticave, Bosforit dhe Dardaneleve. Marina detare britanike e ankoruar në ngushticën e Bosforit mbikëqyri daljet nga Marmara dhe ngushtica e Dardaneleve u mbajt gjithashtu nën kontrollin e britanikëve. Me fjalë të tjera, britanikët kishin kontrollin e hyrjes dhe daljes në Detin Marmara dhe rrjedhimisht në Detin e Zi. Kështu, ata mund të mbanin nën kontroll anijet luftarake ruse dhe të vendosnin taksa mbi tregtinë ruse. Pra kishin avantazh ndaj Rusisë Bolshevike të sapo krijuar. Shën Petersburg, ose Leningrad siç dihej gjatë kohës sovjetike, ishte porti i vetëm rus afër Evropës. Ishte i ngrirë për 6 muaj të vitit dhe i mungonte infrastruktura gjeografike ose strategjike e kërkuar nga marina ruse. Rusët gjithmonë dëshironin të kishin akses në ujërat më të ngrohtë. Megjithëse Deti i Zi ishte nën kontrollin rus, çdo shtet që kontrollonte ngushticat lehtë mund ta tejkalonte atë kontroll.

Britanikët, përmes okupimit të Stambollit dhe ngushticave, donin gjithashtu të mbanin nën kontroll Rusinë e pas-revolucionit.

Nëntoka Shtetërore Britanike po shikonte me padurim afinitetin në rritje midis bolshevikëve dhe lëvizjes turke të pavarësisë. Ata kishin frikë se rusët mund të forcoheshin përsëri dhe të ndiqnin një politikë imperialiste dhe besuan se nëse do të mund të kontrollonte ngushticat dhe Stambollin, do të ishte në gjendje të parandalonte një zgjerim të tillë.

Një objektiv tjetër i britanikëve për pushtimin e Stambollit ishte minimi i autoritetit të Kalifit mbi kolonitë britanike për të dhënë përshtypjen se sundimi britanik tashmë kishte zënë vendin e Sulltanit; Kalifi dhe e gjithë Perandoria Osmane tani ishte nën kontrollin britanik. Britanikët shpresonin se ata mund të shkurajonin nënshtetasit myslimanë dhe të frikësonin udhëheqësit fisnorë rajonalë, udhëheqësit fetarë dhe udhëheqësit e pakicave. Ata donin të jepnin një mesazh të qartë për të gjithë se nuk ka më kthim për Perandorinë Osmane. Pushtimi shënoi kulmin e Perandorisë Britanike. Përmes okupimit, ata dëshironin të shtypnin sundimin islam dhe të gjenin koloni të reja të mundshme.

Mesazhi më i rëndësishëm i pushtimit të Stambollit ishte largimi i turqve nga Evropa, me anë të së cilës Perandoria Osmane nuk do të konsiderohej më pjesë e Evropës. Stambolli kishte qenë gjithmonë 'Kryeqyteti Lindor' i Evropës. Grekët e lashtë, Venecianët, Romakët, Gjenezët dhe Bizantinët kishin zgjedhur këtë qytet të bukur si shtëpinë e tyre. Sundimi 600-vjeçar Osman në Stamboll e bëri Perandorinë Osmane Evropiane. Prandaj, okupimi do të nënkuptonte largimin e Turqve nga Evropa.

Publiku britanik e konsideroi aleancën osmane me Gjermaninë në Luftën e Parë Botërore si një tradhti dhe donte që kjo 'tradhti' të ndëshkohej. Sidoqoftë, siç u shqyrtua në faqet e mëparshme, kjo aleancë u imponua disi nga Nëntoka Shtetërore Britanike, por qarqe të ndryshme u shprehën që kjo e ashtuquajtur tradhti nuk duhet të mbetet pa u ndëshkuar. Nëntoka Shtetërore Britanike ishte i bindur se pushtimi i Stambollit do t'i jepte Perandorisë Osmane dënimin më të ashpër dhe do t'i bënte Turqit të paguanin çmimin e rëndë të tradhtisë. Në të vërtetë, shumë besuan se duke u marrë turqve Stambollin, do të vulosej disfata e tyre dhe bota islame do të ndalonte së shikuari turqit si 'ushtarët fitimtarë të Islamit'. Sipas Nëntokës Shtetërore Britanike, ky okupim duhej të ishte jashtëzakonisht poshtërues dhe përfundimtar, në mënyrë që të gjithë të bindeshin se Turqit u larguan për të mos u kthyer më. Nëntoka Shtetërore Britanike besonte se kjo ishte thelbësore për qëllimin e politikës së saj të dominimit dhe një tjetër shfaqje e mentalitetit të saj 'dyfytëresh' në raport me Perandorinë Osmane.

Mirëpo, planet britanike nuk do të funksiononin ngase nuk i merrnin parasysh njerëzit e Anadollit. Lëvizja e Pavarësisë së Anadollit e udhëhequr nga Mustafa Kemal për t'ia kujtuar gjithë botës se pse turqit u konsideruan ushtarët fitimtarë të Islamit. Gjatë tre viteve të ardhshme, fitimtarët e Luftës së Parë Botërore u tërhoqën plotësisht nga tokat Osmane, pasi kishin pësuar një humbje poshtëruese. Francezët, Italianët, Grekët dhe Britanikët, një nga një, pranuan humbjen, nënshkruan traktate paqeje dhe i kthyen trupat e tyre përsëri në shtëpi.

Stambolli: Qendra që zbuloi komplotet sekrete evropiane

Nëntoka Shtetërore Britanike e dinte që Stambolli ishte një qendër e rëndësishme që prishi në mënyrë efektive ekuilibrat në Evropë. Ata gjithashtu besuan se për sa kohë që Turqit do ta kontrollonin atë, ata do të vazhdonin të prishnin planet e tyre dhe kështu që ata donin të hiqnin Stambollin, Ngushticat dhe Trakinë nga zotërimi i Turqve. Ata ishin të bindur se administrata turke pa Stambollin nuk do të kishte më një qëndrim unik në lidhje me Evropën.

Sidoqoftë, Nëntoka Shtetërore Britanike gjithmonë ka zgjedhur të fshehtë planin e saj për të copëtuar Perandorinë Osmane pas maskimeve të ndryshme. Gjatë Luftës së Parë Botërore, pretendimi që përdorte ky projekt imperialist ishte qëllimi i supozuar i mbrojtjes së të drejtave të pakicave. Ata përhapën nocionin e gabuar për publikun britanik se

Perandoria Osmane po tregohej e pamëshirshme ndaj nënshtetasve të saj të krishterë dhe se armenët, grekët, asirianët dhe arabët e krishterë në tokat osmane ishin nën kërcënim. Ata i ndërtuan këto pretendime mbi pretendimet e rreme se të krishterët ishin pronarët e vërtetë të Anadollit dhe se turqit e kishin marrë atë territor me forcë. Për shembull, një anëtar i Parlamentit Viscount James Bryce tha gjatë një fjalimi në Dhomën e Lordëve, "*Azia e Vogël, Siria, Armenia dhe Arabia - kanë qenë shtëpitë e qytetërimeve të lashta; disa prej tyre gëzonin nën qeveritë të cilat ata drejtojnë një mijë ose pesëmbëdhjetë qind vjet më parë një jetë dhe prosperitet të vërtetë kombëtar dhe kishin një ndjenjë të vendit dhe misionit të tyre në botë të cilin ata e kanë humbur nën tiraninë turke për gjashtë shekujt e fundit*" Me shumë lehtësi, ai pohoi se Britania duhet të ndihmonte ato civilizime antike në mënyrë që ata të mund të rifitonin lirinë e tyre. Nëntoka Shtetërore Britanike pretendoi se sapo Stambolli të pushtohej, të ashtuquajturat politika 'të padrejta' do të merrnin fund. Gazetat britanike vazhdonin të pretendonin se Stambolli nuk ishte kryeqyteti kombëtar i turqve dhe se një shumicë e popullsisë ishte jomyslimane. Sidoqoftë, sipas regjistrimit të vitit 1919, 67% e banorëve të Stambollit ishin myslimanë. Numri kishte qenë më i lartë, por shumica e myslimanëve tashmë ishin vrarë në luftërat Ballkanike dhe gjatë Luftës së Parë Botërore.

Përkundër thashethemeve që Nëntoka Shtetërore Britanike kërkonte të përhapte, politikat e pakicave të Perandorisë Osmane ishin mbresëlënëse liberale dhe bujare. Perandoria Osmane kishte mbrojtur të drejtat e pakicave për 600 vite dhe pakicat jetuan si pjesë e rëndësishme e kombit Osman. Në fakt, anëtarët e komuniteteve pakicë nuk kishin asnjë problem të ngjiteshin në shkallët më të larta shoqërore për të arritur pozicione administrative. Shumica ishin të angazhuar në art dhe tregti dhe kishin jetuar jetë relativisht të pasur në pjesët më të bukura të Stambollit dhe tokave osmane në përgjithësi, për më tepër ata gëzonin mbështetje të fuqishme nga qeveria osmane. Edhe pas shpërbërjes së Perandorisë, ata vazhduan praninë e tyre në Turqi dhe ofruan mbështetjen e tyre për shtetin e ri Turk. Thashethemet që u përhapën në lidhje me pakicat nuk ishin asgjë tjetër veçse propagandë. Edhe disa nga spiunët britanikë që erdhën në Stamboll gjatë atyre viteve për të mbledhur informacione, më vonë pranuan se të jetesa e pakicave turke ishte e admirueshme.

Sidoqoftë, Nëntoka Shtetërore Britanike vazhdoi të përhapte propagandën e saj të zezë duke përdorur pakicat pasi ishte e bindur se pretendimet e rreme të 'grupeve të përndjekura' do të ishin një levë efektive për ndikim. Ata kishin të drejtë. Politikat okupuese të Nëntokës Shtetërore Britanike gjetën mbështetje te disa përfaqësues të pakicave. Patriarku Grek i Stambollit deklaroi në një letër dërguar Konferencës së Paqes në Paris se Çështja e Lindjes (plani për të copëtuar Perandorinë Osmane) nuk do të zgjidhej kurrë derisa Stambolli ti kthehej Grekëve.

Në mënyrë të ngjashme, nënshtetasit e krishterë të Perandorisë Osmane si Koptët në Egjipt, Maronitët në Liban dhe Asirianët e Krishterë në Siri, e konsideruan okupimin e Stambollit si një hap drejt pavarësisë së tyre dhe mbështetën planin djallëzor. Vetëm hebrenjtë midis nënshtetasve osmanë, në veçanti krye Rabini Nahum Effendi, qëndruan me turqit kundër pushtuesve lakmitarë evropianë.

Taktikat britanike për të justifikuar okupimin

Nëntoka Shtetërore Britanike përdori metoda të ndryshme për të pushtuar Stambollin dhe praktika të ngjashme mund të vërehen edhe sot në të gjithë botën. Demaskimi i këtyre taktikave është thelbësor për të kuptuar rrezikun me të cilin po përballet bota. Plani i largimit të turqve nga Anadolia, ende aktiv edhe pas 100 vjetësh, arriti kulmin me pushtimin e Stambollit. Për të arritur këtë qëllim, Nëntoka Shtetërore Britanike mashtroi publikun dhe aleatët e saj. Miliona dollarë janë përdorur në këtë skemë, nga disa aktorë Nëntokës Shtetërore Britanike. Le të shohim se si.

Nëntoka Shtetërore Britanike fillimisht pretendoi se nuk e kishte synim Anadollin

Kryeministri britanik Lloyd George, gjatë fjalimit së tij në Parlament më 5 janar të vitit 1918, siguroi anëtarët e parlamentit se nuk do të kishte luftë për Stambollin, Anadollin ose Thrakinë. Në këto toka, popullsia turke ishte shumica. E vërteta është se Lloyd George po përpiqej vetëm të shkakonte një devijim duke u përpjekur të bindte popullin e tij dhe Perandorinë Osmane se nuk i kishte për synim këto territore.

Për më tepër, nuk kishte asnjë sugjerim të okupimit të Stambollit në Armëpushimin e Mudros që shënoi fundin e Luftës së Parë Botërore për Perandorinë Osmane. Përkundrazi, Admirali Calthorpe, i cili nënshkroi Armëpushimin në emër të Fuqive Aleate, dha sigurinë e tij verbale se Britanikët nuk kishin ndërmend të pushtonin Stambollin dhe të ndërprisnin administratën Osmane ose të merrnin kontrollin e forcave ushtarake Osmane. Delegacioni osman që u kthye në Stamboll pas armëpushimit solli me vete letrën personale të Calthorpe. Në këtë letër, Calthorpe siguroi që ushtarët francezë dhe britanikë do të vendoseshin vetëm në ngushtica dhe një njësi e vogël nga ushtria turke do të lejohej të qëndronte atje si shenjë e sovranitetit osman.

Mirëpo, vetëm trembëdhjetë ditë pas Armëpushimit, trupat britanike dhe franceze hynë në Stamboll. Calthorpe, i cili kishte premtuar personalisht se Stambolli nuk do të pushtohej, u emërua si komisar i lartë britanik dhe gjëja e parë që bëri ishte arrestimi i dyqind njerëzve nga qeveria e Tevfik Pashait dhe internimi i tridhjetë prej tyre në Maltë. Të gjithë ata që u arrestuan ishin administratorë turq dhe myslimanë. Me këtë lëvizje, Calthorpe dha një mesazh të qartë se Stambolli ishte nën okupim dhe se kushdo që refuzonte të bashkëpunonte me forcat okupuese do të dënohej në mënyrën më të ashpër. Ai më vonë i dërgoi një mesazh Zyrës së Jashtme, duke i siguruar që arrestimet ishin "shumë të kënaqshme" duke dërguar mesazh të qartë për kryengritësitë të mundshme në Stamboll.²⁹⁴

Shumë oficerë, të cilët më parë ishin në listën e zezë gjatë luftës, gjithashtu u internuan. Kur britanikët vunë këmbën në Stamboll, ata filluan kërkim të individëve jo vetëm në Stamboll, por të gjithë Turqinë. Kërkesa e tyre e parë ishte kapja dhe ndëshkimi i nëntë komandantëve turq: Ali Ihsan Pasha (Komandant i Ushtrisë së Gjashtë), Fahrettin Pasha (Komandant i Korpusit të Kalorësisë V), Nuri Pasha (Komandant i Ushtrisë Islame të Kaukazit), Mürsel Beu (Komandant i Divizionit të 5-të Kaukazian), Yakub Shevki Pasha (Komandant i Ushtrisë së Nëntë), Nihat Pasha (Shef i Shtabit të Ushtrisë së Dytë në Pozanti), Galip Pasha (Komandant i divizionit të 40të Jemenit) dhe Tewfik Pasha (Komandant i Korpusit të Shtatë në Jemen). Ishte e qartë se këta komandantë turq u zgjodhën posaçërisht për performancën e tyre të jashtëzakonshme kundër Britanikëve, duke qenë se ata mbrojtën stoikisht vendin e tyre. Mirëpo Nëntoka Shtetërore Britanike dështoi në gjykimin e saj për patriotizmin turk pasi besonte se shënjestrimi i komandantëve do të funksiononte. Siç do ta bënin të qartë ditët në vijim, kapja dhe internimi i 100-150 njerëzve të një kombi thellësisht patriot, të cilët kishin jetuar gjithmonë të pavarur, nuk do të i lëkundnin këtë popull në luftën e tyre për pavarësi.

Yakub Shevki Pasha, i cili refuzoi të shpërbëjë Ushtrinë e Nëntë, shpërfilli urdhrin britanik për të dorëzuar armët dhe municionet dhe në vend të kësaj zhvendosi rezervat e tij të ushqimit në Perëndim. Natyrisht, ai ishte në krye të listës britanike 'për t'u internuar në Maltë'. Ashtu si ai, të gjithë anëtarët e Parlamentit të Karsit do të internohen në Maltë. Halil Pasha dhe Mehmed Djemal Pasha nga Ushtria Kaukaziane dhe shumë oficerë turq si Ali Rifat dhe Mürsel Beu, të cilët ishin komandantë të divizioneve ushtarake, u futën në listën e zezë nga Britanikët në muajt e parë të Armëpushimit. Ndërkohë, planet për kapjen, provimin dhe internimin e këtyre komandantëve ishin duke u zhvilluar në shtabin e pushtimit.

Shumë intelektualë dhe diplomatë pro-britanikë i konsideruan premtimet e dhëna para okupimit si garanci. Sidoqoftë, pas Armëpushimit, Kryeministri Britanik Lloyd George pretendoi se deklaratat e tij të mëparshme nuk ishin një garanci për Turqit, por kishin për qëllim të siguronin publikun e tij dhe veçanërisht Myslimanët Indianë të cilët nuk dëshironin të luftonin me myslimanët e tjerë. Ai shpresonte që kjo qasje të justifikonte okupimin.

Është e rëndësishme të mbani mend një gjë: Nëntoka Shtetërore Britanike bënë deklaratat të rreme për të pretenduar se janë aleatë, të bëjnë premtime ose të nënshkruajnë letra zyrtare. Sidoqoftë, të gjitha këto premtime nuk kanë absolutisht asnjë efekt mbi përfaqësuesit e Nëntokës Shtetërore Britanike dhe vendosmërinë e tyre për të kryer planet e tyre origjinale. Ata kurrë nuk do të pushojnë së provuari të realizojnë planet e tyre djallëzore të ideuara shekuj më parë pas dyerve të mbyllura. Prandaj, rënia në gracë në premtimet e tyre mund të jetë katastrofike për të ardhmen.

Nëntoka Shtetërore Britanike i siguroi aleatët e saj se Anadulli do të ishte për një mandat i SHBA-ve

Pas Luftës së Parë Botërore, hartat u ridizajnuan në Konferencën e Paqes në Paris të vitit 1919. Përfaqësues nga 32 vende morën pjesë në konferencë. Filloi më 18 Janar të vitit 1919 dhe u mbajtën në total 1646 seanca. Natyrisht, kjo pjesëmarrje e madhe ishte vetëm për të vazhduar shfaqjen. Vendimet e vërteta në konferencë u morën nga të

ashtuquajturit 'Katër të Mëdhenjët': Kryeministri Britanik Lloyd George, Presidenti i SHBA-ve Woodrow Wilson, Kryeministri Francez Georges Clemenceau dhe Kryeministri Italian Vittorio Emanuele Orlando.

Pesë traktatet që i dhanë fund luftës u hartuan në Konferencën e Paqes në Paris: Traktati i Versajës që u nënshkrua me Gjermaninë të njëjtin vit, Traktati i Saint-Germain-en-Laye me Republikën e Gjermano-Austriake, Traktatet e Neuilly-sur-Seine me Bullgarinë dhe Trianon me Hungarinë dhe Traktati i Sevres me Perandorinë Osmane u nënshkruan të gjitha gjatë kësaj konference.

Para se të kalojmë në shqyrtimin e planeve për të shkatërruar Perandorinë Osmane, ne duhet të prekim shkurtimisht Traktatin e Versajës. Para Versajës, publiku gjerman ishte siguruar që parimet e njohura si Katërmbëdhjetë Pikat e Wilsonit do të ishin bazat e traktatit. Mirëpo, sapo erdhi koha për nënshkrime, u shfaq një plan i rëndë kolonizimi që ishte një fyerje për gjermanët në çdo mënyrë. Kushtet e vështira e detyruan ekonominë gjermane të punonte për Fuqitë Aleate për vite me radhë. Shumë historianë pajtohen se kushtet e ashpra të këtij traktati çuan në ngritjen e regjimit nazist dhe nxitjen e ndjenjave hakmarrëse tek publiku gjerman.

Britania dhe Franca bënë një marrëveshje gjatë Konferencës së Paqes në Paris për të ndarë tokat osmane në Arabi, Traki, Mesdhe dhe Egje midis tyre. Ata donin ta bënin Turqinë një vend të vogël aziatik të bllokuar brenda Anadollit. Sipas planit të tyre, Turqia e vogël e bllokuar në këtë pjesë të tokës do të vihej nën mandatin e SHBA-ve.

Me fjalë të tjera, plani i Nëntokës Shtetërore Britanike për Konferencën e Paqes në Paris ishte vendosja e vendeve që ata i konsideronin të paaftë për të qeverisur vetë nën mandatin e vendeve të zhvilluara. Lindja e Mesme u shpërnda sipas këtij plani. Britania paraqiti një propozim në Konferencë më 21 maj të vitit 1919 dhe sugjeroi që Mesopotamia, Siria dhe Palestina të viheshin nën mandatin Francez dhe Britanik, dhe Perandoria Osmane nën mandatin e SHBA-ve. Le të kuptojmë për të vërtetën e këtij plani nga telegrami i Halide Edip Adıvar dërguar Mustafa Kemal Pashas më 10 gusht të vitit 1919:

Situata në Kostandinopojë në lidhje me politikën e jashtme është kjo:

Megjithëse Franca, Italia dhe Anglia i kanë ofruar një mandat mbi Turqinë Senatit Amerikan, ata po përpiqen me të gjitha mjetet e mundshme t'i parandalojnë ata që ta pranojnë atë.

Nuk ka dyshim se secila prej këtyre Fuqive dëshiron të marrë pjesën e tyre kur vendi ndahet.

Franca, pasi ka mbetur e zhgënjyer në Siri, dëshiron ta kompensojë veten në Turqi. Italia, duke qenë haptasi imperialiste, deklaron qartë se ajo ka hyrë në luftë me qëllimin e vetëm për të marrë një pjesë të plaçkës në Anadoll.

Pjesa e luajtur nga Anglia është mjaft më e komplikuar.

Duke parë nga e ardhmja, Anglia nuk ka dëshirë që Turqia të mbetet e bashkuar, të modernizohet ose të gëzojë pavarësi të vërtetë. Një shtet Turko-Mohamedan, i fuqishëm dhe i pajisur me të gjitha kërkesat dhe idetë moderne, dhe veçanërisht me një Kalif në krye të tij, do të ishte një shembull jashtëzakonisht i keq për subjektet Mohamedane të Anglisë.

Nëse ajo do të mund të merrte pushtetin mbi Turqinë pa ndërhyrë fare, ajo do ta copëtojë atë pa asnjë ndërhyrje dhe do të përpiqet brenda disa vitesh ta shndërrojë atë në një koloni besnike.²⁹⁵

Është e qartë, planet e Nëntokës Shtetërore Britanike kanë qenë gjithnjë të liga dhe të ndërlikuar. Mbështetja e një mandati të SHBA-ve ishte vetëm një akt nga plani shekullor. Dëshira e vërtetë e Nëntokës Shtetërore Britanike, për një kohë të gjatë, kishte qenë një shtet turk plotësisht i shpërbërë, i dobësuar dhe i shkatërruar.

Për të analizuar saktë planet e Nëntokës Shtetërore Britanike, është e rëndësishme të shikojmë disa hapa përpara. Ne nuk duhet të harrojmë se megjithëse ishte e destinuar për Churchill, deklarata "ai ishte i pari, i fundit dhe gjatë gjithë kohës një anglez i madh, më i interesuar për të ruajtur pozicionin e Anglisë në Evropë sesa për ruajtjen e paqes"²⁹⁶ në të vërtetë vlen për çdo anëtar të Nëntokës Shtetërore sepse për Nëntokën Shtetërore Britanike nuk ka aleatë ose miq. Të gjithë janë mjete për të arritur synimin e caktuar. Ekzistenca e tyre u shërben planeve të Nëntokës Shtetërore. Kjo është e

vërtetë edhe për udhëheqësit të cilët vetëm në dukje janë më të fuqishmit e botës, pasi ata nuk kanë asnjë mundësi tjetër përveçse të luajnë sipas skenarit që ju është dhënë.

As Italianët nuk u kursyen nga strategjitë e thella të Nëntokës Shtetërore Britanike

Ndërsa Lufta e Parë Botërore u ndez, Fuqitë Aleate kishin takime të fshehta për të rënë dakord mbi një plan për ndarjen e Perandorisë Osmane. Marrëveshja e parë e fshehtë, e njohur si Traktati i Londrës, u nënshkrua në vitin 1915. Sipas këtij pakti sekret midis Bllokut të Antantës (Britani, Francë, Rusi) dhe Italisë, italianëve iu premtua Antalia dhe rajonet përreth Mesdheut në këmbim të bashkimit në luftë në krah të Fuqive Aleate. Për shkak të Revolucionit Bolshevik, ky traktat u zëvendësua nga Marrëveshja e St.-Jean-de-Maurienne e vitit 1917, e cila u nënshkrua nga vetëm Italia, Franca dhe Britania. Sipas planit të ri, italianëve do t'u jepej gjithashtu Anadulli Perëndimor duke përfshirë Izmirin, përveç vijës bregdetare të Mesdheut.

Edhe një herë, skena e pasluftës nuk po zhvillohej sipas pritjeve të italianëve, por po shkonte sipas planeve origjinale të britanikëve. Bashkëpunimi Eleftherios Venizelos-Lloyd George rezultoi në okupimin e forcave greke të Izmirit më 15 maj të vitit 1919 dhe Anatolia Perëndimore mbeti nën okupimin grek deri më 9 shtator të vitit 1922, kur u detyruan të tërhiqeshin nga ushtria turke. Nëntoka Shtetërore Britanike, duke përfituar nga ëndrrat imperialiste greke, ndërtoi një ushtri në Anadoll që do të kryente punët e saja. Kjo gjithashtu në mënyrë të efektshme parandaloi që Italia të kishte fjalën e fundit në rajon. I gjithë plani i okupimit bazohej në propagandën se të krishterëve vendas u duhej mbrojtje nga të ashtuquajturat banda myslimane dhe këtij plani të lig ju dha legjitimitet ndërkombëtar. Sidoqoftë, u vërtetua qartë në raportin e mëposhtëm të Komisionit të Hetimit, në Stamboll, më 12 tetor të vitit 1919 që ato pretendime ishin gënjeshtër të plota:

Hetimi ka dhënë prova se gjendja e përgjithshme e të krishterëve në vilajetin e Ajdinit ka qenë e kënaqshme që nga armëpushimi dhe se ata nuk kanë qenë në rrezik. - Siguria në vilajetin e Ajdinit dhe në Smyrna [Izmir] në veçanti, në asnjë mënyrë nuk e justifikoi pushtimin e kalave të Smirnës duke zbatuar nenin 7 të armëpushimit. Për më tepër, situata në vilajet nuk justifikonte zbarkimin e trupave aleate në Smyrna.²⁹⁷

Edhe ky raport nuk ishte i mjaftueshëm për të ndaluar planet e Nëntokës Shtetërore Britanike

Nëntoka Shtetërore Britanike përdori italianët kur kishte nevojë, me pretendimin për të qenë një aleat i besueshëm dhe me disa premtime të tjera të rreme. Por kur nuk i duhej më Italia, e la atë të vetme. Mirëpo siç dihet edhe vetë italianët kishin plane për pushtimin e tokave osmane ashtu si fuqitë e tjera aleate, dhe në këtë drejtim, Italia atëherë ishte po aq fajtores sa të tjerët. Çështja është që, edhe ndaj aleatëve të saj, Nëntoka Shtetërore Britanike ndjek gjithmonë një politikë të përqendruar në mashtrime dhe me dyfityrësi.

Mustafa Kemali, udhëheqësi i Luftës Turke për Pavarësi dhe shpëtimtari i popullit turk dhe Turqisë, përfitoi nga kjo politikë dyplanëshe e britanikëve: Pas vitit 1920, qeveria italiane filloi t'i siguronte armë, logjistikë dhe inteligjencë turqve nacionalistë.

Pretendimi për Mbështetjen e të Drejtave të Pakicave është Metoda Tipike e Nëntokës Shtetërore Britanike për të justifikuar okupimet

Sipas Armëpushimit të Mudros të nënshkruar pas luftës, ushtritë Aleate duhet të kishin qëndruar në pozicionet e tyre aktuale dhe asnjë okupim nuk do të ndodhte nëse nuk kishte ndonjë kërcënim. Sidoqoftë, siç u shpjegua më parë, Britanikët megjithatë pushtuan Stambollin dhe Grekët zbarkuan në Izmir. I vetmi “justifikim” për këto okupime ishte pretendimi i rremë se pakicat e krishtera ishin në rrezik. Klauzola e 7-të e Armëpushimit të Mudros u dha Fuqive Aleate të drejtën për të zënë vendet strategjike në rast të një kërcënimi të sigurisë. Duke kombinuar të drejtën e okupimit të dhënë nën klauzolën e 7-të me të ashtuquajturat kërcënime me të cilat supozohej se përballeshin pakicat, okupimi i Anadollit u bë me dinakëri në përputhje me ligjin ndërkombëtar.

Sidoqoftë, situata në kryeqytet në ditët e para pas nënshkrimit të Armëpushimit ishte shumë i ndryshëm. Parlamenti osman ratifikoi unanimisht Armëpushimin. Zyra Postare Osmane shtypi pulla për Armëpushim, sikur të festonte lajme

të mira. Vetëm dhjetë ditë pas deklaratave optimiste të Ministrit Osman të Punëve Detare Rauf Beut, më 13 nëntor të vitit 1918, flota armike me 55 njësi kaloi nëpër ngushticën e Dardaneleve dhe u ankorua në Dolmabahçe. Kjo flotë e madhe përbëhej nga 22 anije luftarake britanike, 17 italiane, 12 franceze dhe 4 greke.

Ky pushtim përfaqësonte kulmin e planeve shekullore të Nëntokës Shtetërore Britanike për të shpërbërë Perandorinë Osmane dhe për të larguar Turqit nga Evropa. Kryeqyteti u pushtua, ushtria u shpërbë dhe anijet tregtare, kantieret e anijeve, portet, hekurudhat dhe kanalet e komunikimit u vunë në dispozicion për përdorimin e vetëm të forcave të okupimit. I gjithë ky plan u krye me një pretendim ligjor dhe u mbështet nga forca ushtarake. Për më tepër, propaganda e zezë u përdor në mënyrë të plotë për të ndaluar çdo mbështetje të mundshme publike për administratën Osmane.

Ndjenjat anti-osmane që u përhapën në Evropë dhe në Shtetet e Bashkuara për vite me radhë përmes gazetave, romaneve dhe pjesëve teatrale kishin për qëllim ta bënin më të lehtë këtë okupim. Qindra libra, pamflete dhe broshura të shtypura me karikatura që përshkruajnë turqit si njerëz të egër i shërbenin qëllimit të ndërtimit të një imazhi turko-mysliman që supozohej se masakronte të krishterët. Makineria e propagandës filloi të bindte opinionin botëror, më së shumti publikun amerikan dhe britanik, se Perandoria Osmane duhej të binte për hir të krishterimit, lirisë dhe të drejtave të njeriut. Çdo zë i kundërt që mund të ishte ngritur për të drejtat e osmanëve dhe për drejtësinë u hesht paraprakisht. Nëntoka Shtetërore Britanike u siguroi që të mos kishte rrugëdalje tjetër. Edhe pse ky plan i mbrapshtë dështoi për shkak të Luftës për Pavarësi, ai është në planet e Nëntokës Shtetërore Britanike. Aktualisht, tokat anadollake janë të rrethuara në çdo drejtim dhe fryma e solidaritetit dhe atdhedashurisë është fuqia e vetme që mund t'i rezistojë këtij komploti.

Nëse Zoti ju ndihmon askush nuk ju mund dot. Nëse ai ju lë të pandihmë kush do të mund të ndihmojë përveç Tij? Andaj besimtarët duhet të mbështeten tek Zoti. (Kur'an, 3:160)

Një gazetar në bashkëpunim me Nëntokën Shtetërore Britanike: Walter Lippmann

Sipas shumë burimeve, Katërmbëdhjetë Pikat e Wilsonit, të cilat supozohej të ishin baza e traktateve që do të nënshkruheshin pas Luftës së Parë Botërore, u përgatitën nga qeveria britanike me kontributin e Walter Lippmann, një i diplomuar në Harvard i cili punoi si këshilltar i Presidentit të SHBA-ve, Wilson. Këto parime supozohej të përdreshin për negociatat e paqes. Sidoqoftë, më vonë u bë e qartë si në Versajë dhe Sèvres se dokumenti nuk kishte qasje paqësore. Gazetari Lippmann, i cili hartoi Katërmbëdhjetë Pikat, më vonë u bë një vendimmarrës në CFR (Këshilli për Marrëdhëniet me Jashtë), organizatë si motër Amerikane e Chatham House, e cila njihet si një institut nën ndikimin e Nëntokës Shtetërore Britanike. Ai punoi si këshilltar jo-zyrtar i tetë presidentëve të SHBA. Me librin që shkroi në vitin 1946, ai ishte i pari që prezantoi konceptin e 'Luftës së Ftohtë'. Sot, shumë njerëz e quajnë Lippmannin si '*gazetari më me ndikim të shekullit të 20-të*', ose '*babai themelues i gazetarisë moderne*'. Presidentët, kryeministrat, ministrat mund të ndryshojnë; por anëtarët nëntokës shtetërore, të ngulitur thellë, i rezistojnë ndryshimeve.

Okupimi i Stambollit, Parlamenti i fundit Osman dhe pakti Nacional

Pushtimi i Izmirit shpejtoi fushatën për pavarësinë e Anadollit dhe i dha asaj më shumë mbështetje. Kongresi i Erzurumit në Korrik-Gusht të vitit 1919 dhe Kongresi i Sivas në Shtatorit të vitit 1919 ishin platformat e para ku u shfaqën për herë të parë grupet përfaqësuese për Kombin Turk. Pothuajse në çdo qytet të Anadollit, po formoheshin grupe rezistence, të cilat më vonë u bashkuan nën një organizatë të vetme të quajtur Bashkimi për Mbrojtjen e të Drejtave të Anadollit dhe Rumelisë. Ndërkohë, fushata e pavarësisë fitoi një emër të ri: Kuva-yi Milliye (Forcat Kombëtare). Në Dhjetor të vitit 1919, u mbajtën zgjedhjet për Dhomën e Deputetëve të Parlamentit Osman, në përputhje me Protokollin e Amasya më 22 Tetorit të vitit 1919. Njerëzit që mbështesnin idetë e Forcave Kombëtare u zgjodhën si Anëtarë të Parlamentit ndërsa Mustafa Kemal u zgjodh deputet për zonën e Erzurumit.

Më 12 janar të vitit 1920, Parlamenti i sapozgjedhur u mbledh në Stamboll, kjo do të ishte mbledhja e fundit e Parlamentit Osman. Pas okupimit të Stambollit më 16 Mars, Parlamenti shpalli Misak-i Milli (Paktin Kombëtar), i cili u pranua më parë në Kongreset e Erzurumit dhe Sivas.

Zgjedhjet në Parlamentin Osman dhe shpallja pasuese e Paktit Kombëtar treguan qartë se sa thellë Nëntoka Shtetërore Britanike e nënvlerësoi Kombin Turk. Qasja evropiane arrogante dhe mentaliteti i sëmurë për të parë turqit si qytetarë të klasit të dytë kanë qenë gjithmonë pika më e dobët e planit 100-vjeçar të Nëntokës Shtetërore Britanike. Nëntoka Shtetërore mendoi gabimisht se Kombi Turk do të dorëzohej dhe do të shfaqte karakter të dobët. Do të duhej një humbje e rëndë dhe largim përfundimtar nga Anadollit që përfaqësuesit e Nëntokës Shtetërore të kuptonin gabimin e tyre.

Britanikët ishin të ngazëllyer me zgjedhjet që do të mbaheshin për Parlamentin Osman; ata ishin të sigurt se Parlamenti i ri do të ishte një linjë me Sulltanin. Mirëpo, pas zgjedhjeve, figurat pro-Paktit Kombëtar ishin ata të cilët hynë në Parlament. Përfaqësuesit e Nëntokës Shtetërore pastaj insistuan që Parlamenti të mblidhej në Stamboll, gjë që ata shpresonin se do të rriste ndikimin e Sulltanit në Parlament dhe do të merreshin vetëm vendime që i përshtateshin interesave të Nëntokës Shtetërore. Por, përsëri ishin gabim. Dashamirët e lirisë në Parlamentin e ri krijuan një grup dhe e quajtën veten Felâh-ı Vatan (*Shpëtimi i Atdheut*). Pakti Kombëtar u hartua në Ankara dhe u dërgua në Stamboll për njoftim. Të gjitha këto zhvillime ishin të shqetësuese për Aleatët pushtues.

Parlamenti miratoi rezolutën përfundimtare, e cila ishte njitimi për miratimin e Paktit Kombëtar dhe pastaj Parlamenti u shpërbë.

Pushtimi i Stambollit shkaktoi trazira të shumta në të gjithë vendin dhe si hakmarrje ndaj kësaj ngjarje, oficerët e Fuqive Aleate në Anadoll u arrestuan. Pas okupimit, komunikimi me Stambollin kaloi nëntokë. Lidhjet hekurudhore midis Anadollit dhe Stambollit u ndërpre në rreth Geyve dhe Ulukışla dhe dërgimi i parave ose aseteve të vlefshme në Stamboll u ndalua.

Ndërsa okupimi i Stambollit ushqeu ndjenjën mbarëkombëtare të unitetit dhe solidaritetit, servilët e Nëntokës Shtetërore Britanike po i prisnin forcat britanike me padurim. Për këtë arsye këta individë do të kujtohen gjithmonë me turp. Sirkeci Shore, Galata Bridge dhe Galata Pier, Tophane, Salıpazarı dhe Dolmabahçe Shores ishin të mbushura me servilë të Nëntokës Shtetërore Britanike. Disa nga ndërtesat në vijën bregdetare kishin varur flamuj britanikë, francezë dhe grekë. Ushtarët e forcave të okupimit po priteshin me duartrokitje nga marionetat e tyre.

Patrick Balfour, i njohur si Lord Kinross, shkroi për këta turq anglofilë që ishin rreth ditëve të okupimit:

*Disa madje u shtirën sikur nuk ishin turq, hodhën feze-t e tyre dhe u përpoqën të bashkëpunonin me forcat aleate të cilët ishin zhvendosur në qytet.*²⁹⁸

E vetmja lëvizje e pavarur, e aftë për të përfaqësuar popullin turk ishte Kuva-yi Milliye (*Forcat Kombëtare*). Gjëja e parë që bëri administrata e Ankarasë ishte fillimi i Agjencisë së Lajmeve Anatoliane më 6 Prill të vitit 1920 në mënyrë që e gjithë bota të mund të informohej me saktësi për rezistencën e duhur në Anadoll. Pastaj, më 23 Prill të vitit 1920, Parlamenti i parë që do të përbënte themelet e Republikës së re u ngrit në Ankara në një ndërtesë të shkollës së vjetër.

Tani, fuqia e vetme legjislative për të përfaqësuar turqit ishte në Ankara. Plani për Luftën për Pavarësi, që do të zgjaste më shumë se dy vjet, u përgatit dhe më pas u zbatua atje.

Pakti Kombëtar dhe Rëndësia e tij

Pakti Kombëtar përbëhet prej gjashtë klauzolash, të cilat shkurtimisht janë këto:

** E ardhmja e territoreve të banuara nga një shumicë arabe në kohën e nënshkrimit të Armëpushimit të Mudros do të përcaktohet me një referendum. Nga ana tjetër, territoret të cilat nuk ishin të okupuara në atë kohë dhe të banuara nga një shumicë turke janë atdheu i kombit turk.*

** Statusi i Kars, Ardahan dhe Batumit [të cilët u bashkuan në moment që u çliruan] mund të përcaktohet me referendum.*

** Statusi i Trakisë Perëndimore do të përcaktohet nga votat e banorëve të saj.*

** Duhet të garantohet siguria e Stambollit dhe Marmaras. Transporti dhe tregtia e lirë në ngushticat e Bosforit dhe Dardaneleve do të përcaktohen nga Turqia dhe vendet e tjera të interesuara.*

** Të drejtat e pakicave do të diskutohen me kusht që të mbrohen të drejtat e pakicave myslimane në vendet fqinje.*

** Në mënyrë që të zhvillohet në çdo fushë, vendi duhet të jetë i pavarur dhe i lirë; të gjitha kufizimet në zhvillimin politik, gjyqësor dhe financiar do të hiqen.*

Në përputhje me Kongresin e Erzurumit dhe Sivas, Pakti Kombëtar shpalli kufijtë e synuar dhe qëllimin e fushatës së pavarësisë. Pakti Kombëtar ishte dokumenti i dytë, pas Protokollit të Amasya, për të legjitimuar fushatën e pavarësisë.

Vendet strategjike për Okupim:

Kulla Galata dhe rëndësia e rrethinës së Galatas

Gjatë gjithë okupimit Britanik, Nëntoka Shtetërore Britanike ishte fiksuar në një nocion: Turqit kanë qëndruar në Evropë për shekuj dhe kanë shkaktuar shqetësime në Evropë. Stambolli nuk është i turqve por është i grekëve. Turqit duhet të dëbohen prej andej. Në fakt, planet e ditëve moderne që Nëntoka Shtetërore Britanike i ka për qëllim për Turqinë nuk janë shumë të ndryshme; politikat e formuara 100 vite më parë ende ndiqen përmes metodave të ndryshme. Sot, me imponimin e nëntokave shtetërore, SHBA-të dhe BE ndjekin këtë plan. Ka gjithashtu përpjekje për ta bërë Rusinë pjesë të kësaj skeme.

Rreth 100 vite më parë, me pushtimin e 16 marsit të vitit 1920, plani arriti kulmin e tij dhe britanikët hynë në Stamboll me 27,419 ushtarë.

Fuqitë Aleate vendosën që Stambolli i vjetër do të kontrollohej nga Francezët, ndërsa Beyoğlu dhe Straits do të kontrolloheshin nga Britanikët. Italia do të mbante kontrollin mbi Kadıkoy dhe Üsküdar. Natyrisht, britanikët menjëherë morën kontrollin mbi ato zonat tjera duke mos i besuar askujt, as italianëve. Në çdo rast, Komisioneri i Lartë Britanik ishte përgjegjës për kontrollin dhe mbikëqyrjen e qytetit.

Forcat franceze në Stamboll kishin vetëm një burg, në Kumkapı, ndërsa britanikët ndërtuan gjithsej 5 burgje; nën kullën Galata, në Arabian Han, Sansarian Han, Hotel Kroecker dhe Şahin Pasha Hotel. Kjo zonë ishte qendra ku mijëra

njerëz u futën në listën e zezë, u torturuan dhe ku nga ku u spiunua lëvizja nacionaliste. Kulla Galata ishte bërë simboli i Nëntokës Shtetërore Britanike, pasi ishte shumë e përshtatshme për spiunazhë dhe vëzhgim. Ajo u përdor gjithashtu si seli e inteligjencës dhe qendër për tortura.

Gjatë viteve të pushtimit, të gjitha vendet u kthyen në shërbim të forcave britanike. Për shembull, forcat britanike përdorën rrugën e Kullës Galata për spiunim ndaj nacionalistëve, ndërsa Kulla Galata u përdor si kullë vrojtimi. Me një flamur britanik mbi të, kulla në atë kohë simbolizonte pushtimin. Pjesa e sipërme e kullës kishte një pamje të gjerë që vështronte Bririn e Artë dhe një pjesë të madhe të Stambollit dhe për këtë arsye i ndihmoi Britanikët të dallonin çdo lëvizje të dyshimtë.

Ndërtesa pranë Kullës Galata, e quajtur Shtëpia Galata dhe e ndërtuar në vitin 1904, u përdor gjithashtu për nevojat e britanikëve. Kjo ndërtesë dëshmoi skena të tmerrshme të torturave të shkaktuara nga hetuesit profesionistë të Nëntokës Shtetërore Britanike ndaj mbështetësve të Luftës Turke për Pavarësi. Dokumentacioni i sjellur nga frikacakët që punonin për forcat e okupimit Britanik u morë si bazë që njerëzit në pozicionet kryesore të merren në pyetje dhe të torturuohen për vdekje. Shumë patriotë u vranën në ndërtesë dhe u varrosën poshtë kullës. Vite më vonë, shumë gropa u gjetën thellë brenda Kullës Galata përveç kafkave dhe eshtrave njerëzore të zbuluara në kanalet e kullës. Hapësira në mes të kullës u përdor si burg. Gjatë viteve të pushtimit, mijëra njerëz u futën në listën e zezë dhe më pas u torturuan aty.

Kulla Galata ishte me rëndësi për operacionet e Nëntokës Shtetërore Britanike. Njihej si qendra e Mawlawiyah, qendra e inteligjencës britanike për dhunë dhe tortura. Rajoni u përdor gjithashtu si një gjykatë britanike. Me fjalë të tjera, rrethi Galata u përdor si bazë, si qendër torturash, burg, gjykatë, për të mos përmendur si pikë e takimit të spiunëve britanikë. Ashtu si Faraoni bëri me kullën e tij të vrojtimit, Nëntoka Shtetërore Britanike vëzhgonte popullin turk nga Kulla e Galatës. Shtëpia e parë Mawlawi e Stambollit në Galata u përdor gjithashtu nga Britanikët për qëllime të inteligjencës.

Baza e dytë e rëndësishme që britanikët përdorën për të shtypur nacionalistët turk gjatë okupimit ishte Hotel Kroecker. Dhomat në bodrum u përdorën si dhoma torturash dhe qindra nacionalistë që kundërshtuan okupimin u torturuan për vdekje. John Bennett, oficer britanik i inteligjencës, përdori Hotel Kroecker si një seli, sepse hoteli gëzonte vendndodhje qendrore në Beyoğlu. Me një kamxhik në duar, Bennett merrte në pyetje njerëzit në dhomat e torturave gjatë natës. Bennett, gjithashtu një Sufi dhe Mawlawi, kurrë nuk hoqi dorë nga lidhjet e tij me Perandorinë Osmane dhe botën Islame, edhe pas okupimit. Siç ndodh zakonisht, ai hapi shtëpinë e parë Mawlawi / Sufi në Britani dhe u bë vetë shejh. Duke përdorur këtë karakter të ri, ai punoi për të shkaktuar dëme popullit turk dhe myslimanëve duke përdorur Mawlawiyah si maskim. Si rezultat, shumë njerëz nuk arritën ta shihnin mashtrimin në retorikën e tij dhe në vend të Islamit, gabimisht miratuan filozofinë e Rumi, e cila në të vërtetë është kundër Islamit. Planet e Nëntokës Shtetërore Britanike për të shkatërruar botën islame nga brenda, pas kësaj pike, do të vazhdonin kryesisht përmes mësimëve të orientuara drejt Rumi.

Le të theksojmë se burimet kryesore të inteligjencës së britanikëve gjatë okupimit kishin qenë shtëpitë Mawlawi. Tradhtarët në Perandorinë Osmane, të cilët ishin adhurues të Rumiut dhe kulturës britanike, frekuentonin shtëpitë e përmendura Mawlawi dhe jepnin mesazhin se ata janë bashkëpunëtorë besnikë të Britanikëve.

Forcat e okupimit që donin të mbanin Stambollin nën kontroll ushtruan presion edhe mbi civilët. Përveç flotës okupuese të ankoruar në Bosfor, një nëndetëse britanike ishte vendosur përpara Kullës Galata. Armët e flotës detare u kthyen drejt qytetit, të gatshme për të qëlluar. Trupat e okupimit marshonin rreth qytetit me tanket dhe altilerinë e tyre, për të shfaqur forcën. Shumë tanke u vendosën rreth pikave strategjike në Sheshin Taksim. Oficerëve osmanë iu desh të përshëndesnin ushtarët e forcave aleate, pavarësisht nga niveli i tyre, përderisa ata nuk nderoheshin në asnjë formë. Sulltani u detyrua të miratojë një dekret që mbështeste okupimin, në mënyrë që të parandalonte ngritjen e çdo forme të nacionalizmit në popull, dhe fetva të ngjashme (*mendime autoritare ligjore për çështje që kanë të bëjnë me ligjin Islam*) u lëshuan nga Shejh al-Islami (*Myftiu i Madh*) dhe disa studiues të tjerë fetarë. Kutitë e pijeve alkoolike të sjella nga Britania po mbushnin tavernat e Stambollit, e cila ishte një përpjekje tjetër për të dobësuar njerëzit dhe për të rrënuar moralin e tyre.³⁰⁰

Spiunët britanikë ishin kudo në Stamboll. Një spiun, me pseudonimin RV5, hapi një rrobaqepësi në vitin 1921 dhe arriti të ishte rrobaqepësi i Unionistëve (zakonisht të quajtur 'Xhonturq' në Perëndim) dhe njerëzve të afërt me Mustafa

Kemalin. Ai madje ishte i lirë të vizitonte gjithmonë Ministrinë e Jashtme Turke. Ai do t'ua dorëzonte britanikëve tërë inteligjencën që kishte. Një spiun tjetër, me pseudonimin JQ6, ishte duke drejtuar një kafene në Stamboll, e cila zakonisht frekuentohej nga njerëz të afërt me Mustafa Kemalin. Përkrahësit e tij do të mbanin të gjitha takimet e tyre në këtë dyqan dhe të gjitha informacionet sekrete që diskutuan do të përcilleshin menjëherë te Britanikët. Në ndërkohë, vendasve iu desh të vazhdonin jetën e tyre të përditshme nën rrethimin e Nëntokës Shtetërore Britanike.³⁰¹

Shënim i Rëndësishëm në lidhje me Mawlawiyah

Rumi është një mistik i shekullit të 13-të. Ai shkroi librin Masnavi dhe megjithëse ky libër përmban deklarata të lavdërueshme në lidhje me besimin dhe Islam, ai gjithashtu përmban kontradikta serioze me Islam dhe Kuranin. Masnavi dhe kultura Mawlawiyah, për shkak të pjesëve të shkruara në Masnavi që janë në kundërshtim me besimin Islam, me kohë u shndërrua në një mënyrë jetese të promovuar nga qarqet që kërkonin t'i shkaktonin Islamit devijime. Në fakt, kjo kulturë është vlerësuar dhe promovuar gjerësisht nga ateistët, qarqet anti-islame, homoseksualët dhe darvinistët. Më posaçërisht, njerëz të caktuar që dëshirojnë të përhapin veprime të cilat ndalohen në Kur'an, si homoseksualizmi, Darvinizmi etj, andaj disa e kanë përdorur Melawlawiyah dhe filozofinë e Rumi për të arritur qëllimet e tyre. Për çudi, Nëntoka Shtetërore Britanike e ka përdorur në mënyrë të përsëritur këtë kulturë të rrezikshme si levë kundër myslimanëve.

Duhet të kihet parasysh se kritikantët këtu nuk i drejtohen Rumi, autorit të Masnavit, duke marrë parasysh se libri Masnavi mund të jetë ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme që nga shekulli i 13-të. Është e qartë se kritika është për librin Masnavi dhe përpjekjen për të dëmtuar shoqëritë islame. Prandaj, kritika jonë këtu nuk i drejtohet Mawlana Jalal ad-Din Rumi, por filozofisë së çuditshme të zhvilluar bazuar në përmbajtjen e Masnavit.

Kapitujt vijues do të merren me filozofinë e Rumiut në mënyrë të detajuar.

Cenzurimi i Medias gjatë okupimit britanik

Historiani dhe autori turk Atilla Oral shpjegon ditët e okupimit si në vijim:

Flota armike që vendosjen në ngushticën e Bosforit kishte detyra shumë të rëndësishme. Ata nuk qëndruan në Stamboll për pesë vjet vetëm për tu shfaqur. Ishte pjesë e një plani të kërcënimit të hartuar strategjikisht.³⁰²

Taktikat e frikësimit kishin për qëllim shtypjen e njerëzve dhe thyerjen e shpirtit të tyre. Propaganda që kishte për synim njerëzit u konsiderua shumë e rëndësishme, ngase Nëntoka Shtetërore Britanike donte të ndalonte çdo mbështetje të njerëzve për lëvizjen nacionaliste.

Siç u shpjegua më parë, Nëntoka Shtetërore Britanike u përpoq të dëmtonte 'vlerat nacionaliste dhe patriotike' të popujve që i synonte. Arsyeja kryesore ishte sepse kur një shoqëri largohet nga vlera të tilla, rënia e saj vjen shumë shpejt. Nëntoka Shtetërore Britanike supozoi se një lëvizje e pambështetur nga publiku nuk do të ishte më 'kombëtare' dhe për këtë arsye do të përqendrohej në propagandë psikologjike.

Për Nëntokën Shtetërore Britanike, një nga mënyrat për ta arritur këtë qëllim ishte cenzurimi i mediave. Prandaj, gjatë okupimit, shtypi turk u censuroi shumë. Gazetat u shqyrtuan së pari nga oficerët e censurës që punonin për Nëntokën Shtetërore Britanike para se të botoheshin dhe çdo përmbajtje ose foto që nuk u dukej e përshtatshme nuk lejohej të shtypet. Nëse Nëntoka Shtetërore Britanike nuk miratonte një fotografi ose shkrim të caktuar, ajo do të largohej. Si rezultat, shumë gazeta gjatë asaj kohe duhej të shtypeshin me kolona të zbrazëta. Ishte krim i madh të botoje fotografi që nuk mbanin vërejtjen "Censuruar nga Autoritetet Aleate - Censori".

E gjithë dëshmia vizuale e krimeve të kryera nga Nëntoka Shtetërore Britanike kundër njerëzimit u zhduk pothuajse plotësisht. Për një kohë të gjatë, nuk ishte e mundur të gjendej ndonjë fotografi që vërtetonte se Stambolli ishte pushtuar ndonjëherë, për shkak të lëvizjes sistematike të Nëntokës Shtetërore Britanike për të mbledhur të gjitha fotot e luftës.

Kur këto fotografi u morën më vonë nga arkivat britanike, populli turk u befasua. Atila Oral shpjegon se si i siguroi ato fotografi:

Arkivat britanike kanë një numër të bollshëm të provave vizuale të rëndësishme, në lidhje me Luftën Turke për Pavarësi dhe vitet e pushtimit. Thuhet se shteti britanik vë në dispozicion arkivin e tij për studiuesit pas një kohe, por kjo është e vërtetë vetëm për dokumentet e shkruara. Është krejt tjetër gjë për pamjen vizuale ose regjistrimet audio. Kam mbledhur dokumente dhe fotografi për 20 vitet e fundit për të qenë në gjendje të shkruaj këtë libër. Pothuajse të gjitha fotografitë që përdora erdhën nga burime dhe ankande britanike. Fotografitë e mbajtura nga forcat e okupimit për dekada tani shiten nga fëmijët e tyre të mëdhenj, duke zbuluar në mënyrë efektive shumë pjesë të historisë të mbajtura nën hije deri më tani.³⁰³

Censura në mënyrë efektive e pengoi popullin turk të shihte tiraninë e Nëntokës Shtetërore Britanike, sekretet e ndyra, të cilat u zbuluan vetëm pas luftës, padrejtësinë dhe anën torturuese të pushtimit. Vetëm në shekullin 21 ne tani jemi në gjendje të dëshmojmë dhunën dhe tiranisë që ndodhi. Sidoqoftë, dhe me gjithë përpjekjet për ta frenuar atë, fushata nacionaliste lulëzoi në një mënyrë që tronditi plotësisht Nëntokën Shtetërore Britanike. Spiunët dhe cenzuruesit nuk mund të ndalnin vullnetin e popullit turk dhe komplotet e Nëntokës Shtetërore Britanike dështuan një nga një.

Mbështetësit e Nëntokës Shtetërore Britanike gjatë okupimit

Faqet e mëparshme trajtuan mënyrën se si Nëntoka Shtetërore Britanike zbatoi planin e saj për të pushtuar Stambollin: se si ata arritën të siguronin mbështetjen e publikut përmes propagandës anti-turke, aleancave të fshehta ushtarake, manipulimet qeveritare dhe klauzolat e marrëveshjeve për t'i bërë ato të përputhshme me okupim, ku përfundimisht nisi okupimin më 16 Mars të vitit 1920. Që okupimi të vazhdonte, duhej të kishte jo vetëm pushtet ushtarak, ekonomik ose politik, por edhe mbështetës vendas. Kjo pjesë do të zbulojë disa emra dhe organizata që u përfshinë aktivisht në okupim, me vetëdije apo jo.

Sait Molla, i cili ishte redaktori i *Yeni Stamboll*, gazetës së përditshme pro-britanike të botuar gjatë viteve të okupimit, shkroi një pjesë më 9 nëntor të vitit 1918 me titullin, "*Britania dhe Ne*", duke shfaqur haptas servilizmin e disa personave Osman ndaj Britanikëve:

... Meqenëse populli ynë në të gjithë Anadollin ka krijuar admirim dhe respekt për britanikët, është e qartë se çdo ndihmë e vogël britanike për Turqinë do të ishte jashtëzakonisht e nevojshme. ... Osmanët, turqit e vjetër mund të gjejnë prosperitet dhe mirëqenie vetëm me ndihmën e sinqertë të popullit fisnik britanik.³⁰⁴

Pas okupimit, Nëntoka Shtetërore Britanike ndërtoi një rrjet të madh spiunësh, me ndjenja të forta anti-muslimane, me qëllim për të frenuar rezistencën e Anadollit. Ndërsa disa nga këta spiunë paguheshin nga britanikët, të tjerët dolën vullnetarë. Me sa duket, fuqia e britanikëve i joshte disa nga spiunët.

Oficerët e pushtimit përdorën disa lozha të dervishëve për qëllime të inteligjencës dhe Shtëpitë Mawlawi dhe Galata ishte shtëpitë më për përdorura për këso qëllime. John Bennett, kreu i Divizionit të Inteligjencës Ushtarake "B", siç u përmend më parë, zakonisht frekuentonte këtë Shtëpinë Mawlawi. Ai shkruan për ditët e tij si në vijim:

Tentova të hulumtoj se çfarë po bënin dervishët. ... Çdo dervish mund të ishte një agjent sekret i maskuar, ose ai mund të ishte misionar fanatik në emër të ndonjë vëllazërie politiko-fetare. Një faktor tjetër i rëndësishëm ishin vëllazëritë e dervishëve, prej të cilave më me ndikim besohej të ishin Vëllazëria Mevlevi.³⁰⁵

Nëntoka Shtetërore Britanike zgjidhte dhe trajnonte një nga një operativët e inteligjencës për të siguruar besnikërinë e tyre. Për disa vendas, lajkat, paratë dhe premtimet për një të ardhme të mirë duket se ishin të mjafteshme. Me sa duket, për ta, fitimet e vogla ishin më të rëndësishme sesa vendit i tyre. Siç shpejguan okupatorët Britanikë më vonë, kishte disa vendas që u bashkuan me Nëntokën Shtetërore Britanike, duke u shtirur sikur ishin miq të Britanikëve. Sidoqoftë, asnjë nga këto gjëra nuk mund të ndryshojë faktin se komplotet dhe tradhtë e spiunëve janë gjithmonë të destinuar të dështojnë dhe përcaktimi i Zotit do të mbizotërojë gjithmonë. Kjo është pikërisht ajo që ndodhi më vonë.

Unë do të ju jap atyre afat. Por, plani Ynë është më i fortë. (Kur'an, 7:183)

Shoqëria e miqëve të Anglisë - Grupet Britanike në Perandorinë Osmane

Shoqëria e Miqve të Anglisë ishte një organizatë me njerëz si Damat Ferid Pasha dhe Sait Molla si dhe mbështeste me pasion idenë e mandatit britanik në Perandorinë Osmane. Ajo u themelua më 20 maj të vitit 1919 me qëllimin kryesor të nxitjes së trazirave në Anadoll për të ndaluar lëvizjen nacionaliste për pavarësi dhe mori mbështetje të vazhdueshme financiare nga britanikët. Çdo protestë vendore e filluar kundër Luftës Turke për Pavarësi ishte disi e lidhur me këtë shoqëri. Një metodë tjetër e këtij grupi ishte përdorimi i botimeve të ndryshme për të diskredituar qeverinë e Ankarasë në sytë e publikut të Stambollit, ndërsa ndërtonte opinionin publik në favor të Nëntokës Shtetërore Britanike.

Sait Molla, njëri nga bashkëthemeluesit, nisi një luftë të plotë propagandistike në Stamboll me të përditshmen e tij *Yeni Istanbul*. Më vonë u bë e ditur se ai paguhej 300 Lira në muaj nga Ambasada Britanike.³⁰⁶ Deklarata themeluese ishte shkruar nga Dr. Avdullah Cevdet, i cili vazhdimisht i quante turqit si popull primitive. (kombi fisnik turk është mbi pretendime të tilla). Shoqëria arriti të kishte 53 mijë anëtarë në tre muajt e parë pas themelimit të saj. Më 23 maj të vitit 1919, Sait Molla u dërgoi një telegram të gjithë Kryetarëve të Bashkive duke pretenduar se mënyra e vetme e shpëtimit ishte pranimi i mandatit Britanik.³⁰⁷

Mustafa Kemal Atatürk përmendi qëllimin e kësaj shoqërie dhe anëtarëve të saj në Nutukun e tij të famshëm (*Fjalimi i Madh*):

Një nga më të rëndësishmet prej tyre, "Shoqëria e Miqve të Anglisë" është e denjë për t'u përmendur posaçërisht. Nga emri i saj nuk rrjedh që anëtarët e saj ishin domosdoshmërisht miq të Anglisë. Sipas mendimit tim, themeluesit e kësaj shoqërie ishin njerëz që mendonin, para çdo gjëje tjetër, për sigurinë e tyre dhe interesin personal dhe të cilët u përpoqën t'i siguronin këto gjëra duke nxitur Qeverinë e Lloyd George t'u siguronte atyre mbrojtje angleze. Pyes veten nëse këta persona të lajthitur me të vërtetë imagjinuan se Qeveria Angleze kishte ndonjë qëllim ruajtjen e intergritetit të Shtetit Osman?

*Aventurierë të caktuar anglezë, për shembull një klerik me emrin Frew, gjithashtu i përkisnin kësaj Shoqërie. Për të gjykuar nga energjia që shfaqte ky i fundit, ai praktikisht ishte kryetari i saj. Shoqëria kishte fytyrë karakter të dyfishtë. Nga njëra anë, ajo kërkoi hapur mbrojtjen e Anglisë me metoda të frymëzuara nga civilizimi. Nga ana tjetër, ai punoi në fshehtësi dhe tregoi se qëllimi i saj i vërtetë ishte të nxisë njerëzit për revoltë duke formuar organizata në brendësi, të paralizojë ndërgjegjen kombëtare dhe të inkurajojë vendet e huaja të ndërhyjnë. Këto ishin planet tinazre që qëndronin në themel të punës së kësaj Shoqërie. Do të shohim më vonë sesi Sait Molla luajti aktivisht një pjesë, ndoshta pjesën më të rëndësishme, në këtë Shoqëri. Ajo që sapo thashë për këtë Shoqëri do të bëhet më e qartë për ju kur të hyj në hollësi të mëtejshme më vonë dhe të vë para jush disa dokumente të cilat do t'ju mahnisin.*³⁰⁸

Kleriku Frew, të cilin Atatürk e përmend në Fjalimin e tij të famshëm, ishte shefi i inteligjencës britanike në Stamboll. Ai mbante kodet britanike të komunikimit, të cilat Ali Rıza Beu nga Shoqëria Karakol (një shoqëri sekrete brenda qeverisë së Stambollit të Perandorisë Osmane qëllimi i së cilës ishte të ndihmonte përpjekjet e forcave nacionaliste) i vodhi dhe i asgjësoi. Kjo zbërtheu kryengritjen e planifikuar në Dijarbakir nga fisi Bedirhan nën kujdesin e Damat Ferid Pashës. Mustafa Kemal Pasha, pasi u informua drejtpërdrejt për detajet, të cilat ishin të gjitha në dosjen e Frew, ishte në gjendje të merrte masat e nevojshme paraprake.

Propaganda britanike në Stamboll nuk ishte vetëm nga Shoqëria e Miqve të Anglisë. E përditshmja Alemdar e Refi Cevat Ulunay shtypi një editorial në ditën që Atatürk mbërriti në Samsun, me titull 'Kë Duam'. Aty shkruhej: "Në vend që të shqyejmë nga një lëkurë tjetër çdo ditë, le të dorëzojmë lëkurën tonë tek një mjek dhe le të shpëtojmë veten. Anglo-Saksonët janë në gjendje t'i japin frymë një jete kaq të fortë kudo që ndodhen, saqë e sjellin atë komunitet në një pozitë ku do të jini një kandidat i fortë për të ardhmen".

Veziri i Madh Ahmet Tevfik Pasha, i cili pasoi Damat Ferid Pasha, posa mori pozicionin e tij më 11 nëntor, dha një intervistë për *The Daily Mail* dhe tha se 'qëllimi i tyre ishte rikthimi i miqësisë së vjetër me Anglinë'.³⁰⁹

U shkruan romane për bashkëpunëtorët e britanikëve gjatë okupimit të Stambollit

Sami Beu, në romanin e famshëm të Yakup Kadri Karaosmanoğlu me titull Sodom ve Gomore (*Sodoma dhe Gomorrah*), ishte një personazh kozmopolitan që kishte humbur lidhjet me vlerat e tij kombëtare, kishte harruar identitetin e tij dhe supozonte se vëllazërimi me të huajt do ta lartësonte statusin e tij shoqëror. Sami Beu ishte i bindur se britanikët ishin të aftë të bënin çdo gjë andaj kundërshtuan lëvizjen nacionaliste në Anadoll. Veziri i Madh Damat Ferid dhe gazetari Ali Kemali ishin ndër figurat kryesore të përfaqësuara në roman nga Sami Beu.

Është e evidentuar se shumë njerëz u bashkuan dhe i shërbyen britanikëve gjatë okupimit. Ata ishin pengesë për vendasit e Stambollit dhe Anadollit duke spiunuar gjatë gjithë kohës. Lufta për Pavarësi filloi mes shumë sfidave por në fund rezultoi në një fitore epike.

Said Nursi refuzon Fetva kundër forcave nacionaliste

Nëntoka Shtetërore Britanike, menjëherë pas pushtimit të Stambollit, caktoi disa të ashtuquajtur klerikë si rojtarë të tyre. Këta të ashtuquajtur klerikë që bashkëpunuan me britanikët lëshuan një fetva në vitin 1920 duke pohuar se pushtimi britanik ishte i drejtë dhe se Forcat Nacionaliste nuk ishin në përputhje me Islamin. Dijetari mysliman Bediüzzaman Said Nursi ishte i pari që refuzoi të pranonte këtë fetva:

Një fetva e lëshuar nga qeveria dhe Zyra e Şeyhül-İslam në një vend të okupuar dhe nën komandën e Britanikëve nuk duhet të merret parasysh. Ata që dalin kundër pushtimit nuk janë rebelë. Fetvaja duhet të anulohet.³¹⁰

Said Nursi gjithashtu dha disa detaje të rëndësishme për Nëntokën Shtetërore Britanike:

Politika britanike [e Nëntokës Shtetërore Britanike] po shkakton përçarje dhe trazira, duke përfutur nga konfliktet, duke orkestruar të gjitha llojet e së keqes për të çuar përpara qëllimet e saja, duke përdorur gënjeshtër, manipulime dhe negativitet. Duke përdorur korrupsionin dhe degjenerimin për politikën e tyre, ata inkurajojnë degjenerimin kudo.³¹¹

Said Nursi, me qëndrimin e tij të fuqishëm intelektual kundër okupimit të Stambollit dhe propagandës britanike, ishte kleriku më i rëndësishëm i kohës. Hutuvat-i Sitte, e cila u shtyp në fshehtësi në Arabisht dhe Turqisht dhe qarkulloi në fshehtësi, ishte botim i rëndësishëm i cili rriti frymën nacionaliste kundër Britanikëve. Nuk është për t'u habitur që pas këtij botimi, Britanikët urdhëruan që Said Nursi të vritej. Mirëpo, me ndihmën dhe mbrojtjen e Zotit, megjithë kërkimet e tyre intensive në Stamboll, nëntoka shtetërore nuk mund ta lokalizonte atë.

Abdul Hamidi i II-të urdhëron që Bediuzzaman Said Nursi të Dërgohet në Spitalin e të Sëmurëve Mendor

Bediüzzaman Said Nursi ishte një shërbyes i devotshëm i Zotit, i cili pasi zbuloi atë që po ndodhte, tërhoqi vëmendjen për planet e liga të Nëntokës Shtetërore Britanike që kur ishte i ri. Nuk kaloi shumë dhe anëtarët e Nëntokës Shtetërore Britanike panë inteligjencën dhe talentin e këtij njeriu të përkushtuar dhe u përpoqën ta ndalnin atë. Një nga ato përpjekje ndodhi kur Said Nursi erdhi në Stamboll për të vizituar Sulltan Abdul Hamidin e II-të.

Në vitin 1907, Said Nursi kërkoi një takim me Sulltan Abdul Hamidin e II-të për t'i treguar atij rreth ideve të tij mbi themelimin e një universiteti në Van, të cilin ai e quajti "Madrasah al-Zahra", dhe ku shkencat islame dhe fizike do të mësoheshin së bashku. Sidoqoftë, kur ai shkoi në Pallat, ai u arrestua për të ashtuquajturin 'krim' të veshjes, (ndonëse ai kishte veshur veshje tradicionale turke) dhe u dërgua në Spitalin e të Sëmurëve Mendor Üsküdar Toptaşı. Kjo praktikë e padrejtë, e kryer me udhëzimet e Abdul Hamidin të II-të, ishte një shembull i qartë i frikës dhe shqetësimit që Said Nursi ngjalli tek Nëntoka Shtetërore Britanike me trimërinë e tij të paparë.

Dr. Hamid Uras, një nga mjekët më të vlerësuar të Gaziantep, ishte në spital në kohën kur u soll Said Nursi. Ai kujtoi incidentin me fjalët në vijim:

Ishte gjatë periudhës së dytë kushtetuese dhe ne ishim studentë në Shkollën e Mjekësisë. Nursi ishte gjithashtu në Stamboll në atë kohë. ... Ai ishte shumë i njohur, fama e tij ishte përhapur kudo. ... Ata e dërguan atë për t'u kontrolluar nga një mjek qeveritar, një grek. Mjeku intervistoi Saidin dhe gjatë bisedës së tyre Said mori një libër shkollor mbi anatominë nga raftet e librave dhe lexoi katër ose pesë faqe, pastaj i kërkoi mjekut që ta sfidonte me atë libër. Mjeku pasi e testoi me atë libër dhe mbeti i habitur ndërsa pacienti i citonte faqe për faqe fjalët nga libri. Ai i kërkoi falje Saidit dhe e shkroi një raport të favorshëm për ta dërguar në pallat me anë të shefit të policisë.¹

Pas raportit ku thuhej se Said Nursi nuk kishte probleme mendore, ai u shkarkua dhe u dërgua përsëri në selinë e policisë. Kjo e shtyu Abdul Hamidin e II-të t'i ofrojë Said Nursi para për t'u kthyer në qytetin e tij, gjë që Said Nursi menjëherë e refuzoi.

1. Şükran Vahide, *Islam in Modern Turkey: An Intellectual Biography of Bediuzzaman Said Nursi*, State University of New York Press, New York, 2005, fq. 39

Nëntoka Shtetërore Britanike nuk mund të ndal Lëvizjen kombëtare turke për pavarësi

Disa njerëz që po përpiqeshin të dilnin mirë para Nëntokës Shtetërore Britanike spiunuan për patriotë të guximshëm që mbështetën lëvizjen turke për pavarësi. Ata patriotë që u kapën u vranë pamëshirshëm nga skuadrat e pushkatimit britanik pa asnjë gjyq. Para ekzekutimit, ata do të liheshin në dhomat e torturave të John Bennett në Hotel Kroecker dhe do të torturoheshin në mënyrat më të ashpra për të treguar çdo detaj.

Tradhtarë të tillë përbënin vetëm një pakicë brenda kombit turk. Shumica e vendasve rrezikuan tortura dhe vdekje duke mbajtur fshehtas armë dhe municione brenda staneve, qeseve të ushqimit dhe shportave të perimeve deri në periferi të ngushticës së Detit të Zi dhe duke i ngarkuar ato në maune për t'u dërguar në Inebolu. Këta patriotë, plotësisht të vetëdijshëm për rrezikun e pushkatimit, zbrazën pa frikë municionet në Selimiye dhe Maçka. Forcat e pushtimit kishin okupuar të gjitha anijet në portet turke, prandaj maune në karrocet e detit dhe transporti me qerre ishin mënyrat e vetme në dispozicion për të kryer këtë transport.

Vendasit në Stambolli ishin varfëruar ndjeshëm gjatë viteve të pushtimit sepse qytetet që eksportonin mall dhe veshje nga dhe Stambolli nuk merrnin më asgjë. Përkundër të gjitha këtyre vështirësive, njerëzit turq dërguan gjithçka që kishin në Anadoll për të mbështetur lëvizjen për pavarësi. Zonjat përdorën krejt ç'a patën për të thurur rroba dhe çorape për ushtarët në Anadoll.

Organizatorët e okupimit dhe lidhjet e tyre me nëntokën shtetërore

Churchill, Kryeministri i atëhershëm Britanik tha: *'Ai që nuk mund ta shohë se në Tokë po ndodh një përpjekje e madhe, një plan i rëndësishëm, mbi të cilin na lejohet të bashkëpunojmë si shërbëtorë besnikë, sigurisht që duhet të jetë i verbër.'*¹³¹²

Öcalan, udhëheqësi i organizatës terroriste PKK, shpjegon në detaje se si Nëntoka Shtetërore Britanike në të vërtetë po kontrollon grupin terrorist që ai e nisi dhe se si politikat e tilla janë gjithmonë të planifikuara nga këto fuqi nëntokësore:

Britania është vendi që ka qasjen më të mençur ndaj çështjes sonë. Ata i dhanë licencë MED TV-së. Britania i ndërton politikat dhe i shtyen ShBA-të t'i zbatojnë ato. Unë mendoj se Britania është ajo që ndërton politikat kryesore dhe përfshinë bashkëpunëtorët e saj në Evropë, por më së shumti janë ShBA-të, të cilët e zbatojnë planin e saj. Nuk ka asnjë dokument që e vërteton këtë gjë, natyrisht do të ishte e pamundur. Por duhet parë se gjithçka në Evropë vjen nga Britania. Ka një qëndrim shumë të thellë lidhur me këtë çështje.¹³¹³

Në Prill, 2008, Öcalan bëri deklaratën në vijim në İmralı, duke aloduar në Nëntokën Shtetërore Britanike:

Që nga shekulli i 16-të, [Britanikët] kanë planifikuar në Londër atë që do të ndodhë në pjesën tjetër të botës.

Ata gjithashtu manipulojnë opinionin publik. Marksi jetonte në Londër; ata e mbajtën qëllimisht atje. Marksi i formësoi idetë e tij atje dhe i shpërndau nëpër botë që andej. ... Mbretëresha Elizabeth e mbajti Marksit gjithmonë afër. Marksi, Lenini, Mao; ata u mashtruan të gjithë nga Britanikët.³¹⁴

Nëntoka Shtetërore Britanike ka nevojë për njerëz për të zbatuar dhe menaxhuar planin e saj. Në faqet vijuese, lexuesit do të njihen me ata që menaxhuan dhe zbatuan planin për ndarjen e Perandorisë Osmane, bazuar në pushtimin e Stambollit..

Lloyd George

Lloyd George ishte Kryeministri Britanik kur po zbatohet plani për ndarjen e Perandorisë Osmane. Kështu e përshkroi Churchill opinionin e Lloyd George dhe planet e tij për të ardhmen e turqve dhe territorit turk:

Grekët [pohoi Lloyd George] janë njerëzit e kulturës në Mesdheun Lindor. ... Një Greqi e madhe do të jetë një avantazh i paçmuar për Perandorinë tonë Britanike. Ata do të zotërojnë të gjithë ishujt më të rëndësishëm në Mesdheun Lindor. Këto ishuj janë bazat e së ardhmes; ato shtrihen përmes Kanalit të Suezit me Indinë, Lindjen e Largët dhe Australinë.

Në 22 dhjetor të vitit 1920, Lloyd George deklaroi se prezenca e popullit grek në Azinë e Vogël është, 'jetike për Britaninë e Madhe, më jetike se për çdo vend tjetër në botë.'³¹⁵

Ajo që Lloyd George donte të thoshte ishte një e ashtuquajtur 'Greqi e Madhe' që përfshinte Anadollin, një që do të mbronte kufijtë e Perandorisë Britanike. Për këtë qëllim, Kryeministri George ndihmoi grekët të fillonin një ofensivë në Trakinë Lindore dhe Izmir. Britanikët supozuan se në këtë mënyrë, ata nuk do të rrezikonin ushtarët Britanikë ndërsa u përpoqën të mposhtnin Turqit në vendlindjen e tyre dhe të përdornin Kryeministrin Grek, Venizelos i cili ngjalli ëndrrat e një 'Greque të Madhe'. Me anë të ofensivës Greke, George donte të shkatërronte gjurmët e mbetura të rezistencës Turke dhe të lehtësonte procesin e shpërndarjes së tokave Turke midis Aleatëve. Ai i cili e nisi këtë plan, i braktisi Grekët pas humbjes së tyre poshtëruese.

Kryeministri britanik nuk u përmbajti asnjëherë nga qasjes së tij raciste ndaj turqve me deklarata si: "Ju nuk mund t'u besoni atyre, ata janë popull primitiv".³¹⁶ Në mënyrë që të marrë miratimin e nevojshëm nga Kabineti i tij dhe parlamenti britanik për të filluar pushtimin e Stambollit, ai pretendoi se turqit mund të nxirren nga tokat e tyre paduke përdorur fuqi të cilat ata nuk nuk do të mund t'i rezistonin.³¹⁷

Thirrjet e Lloyd George për Mustafa Kemal Atatürk, të bëra në Dhomën e Komuneve më 19 tetor të vitit 1922, tregonin qartë se kush prishi komplotet e Nëntokës Shtetërore Britanike:

Shekujt rrallë prodhojnë një gjeni. gjeniu i madh i epokës sonë iu dha kombit turk..³¹⁸

Kur planet e tij për të copëtuar Turqinë dështuan, Lloyd George nuk kishte mundësi tjetër përveçse të tërhiqej. Nga vitet 1930, ai tashmë ishte zhytur në harresë dhe nuk kishte më mbështetje publike ose ndikim politik.

Lord Curzon

George Curzon, i njohur si Lord Curzon, ishte Sekretari i Shtetit për Punët e Jashtme në qeverinë Lloyd George. Ishte ai që doli me idenë se "Eufrati formon kufirin perëndimor të Indisë".³¹⁹ Ai ishte i bindur se për të mbështetur politikën e Nëntokës Shtetërore Britanike dhe për të siguruar kontroll të plotë të Indisë, rajonet arabe dhe kurde brenda kufijve osmanë duhej të ishte vendosur nën mandatin britanik.

Çfarëdo që duam, ju e refuzoni. Tani ne po i fusim ofertat në xhepat tanë, por ju jeni një vend i varfër, i sapo dalur nga lufta. Ju do të keni nevojë për para për tu zhvilluar. Kur të vini tek ne në të ardhmen, ne do t'i sjellim këto gjëra para jush dhe do të jua marrim përsëri.³²⁰

Lord Curzon e zhvilloi këtë bisedë me Ismet İnönü gjatë negociatave të Lozanës. Edhe sot, të gjitha të drejtat e fituara në Lozanë paraqiten në raste të ndryshme në një përpjekje për t'i marrë ato sërish. Në fakt, këmbëngulja e BE-së që Turqia të ndryshojë ligjin e saj antiterror në këmbim të lëvizjes pa viza nuk është asgjë tjetër përveç rimishërimit të kërcënimit të Curzonit.

Curzon shprehu këtë pikëpamje për njerëzit tanë të nderuar në shënimet e tij më 4 shkurt të vitit 1920:

Turqit duhet të dëbohen jashtë Evropës. Siç tha Senatori Amerikan Lodge, Stambolli duhet të merret totalisht nga Turqit, kjo fole e murtajës, krijuese e luftërave dhe blasfemisë për fqinjët, duhet të zhduket nga Evropa. Turqit janë primitivët e Azisë dhe kështu fundi i tyre do të jetë i mjerueshëm.³²¹ (Kombi i Nderuar Turk është mbi deklaratat e tilla).

Somerset Arthur Gough-Calthorpe

Komisioneri i Lartë Britanik Admiral Calthorpe, i emëruar në Stamboll, shkruajti në shumë telegrame të tij drejt Londrës se një mënyrë për të dobësuar Perandorinë Osmane ishte vënia e Kurdëve dhe Turqve kundër njëri-tjetrit.

Gjatë negociatave për Armëpushimin e Mudros, Admirali Calthorpe premtoi se do të bëhej gjithçka që është e nevojshme për t'u siguruar që turqit nuk do të ofendohen. Ai premtoi se anijet greke nuk do të dërgoheshin në Stamboll ose Izmir, por shtoi se një klauzolë që theksonte se '*Stambolli nuk do të pushtohet*' nuk mund të përfshihej në armëpushim.³²² Vetëm 13 ditë pas këtyre deklaratave, marina greke dhe britanike anije zbarkuan në ngushticën e Bosforit.

Ishte gjithashtu përgjegjësi e Calthorpe për të sqaruar në lidhje me pushtimin e afërt grek të Izmirit. Më 14 maj të vitit 1919, në orën 09:00 të mëngjesit, ai i dërgoi një notë diplomatike Ali Nadir Pashës, Komandantit të Korpusit të XVII-të, duke e informuar atë që kalatë e Izmirit do të pushtoheshin nga Forcat Aleate në përputhje me Klauzola e 7-të të Armëpushimit. Në të njëjtën ditë, ai dërgoi një notë të dytë, duke thënë se Izmiri do të pushtohet më 15 maj të vitit 1919 nga Grekët në emër të Aleatëve dhe flota në port do të ishte autoriteti më i lartë për të siguruar rendin gjatë okupimit.

John Michael de Robeck

Admirali Robeck ishte i bindur se aleanca kurdo-armene do të ishte politikisht e dobishme për partitë përkatëse dhe Britaninë. Në telegramin e tij drejtuar Lord Curzonit më 11 dhjetor të vitit 1919, ai përsëriti se një aleancë e tillë do të ishte në interesin më të mirë të Britanisë në rajon dhe kërkesat e Kurdëve dhe Armenëve duhet të mbështeten dhe promovohen me kujdes. Në përgjigjen e tij të datës 20 dhjetor, Lord Curzon urdhëroi Komisariatit të bashkëpunoj me palët.³²³

Është krejt normale që kërkesat e popullit Kurd dhe Armen të përmbushen. Mirëpo siç dihet anëtarët e Nëntokës Shtetërore Britanike donin që të realizonin vetëm axhendën e tyre. Sapo kushtet që u përshtateshin interesave të tyre pushuan së ekzistuari, ata filluan bombardimin e fshatrave kurde, si në vijim të Traktatit të Lozanës.

De Robeck, një nga emrat më të shquar pas okupimit të Stambollit, u përpoq të justifikonte okupimin duke thënë se nëse Aleatët do të duhet të vëjnë paqen në rajon, ata do të duhet të kalonin përmes Turqëve në Stamboll dhe të dobësonin rezistencën e tyre.³²⁴

George Francis Milne

George Milne, një oficer i lartë i ushtrisë britanike, u ngarkua si komandant në detyrë për pushtimin e Stambollit. Ai citoi vazhdimësinë e popullit Kaukazian dhe Turk:

Unë jam plotësisht i vetëdijshëm se tërheqja e trupave britanike ndoshta do të çonte në anarki, por nuk mund ta them se bota do të humbte shumë nëse të gjithë banorët vendas do t'i prisnin fytyrë njëri-tjetrit. Ata sigurisht se nuk vlejnë sa jeta e një ushtari britanik. Gjeorgjianët janë thjesht bolshevikë të maskuar. Armenët janë ata

që kanë qenë gjithmonë, racë e neveritshme. Më të mirët janë banorët e Azerbajxhanit, megjithëse janë me të vërtetë të pacivilizuar.³²⁵ (Të gjithë popujt e përmendur më lartë janë mbi këto pretendime).

George Milne ishte jashtëzakonisht i ashpër me lëvizjen nacionaliste që Mustafa Kemal filloi në Anadoll dhe i shkroi Ministrisë Osmane të Luftës më 6 qershor të vitit 1919 duke kërkuar që autoritetet ta thërrasin përsëri në Stamboll:

Unë e konsideroj të padëshirueshme praninë e gjeneralit Kemal Pasha dhe stafit të tij në provinca. Është shqetësuese për opinionin publik në këtë moment që një Gjeneral së bashku me shtabin e ti të udhëtojnë në një vend të tillë andaj nuk shoh ndonjë nevojë për prezencën e tyre nga pikëpamja ushtarake. Unë kërkoj që ju të urdhëroni kthimin e menjëhershëm në Konstandinopojë të Gjeneral Kemal Pashait dhe Shtabit të tij.³²⁶

Mustafa Kemal ishte i indinjuar nga toni përçmues i Milneit ndaj popullit turk dhe qeverisë së Stambollit, dhe përgjigjeve të dëshpëruara të Ministrisë së Mbrojtjes. Ai i shpjegoi ndjenjat e tij me fjalët në vijim:

... yet this does not seem to wound the pride of the Minister of War, who, in all his transactions with the national organisation, is ever referring to questions of self-respect and scarcely ever mentions the dignity of the Government who accepted the responsibility of safeguarding the independence of the Ottoman Empire. They will not allow that their dignity is already assailed and the independence of the State jeopardised. They do not even protest against this attack; they do not even venture to assert that they decline to make themselves the instrument for this blow against our independence.³²⁷

E vërteta është se deklaratat përbuzëse të cituara më lartë janë vetëm një pjesë e vogël e mendimit të këtyre individëve ndaj turqve. Zemrat e tyre ishin plot urrejtje dhe inat për popullin turk dhe nuk u përmbajtën pa e shfaqur haptazi urrejtjeje para dhe pas Luftës Turke për Pavarësi. Ata shfrytëzuan çdo mundësi për të shtypur dhe poshtëruar kombet osmane, të cilat, në mendjen e tyre të lig, ishin raca inferiore. Sot, i njëjti mentalitet jeton. Disa njerëz, të cilët gabimisht besojnë se mund të gjejnë miqësi ose një të ardhme në një aleancë me nëntokat shtetërore, do të bënin mirë të kenë parasysh këto detaje.

Spiunët në territorin Osman raportojnë në qeverinë e Stambollit

Spiunët që ishin shpërndarë në të gjithë territorin osman luajtën një rol të rëndësishëm në zbatimin e planit për shpërbërjen e Perandorisë Osmane. Spiunët themeluan shtete, ndanë vendet, emëruan mbretër dhe hartuan kufij. Ky rrjet i gjerë spiunësh u administrua nga Britanikët, përmes qendrës së operacionit në Stamboll që raportonte në inteligjencën ushtarake. Prandaj pushtimi i Stambollit i ofroi logjistikë shumë të nevojshme këtij rrjeti të spiunimit. Shumë spiunë u dërguan në Anadoll, të maskuar si 'zyrtarë të okupimit'.

Ndërsa lëvizja kombëtare e pavarësisë fitoi vrullshëm, ky rrjet spiunazhi zhvendosi fokusin e tij në planet ushtarake turke. Në vitin 1921, Sir James Marshall-Cornwall u emërua si oficeri special i inteligjencës që i raportonte Sir Charles Harington, Komandantit të Përgjithshëm të ushtrisë aleate të okupimit me qendër në Stamboll. Marshall-Cornwall ndërtoi një ekip të vogël, por operacionale për të mbajtur shënime për Mustafa Kemal Pashan dhe lëvizjen nacionaliste. Duke folur rrjedhshëm turqisht, ai u dërgua në Stamboll edhe një herë në vitin 1941 për të bindur Ismet Inonun të bashkohej në Luftën e Dytë Botërore si një aleat britanik, por u kthye duarbosh.

Qasja e Nëntokës Shtetërore Britanike në Sulltanat dhe planet për të ardhmen e Perandorisë Osmane

Gjatë Luftës së Parë Botërore, Kryeministri britanik Lloyd George pohoi se të gjitha tokat që flasin arabisht duhet të merren nga Perandoria Osmane dhe të vendosen nën mandatin e aleatëve dhe se Turqit duhet të kenë pjesë të caktuara të Anadollit, por jo territor në Europë. Ai u shpreh se turqve nuk duhet t'u jepet asnjë pjesë në ngushtica ose në det.³²⁸ Ky është plani i Nëntokës Shtetërore Britanike për të ardhmen e Perandorisë Osmane dhe ishte ndërtuar shekuj më parë.

Ajo që donte të theksonte ishte mbajtja e turqve në një territor të vogël përreth Ankarasë, Konjës dhe Anatólisë Qendrore. Ky plan u shpreh qartë në Lozanë nga Lord Curzon, Sekretari Britanik i Shtetit për Punët e Jashtme. Në fakt, edhe ai plan ishte thjesht një ndalesë e përkohshme në rrugën drejt qëllimit të tyre përfundimtar. Nëntoka Shtetërore Britanike planifikoi të shtypte Kombin Turk derisa të gjithë turqit të dëboheshin në Azinë Qendrore. Kjo është politika e fshehtë e Nëntokës Shtetërore Britanike. Sot, qarqet që kërkojnë t'i japin Anatólinë Juglindore organizatës terroriste PKK, që dëshirojnë një qeveri federale në rajonin e Detit të Zi pasi të ndahet si Perëndim dhe Lindje, që dëshirojnë të ndajnë rajonin Mesdhe dhe Antalia si zona federale dhe hartat e shtypura që përshkruajnë Stambollin si një territor ndërkombëtar dhe Izmirin dhe afërsinë e tij si një shtet i pavarur, derivojnë nga kjo strukturë nëntokësore.

Raporti i Komitetit për Turqinë Aziatike, nën kryesimin e Sir Maurice de Bunsen, i lëshuar më 30 qershor të vitit 1915, e bëri planin e copëtimit të Nëntokës Shtetërore Britanike mjaft të qartë. Raporti rekomandoi që territori osman të ndahet në pesë rajone kryesore / provinca autonome: Siri, Palestinë, Armeni, Anadoll / Turqi dhe Irak. Raporti gjithashtu tha se vendet strategjike përgjatë vijës që shtrihen nga Mesdheu në Gjirin Persik duhet të vendosen direkt ose indirekt nën kontrollin e Britanisë. Mënyra e vetme për ta bërë këtë ishte okupimi i plotë i Palestinës dhe Irakut. Në këtë mënyrë, supozuan ata, britanikët do të ishin në gjendje të kapnin të gjithë të mirat ekonomik, natyrisht të ardhurat e naftës ishin më të rëndësishmet, në Turqinë Aziatike (përfshirë Mosul) në epokën e pasluftës.

Komisioneri i Lartë Britanik Admiral Ueb shkroi si në vijim në një letër që i dërgoi një mikut të tij më 19 janar të vitit 1919:

Megjithëse nuk i kemi okupuar vendet e tyre tërësisht, ne ende emërojmë dhe shkarkojmë guvernatorët e tyre. Ne administrojmë policinë e tyre, kontrollojmë mediat, hyjmë në birucat e tyre dhe lirojmë të burgosurit grekë dhe armenë pa i pyetur se çfarë krimesh kanë bërë. Ne i mbajmë hekurudhat e tyre nën kontrollin tonë dhe marrim gjithçka që duam. Politika jonë mbështetet në tehun e mprehtë të bajonetës... Për sa kohë që kemi kalifin e tyre nën kontrollin tonë, ne kemi kontroll shtesë mbi botën islame.³²⁹

Këto fjalë u shqiptuan në një kohë kur Nëntoka Shtetërore Britanike mendoi se se kishte kontrollin e plotë mbi Perandorinë Osmane.

Kjo arrogancë dhe iluzion i madhështisë ishte arsyeja pse Nëntoka Shtetërore Britanike nënvlerësoi lëvizjen për pavarësi të Anadollit. Britanikët, në fillim, nuk besuan në rezistencën kombëtare. *Renin*, një e përditshme e kohës që njihej me pikëpamjet e saj që kundërshtonin lëvizjen e pavarësisë së Atatürkut, e shpjegoi atë si në vijim:

Mustafa Kemal Pasha po përpiqet të ndërtojë një lëvizje kombëtare në Anadoll. Çfarë ëndrre feminare! Si mundet Anatólia e varfër, e përmbysur, e humbur tashmë në luftë, t'i dalë ballë gjithë botës? Çfarë ka mbetur në Anadoll, çfarë ka atje që ata të mund t'i rezistojnë?³³⁰

Traktati i Sèvres, i nënshkruar pas Armëpushimit të Mudros, ishte faza përfundimtare e planit. Ishte një nga shembujt më të habitshëm të imperializmit të Nëntokës Shtetërore Britanike. Burrështetasit, të cilët ishin gjoja më të civilizuarit, më modernët dhe liberalët e kohës, po bënë me vrull plane në tryezat e konferencave për të ndërtuar rendin

e ri botëror. Ata planifikuan jo vetëm të copëtojnë Perandorinë Osmane, të cilën gabimisht e quajtën 'të sëmurë', por edhe të pushtonin rajone dhe porte të rëndësishme. Nëntoka Shtetërore Britanike ishte i sigurt se turqit, të cilët ata i hodhën poshtë si të mundur dhe të dëshpëruar, nuk do të kundërshtonin planin e pushtimit dhe copëtimit.

Nëntoka Shtetërore Britanike planifikoi të mbante Kalifatin dhe Sulltanatin si tituj simbolikë që veprojnë nën kontrollin e tyre. Sipas planeve të tyre, Stambolli do të bëhej një shtet i veçantë, dhe Sulltani do të banonte në Kocaeli ose Bursa.³³¹ Sidoqoftë, Zoti i Plotfuqishëm nuk e la Stambollin dhe tokat turke, vendin e shfaqjes së *Mehdiut* (p.q.m.t), të binin në duart e shërbyesve të djallit. Këta njerëz arrogantë, të cilët e konsideronin veten si ideatorët, bënë një gabim të madh dhe nuk morën parasysh planin e Zotit të Plotfuqishëm. Ata harruan se Ai kontrollonte dhe sundonte të gjitha mendjet dhe planet.

**Ata [pabesimtarët] përgatitën kurthe por edhe Allahu i komplotoi. Zoti është strategu më i mirë.
(Kur'an, 3:54)**

'Një shtet i pavarur i Konstadinopolit': Plani për të kontrolluar ngushticat

Plani i pasluftës i Nëntokës Shtetërore Britanike për Stambollin ishte ta bënte atë shtet të pavarur. Shteti i ri do të shtrihej në ngushticën e Bosforit dhe do të shtrihej deri në Çatalca në Evropë dhe Izmit në Azi. Ky shtet ishte menduar si një shtet satelitor që do të siguronte kontrollin britanik mbi ngushticat. Për këtë arsye, ngushtica e Dardaneleve dhe Ishujt Marmara do të përfshiheshin gjithashtu brenda kufijve të këtij shteti. Ata planifikuan që ky shtet të ishte nën kujdesin e Lidhjes së Kombeve (Kombet e Bashkuara sot) dhe do të kishte zona pa armë midis këtij shteti dhe shteteve fqinje. Qeveria do të drejtohej nga delegatë britanikë dhe francezë me rrotacion. Sipas planit, ajo do të ishte plotësisht e pavarur nga Perandoria Osmane dhe e pavarur nga Aleatët VETËM për sa i përket financave, drejtësisë dhe forcave të xhandarmërisë.

Sot i njëjti projekt është sjellë në mënyra të ndryshme me të njëjtin qëllim. Ekzistojnë modele të ndryshme të tilla si bërja e Stambollit rajon unik autonom, ose pranimi i tij i veçuar në BE pa Turqinë, përmes një statusi tjetër. Në një hartë të botuar nga *The New York Times* më 14 maj të vitit 2016, Turqia paraqitet e ndarë në shtete të ndryshme, ku Stambolli paraqitet si shtet i pavarur. Siç u përmend më parë, planet e Nëntokës Shtetërore Britanike nuk janë asnjëherë të mbyllura, ato pezullohen vetëm për një kohë ose akterët ndërrohet. Të gjitha planet e tyre vihen në lëvizje si të vije koha e duhur, edhe nëse ajo kohë e duhur është shekuj më vonë.

Sidoqoftë, gjëja e rëndësishme është fakti se askush nuk do të jetë në gjendje të ndajë Turqinë. Nuk ka ndarje apo ndryshim në fatin e Turqisë. Prandaj, pa marrë parasysh se sa të frikshme ose të paqarta mund të duken planet e Nëntokës Shtetërore Britanike, ajo kurrë nuk do të jetë në gjendje të kapërcejë fatin e përcaktuar nga Zoti i Plotfuqishëm.

Problemi i Nëntokës Shtetërore Britanike gjatë atyre ditëve ishte nënvlerësimi i turqve. Përfaqësuesit aktual të Nëntokës Shtetërore Britanike po bëjnë të njëjtin gabim sot. Këta përfaqësues të strukturës së thellë me mentalitetin e tyre mafioz nuk arrijnë të kuptojnë dashurinë e Turqve për vendin, kombin dhe flamurin e tyre. Ata gabimisht besojnë se mund t'i arrijnë qëllimet e tyre duke botuar në media të ndryshme harta të një Turqie imagjinare të ndarë, duke krijuar lidhje të mbrapshta me grupe terroriste përmes përdorimit të spiunëve vendas. Ata nuk arrijnë të kuptojnë që Kombi Turk kurrë nuk do të lejojë kurrë të ndodhë kjo gjë. Ata së shpejti do të kuptojnë se planet e tyre do të dështojnë dhe se nuk ka ndarje të Turqisë.

Në fakt, problemi i vërtetë i Nëntokës Shtetërore Britanike është pamundësia e tyre për të kuptuar që përcaktimi i Zotit tejkalon të gjitha planet e tjera sepse fuqia e pafund e Zotit do të shfuqizojë të gjitha planet tinëzare. Përcaktimi i do të ndodhë patjetër. Zoti i Plotfuqishëm kurrë nuk do të lejojë që njerëzit e sinqertë, të ndershëm, të drejtë dhe të devotshëm të dështojnë:

Zoti nuk do të ju jap pabesimtarëve asnjë shancë kundër besimdrejtëve... (Kur'an, 4:141)

Trazirat kundër forcave kombëtare në Anatolia dhe lidhjet e tyre me nëntokën shtetërore

Ndërsa pushtimi i Stambollit vazhdonte, Nëntoka Shtetërore Britanike njëkohësisht po bënte plane për të shtypur përpjekjen për pavarësi që po merrte vrull shpejt. Së pari, ata ngritën njësi ushtarake, stërvitën dhe armatosën ushtarët e tyre. Kjo ushtri e vogël u quajt *Kuva-yi İnzibatiye* (Forcat e Rendit) dhe Süleyman Şefik Pasha u emërua si komandant i saj. Ata gjithashtu mbështetën bandat në Anadoll që u rebeluan kundër qeverisë së Ankarasë dhe u siguruan atyre para dhe armë. Këto banda, më së shumti njësitet e Ahmet Anzavur, përbëheshin nga refugjatë Kaukazianë që ikën nga lufta civile ruse. Gjatë viteve të para të përpjekjes për pavarësi, me gjithë vështirësitë e formimit të një shteti të ri, Mustafa Kemal duhej të ballafaqohej edhe me këto banda.

Nëntoka Shtetërore Britanike u përpoq të kthente kurdët në Anadoll kundër Forcave Nacionaliste. Nënkolonel Edward William Charles Noel, i njohur gjithashtu si Lawrence i Kurdëve, ishte një spiunë të cilit iu caktua detyra që të bënte Kurdët të ngriheshin dhe të shkëputnin Anadollin Juglindor nga Perandoria Osmane.

Le të shohim se se çfarë theksoi Mustafa Kemal Atatürku për Noelin në *Fjalimin e tij të Famshëm*:

Për të krijuar një luftë vëllazërore midis turqve dhe kurdëve dhe për të ndihmuar në ndërtimin e një Kurdistani të pavarur nën kontrollin britanik, ata provokuan kurdët. Ata shpenzuan shuma të mëdha parash për këtë qëllim, spiunuan pa fund ... Një oficer britanik i quajtur Noel punoi për një kohë të gjatë në Diyarbakir për të arritur këtë qëllim dhe përdori të gjitha mënyrat për të mashtëruar njerëzit për të arritur synimin e tij.³³²

Noel, i cili argumentoi se kurdët i përkisnin racës ariane dhe për këtë arsye ishin më afër evropianëve sesa turqit, sugjeroi krijimin e një entiteti autonom kurd në Anadollin Juglindor nën kontrollin britanik.

Çlirimi i Stambollit

Pasi trupat turke shpëtuan Izmirin nga pushtimi më 9 shtator të vitit 1922, ata u kthyen në veri, në ngushticën e Dardaneleve. Ndërsa ushtritë turke dhe britanike u përplasën me njëra-tjetrën midis 15 dhe 23 shtatorit, diskutimet filluan në Parlamentin Britanik. Disa donin paqe, ndërsa të tjerët bënin presion për të vazhduar luftimet. Më në fund, më 23 shtator, u vendos që Trakia Lindore dhe Stambolli t'u jepeshin turqve dhe menjëherë pas kësaj, më 11 tetor të vitit 1922, u nënshkrua Armëpushimi i Mudanya, i cili zyrtarisht i dha fund Perandorisë Osmane dhe vulosi mbarimin e Luftës Turke për Pavarësi. Kështu, plani 100-vjeçar i Nëntokës Shtetërore Britanike mbi Anadollin përfundoi falë përpjekjes për pavarësi të Anadollit të udhëhequr nga Mustafa Kemal Atatürk. Nëntoka Shtetërore Britanike e mbajti kryeministrin Lloyd George përgjegjës për këtë dështim dhe e detyroi atë të dorëhiqej. George, nga ajo pikë e tutje, nuk do të ishte kurrë më me ndikim në politikën britanike.

Trupat britanike u tërhoqën nga Stambolli, por e mbajtën të paprekur praninë e tyre ushtarake në Mosul, Irak, Arabi dhe Kuvajt. Nëntoka Shtetërore Britanike nuk i braktisi asnjëherë përpjekjet e saja për të prodhuar kriza. Ajo kurrë nuk pushoi së ndërhyruri në Suez dhe Egjipt, Siri ose Jordan, nuk hoqi dorë kurrë nga provokimi i Kurdëve. Sistemi që Nëntoka Shtetërore Britanike e ndërtoi në Lindjen e Mesme pasi shkatërroi Perandorinë Osmane nuk solli asgjë tjetër përveç konfliktit dhe vdekjes për myslimanët. Në shekullin e 20-të, më shumë se 100 grushtë shtete dhe mbi 30 luftëra civile ndodhën në Lindjen e Mesme dhe Afrikën e Veriut, dhe si rezultat, më shumë se 15 milion myslimanë humbën jetën. Atentatet, kryengritjet, masakrat, armët kimike dhe luftërat e përgjakshme ku myslimanët vranë myslimanë të tjerë u bënë pjesë e ngjarjeve të përditshme. Fillimi i shekullit 21 ka qenë edhe më i përgjakshëm.

Incidente të ngjashme ndodhën jo vetëm në Lindjen e Mesme, por edhe në Indi, Pakistan, Bangladesh dhe Afganistan. Ndërsa anëtarët e nëntokës shtetërore kënaqeshin në pallatet e tyre me pasuritë e tyre në ishujt Verior, gjaku mysliman derdhej pafund. Çuditërisht, Nëntoka Shtetërore Britanike nuk i fitoi ato luftëra duke përdorur ushtarët e vet. Myslimanët u detyruan të luftonin me myslimanët e tjerë.

Duke iu kthyer atmosferës së konfliktit që Nëntoka Shtetërore Britanike e krijoi në Lindjen e Mesme, kurdët u mashtruan me premtime për të krijuar shtetin e tyre, si rezultat i të cilit, ata u shtypën dhe vranë nga qeveritë Irakiane dhe Siriane. Shijat u provokuan kundër fqinjëve të tyre suuni dhe anasjelltas. Konservatorët, patriotët, liberalët dhe të majtët u vunë përballë njëri-tjetrit. Ndërsa pushtimi i Kuvajtit ishte duke u zhvilluar, agjentët e Nëntokës Shtetërore Britanike po i thoshin Saddam Huseinit se Kuvajti i përkiste atij dhe se ai e kishte me të drejtë të merrte atë që i takon. Ndërsa Hafiz al-Asad po masakronte njerëzit në Hama, të ashtuquajturit këshilltarë të tij i thanë se nëse nuk i vriste ata, ata do ta vrisnin. Ushtritë arabe, para se të fillonin një sulm kolektiv kundër Izraelit, morën dritën jeshile nga diplomatët britanikë. Nëntoka Shtetërore Britanike natyrisht e dinte që ushtritë arabe do të mposhteshin nga Izraeli. Egjipti, duke shtetëzuar Kanalin e Suezit, gjoja për interesat e veta, vetëm ndihmoi britanikët dhe askënd tjetër.

Një pikë duhet ta kemi parasysh: nuk do të ishte realiste të bëjmë me gisht vetëm kah Nëntoka Shtetërore Britanike për gjithçka që shkon keq në Lindjen e Mesme. Nuk ka dyshim se skemat e Nëntokës Shtetërore Britanike janë të pamëshirshme dhe të liga. Sidoqoftë, të bësh pre e të gjitha kompleteve të nëntokës shtetërore është në të vërtetë një nga gabimet dhe dështimet më të mëdha të disa prej myslimanëve dhe bashkësive islame. Disa shoqëri myslimane që harruan t'i besojnë Zotit dhe të ndjekin Kuranin, që i trajtuan bestytnitë si fe, që u mësuan ta shikonin veten si inferiorë dhe të pafuqishëm pasi besuan në gënjeshttrat dhe mashtrimet e 'racës superiore' të prodhuara nga Nëntoka Shtetërore Britanike, u mboshtën let në fund. Duke besuar në marrëzitë e 'racës superiore', ata u bënë të prekshëm nga propaganda e nëntokës shtetërore. Për këtë arsye, ata paguan çmim të rëndë për këtë gabim dhe po e paguajnë akoma. Nëse ata vazhdojnë të qëndrojnë larg Kuranit dhe të distancohen nga vëllezërit e tyre myslimanë, ata do të vazhdojnë të jenë peng e kompleteve të nëntokave shtetërore. Është thelbësore që ky rrezik të pranohet dhe që komuniteti mysliman të bashkohet rreth Islamit - vetëm rreth Islamit të bazuar në Kuran. Është gjithashtu thelbësore që bashkësia islame të bashkojë forcat për të udhëhequr botën për nga cilësia, dashuria, paqja dhe drejtësia.

Ata të cilët janë pabesimtarë janë miq dhe mbrojtës të njëri tjetrit. Nëse nuk veproni ashtu siç jeni udhëzuar, do të bëhen ngatërresa dhe shkatërrime në tokë. (Kur'an, 8:73)

Përpjeket e Nëntokës Shtetërore Britanike për të marrë Islamin nga Myslimanët

Pasuesit e ish-kryeministrit britanik William Ewart Gladstone, i cili tha 200 vjet më parë, "*Për sa kohë që kishte pasues të këtij libri të mallkuar [natyrisht që Kur'ani është mbi pohime të tilla], Evropa nuk do të njihje paqe*",³³³ sot po bëjnë gjithçka që kanë në dorë për ta mbajtur botën islame larg Kur'anit. Në fakt, ata kanë qenë të suksesshëm në një farë mase. Në një masë të madhe, Kur'ani ju mor myslimanëve dhe në vend të tij, u prezantua një filozofi radikale e mbushur me bestytni. Nuk duhet harruar që politika moderne e Nëntokës Shtetërore Britanike po merr Islamin autentik, me fjalë të tjera Islamin siç përcaktohet në Kuran, nga myslimanët. Nëntokat shtetërore janë plotësisht të vetëdijshme për faktin se Islami Kur'anor është mishërimi i civilizimit, modernizmit dhe është burimi i vërtetë i paqes, dashurisë dhe demokracisë. Ata janë gjithashtu të vetëdijshëm për faktin se një sistem kaq i shkëlqyeshëm do të triumfojë mbi sistemin pseudo socialist, me të vërtetë komunist-anarkist-imperialist që ata po përpiqen të ndërtojnë. Kjo vetëdije është arsyeja se pse Nëntoka Shtetërore Britanike gjithmonë ka synuar Islamin e vërtetë.

Në përpjekjen e saj të paepur për t'i dhënë fund dhe copëtuar Perandorinë Osmane, Nëntoka Shtetërore Britanike gjithmonë ka përdorur këtë metodë. Disa pashallarë dhe udhëheqës osmanë që nuk e dinin Islamin Kur'anor, të cilët nuk kishin vetëbesim dhe të cilët nuk ishin në gjendje të mendonin si duhet nën ndikimin e bestytnive, e përgatitën këtë shkatërrim pothuajse me duart e tyre. Duhet të kihet parasysh se Nëntoka Shtetërore Britanike vazhdon të shkatërrojë vendet e Lindjes së Mesme duke përdorur të njëjtën metodë. Duke e ditur përmes përvojës se mënyra më e mirë për të shkatërruar është 'vënia e vëllait kundër vëllait', Nëntoka Shtetërore Britanike shfrytëzon çdo mundësi për ta bërë këtë gjë. Meqenëse ky komplot është e ekspozuar tani, është thelbësore që komuniteti mysliman ti njoh sfidat dhe të identifikojë gabimin.

Ndarja dhe konfliktet nuk do të përfundojnë duke u bërë armiq myslimanët me njëri-tjetrin. Përkundrazi, gjithçka duhet të bëjmë që të jemi më të bashkuar. Kjo mund të arrihet vetëm duke iu përmbajtur Kuranit. Prandaj, bota

muslimane duhet ta rregullojë shpejt këtë situatë duke korrigjuar gabimet e tyre dhe duke iu përmbajtur librit tonë fisnik Kuranit.

[Besimtarë janë] ata të cilët i përgjigjen thirrjes së Zotit të tyre, e falin namazin dhe këshillohen për punët e tyre me njëri-tjetrin, ndajnë nga ajo të cilën i kemi furnizuar; ata të cilët kur i godet ndonjë padrejtësi e madhe, i bëjnë qendresë dhe marrin hak. (Kur'an, 42:38-39)

Ata dëshirojnë të fikin dritën e Allahut me gojën e tyre, por Allahu e përsos dritën e Tij, edhe nëse (këtë gjë) e urrejnë pabesimtarët Zoti është Ai i cili e ka udhëzuar të dërguarin e Tij me udhërrëfimin dhe fen e vërtetë, për ta ngritur atë më lartë se të gjitha besimet tjera, edhe nëse këtë gjë nuk e pëlqejnë idhujtarët. (Kur'an, 61:8-9)



Rruga për në Lozanë

Pas luftës së madhe

Kur Sir Adam Block, i deleguari britanik dhe Presidenti i Këshillit të Administratës së Borxhit Publik Osman, po përgatitej të largohej nga Stambolli pas shpalljes së luftës në vitin 1914, ai bëri paralajmërimin vijues:

*Nëse Gjermania fiton, ju do të bëheni koloni gjermane. Por nëse Britania fiton, ju do të vdisni!*¹³³⁴

Lufta e Parë Botërore me përmasa shkatërruese e cila filloi me shkrepjen e një pistolete më 28 korrik të vitit 1914 përfundoi zyrtarisht më 11 nëntor të vitit 1918. Rreth dy muaj më vonë, u mbledh Konferenca e Paqes në Paris. Më 18 janar të vitit 1919 disa nga palët filluan të zbatonin marrëveshjet sekrete që kishin hartuar më parë ndërsa lufta po vazhdonte ende. Britania dhe Franca, për të shmangur shkeljen e plotë të Katërmbëdhjetë Pikave të Wilson, duke mos hequr dorë nga aspiratat e tyre koloniale, propozuan "pagesa për dëme gjatë luftës" në vend të "dëmshpërblimit të luftës" dhe "mandate" në vend të "kolonializmit".

Konferenca e Paqes në Paris dëshmoi diskutime të nxehta për ligjet e luftës dhe për ndarjen e territoreve; por këto nuk ishin temat e vetme të debatuar. Po hidheshin hapa të fshehtë për të formuar një rend të ri botëror. Me një seancë të mbajtur më 30 maj të vitit 1919, u vendos që të bëhej zyrtare një organizatë e pakapshme, të cilën nëntoka shtetërore do ta përdorte më vonë për të kontrolluar botën. Për të kuptuar më mirë këtë strukturë, e cila sot njihet si 'Chatham House', le të mësojmë së pari disa fakte rreth babait të saj themelues, Lionel George Curtis.

Arkitektët e traktatit të Sevres

Lionel Curtis për herë të parë u bë i njohur gjatë aktiviteteve të tij në kolonitë britanike në Afrikën e Jugut midis viteve 1899-1909. I caktuar nga Sir Alfred Milner për të kryer detyra të ndryshme në rajon, Curtis u shoqërua nga të diplomuar të tjerë të Oksfordit, të cilët gjithashtu u dërguan nga Milner.

I njohur ndryshe si 'Kopshti i Milnerit', ky ishte një grup i ngushtë njerëzish me prejardhje të ngjashme arsimore, vlera të përbashkëta dhe stil të njëjtë të jetesës. Ata kaluan shumë kohë së bashku në Afrikën e Jugut dhe patën debate të shpeshta për çështje shoqërore dhe politike. Kopshti përbëhej nga njerëzit e mëposhtëm:

George Geoffrey Dawson: Drejtor dhe Redaktor i revistës *Times*

Richard Feetham: Avokat, Gjykatës i Apelit në Gjykatën e Apelit të Afrikës së Jugut, anëtar i Këshillit Legjislativ Transvaal

William Lionel Hitchens: Kryetari i Kompanisë Elektrike Angleze

Robert Henry Brand: Drejtor Menaxhues në Lazard Brothers Co.

Sir Patrick Duncan: Guvernatori i Përgjithshëm i Afrikës së Jugut

John Dove: Gazetar, Redaktor i Revistës së "Tryezës së Rrumbullakët"

J. F. (Peter) Perry

Xhefri Robinson

Pas vitit 1905, Hugh Wyndham, Philip Kerr (ambasadori britanik në ShBA, gjatë viteve 1939-1940), Lord Selborne dhe Sir Dougal Orme Malcolm gjithashtu u bënë pjesë e këtij grupi.

Aktivitetet e këtij grupi vazhduan më intensivisht pasi anëtarët e lartëcekur u larguan nga Afrika e Jugut.

Qëllimi i Alfred Milner ishte bashkimi i kolonive të Afrikës së Jugut nën flamurin britanik. Ai ndihmoi në transferimin e parave tek grupi i tij nga fondi 'Bursat e Rhodes', të cilat ishin vendosur më parë në përputhje me testamentin e Cecil Rhodes. Lexuesit do të rikujtojnë nga kapitujt e parë të librit se Cecil Rhodes ishte një nga anëtarët më të shquar darvinistë dhe racistë të Nëntokës Shtetërore Britanike, i cili arriti pasuri të madhe në Afrikën e Jugut përmes tregtisë së diamanteve dhe minierave.

Në ndërkohë, Lionel Curtis filloi të quhej '*profeti*' brenda anëtarëve të Kopshtit (Sigurisht që profetët janë mbi pretendime të tilla). Curtis arriti të bashkonte Afrikën e Jugut më 31 maj të vitit 1910. Për Curtis, Afrika e Jugut ishte një 'mikrokozmos' dhe ajo që ishte e vërtetë për Perandorinë Britanike ishte po aq e vërtetë në Afrikën e Jugut. Pasi bashkimi përfundoi në kontinent, ai besoi se Kopshti mund të "fillojë disa punë të të njëjtit lloj" në vendet e tjera.³³⁵

Në vitin 1909, Alfred Milner u takua me sponsorë dhe mbështetës të mundshëm duke ndihmuar Lionel Curtisin me një detyrë tjetër: duke i mundësuar atij që të organizonte një takim të Tryezës së Rrumbullakët në rezidencën e Lord Anglesey në Plas Newydd në Uells në Britaninë e Madhe më 4-5 shtator, të vitit 1909. Përveç anëtarëve të ekipit të Kopshtit, Lordët Howick, Lovat, Wolmer dhe FS Oliver ishin gjithashtu të pranishëm në këtë takim. Pas pak, një tjetër formacion ekskluzivisht britanik ju bashkua tryezës, i cili përfshinte Leo Amery, Lord Robert Cecil, Reginald Coupland, Edward Grigg dhe Alfred Zimmern.

Lionel Curtis botoi një artikull në Dhjetor të vitit 1918 në revistën e Tryezës së Rrumbullakët, ku ai propozoi që një Lidhje e Kombeve duhet të ndërtohej pas Luftës së Parë Botërore për të mbikëqyrur një sistem të mandateve në të gjithë botën. Ai besonte se një aleancë britaniko-amerikane në menaxhimin e këtij sistemi do të siguronte ekuilibrin ndërkombëtar. Si pasojë, ai u ftua në Konferencën e Paqes në Paris. Pastaj, ai ndoqi seancën e Lidhjes së Kombeve të kryesuar nga Robert Cecil nga Ministria Britanike e Informacionit, i cili ishte gjithashtu një nga kuadrot e Tryezës së Rrumbullakët. Në vitin 1919, u themelua Instituti Amerikan-Britanik për Çështje Ndërkombëtare, i cili më vonë do të shndërrohej në CFR (Këshilli për Marrëdhëniet me Jashtë) në New York, dhe Instituti Mbretëror i Punëve Ndërkombëtare i njohur Chatham House, me seli në Londër.

Presidentët e parë të Chatham House:

Robert Cecil

Arthur James Balfour

John R. Clynes

Edward Grey

Natyrisht, ky formacion ishte prapa planeve të copëtimit të Perandorinë Osmane në Konferencën e Paqes në Paris si dhe Traktatin e Sevres.

Për më tepër, përsëri gjatë konferencës, komisioni i udhëhequr nga Britanikët vendosi të ndërtojë Lidhjen e Kombeve.

Turqia e re në rrugë për Lozanë

Humbja e ushtrisë greke në Anadoll më 30 gusht të vitit 1922 nga ushtria turke çoi në Armëpushimin e Mudanya më 11 tetor të vitit 1922. Kjo marrëveshje armëpushimi përcaktoi që forcat e okupimit të largoheshin nga territori turk dhe të nënshkruhej një traktat përfundimtar i paqes. Prandaj, Aleatët i dërguan një njoftim qeverisë së Ankarasë më 27 tetor të vitit 1922 dhe e ftuan atë në konferencën e paqes që do të fillonte në Lozanë më 13 nëntor të vitit 1922.

Turqia luftoi 10 vite që të ishte në gjendje të arrinte në rrugën për në Lozanë. Nga Luftërat Ballkanike që filluan në 1912 deri në përfundimin e Luftës Turke për Pavarësi në vitin 1922, 5 milion njerëz humbën jetën. Krahasuar me vendet e tjera që luftuan në Luftën e Parë Botërore, kjo përfaqësoi numrin më të madh të viktimave. Kombi turk doli i dërrmuar, i lodhur dhe i varfëruar nga kjo luftë e tmerrshme poashtu me një shtet më pak. Sidoqoftë, përkundër të gjitha pengesave, populli turk nuk u dorëzua kurrë dhe bëri një rikthim me një shtet të ri përmes Traktatit të Lozanës. Ky traktat është i vetmi traktat paqeje që është ende në fuqi që nga Lufta e Parë Botërore. Të gjitha traktatet e tjera të nënshkruara në epokën e pasluftës u revokuan nga Lufta e Dytë Botërore. Me fjalë të tjera, Turqia është i vetmi vend që ka kaluar 93 vitet e fundit pa luftë.

Konferenca e Lozanës ishte një proces i mundimshëm, i tensionuar dhe i vështirë. Negociatat filluan më 20 nëntor të vitit 1922 por vetëm më 24 korrik të vitit 1923 palët ishin në gjendje të arrinin një marrëveshje dhe të nënshkruanin traktatin. Për më tepër, çështje si Mosuli, ngushticat dhe Hatay nuk mund të zgjidheshin dhe u shtynë për një datë të mëvonshme. Kohë pas kohe, bisedimet ngecnin dhe herë u ndaluan herë pezulluan. Sidoqoftë, shteti i ri turk ishte i vendosur ndaj Paktit Kombëtar (*Misak-ı Milli*) dhe nuk do të hiqte dorë nga qëndrimi i tij ndaj ngushticave. Prandaj, kur negociatat përfunduan, kufijtë e Paktit Kombëtar u ruajtën në masë të madhe, pavarësisht dorëzimit të disa tokave të vogëla.

Britania, e cila doli të ishte burimi kryesor i vështirësisë për shtetin e ri turk gjatë procesit të negociatave, për shkak të politikave të saj mashtruese dhe manipulative - madje edhe përgjimit të telegrameve të delegacionit turk - përdori intensivisht politikën nëntokësore gjatë negociatave të Lozanës dhe bëri të pamundurën për të sabotuar palën turke.

Britania përpara negociatave të Lozanës

Është e dobishme të kuptohet qasja britanike ndaj Turqisë përpara negociatave të Lozanës dhe se si ajo e formoi strategjitë e saj nën ndikimin e nëntokës shtetërore. Kjo pikë është e rëndësishme ngase kjo pjesë e librit do të fokusohet në mashtrimet e Nëntokës Shtetërore Britanike kundër Turqisë gjatë këtyre negociatave. Për ta bërë këtë, së pari duhet kuptuar se si udhëheqësit e atëhershëm britanikë i shikonin turqit dhe Turqinë e re.

Sidoqoftë, Ismet Pasha i kuptoi planet e tyre, nuk ju besoj sygjërimeve të tyre dhe iu drejtua qeverisë francize për ndihmë në radhë të parë. Mirëpo, Franca deklaroi se çështja e Mosulit duhet të zgjidhet midis turqve dhe britanikëve.

Në të njëjtën kohë, disidentët po bëheshin më të fortë në parlamentin britanik. Edhe pse Curzon pohoi se ishte për shkak të kokëfortësisë së Ismet Pashës që çështja e Mosulit ishte ende problematike, ajo u pa si një dështim i Curzon në Parlamentin Britanik dhe filloi një fushatë e egër kundër tij. Më 8 dhjetor të vitit 1922, ish-kryeministri Bonar Law i shkroi një letër Curzonit duke e bërë të qartë qëndrimin ndaj tij:

... Ka filluar një fushatë e madhe kundër jush. Kohët e fundit, letra që Gounaris ju shkroi më 15 shkurt u bë publike. Pretendimi se ju ishit arsyjeja e dështimit grek dhe jo Lloyd George po përdoret si armë kundër jush. Një pyetje parlamentare u paraqit për të hetuar nëse Kabineti ishte në dijeni të atyre letrave. Dhe unë thashë, po. Çështja u hetua, por përfundimi nuk mund të arrihet. Është dëshmi shumë e rëndësishme për ne që emri juaj nuk përmendet jo vetëm në listën e Foreign Office, por edhe në listat që Horne dhe Austen u lanë pasardhësve të tyre. E di, të jeni të sigurt. Ata kurrë nuk mund t'ju fajësojnë për këtë çështje.³⁷⁹

Duket se Curzon ishte nën presion të madh nga Nëntoka Shtetërore Britanike dhe u detyrua të mos bënte kompromise me çështjen e Mosulit. Për shkak të këtij presioni, Curzon bëri çmos që të mos e jepte Mosulin në Lozanë, pasi ishte një levë e rëndësishme për Nëntokën Shtetërore Britanike.

Duke parë se nuk kishte asnjë marrëveshje me Lord Curzonin për Mosulin, Ismet Pasha dërgoi ekonomistin turk Rüstem Beu dhe ish-ministrin e Tregtisë dhe Hekurudhave Şeref Beun tek Bonar Law, kryeministri britanik i cili nuk dëshironte që negociatat të pezulloheshin. Ky veprim zemëroi pafund Lord Curzonin. Ai i shkroi një letër të ashpër diplomatit britanik Sir Eyre Crowe më 11 janar të vitit 1923 dhe pohoi se nëse bisedimet me përfaqësuesit turq nuk mbarojnë, ai do të tërhiqet nga negociatat për Mosulin.

Më vonë Curzon i dërgoi një letër tjetër me të njëjtin ton të ashpër më 17 janar të vitit 1923, Sekretarit të Shtetit për Kolonitë, Walter Hulme Long. Në telegram ai shkroi:³⁸¹

Si një ish-koleg dhe mik i juaji, a mund t'ju pyes, si mund të ngulni hundën në çështjet me të cilat po merrem unë? Një ditë tjetër, Rickett, me të cilin jeni njohur gjithashtu, ishte këtu. Duke shkuar prapa shpinës sime dhe duke mashtruar Ismet Pashën, ai e bindi atë të dërgonte tre përfaqësues në Londër, me të cilët jam i sigurt se jeni njohur me ta.³⁸² Këta përfaqësues shkuan në Londër për të ofruar koncesionet e naftës në këmbim të kthimit të Mosulit për turqit. Unë, nga ana tjetër, e kisha bërë të qartë se isha me vendosmëri kundër idesë dhe se do të bëja gjithçka për të mbrojtur Mosulin dhe me politikën që ndoqa, synova të sigurohesha që turqit do të hqinin dorë nga ato toka sot e përgjithmonë. Rickett duhet të ketë bindur turqit se ai kishte një ndikim të madh tek ju dhe Bonar Law, dhe turqit menduan se nëse shkonin në Londër, ata mund të merrnin Mosulin. Sigurisht, nuk mund ta di se sa dini për atë që po ndodh. E vetmja gjë që di është se ju nuk do të përpiqeni qëllimisht ta bëni punën time më të vështirë dhe të dëmtoni interesat e vendit tuaj. Ju lutemi qëndroni larg kësaj aventure të naftës. Shumë akte të turpshme përfshihen në këtë çështje për të cilat ju nuk jeni në dijeni dhe të cilat herët a vonë mund të njollosin persona të pafajshëm. Rickett nuk është person i besueshëm. Unë e di se çfarë ai u ka thënë turqve dhe çfarë i ka thënë Sir G. Armstrong.³⁸³

Aktet e turpshme të cilat Lord Curzon i përmend ishin truket e pista të cilat Nëntoka Shtetërore Britanike organizoi pas dyerve të mbyllura.

Një detaj tjetër i rëndësishëm ishte se inteligjenca britanike kishte përgjuar ilegalisht telegramet turke. Me një sistem të veçantë të dekodimit të radio-telegramit që britanikët instaluan në Stamboll, ata mund të përgjonin dhe deshifronin telegramet e dërguara nga qeveria turke në Lozanë dhe i dërguan në Londër para se delegacioni turk t'i merrte në Lozanë. Pasi siguruan telegramet turke, ata u ulën në tryezën e bisedimeve, plotësisht të vetëdijshëm për strategjinë që kishin turqit. Rumbold, kreu i delegacionit britanik në Lozanë, rregullisht e njoftonte mikun e tij Lancelot Oliphant në Foreign Office për këtë gjë më 18 korrik:

Informacioni që morëm nga burimet sekrete ishte shumë i çmuar për ne dhe na vendosi në pozicionin e një njeriu i cili luan poker dhe i sheh letrat në dorën e kundërshtarit të tij.³⁸⁴

Kjo i lejoi Lordit Curzonit dhe ndihmësit të tij Rumbold të dinin se në cilat pika turqit mund të ishin më fleksibël. Duke vëzhguar nga afër strategjitë e tyre të ardhshme, bazuar në këtë njohuri ata ose do të këmbëngulnin në një kusht, ose do të hiqnin dorë duke ditur se nuk do të kishte kuptim të negociatave me Ismet Pashën. Ky informacion gjithashtu i mundësoi Nëntokës Shtetërore Britanike të identifikojë pikat të cilat pala turke do të ishte më e gatshme t'i diskutonte. Siç shihet, Nëntoka Shtetërore Britanike nuk ngurroi të përdorte çdo metodë në negociatat e paqes dhe u përpoq të fitonte Mosulin me komplete dhe truke. Vetëm për të marrë kontrollin mbi të ardhurat e naftës dhe rrugët tregtare. Mosuli ishte hapi i parë në një plan 100-vjeçar kundër Turqisë.

Liga e Kombeve = Britania e Madhe

Siç u përmend më parë, diskutimet mbi Mosulin ishin diskutimet më të gjata dhe më të nxehta gjatë Konferencës së Lozanës. Asnjëra palë nuk donte të bënte kompromis, por çasja kryeneqe e Nëntokës Shtetërore Britanike për çështjen e Mosulit, i ktheu të dyja vendet në prag të luftës. Lord Curzon bëri manovra që synonin t'i çonin negociatat në një qorrsokak dhe kërkoi që çështja të zgjidhej nga Lidhja e Kombeve. Mirëpo, Turqia nuk ishte anëtare e Lidhjes së Kombeve në atë kohë dhe ishte krejtësisht e vetëdijshme se Britania kishte rrjetin e nevojshëm për të siguruar kalimin e vendimeve në favor të Britanisë.

Për të kapërcyer ngërçin, Ismet İnönü propozoi një alternativë të re. Mbatjen e një referendum në mënyrë që populli kurd të merr vendimin për vete. Mirëpo, duke e ditur se rezultati do të ishte në disfavur të Britanisë, Lord Curzon refuzoi propozimin. Historiani Sevtap Demirel shpjegon pse Lord Curzon e hodhi poshtë këtë ide:

*Lord Curzon thotë se një referendum nuk mund të pranohet kurrë. Pse? Sepse është një proces i mundimshëm. Duhet të gresh gomarë, duhet të gresh letra, t'i ngarkosh letrat në gomarë, t'i dërgosh në male, të shkosh te kurdët atje dhe t'i pyesësh ata 'a doni të qëndroni në Turqi? A doni të qëndroni nën mandatin Britanik në Irak? 'Këta kurdë', po përsëris fjalët e sakta në dokumentin 'Këta kurdë do t'i hanë ato letra'. Kjo është arsyeja pse ata thonë, thjesht harroni referendumin. A e dini pse po e bëjnë këtë? A i dini arsyet pas kësaj? Ai rajon i dërgon informacione të rregullta Zyrës së Jashtme rrjedhimisht edhe Lord Curzonit. Kam lexuar qindra raporte të inteligjencës. Ata të gjithë nënvizojnë një të vërtetë: Nëse në rrethanat e asaj dite, do të mbahej një referendum dhe kurdët në Mosul do të pyeteshin 'kujt do të dëshironit t'i bashkoheshit?' 99% do të zgjidhnin Turqinë. Këto të dhëna janë në raportet e inteligjencës britanike. Britanikët thanë "ne do të humbasim Mosulin, kështu që ne kurrë nuk mund t'i lëmë turqit të bëjnë një referendum dhe të pyesin kurdët se çfarë duan"...*³⁸⁵

Akademiku, historiani dhe autori İhsan Şerif Kaymaz shpjegon se si Curzon, në mendjen e tij, u përpoq të fyente popullin kurd:

Curzon argumentoi se nuk ishte çështja e zgjedhjes se kujt do t'i bashkohej Mosuli dhe se kufiri ishte vetëm një çështje e thjeshtë teknike andaj asnjë referendum nuk mund të mbahej atje. Ai tha se referendumi nuk ishte në pyetje ngase popullsia dhe kultura e atij rajoni nuk ishin të përshtatshme për referendum. Pasi njerëzit ishin analfabetë dhe nuk kishin parë kurrë një kuti votimi në jetën e tyre. Ai madje përdori disa fjalë fyese, ofenduese dhe nënçmuese për të pohuar qëndrimin e tij dhe pretendoi se referendumi mund të çojë në konflikt madje edhe në gjakderdhje. Prandaj ai tha se në vend të kësaj, çështja duhet të dërgohet Lidhjes së Kombeve.³⁸⁶

Këto pretendime ofenduese për kurdët tregojnë se pikëpamja e Nëntokës Shtetërore Britanike për kurdët nuk dallon me qasjen e tyre sot. Populli kurd është larg nga këto deklarata që kalojnë çdo kufi. Këto pohime të Curzon zbulojnë se Curzon e dinte mirë se Nëntoka Shtetërore Britanike nuk kishte ndikim mbi vendasit. Këto ofendime dëshmuar se Nëntoka Shtetërore Britanike nuk mund të fitonte kurrë mbi kurdët dhe arabët e Mosulit. Nëntoka Shtetërore Britanike mund të kishte marrë kontrollin e rajonit përmes mashtrimit dhe dhunës, por kurrë nuk ishte në gjendje të fitonte zemrat e njerëzve.

Mosuli refuzon mandatin Britanik

Populli i Mosulit janë turq që përfshijnë arabë, turq dhe kurdë, të cilët jetuan së bashku nën sundimin turk për 700 vite. Shkëputja e tyre nga sundimi turk është shkëputje nga vendlindja. E vetëdijshëm për këtë fakt, për të 'bindur' publikun, Nëntoka Shtetërore Britanike përdori metodën së saj të zakonshme: dhunën.

Qeveria e Ankarasë, në një përpjekje për të balancuar fuqinë e Britanisë në çështjen e Mosulit, nënshkroi një marrëveshje me kompaninë amerikane Chester dhe i dha privilegje të mëdha në ndërtimin e hekurudhave dhe eksplorimin e minierave, dhe kur Parlamenti turk miratoi këtë marrëveshje, britanikët u nevrifikosën. Pavarësisht se çfarë bënte, Nëntoka Shtetërore Britanike nuk mund të arrinte kontrollin mbi Mosulin. Kur njerëzit u ngritën kundër mandatit britanik dhe Mbretit Faisal të Irakut të caktuar nga Britania, britanikët shtypën dhunshëm protestuesit.³⁸⁷ Forcat britanike ushtruan presion mbi fiset anësore të Turqisë dhe arrestuan udhëheqësit e fiseve. Sidomos vendasit e Kirkukut dhe Sulejmanisë vazhduan të refuzojnë mandatin britanik pavarësisht dhunës së britanikëve.³⁸⁸

Në Mosul, kurdët filluan trazira kundër mandatit britanik edhe atje britanikët e ndaluan me dhunë protestën. Ihsan Şerif Kaymaz tregon për këtë masakër në vijim në librin e tij, bazuar në arkivat britanike:

Si përmbledhje, Churchill zvogëloi forcat tokësore për të kursyer buxhetin e mbrojtjes dhe forcoi forcat ajrore të stacionuara në Mosul. Britanikët vendosën të përdorin ushtrinë irakiane dhe milicinë asiriane si trupa tokësore. Qëllimi ishte dhënia e mesazhit se edhe lëvizja më e vogël e kurdëve në Mosul do të ndëshkohej në mënyrën më të ashpër të mundshme. Metoda ishte mizore, por e suksesshme. Pas një kohe, vetëm zhurma e avionëve ishte e mjaftueshme për të "zbutur" fiset ...

Qytetet, qendrat dhe fshatrat u goditën pa pushim me sulme ajrore dhe më pas u dogjën totalisht nga milicia asiriane. Kafshët dhe prodhimtaria e fiseve që besohet se mbështesin turqit u shfarosën. Qytetet dhe qendrat si Köysançak, Raniye, Revanduz, Biraz, Kapra, Kale, Diza, Barzan, Derbet dhe Merga u shkatërruan krejtësisht ... Fisi Barzan u detyrua të zgjedhë midis urisë dhe dorëzimit. Por tmerrri i vërtetë filloi kur ata u dorëzuan. Qyteti dhe fshatrat e Barzanit u shkatërruan nga milicia asiriane...³⁸⁹

Më 4 shkurt të vitit 1923, bisedimet e Lozanës u pezulluan. Vetëm dy ditë më vonë, Mustafa Kemal në Izmir, theksoi " Ata po përpiqen të marrin me forcë Mosulin dhe rajonin në jug të Mosulit nga ne, nga kontinenti ynë."³⁹⁰

Kjo masakër e tmerrshme e kryer në Mosul është tregues i qartë se sa largë mund të shkoj Nëntoka Shtetërore Britanike për të marrë kontrollin e një rajoni që synon. Në fakt, kjo strategji nuk është e ndryshme nga politikat e gjenocidit të praktikuara në Afrikën e Jugut dhe Indi. Nëntoka Shtetërore Britanike masakroi popullin fisnik kurd që e konsideroi si inferior. Për Nëntokën Shtetërore Britanike, këta njerëz mund të përdoren për qëllime të ndryshme. Mirëpo, meqenëse ishte Nëntoka Shtetërore Britanike në fjalë, askush nuk mund të kundërshtonte këtë 'paligjshmëri' dhe askush nuk mund t'i quante këto masakra 'gjenocid' pas Luftës së Parë Botërore, ashtu siç kishte ndodhur shumë herë më parë.

'Operacioni Kurdistan'

Historiani Sevtap Demirci shpjegon se projekti i Chester dhe propozimi i referendumit ishin ndër arsyt kryesore se pse britanikët i shuanin dhunshëm trazirat kurde:

Kishte një 'O.K.' në arkivin për të cilin askush nuk dinte apo shkruante. Unë e hasa atë papritur gjatë kërkimit tim. Kështu fillova të kërkoj për të gjetur se çfarë është kjo 'O.K.' e nënkuptuar. Mendova me vete se nuk mund

të thotë 'në rregull', sepse raportet ishin të ndërlikuara. Nëse do të ishte në rregull, ata nuk do të kishin vënë pika në mes. Ishte pika 'O', pika 'K'. Ishte në një vend të vogël. Kështu kaluan ditë, muaj dhe unë nuk e gjeta në dokumentet e Zyrës së Jashtme, por në dokumentet e Sekretarit të Shtetit për Kolonitë. Rezulton se ishte e shkurtër për 'Operacioni Kurdistan' ... Britania kishte vënë në lëvizje projektin 'Operacioni Kurdistan'. Nëse pyesni, se cili është ky operacion, atëherë nuk ka detaje. Asnjë informacion, asnjë dokument, vetëm O.K....

Brenda fushëveprimit të operacionit Kurdistan, britanikët bombarduan rëndë atë zonë. Ishte një operacion shumë i fshehtë, askush nuk e dinte për të. Një person nga selia e ushtrisë britanike dhe një person nga Kryeministria ... Askush nuk ishte i informuar për këtë. As parlamenti, as aleatët, askush. Për dy ditë rresht, britanikët sulmuan pareshtur Mosulin, Kirkukun dhe Sulemaninë. Raundi i dytë i negociatave në Lozanë ishte menduar të fillonte më 23 prill të vitit 1923. Operacioni përfundoi në orën 12:00 të 22 prillit. Të nesërmen, kur raundi i dytë i bisedimeve filloi në Lozanë, Turqia nuk kishte më njerëz në rajon që mund të merrnin pjesë në referendum. Ky operacion pamundësoi plotësisht mundësinë e një referendumi. Nëse pyesni, sa njerëz vdiqën, unë nuk e di, vetëm di se shumë civilë humbën jetën. Çfarë donte të thoshte Britania? Ju i jepni këto privilegje ShBA-ve, por nuk mund të merrni vendime pa përfshirjen time. Dhe rezultati i dytë ishte, në njëfarë mënyre, marrja në robëri e fiseve kurde që mbështesin turqit dhe populli indigjen që dëshironin t'i bashkoheshin Turqisë. Kështu që kur filloi raundi i dytë, Turqia nuk ishte më në gjendje të sugjeronte mbajtjen e një referendumi.³⁹¹

Nëntoka Shtetërore Britanike ishte e vetëdijshëm se, vetëm nëse vriste të gjithë në rajon, do të kishte kontrollin mbi Mosulin. Për këtë arsye, ajo iu kthye traditës së saj shekullore dhe nuk u përmbajt nga vrasja brutale e mijëra njerëzve të pafajshëm, popullsisë autoktone të atij rajoni. Është e qartë se masakra kishte një qëllim tjetër përveç naftës ose tregtisë. 'Operacioni Kurdistan' ishte teknika e Nëntokës Shtetërore Britanike për të fituar Mosulin. Në të vërtetë, kjo është arsyeja se pse ky mision ishte kaq i fshehtë, pse nuk kishte asnjë dokument zyrtar që vërtetonte se ky mision ka ekzistuar ndonjëherë. Ndërsa bisedimet e Lozanës ishin duke u zhvilluar, Nëntoka Shtetërore Britanike po zbatonte planin e saj për Kurdistanin, të hartuar shumë kohë më parë. Në qendër të tij ishte Mosuli, i cili duhej marrë nga Turqia. Kurdët që viheshin nën sundimin britanik shënuan hapin e parë drejt ndërtimit të çështjes artificiale kurde, e cila do të vazhdonte edhe njëqind vite të tjera. Nëntoka Shtetërore Britanike ishte i bindur se ëndrra e Gladstone për të 'kthyer turqit në stepat e Azisë Qendrore' mund të realizohej në këtë mënyrë. Edhe shkatërrimi i një populli të tërë justifikojë nëse qëllimet arrihen.

Turqia tërhiqet nga Mosuli

Deri në atë pikë, delegacioni turk ishte i vendosur për të marrë Mosulin, por me zhvillimet e reja, ata u detyruan të miratojnë një strategji të re sepse Nëntoka Shtetërore Britanike nuk hezitonte të kryente masakra në Mosul, Kirkuk dhe Sulemani. E vetmja rrugëdalje ishte pajtimi.

Një arsye tjetër e rëndësishme se pse Turqia nuk rrezikoi luftën në Mosul dhe u pajtua me kushtet e propozuara nga britanikët ishte fakti se Ankaraja nuk kishte forca ajrore për të luftuar forcat ajrore britanike të stacionuara në Irak. Pas luftës, Britania vendosi të gjithë forcën e saj ajrore në Irak. Kjo gjithashtu demonstroi qartë se Mosuli nuk ishte një temë e negociueshme për Britaninë. Natyrisht, duhet të kihet parasysh se pala turke sapo kishte dalë nga një periudhë dhjetëvjeçare e luftërave të vazhdueshme që përfshinin Luftërat Ballkanike, Luftën e Parë Botërore dhe Luftën për Pavarësi. Turqia, gjatë atyre viteve, ishte një vend i dërrmuar dhe i varfëruar që përpiqej të qëndronte i fortë mes rrënojave të Perandorisë Osmane. Jo vetëm që nuk kishte forcë ajrore për t'u mbrojtur, por gjithashtu kishte aftësi të kufizuar ushtarake.

Për më tepër, gjatë bisedimeve të Lozanës, Stambolli ishte ende nën okupim. Në këto rrethana, pala turke ishte në disavantazh me palën britanike. Të gjithë këta faktorë e detyruan palën turke të bënte kompromis për çështjen e Mosulit.

Mustafa Kemal, deri në kohën kur bisedimet e Lozanës u pezulluan, tha në shumë raste se Mosuli ishte një tokë turke dhe se ai do të sigurohej që të qëndronte kështu, duke përdorur forcën ushtarake nëse ishte e nevojshme. Mirëpo, më vonë ai e ndryshoi tonin në mënyrë të konsiderueshme. Ai filloi të thotë se do të ishte e gabuar të jesh këmbëngulës në Lozanë për zgjidhjen e çështjes së Mosulit dhe se ajo mund të zgjidhet më vonë. Një raport i inteligjencës britanike

i datës 15 mars të vitit 1923 shpjegon arsyen pas këtij ndryshimi të kësaj retorike. Raporti deklaroi se në dy vitet e ardhshme, jo vetëm Mosuli, por Iraku, Basra, Arabia, Siria dhe ndoshta vende të tjera islame, do të mund të bashkohen nën hegjemoninë turke dhe se do të realizohet projekti i Bashkimit Islamik.³⁹²

Bashkimi Islamik do të ndodhë patjetër, të gjitha vendet islame do të bashkohen, kufijtë do të hiqen dhe madje vende të tilla si Rusia, ShBA-të, Izraeli, Kina dhe të gjitha vendet e tjera të botës do t'i bashkohen këtij unioni. Ky bashkim do të ndodhë me shfaqjen e *Mehdiut* (p.q.m.t) kur të gjitha komplotet e liga të Nëntokës Shtetërore Britanike, luftërat dhe konfliktet të përfundojnë dhe kur të mos derdhet as edhe një pikë gjaku. Mustafa Kemal, pa dyshim, e dinte që do të vinte kjo kohë. Ai ishte i vetëdijshëm se, herët a vonë, turqit do të merrnin përsëri tokat që dikur u takonin atyre. Ai ishte i sigurt se, edhe pse nuk ndodhi në atë kohë, do të ndodhte me ardhjen e *Mehdiut* (p.q.m.t). Për këtë arsye, ai nuk e shtyu zarfin dhe e mbajti gjallë shpresën dhe ëndrrën për realizimin e Bashkimit Islamik.

Finalizimi i traktatit të Lozanës

Me klauzolën e 3 -të të Traktatit të Lozanës të nënshkruar më 24 korrik, kufiri midis Turqisë dhe Irakut u rregullua. Kjo klauzolë, ku Mosuli nuk përmendej, përcaktonte që Turqia dhe Britania do të vazhdonin negociatat për 9 muaj të tjerë për të përcaktuar kufirin dhe se çështja e Mosulit do të çohet në Këshillin e Lidhjes së Kombeve nëse nuk arrihej një marrëveshje. Sidoqoftë, klauzola nuk ishte e qartë në lidhje me metodat e Lidhjes së Kombeve ose thjesht se për çfarë vendimi bëhej fjalë. Siç u përmend më parë, dërgimi i çështjes së Mosulit në Lidhjen e Kombeve do të ishte në çdo rast në favor të interesave britanike. Turqia qartë nuk do të mund të fitonte në një organizatë në të cilën nuk ishte as anëtare. Nëntoka Shtetërore Britanike, e cila kishte mbajtur një kontroll të fortë mbi Lidhjen e Kombeve, shtyu me gjithë forcën e saj pretendimet e paligjshme mbi Mosulin.

Kur çështja përfundimisht iu dërgua Lidhjes së Kombeve, Turqia kërkoi që Lidhja të vendoste '*vullnetin e popullit të Mosulit*', por Britania kërkoi krijimin e '*kufirit midis Turqisë dhe Irakut*'. Fakti që klauzola përkatëse në Traktatin e Lozanës nuk i referohej Mosulit, por përmendte vetëm 'kufirin', i dha fitoren e parë argumentit britanik.³⁹³

Mosuli pas Lozanës

Mosmarrëveshja mbi Mosulin me Britaninë ishte çështja më e nxehtë e politikës së jashtme turke midis viteve 1923-1926.

Me aplikimin e Britanisë, mosmarrëveshja e Mosulit iu referua Lidhjes së Kombeve më 6 gusht të vitit 1924, e cila filloi ta diskutonte këtë çështje më 20 shtator të vitit 1924, një vit pasi u nënshkrua Traktati i Lozanës. Gjatë bisedimeve, pala turke përsëriti ofertën e tyre për një referendum në Mosul, por Britania, ashtu si më parë, e hodhi poshtë idenë me justifikime të pahijshme si '*vendasit janë injorantë dhe nuk i kuptojnë çështjet e kufirit*'.³⁹⁴ (Populli kurd në rajon janë mbi pretendime të tilla). Më 30 shtator të vitit 1924, u mor një vendim për krijimin e një komisioni hetimor, i cili përcaktoi kufijtë më 28 tetor të vitit 1924 dhe krijoi një kufi status quo turko-irakian të quajtur "Linja e Brukselit". Pikat kryesore nga raporti i komisionit që iu paraqit Lidhjes së Kombeve më 16 korrik të vitit 1925 ishin si më poshtë:

- 1- Linja e Brukselit duhet të përcaktohet si kufi gjeografik,
- 2- Kurdët me popullsinë e tyre prej 500,000 banorë përbënin shumicën në vilajetin e Mosulit,
- 3- Kurdët ishin më shumë në numër se turqit dhe arabët,
- 4- Mandati në Irak që supozohej të përfundonte në vitin 1928, do të zgjatet për 25 vite të tjera,
- 5- Mosuli t'i lihet administratës irakiane me kusht që kurdëve në rajon t'u jepen të drejta administrative dhe kulturore,
- 6- Nëse Lidhja e Kombeve vendos që rajoni të ndahet midis dy vendeve, vija e lumit Zab i Vogël do të pranohet si kufi,

7- Nëse Lidhja e Kombeve nuk e konsideron të përshtatshme që mandati në Irak të zgjatet dhe që rajoni t'i lihet Irakut me privilegje të caktuara për kurdët, atëherë Mosuli t'i lihet Turqisë,

8- Pretendimet dhe kërkesat e Britanisë në lidhje me Hakkarin të refuzohen.

Kur Turqia ngriti kundërshtime ndaj këtij raporti, Këshilli i kërkoi Gjykatës së Përhershme të Drejtësisë Ndërkombëtare në Hagë më 19 shtator të vitit 1925 të paraqiste mendimin e saj. Ky opinion ishte në përputhje me dëshirat e Lidhjes së Kombeve, dhe pavarësisht protestave turke Asambleja e Lidhjes së Kombeve njoftoi më 8 dhjetor të vitit 1925 se miratoi rezolutën e Gjykatës së Drejtësisë. Vetëm disa ditë më vonë, më 16 dhjetor të vitit 1925, ai miratoi raportin e Komisionit Hetues dhe vendosi që tokat që shtrihen në jug të vijës së Brukselit t'i lihen Irakut.

Kryengritja e Nëntokës Shtetërore Britanike nxit trazirat në të gjithë rajonin

Trazirat Nestoriane

Nestorianizmi dhe Aktivitetet Misionare që synojnë Nestorianët

Nestorianizmi është një sekt i krishterë me anëtarë në pjesë të ndryshme të Azisë. Midis viteve 1915-1924, një popullsi e konsiderueshme Nestoriane jetonte në Nusaybin, Siirt dhe Hakkari në Turqi,³⁹⁵ nga të cilët shumica u vendosën rreth Hakkarit dhe e konsideruan atë si qendrën e tyre (aktualisht nuk ka Nestorianë në Turqi).

Kur fjala u përhap në Perëndim për praninë nestoriane në tokat osmane, shumë misionarë erdhën në rajon pasi vende të ndryshme kërkuan që të përdornin këtë pakicë të krishtere në tokat osmane në avantazh për ta. Britania ishte më e bindura dhe më e vendosur për këtë strategji.

"Shoqëria Mbretërore Gjeografike" Britanike dhe "Shoqëria për Promovimin e Njohurisë së Krishterë" ishin veçanërisht aktive në aktivitetet misionare. Para se të thellohemi më tej në këto fakte historike, le të kujtojmë edhe një herë një të vërtetë shumë të rëndësishme: të qenit misionar është një veprimtari e shenjtë që njerëzit kryejnë për të përhapur besimin e tyre dhe për të komunikuar fenë në të cilën ata besojnë. Megjithatë, misionarët që do të të përmendura këtu nuk po kërkonin të kryenin një detyrë të tillë; përkundrazi, ata ishin spiunë të Nëntokës Shtetërore Britanike të ngarkuar me kryerjen e detyrave të pista, të maskuar si misionarë. Aq më tepër, ata të ashtuquajtur misionarë të dërguar nga organizatat në fjalë funksionuan njësoj si oficerët e inteligjencës në tokat turke dhe studiuuan rendin shoqëror dhe fuqinë e autoritetit shtetëror në rajon. Ata përcaktuan metodat që mund të përdoren për të provokuar këtë komunitet që kishte sfond të ndryshëm etnik kundër administratës shtetërore.

Trazirat Nestoriane dhe Nëntoka Shtetërore Britanike

Nestorianët kishin filluar revoltën dy herë kundër Perandorisë Osmane, në vitin 1843 dhe vitin 1846, por ata ishin ndalur. Gjatë Luftës së Parë Botërore, ata u përleshën me fiset kurde në Anadollin Juglindor dhe Anadollin Lindor. Arkivat osmane përmendin rivalitetin midis misionarëve protestantë britanikë dhe amerikanë si dhe rusëve ortodoksë kundër nestorianët gjatë këtyre viteve³⁹⁷ dhe se problemet mes nestorianëve dhe kurdëve u përshkallëzuan për shkak të këtyre aktiviteteve gjoja misionare. Krizat e këtyre dy komuniteteve më vonë u shndërruan në përplasje të përgjakshme kur Nëntoka Shtetërore Britanike doli në skenë dhe filloi aktivitetet e saj në rajon nën maskën e aktiviteteve misionare në shekullin XIX.³⁹⁹

Gjatë përleshjeve Kurdo-Nestoriane në vitin 1843, misionarët britanikë të udhëhequr nga George Percy Badger përdornin rroba, ushqim dhe para për të favorizuar nestorianët ndërsa Patriarku Nestorian kërkonte strehim në Konsullatën Britanike.⁴⁰⁰ Ky është një tregues i qartë se si anëtarët e Nëntokës Shtetërore Britanike i konsideruan nestorianët si një mjet ideal për t'i ndihmuar ata në këto rajone. Sapo misionarët britanikë si Dr. William Henry Browne fituan besimin e njerëzve në rajon, ata menjëherë thanë se problemi kishte të bënte me politikën e brendshme⁴⁰¹ dhe morën një qëndrim armiqësor ndaj Perandorisë Osmane.

John George Taylor, konsulli i Britanisë në Erzurum, filloi letrën e tij drejtuar Earl of Clarendon në vitin 1868, me fjalët e mëposhtme: *'Ju lutemi gjeni të bashkangjitura dy raporte të cilat përfshijnë vëzhgimet dhe përvojat e mia në lidhje me vendin dhe njerëzit. Këto të dhëna bazohen në gjashtë vite shërbim. Shtojca e letrës përfshinte, përveç detajeve demografike të nestorianëve, komentin e mëposhtëm:*

Nestorianët janë komuniteti i dytë më i madh i krishterë pas armenëve. Ato nuk janë të rëndësishme për arsye se janë të pasura ose të zgjuar. Ata janë të rëndësishëm sepse jetojnë në një terren malor pranë kufirit iranian dhe mund të kthehen në luftëtarë kur është e nevojshme. Gjithashtu në praktikë ata janë pothuajse të pavarur ... Gjithmonë ankohen për kurdët dhe turqit, nestorianët janë kaq të mjerë, saqë janë gjithmonë të gatshëm të pranojnë sundimin e të huajve për ti ruajtur tokat e tyre.⁴⁰²

Me fjalë të tjera, anëtarët e Nëntokës Shtetërore Britanike zbatuan edhe një herë taktikën e tyre të zakonshme, duke tentuar t'i paraqesin Nestorianët si një "popull i shtypur", kur në të vërtetë ata kanë jetuar për shekuj në paqe. (Nestorianizmi dhe Nestorianët janë mbi pohime të tilla).

Trazirat gjatë Luftës së Parë Botërore dhe Përplasjet e Mëvonshme

Nestorianët që bënë kryengritje gjatë Luftës së Parë Botërore u mundën nga ushtria osmane, dhe si rezultat filluan të lëviznin drejt Hamadanit me drejtimin dhe ndihmën e avionëve britanikë. Më pas, Britania krijoi një vendbanim me 3000 tenda në Baquba, 50 km nga Bagdadi, për 40,000-50,000 Nestorianë.⁴⁰³

Kjo i bëri Nestorianët më të ndjeshëm ndaj Britanikëve. Duke jetuar në kampe tendash të ngritura nga britanikët, ata ranë në kurhet e britanikëve për qëllimet e tyre në rajon.

Duke premtuar një shtet muhtar (vetëqeverisës) për Nestorianët në rajonin Hakkari dhe Urmiye, britanikët donin të ndërtonin një zonë ndërlidhëse midis Perandorisë Osmane dhe tokave të saj në Irak dhe ngritën katër batalione të Nestorianëve të quajtura "Forcat Levy" si forca të armatosur të kësaj zone.⁴⁰⁴

Identike me forcat britanike në uniformat dhe pajisjet e tyre, këto forca organizuan sulme kundër popullatës në provincat Hakkari, nakrnak dhe Van, dhe veçanërisht punuan për të dëbuar popullsinë kurde që jeton përgjatë luginës së Zab nga rajoni. Në shenjë hakmarrjeje, fiset kurde filluan të sulmonin njësitë britanike në zona të ndryshme duke filluar në mars të vitit 1919.⁴⁰⁵

Edhe pse britanikët iu përgjigjën këtyre sulmeve me kundërsulme, ata duhej të hiqnin dorë nga planet e tyre të 'zonës tampon' bazuar në përdorimin e këtyre 'forcave Levy'. Sidoqoftë, Nëntoka Shtetërore Britanike vazhdoi përpjekjet e saja për të ndërtuar një shtet nestorian në Anadoll. Gjatë konferencës së mbajtur në San Remo, Itali nga 18 deri më 26 qershor të vitit 1920, duke thirrur me qëllim të ndarjes së territorit osman, Lord Curzon kërkoi një zonë të veçantë të vendbanimeve për nestorianët. Pas këtij zhvillimi, nestorianët vendosën të ndërmarrin një sulm ushtarak në Hakkari dhe më pas të vendosen atje.⁴⁰⁶ Sulmi që filloi më 27 tetor të vitit 1920 dështoi për shkak të stinës së dimrit.

Trazirat e vitit 1924

Tre vite më vonë, Nestorianët krijuan trazira pandërprerë, mbështetëse e tyre ishin Nëntoka Shtetërore britanike. Ajo vazhdoi të përdorte Nestorianët si mercenarë kundër Turqisë derisa çështja e Mosulit të zgjidhej në favor të saj.⁴⁰⁷

Guvernatori i Hakarit, Halil Rifat Beu, i cili u zu rob në fillim të trazirave Nestoriane të vitit 1924 dhe u lirua më vonë, tha se ai pa ushtarë britanikë të armatosur midis Nestorianëve dhe avionë britanikë që fluturonin mbi kodrat e Hakarit (Çukurca). Bazuar në vëzhgimet e tij, ai tha: "Nuk ka dyshim se britanikët kanë provokuar kohët e fundit këta njerëz kundër qeverisë sonë".⁴⁰⁸

Halil Rifat Beu kishte cituar saktë në analizën e tij se trazirat u mbështetën nga Nëntoka Shtetërore Britanike. Ky fakt verifikohet më tej në një artikull të botuar nga *The Times* gjatë së njëjtës kohë. Ky artikull përshkruante tokat turke, të planifikuara për t'u marrë për Nestorianët, si Shteti Asirian, dhe duke iu referuar incidentit në Hakkari, përdori një ton kërcënues dhe tha se nëse rajoni i lihej Turqisë, do të pasonin më shumë incidente. Në të njëjtin artikull, toka turke

e Çölemerik (Hakkari) u quajt 'toka që nuk i përkisnin ende askujt'. Guvernatori Halil Rifat Beu, i cili shkoi për të hetuar zonën, u portretizua si një person që shkelte rajonin.⁴⁰⁹

Në të vërtetë, Turqia ka deklaruar në disa raste se britanikët kishin armatosur fiset nestoriane që organizuan sulme kundër Turqisë.⁴¹⁰

Nëntoka Shtetërore Britanike po planifikonte të ndërtonte rajone autonome kurde dhe nestoriane brenda vilajetit të Mosulit, të cilat sipas planit të saj më vonë do t'i bashkoheshin shtetit arab që do të themelohej nën mandatin britanik. Kjo do t'i jepte Britanisë zonën tampon që do të mbronte rezervat e saj të naftës në Lindjen e Mesme dhe do t'i mundësonte asaj të shtyjë rajonet kurde dhe nestoriane në veri për të zgjeruar sferën e saj të ndikimit.

Cafer Tayyar (Eğilmez) Pashës, Komandantit të Korpusit të 7-të, iu dha detyra të udhëhiqte operacionin ushtarak për të shtypur trazirat nestoriane⁴¹² dhe fushata filloi më 11 shtator të vitit 1924.⁴¹³ fiset kurde gjithashtu mbështetën fushatën ushtarake kundër nestorianëve.⁴¹⁴

Në mëngjesin e 14 shtatorit, një njësi kalorësish turq që kaloi kufirin midis Hakkarit dhe Mosulit u bombardua për tre orë rresht nga tre avionë britanikë që u ngritën nga Zaxho. Të detyruar të tërhiqen, njësitë turke u zhvendosën drejt veriut.⁴¹⁵ Ndonëse, kur britanikët filluan të shkelnin tokën turke duke përdorur nestorianët, Turqia i dërgoi një shënim diplomatik Lidhjes së Kombeve më 17 shtator të vitit 1924, duke e informuar atë për shkeljen e Traktatit të Lozanë.⁴¹⁶

Fushata arriti në përfundim kur njësitë turke arritën në vijën e lumit Hezil Suyu më 11 tetor të vitit 1924 dhe i përzunë rebelët në veri të Irakut.

Trazirat e Sheikh Saidit

Turqia me siguri nuk ishte e kënaqur me rezolutën e Lidhjes së Kombeve të datës 16 dhjetor të vitit 1925 që i la Mosulin Irakut. Në të vërtetë, sipas inteligjencës britanike, Mustafa Kemal po bëhej gati për një raund tjetër luftimesh. Ndërsa përgatitjet ishin duke u zhvilluar për një fushatë ushtarake për kontrollin e Mosulit, shpërtheu kryengritja e Sheikh Saidit në Anadollin Juglindor. Kjo trazirë, që pa pjesëmarrjen e disa fiseve kurde dhe zaza, ishte mjaft e dyshimtë sa i përket shkaqeve dhe kohës së saj. E vërteta është se trazirat filluan pa ndonjë arsye të vërtetë, përveç asaj që ishte planifikuar vite më parë nga Nëntoka Shtetërore Britanike. Ishte një plan rezervë që do të përdorej nëse Turqia vendos të veprojë - ushtarakisht ose ndryshe - në lidhje me Mosulin. Kjo trazirë e rreme do të theksojë gjithashtu 'ndarjen imagjinare turko-kurde', një tjetër prodhim i Nëntokës Shtetërore Britanike.

Historiani francez Jacques Benoist-Méchin bëri vërejtjet në vijim në lidhje me mbështetjen e Nëntokës Shtetërore Britanike ndaj këtyre trazirave:

Trazirat e Shejh Saidit ishin një sfidë ndaj strukturës unitare të shtetit të ri dhe zbatueshmërisë së ligjeve në të gjithë vendin ... Duke shpresuar se mund të parandalonte forcimin e regjimit Kemalist, Britania po provokonte një trazirë kurde që do të krijonte trazira. Po mbante plagën e hapur për Turqinë, duke siguruar ushqim dhe municion për protestuesit.⁴¹⁷

Britania po monitoronte nga afër kryengritjen e Shejh Saidit. Ky incident ndodhi në pikën më kritike të mosmarrëveshjes së Mosulit, nën mbikëqyrjen e Nëntokës Shtetërore Britanike dhe ashtu siç ishte planifikuar nga Nëntoka Shtetërore Britanike, i dha Britanisë një përkrahje të rëndësishëm. Kjo trazirë e falsifikuar i dha publikut ndërkombëtar mesazhin se 'turqit dhe kurdët nuk ishin në gjendje të jetonin në mënyrë paqësore së bashku në tokat turke'.⁴¹⁹

Në ditët e para të trazirave, Komisariati Francez në Bagdad i dërgoi Parisit një raport prej 40 faqesh. Raporti përmendi interesat konfliktuale franceze-britanike në Lindjen e Mesme, si dhe marrëdhëniet kurdo-britanike. Ai gjithashtu përfshiu deklaratat e mëposhtme për Shejh Saidin:

Që nga viti 1918, Shejh Said ka punuar për Komitetin Kurd të Stambollit, i cili kërkon të ndërtojë një shtet kurd nën mandatin britanik. Në vitin 1918, Abdullah Beu, udhëheqësi i Komitetit të Turqisë për Pavarësinë Kurde e prezantoi Shejh Saidin me majorin Noel, i cili ishte një veglat kryesore të politikës kurde të Britanisë ...⁴²⁰

Le të përsërisim një fakt të rëndësishëm: As kurdët as asirianët nuk dëshironin të nxisnin trazira në tokat turke. Përkundrazi, shumica e këtyre komuniteteve kundërshtuan këto trazira. E vërteta është se trazirat u organizuan dhe orkestruan nga spiunët e Nëntokës Shtetërore Britanike. Qëllimi ishte të lehtësohej ndërhyrja britanike në tokat turke, duke e portretizuar Turqinë si një vend të dobët intolerant ndaj pakicave të saj, dhe natyrisht, duke siguruar sundimin përfundimtar mbi Mosulin. Mashtrimet e Nëntokës Shtetërore Britanike patën sukses dhe Komisioni Hetimor i krijuar nga Lidhja e Kombeve lëshoi raportin e tij në favor të çështjes britanike dhe Lidhja mori vendimin e saj në përputhje me rrethanat. Fjalët në vijim të deputetit të Erzurumit Hüseyin Avni Beu u vërtetuan edhe një herë: *'Lidhja e Kombeve nuk është gjë tjetër veçse një këshill britanik'*.⁴²¹

Mosuli është i humbur

Lidhja e Kombeve e bëri Mosulin pjesë të Irakut nën mandatin britanik, dhe kohëzgjatja e tij u përcaktuar për 25 vite ndërsa fillimisht do të zgjaste vetëm 5 vite. Gjithashtu u vendos që çështjet ekonomike të zgjidhen midis dy vendeve përmes marrëveshjeve të ndryshme.

Arsyet kryesore pse mosmarrëveshja e Mosulit u zgjidh kundër argumentit të Turqisë mund të renditen si më poshtë:

- 1- Turqia nuk ishte anëtare e Lidhjes së Kombeve,
- 2- Britania e Madhe ishte anëtarja më me ndikim e Lidhjes (me të vërtetë, shumë e qvanin Lidhjen një këshill britanik),
- 3- Gjenerali Estonez që shkoi në rajon për të kryer ekzaminime nuk u lejua të shkonte në veri të vijës së Brukselit që përcaktonte kufirin turko-irakian, gjë që e bëri të pamundur kryerjen e një hetimi të paanshëm,
- 4- Turqia nuk mund të dërgonte një përfaqësues në Gjykatën e Përhershme të Drejtësisë,
- 5- Rebelimi i Shejh Saidot, i cili u nxit nga Nëntoka Shtetërore Britanike, e vendosi Turqinë në një pozitë të vështirë.

Megjithëse Turqia kundërshtoi vendimin, për të ruajtur 'atmosferën e paqes' të sapokrijuar dhe për të mos shkelur rezolutat e mëparshme të pranuar, ajo u detyrua të njohë vendimin. Administrata turke kishte vështirësi serioze gjatë asaj kohe sepse Nëntoka Shtetërore Britanike, e cili kishte shumë ndikim në atë kohë, luftoi me shpirt për Mosulin dhe ishte e vendosur të mos bënte kompromise për atë çështje gjatë negociatave. Kjo ishte e rëndësishme për Nëntokën Shtetërore Britanike sepse në vitet në vijim, ajo përdori kurdët për të realizuar planin e saj të lig për Lindjen e Mesme dhe Turqinë. Ndarja e fabrikuar turko-kurde e filluar me çështjen e Mosulit shënoi fillimin shfrytëzimit të kurdëve.

Edhe pse Turqia pohoi se vendimi për Mosulin ishte i padrejtë, për shkak të politikës së saj të jashtme për të ndjekur metodat paqësore për të zgjidhur problemet, ajo u përmbajt nga tensionimi i çështjes dhe shprehu protestën e saj përmes diplomacisë në përputhje me rrethanat e së drejtës ndërkombëtare. Si pjesë e kësaj strategjie, ajo nënshkroi një Traktat të Miqësisë dhe Neutralitetit me Bashkimin Sovjetik më 17 dhjetor të vitit 1925. Ky traktat ishte një 'marrëveshje natyrore' e bazuar në afrimin e dy vendeve, e cila filloi gjatë Luftës Turke për Pavarësi. Vlen të përmendet se ajo u nënshkrua një ditë pas vendimit të Lidhjes së Kombeve për Mosulin. Në atë kuptim, ishte një vazhdimësi e Traktatit të Miqësisë Sovjeto-Turke të nënshkruar më 16 mars të vitit 1921, Traktati i Karsit i nënshkruar me Armeninë, Gjeorgjinë dhe Azerbajxhanin më 13 tetor të vitit 1921, të cilat ishin Republika Sovjetike atëherë, dhe së fundi Traktati i Miqësisë dhe Vëllazërisë u nënshkrua me Ukrainën më 2 janar të vitit 1922. Të gjitha këto aleanca ishin reagime kundër vendimit të Mosulit.

Çka na shpjegon pyetja për Mosulin?

Ndërsa studioni negociatat e Mosulit në Lozanë, është e rëndësishme të kuptoni se pse Nëntoka Shtetërore Britanike ishte kaq e vendosur. I ashtuquajtur 'problem kurd', i cili nuk kishte ekzistuar kurrë më parë, filloi papritmas pasi Mosuli u vu nën kontrollin britanik me forcë përmes negociatave të Lozanës. Plani shekullor i Nëntokës Shtetërore Britanike përfshinte fabrikimin e 'problemit kurd' të paqenë për Turqinë, i cili vazhdon edhe sot. 'Ndarja e turqve dhe kurdëve' u ngrit për herë të parë gjatë atyre ditëve, pothuajse duke ndërtuar infrastrukturën për një plan që do të përdorej në të

ardhmen nga grupet terroriste. Edhe pse kurdët e Turqisë dhe Mosulit në mënyrë të përsëritur deklaruan se ishin "turq" dhe "besnikë ndaj Turqisë", dhe megjithëse anëtarët kurdë të Parlamentit turk theksuan qartë se nuk kishte mosmarrëveshje ose probleme midis turqve dhe kurdëve, britanikët vazhduan me propagandën e tyre të pamëshirshme duke aloduar të kundërtën.

Ashtu si fillimi i tij artificial, 'problemi kurd' është akoma artificial sot, kur shikojmë shkaqet e tij. Duhet të theksohet se ata njerëz që pohojnë sot se ekziston një ndarje e tillë janë në të vërtetë ose agjentë ose servilë që i shërbejnë Nëntokës Shtetërore Britanike. Njerëz të tillë me atë gjendje shpirtërore kanë qenë pjesë e strukturave të thella shtetërore gjatë historisë së Turqisë; ata kanë ndjekur një politikë shtypëse ndaj kurdëve dhe madje kanë krijuar një ndarje në Turqi. Sot dihet mirë që njerëz të tillë krijuan polarizim dhe urrejtje artificiale për pakicat. Një analizë e kujdesshme e situatës aktuale do të zbulojë sesi këto njerëz janë mbështetur nga Nëntoka Shtetërore Britanike.

Çuditërisht, edhe pse grupi terrorist stalinist PKK refuzon të gjitha identitetet kombëtare, ai përdor nacionalizmin kurd si një mjet propagandistik për qëllimin e tij përfundimtar të ndërtimit të një shteti anarkist-komunist në Anadollin Juglindor dhe imponimin e një sistemi komunist për vëllezërit tanë kurdë. Kjo propagandë është një metodë e përdorur shpesh nga Nëntoka Shtetërore Britanike për ti manipulua masat. Në të vërtetë, ishte pikërisht Nëntoka Shtetërore Britanike ajo që i dha këtë ide PKK -së në radhë të parë. Prandaj, nuk është për t'u habitur që PKK mbahet nën mbrojtje ekstreme nga Nëntoka Shtetërore Britanike. U përmend më parë se si u përdor Mosuli për të fabrikuar çështjen kurde që nuk ekzistonte më parë dhe se si ai plan u shtri në shekullin e ardhshëm. Një ekzaminim i kujdesshëm i problemit aktual të PKK zbulon se Mosuli kishte qenë me të vërtetë pika fillestare e kartës kurde që ende po luhet nga Nëntoka Shtetërore Britanike.

Në kohën e negociatave të Lozanës, kurdët ishin familja jonë, populli ynë, pjesë e pandashme e jona; dhe akoma janë. Qëllimisht, në Anadollin Juglindor, ndaj vëllezërit dhe motrat tona kurde është realizuar plani dinak i Nëntokës Shtetërore Britanike. Për vite me radhë, këta njerëz të mëdhenj i rezistuan provokimeve, dhe as tani, pavarësisht kurtheve të poshtra të Nëntokës Shtetërore Britanike dhe të PKK-së, askush nuk do të na ndajë kurrë nga vëllezërit dhe motrat tona kurde, pavarësisht përpjekjeve të tyre.

Kapitullimet në traktatin e Lozanës

Fjala 'kapitullim' zakonisht i referohet një vendi i cili jep koncesione dhe privilegje për qytetarët dhe konsullatat e një vendi tjetër në tokat e saj, të cilat mund të jenë përfitime financiare, tregtare, ligjore, administrative, etj.

Kur Perandoria Osmane filloi t'i jepte këto koncesione shteteve evropiane dhe qytetarëve të tyre në shekullin e 16 -të, rrethanat dhe qëllimet ishin të ndryshme. Pasi që perandoria ishte në rritje; besohej se privilegje të tilla, të dhëna në përputhje me rrethanat e kohës, do të kontribuonin në rritjen e ekonomisë. Mirëpo perandoria nuk arriti ti parashihte pasojat e kësaj lëvizje të rrezikshme në të ardhmen.

Kapitullimet u dhanë së pari venedikasve gjatë sundimit të Sulltan Mehmedit Pushtuesit, pastaj francezëve gjatë sundimit të Sulltan Sulejmanit të Madhërishtëm, të ndjekur nga shtetet e tjera, në veçantë nga Britania. Në fillim, kapitullimet ishin të kufizuara në jetëgjatësinë e Sulltanëve që i dhanë ato, por me një marrëveshje të nënshkruar me Francën në vitin 1740, u bënë të përhershme. Pas kësaj date, kapitullimet e dhëna fuqive të mëdha, më së shumti Britanisë, krijuan çështje të rënda në ekonominë osmane, industrinë dhe sistemin e drejtësisë. Me kalimin e kohës, privilegjet tregtare dhe ligjore u rritën dhe shkaktuan probleme të mëdha në shekullin XIX. Ndërsa në fillim, privilegjet ishin të njëanshme dhe i shërbenin interesave të Perandorisë Osmane, ato më vonë u shndërruan plotësisht në një sistem ku disa të drejta të Perandorisë Osmane iu besoheshin shteteve të huaja përmes marrëveshjeve dypalëshe.

Nëntoka Shtetërore Britanike i udhëhoqi vendet e tjera në menaxhimin dhe kontrollin e këtyre privilegjeve, herë shprehimisht dhe herë pas dyerve të mbyllura.

Interesi i madh i Britanisë së Madhe

Deri në vitet 1820, Britania kishte përfunduar revolucionin e saj industrial dhe u bë e pakonkureshme në tregjet botërore sidomos pasi mposhti Francën në luftërat Napoleonike. Sidoqoftë, gjatë atyre viteve, vendet e tjera evropiane në mes të revolucioneve të tyre industriale po bllokoi produktet britanike që të mos hynin në tregjet e tyre me masa mbrojtëse. Kjo bëri që kapitali britanik të kthehej në vendet jo-evropiane; kështu midis viteve 1820 dhe 1840, Britania nënshkroi marrëveshje të shumta të tregtisë së lirë me vendet në Amerikën Latine dhe Kinën ndër të tjera⁴²² Këto marrëveshje u siguruan ndonjëherë duke fituar mbështetjen e fuqive lokale dhe nganjëherë duke përdorur fuqinë ushtarake. Për shembull, kur Kina ndaloi Britaninë të shiste opium në tokat e saj në vitin 1839, Britania menjëherë i shpalli luftë Kinës. Kur britanikët dolën fitues nga kjo luftë, ata e detyruan qeverinë kineze të lejojë kapitullime të gjera përmes marrëveshjeve të ndryshme.

Mirëpo, e gjithë kjo përpjekje intensive nuk dha rezultatet që Nëntoka Shtetërore Britanike shpresonte.

Në gjysmën e parë të shekullit XIX, taksat doganore në Evropë u rritën dhe tregtia e jashtme britanike hyri në një periudhë recensionimi midis viteve 1819 dhe 1835.⁴²³ Ky stopim dëmtoi seriozisht industrinë e re të vendit dhe bëri që të kërkohej urgjentisht zbulimi i tregjeve të reja. Edhe në periudhën e rënies, Perandoria Osmane ishte ende një nga vendet më të pasura në botë, me territorin dhe njerëzit e pasur. Ky treg fitimprurës e vuri atë në qendër të vëmendjes së Nëntokës Shtetërore Britanike. Britania bëri gjithçka që ishte e mundur për të nënshkruar një marrëveshje të tregtisë së lirë me osmanë.⁴²⁴ Traktati i Balta Liman i nënshkruar midis Perandorisë Osmane dhe Britanisë së Madhe si një marrëveshje tregtare kishte këto pika kryesore:

- 1- Kapitullimet e reja do t'i shtohen atyre ekzistuese;
- 2- Britanisë do t'i lejohet të blejë dhe shesë lirshëm produktet bujqësore dhe industriale;
- 3- Perandoria Osmane do të heqë të gjitha monopolet mbi tregtinë e brendshme si dhe ndalimet e eksportit;
- 4- Tregtarët e huaj do të gëzojnë të njëjtat të drejta dhe privilegje si tregtarët vendas të Perandorisë Osmane;
- 5- Taksat mbi eksportin do të jenë 12%, dhe importin 5%.

Traktati i Balta Liman i vitit 1838 hoqi të gjitha kufizimet në tregtinë e brendshme dhe të jashtme dhe lehtësoi hyrjen e mallrave të huaja në vend. Gjithashtu e bëri më të lehtë eksportimin e produkteve vendase. Me sa duket, ai e vuri industrinë dhe tregtinë osmane nën kontrollin evropian, por në fakt, ajo ishte nën kontrollin britanik.

Aspekti më domethënës i këtij sistemi tregtar ishte humbja e pakthyeshme dhe domethënëse e sovranitetit osman mbi tregtinë e jashtme. Taksat shtesë të vendosura më parë për eksportin dhe importin, të cilat kishin qenë burimi kryesor i të ardhurave për shtetin, u kufizuan dhe Perandoria Osmane nuk ishte më në gjendje të mblidhte taksa shtesë nga këto burime në situata të jashtëzakonshme siç është lufta.⁴²⁵

Pas Traktatit të Balta Limanit, vëllimi tregtar britanik në Lindjen e Mesme u rrit në mënyrë dramatike. Për shembull, në vitin 1837 vetëm 432 anije britanike kishin ardhur në Stamboll dhe kishin shkarkuar mallra prej 86,253 ton, por deri në vitin 1848, këto shifra u rritën në 1392 anije dhe 358,422 ton respektivisht. Rritja u shpejtua dhe në vitin 1856, Britania dërgoi 2,504 anije me një total prej 898,753 ton mallrash.⁴²⁶ Britania po merrte kontrollin e plotë të tregut osman, ndërsa tregtarët osmanë humbën primatin.

Osmanët tentojnë ti shfuqizojnë kapitullimet

Fuqitë e mëdha të Evropës po konkurronin ashpër me njëri-tjetrin për të përfituar më shumë nga Perandoria Osmane. Ndërsa kapitullimet i kufizuan osmanët, shteti nuk ishte as në gjendje të rregullonte taksat e veta. Turqit u kufizuan, por tregtarët e huaj u liruan nga taksat. Të huajt që jetonin në tokën turke nuk iu nënshtruan ligjit turk dhe nuk mund të dërgoheshin në gjykatat turke. Me fjalë të tjera, këta njerëz jetonin në një mënyrë krejtësisht të izoluar në vend; në një status tepër të privilegjuar, ata po praktikonin ligjet e tyre në Perandorinë Osmane. Ata fituan më shumë para nga tregtarët e njëjtë vendas, por prapë nuk paguanin taksa. Edhe sektori i kujdesit shëndetësor u ofroi atyre koncesione të jashtëzakonshme.

Kapitulimet u shndërruan në një plagë gjakderdhëse për osmanët dhe natyrisht shumë administratorë osmanë ndërmorën nisma për të ndaluar gjakderdhjen.

Debati i parë në Kabinetin Osman mbi heqjen e kapitullimeve u zhvillua më 2 shtator të vitit 1914, i cili rezultoi në vendimin për të hartuar një memorandum për të hequr dorë nga këto koncesione.

Si rezultat, një komision i udhëhequr nga Nazir Pirizade Ibrahim Beu u krijua në Ministrinë e Drejtësisë.⁴²⁷ Komisioni hartoi komunikimin zyrtar që do t'i dërgohej Vezirit të Madh më 4 shtator dhe e dërgoi atë menjëherë në ditën tjetër. Qeveria, gjatë takimit të Këshillit të Ministrave më 5 shtator, vendosi të shfuqizojë të gjitha kapitullimet, ekonomike dhe gjyqësore.

Më 8 shtator, qeveria u mblodh, lexoi komunikimin zyrtar dhe vendosi që teksti i miratuar t'u dërgohej ambasadorëve në kryeqytet më 9 shtator. Sulltani miratoi heqjen e kapitullimeve më 8 shtator. Teksti theksonte si në vijim:

Me marrëveshjen e anëtarëve të Parlamentit, koncesionet e ndryshme financiare, administrative, ekonomike dhe gjyqësore dhe të gjitha privilegjet, të dhëna më parë për të huajt që banonin në Perandorinë Osmane, të njohur si 'kapitulimet', shfuqizohen. Kjo rezolutë, me urdhër të Sulltanit, do të hyjë në fuqi më 18 shtator të vitit 1330 [1 tetor vitit 1914 në kalendarin gregorian].⁴²⁸

Kapitulimet duhet të shfuqizohen për tu arritur pavarësia e plotë

Vendimi i administratës osmane për të hequr në mënyrë të njëanshme kapitullimet ishte racional, megjithëse i vonuar. Pothuajse dy muaj para vendimit, lufta botërore kishte shpërthyer në Evropë dhe mund të ishte përhapur në territorin osman në çdo moment. Shtetet që u ishin dhënë kapitullime më parë ishin shumë të zënë për të kundërshtuar vendimin. Në të vërtetë, deklarata për të eliminuar kapitullimet u prit me gëzim nga shumica dërrmuese e Perandorisë Osmane. Perandoria më në fund po e hiqte qafe këtë barrë të rëndë mbi supet e saj.

Edhe pse ambasadorët evropianë ngritën kundërshtime për shfuqizimin e kapitullimeve, Perandoria Osmane nuk u tërhoq. Sigurisht, disa rregullore të reja u bënë në përputhje me kërkesat e ambasadorëve, por ato nuk ishin si kapitullimet. Ky ishte një moment historik i rëndësishëm për Perandorinë Osmane pasi filloi të çlirohej nga zinxhirët e saj. Sidoqoftë, atmosfera e gëzueshme nuk zgjati shumë. Perandoria duhej të hynte në Luftën e Parë Botërore, më pas u mund dhe më 30 tetor të vitit 1918, përsëri duhej të duronte imponimin e shteteve të tjera. Natyrisht, fitimtarët menjëherë i kthyen kapitullimet.

Gjatë viteve të Luftës Turke për Pavarësi, Mustafa Kemal e mori çështjen e kapitullimeve shumë seriozisht dhe tregoi qëndrimin e tij të qartë në favor të pavarësisë së plotë gjatë takimeve të kongresit. Gjatë seancave të Paktit Kombëtar në Parlamentin Osman (22-28 janar të vitit 1920) kapitullimet ishin përsëri në rendin e ditës. Neni 6 i vendimeve të marra aty ishte shkurtimisht si në vijim:

... Sigurimi i lirisë dhe pavarësisë së plotë për të përfunduar zhvillimin tonë kombëtar dhe ekonomik, si çdo vend tjetër, është thelbësore për të ardhmen tonë. Për këtë arsye, çdo faktor që pengon zhvillimin tonë politik, gjyqësor, tregtar ose financiar duhet të eliminohet ...⁴²⁹

Për këtë arsye, Mustafa Kemal udhëzoi në mënyrë të prerë delegacionin i cili zhvilloi bisedimet në Lozanë se nuk mund të ketë kompromis për kapitullimet.

Sigurisht, vendet evropiane po përgatiteshin për të rikthyer kapitullimet në Lozanë. Kjo është arsyeja pse Republika e re Turke ishte e përgatitur mirë për t'u marrë me këtë çështje pa asnjë kompromis. Edhe një herë Britania, i vetmi vend që nuk e njohu pavarësinë e Republikës së re Turke, doli pengesa më e madhe.

Rrugës për në Lozanë

Udhëzimi i dhënë delegacionit kombëtar të nisur për në Lozanë ishte i shkurtër dhe konciz: *'Kapitullimet nuk mund të pranohen asnjëherë. Nëse është e nevojshme, duhet të largohemi nga negociatat.'*⁴³⁰

Në fakt, të gjithë e dinin se do të lindnin vështirësi të mëdha në arritjen e një zgjidhjeje në këtë çështje. Shumë vende, prezent apo jo në konferencë, kishin një dëshirë për vazhdimin e privilegjeve të përmendura. Për më tepër, bota perëndimore ishte mësuar me këto privilegje për të paktën 400 vite dhe të gjitha marrëdhëniet reciproke ishin të bazuara në to. Prandaj, vendet e tjera, pasi arritën një marrëveshje mbi këtë temë, donin që koncesionet të vazhdonin, gjë që e bëri veçanërisht të vështirë perspektivën e heqjes së plotë të kapitullimeve në Lozanë.

Ismet Pasha, kreu i delegacionit turk, ishte në dijeni të këtij problemi andaj tha, *"Të gjithë aleatët dhe ShBA-të ishin kundër nesh në këtë çështje. Por ne e konsideruam këtë gjë një nga çështjet tona më vendimtare."*⁴³¹

Një tërheqje lufte

Më 27 Nëntor të vitit 1922, Komisioni i Financave dhe Çështjeve Ekonomike u mbledh për të diskutuar kapitullimet dhe Ismet Pasha kërkoi që të hiqen të gjitha kufizimet që pengonin pavarësinë ekonomike të Turqisë. Ai shpjegoi se një vend nuk mund të jetë i pavarur me kapitullime dhe se situata e të huajve në Turqi tashmë ishte e garantuar me ligjet e përgjithshme të cilat ishin në fuqi siç është rasti në të gjitha vendet e civilizuara dhe të pavarura dhe se delegacioni turk do të pranonte të ishte në një komisioni vetëm nëse është në përputhje me këto parime.⁴³²

Delegacioni francez, i ardhur nga një vend që kishte fituar fitime të mëdha nga kapitullimet, këmbënguli që kapitullimet të zëvendësoheshin me një sistem tjetër. Ismet Pasha refuzoi ofertën, duke qenë plotësisht i vetëdijshëm se sistemi i ri dhe i panjohur mund të rrezikonte sigurinë ose pavarësinë e shtetit.

Lord Curzon pohoi se kapitullimet bazoheshin në të drejtat e dhëna nga traktati dhe se edhe gjermanët si të vetmit aleat të osmanëve, kundërshtuan shfuqizimin e sistemit. Ai tha gjithashtu se kapitullimet nuk mund të shfuqizohen nëse nuk zëvendësohen nga një sistem i ri i rënë dakord nga palët.⁴³³

Mirëpo, kapitullimet ishin temë e panegociueshme për Turqinë, pavarësisht rrethanave. Më 28 dhjetor të vitit 1922, bisedimet arritën në një qorrsokak. Propozimet u refuzuan me arsyetimin se shkelnin sovranitetin turk. Ismet Pasha mbrojti çështjen turke dhe tha se *"sistemi i drejtësisë në Turqi do të ishte në të njëjtin nivel me sistemet më të mira të botës"*. Ai e konsideroi zëvendësimin e sistemit ose caktimin e gjyqtarëve të huaj në Turqi së bashku me të gjitha propozimet e tjera të ngjashme, sulm ndaj pavarësisë së Turqisë.⁴³⁴

Asgjë produktive nuk doli nga diskutimet e zhvilluara në rrethana të tilla. Ismet Pasha dhe delegacioni turk refuzuan t'i nënshtrohen kërkesave për kufizime të reja, pavarësisht se si u maskuan ato dhe luftuan deri në fund presionin dhe shtypjen. Konferenca përfundoi më 4 shkurt 1923 pa arritur një marrëveshje.⁴³⁵

Fillon përpjeka e dytë

Ndërsa negociatat e Lozanës arritën në përfundim dhe u pezulluan, Mustafa Kemal mbajti një fjalim në Kongresin Ekonomik të Izmirit më 17 shkurt të vitit 1923 dhe e bëri të qartë se nuk do të kishte lëshime mbi kapitullimet:

*Perandoria Osmane u privua nga pavarësia e saj në mënyrë efektive. Nëse një vend nuk mund të vendosë taksa për të huajt në tokën e tij siç bën për qytetarët e tij, nëse një vendi i ndalohej të rregullojë zakonet e veta ... Dhe, nëse një vendi nuk i lejohet të praktikojë sundimin e tij të ligjit për të huajt që jetojnë në tokat e saj, atëherë ai vend nuk është i pavarur...*⁴³⁶

Këto fjalë manifestuan qartë se si heqja e kapitullimeve ishte vendimtare për palën turke. Pra, pezullimi i bisedimeve për shkak të mosmarrëveshjes së kapitullimeve nuk bëri asgjë për të dobësuar vendosmërinë e turqve. Pala turke, sapo kishte duruar një luftë që vazhdoi për dhjetë vite rresht dhe pasi kishte humbur pothuajse gjithçka, nuk hezitoi për një

moment për të filluar përsëri përgatitjet për luftë. Kur negociatat e Lozanës u ndalën për shkak të çështjes së kapitullimeve, Mustafa Kemal urdhëroi ushtrinë turke të fillonte përgatitjet për luftë.

E vërteta është se Fuqitë Aleate nuk donin që edhe negociatat e Lozanës të pezulloheshin. Duke qenë pjesë e Luftës së Parë Botërore, që shkaktoi humbje kolosale, asnjë prej tyre nuk ishte i gatshëm të rifillonte luftën. Për më tepër, vendet evropiane nuk mund të përballonin të ishin "në anën e kundërt të paqes". Publiku perëndimor, i lodhur dhe i dërrmuar, donte paqe me çdo arsye, Fuqitë Aleate duhej të dorëzoheshin dhe të mos ishin këmbëngulëse ndaj kapitullimeve. Të qenit pala që ndaloj negociatat e paqes ishte e barabartë me atë që nuk donte paqe dhe ishte e qartë se një administratë e tillë do të ndëshkohej jo vetëm nga publiku i saj, por edhe nga vendet e tjera. Evropa nuk do ta merrte këtë rrezik.

Për më tepër, Bashkimi Sovjetik, i cili kishte nënshkruar një traktat miqësie me Turqinë në vitin 1921, deklaroi se nëse shpërthente një luftë e re, do të luftonte përkrah Turqisë. Kjo situatë ndryshoi plotësisht ekuilibrin.

Duke parë qëndrimin vendimtar të Turqisë, vendet perëndimore ndërmorën veprime për të rifilluar bisedimet dhe kështu pjesa e dytë e Konferencës së Lozanës filloi më 23 prill të vitit 1923. Lord Curzon dhe 'të famshëmit' e kaluar nuk morën pjesë kësaj radhe. Horace Rumbold, Komisioneri i Lartë në Stamboll, drejtonte delegacionin britanik dhe konferencën.

Kapitullimet përfaqësonin pengesën më të madhe për përfundimin e Konferencës së Lozanës. Perëndimorët nuk donin të hiqnin dorë prej tyre, veçanërisht nën presionin e rëndë të grupeve të ndryshme ekonomike. Nga ana tjetër, Turqia ishte e vendosur në refuzimin e të gjitha llojeve të kufizimeve në pavarësinë e saj. Prandaj, asnjë marrëveshje nuk mund të arrihej dhe bisedimet vazhduan deri më 4 maj. Çështje të tjera financiare gjithashtu vazhduan të ishin burim vështirësive për tu arritur një marrëveshje.

Pas diskutimeve të gjata, u vendos që të shtohet klauzola e mëposhtme në marrëveshje, në lidhje me kapitullimet:

*Neni 28: Secila nga Palët Kontraktuese në këtë mënyrë pranon, heqjen e plotë të Kapitullimeve në Turqi në çdo aspekt.*⁴³⁷

Ndërkohë, palët e tjera kërkuan që kapitullimet shëndetësore të vazhdonin në Stamboll, por pala turke e refuzoi edhe këtë kusht. Në fund, u vendos që për pesë vite, tre mjekë evropianë do të lejoheshin të punonin në punë karantine në cilësinë e konsulentëve. Kjo përfundoi edhe marrëveshjen sa i përket kapitullimeve shëndetësore. Pesë vite më vonë, këta tre mjekë të huaj u pushuan nga puna dhe industria e kujdesit shëndetësor u bë krejtësisht vendore. Atatürku përmendi në Nutukun e tij të famshëm (*Fjalimi i Madh*), "ky nuk ishte kapitullim. Ne u pajtuam që një çift mjekësh të huaj të shërbenin për pesë vite".⁴³⁸

Me fjalë të tjera, qëndrimi i paepur i delegacionit turk e shpëtoi Republikën e re Turke nga kapitullimet, nga prangat e së kaluarës. Në këtë mënyrë, Turqia jo vetëm që arriti pavarësinë e saj të plotë, por gjithashtu shkatërroi plotësisht ëndrrat e Nëntokës Shtetërore Britanike për 'kolonizim'. Nëntoka Shtetërore Britanike nuk arriti të përsëriste skemën e saj të depërtimit tinëzar dhe ndërtimin e hegjemonisë ekonomike dhe ligjore në Turqinë e re. Kjo është arsyeja pse koncesioni i kapitullimit nga ana e delegacionit britanik në negociatat e Lozanës u pa si një humbje e madhe. The Times, në numrin e saj të 14 Prillit të vitit 1924, bëri komentin vijues mbi këtë zhvillim: "*Traktati i Lozanës ishte dështimi i parë i dukshëm i diplomacisë britanike në më shumë se një shekull.*" Pjesa tjetër vazhdoi me vërejtjen e mëposhtme që sqaruan planin e egër të Nëntokës Shtetërore Britanike: "*Në fakt, Marrëveshja e Lozanës i nxorri valixhet e Evropës jashtë Turqisë në vend që t'i nixirte valixhet e Turqisë jashta Evropës.*"⁴³⁹

Plani i kapitullimeve nga Nëntoka Shtetërore Britanike

Ndërsa studiojmë kapitullimet, duhet të kemi parasysh se Nëntoka Shtetërore Britanike bën plane afatgjate të cilat shtrihen edhe në shekujt e ardhshëm. Kjo është ajo që ndodhi me kapitullimet dhe Nëntoka Shtetërore Britanike arriti të zgjasë fushën e koncesioneve fillestare të cilat i ishin dhënë Britanisë me kalimin e kohës, duke abuzuar me mirësinë dhe dobësinë e Perandorisë Osmane për të ndërtuar një strukturë të veçantë brenda Perandorisë. Në fund, gjykatat e huaja vepronin në territorin osman, të huajt blinin dhe shisnin tokat osmane; madje edhe kushtet më të mira mjekësor

ju dhanë mjekëve të huaj për shtetasit e huajt. Këta të huaj të cilët u bënë më të privilegjuar se turqit në tokat e tyre, në fakt po plaçkitnin shtetin dhe bënë jetë plotësisht të pavarur nga ligjet osmane. Meqenëse këta njerëz kishin më shumë të drejta sesa tregtarët turq, ata filluan të dominojnë tregtinë vendase. Ky sistem ishte aplikimi i planit dinak të Nëntokës Shtetërore Britanike. Ky sistem tinëzar, që ende mund të shihet në shumë vende të kolonizuara ose në vende të tjera të infiltuara nga Nëntoka Shtetërore Britanike, depërtoi thellë në Perandorinë Osmane, mori kontrollin e sistemit të saj dhe ndërtoi hegjemoninë e vet. Ky infiltrim gjithashtu lejoi që Nëntoka Shtetërore Britanike të vendosë lehtësisht agjentët e saj në vendet përkatëse. Prosesi është aq sistematik, saqë Republika e re Turke luftoi me mish e shpirt për të hequr qafe këtë virus.

Sot, në Lindjen e Mesme dhe veçanërisht në Afrikë, Nëntoka Shtetërore Britanike vazhdon të shfrytëzojë disa vende dhe bëhet më e pasur pasi vendasit e këtyre shteteve vdesin nga uria dhe varfëria. Kjo është politika e zakonshme e Nëntokës Shtetërore Britanike. Kjo ishte gjithashtu ajo që ishte planifikuar për Perandorinë Osmane me kapitullimet. Por Zoti i Plotfuqishëm nuk lejoi që ky plan të funksiononte dhe bëri që Komandanti i Madh Mustafa Kemal Pasha dhe populli trim turk të ishin arsyeja e përfundimit të hegjemonisë së Nëntokës Shtetërore Britanike. Kapitullimet ishin vetëm një metodë tjetër e shpikur për të shfrytëzuar Perandorinë Osmane nga brenda. Fundi i kësaj fatkeqësie, e cila duhej të shmangej, përfaqëson një fitore të rëndësishme në negociatat e Lozanës.

A janë ata të sigurtë nga përcaktimi i Zotit? Vetëm ata të cilët janë të humbur nuk kanë frikë nga të papriturat e Allahut.. (Kur'an, 7:99)

□□□□□□□□□□□□□□□□

Adnan Oktar: Ne jemi në Kohët e Fundit, periudha e *Mehdiut*. Zoti e krijoi botën sipas saj. Bota është krijuar për të qenë një vend sprove për njerëzit. Është krijuar që ne të jemi shërbëtorë të Zotit, që ne ti lutemi Atij. Zoti i ka dhënë jetë botës në mënyrë që të krijohet Bashkimi Islamik, që është arsyeja për jetën e tanishme të tij. Koha për Ditën e Gjykimit në fakt ka ardhur, por është zgjidhur për të lejuar që të shfaqet *Hazreti Mehdiu* (p.q.m.t) dhe të krijohet Bashkimi Islamik. Gjëja që ata tani e quajnë "Perandoria e Re Osmane" ose modeli osman në fakt i referohet lëvizjes së *Mehdiut*. Bashkimi Islamik është një nga emrat e lëvizjes Mehdi. Emrat nuk paraqesin dallim. Sistemi i ri do të prodhojë shtete të pavarura, të pavarura në çështjet e brendshme, të pavarura në çështjet e jashtme; por do të jetë sistem ku mbretëron vëllazëria, dashuria, miqësia dhe paqja; një në të cilën entuziazmi, qëllimet e mira, bamirësia, arti dhe shkenca mbretërojnë mbi botën dhe në të cilën bota do të jetë si një familje e lidhur nga një lidhje e vetme. Të gjithë i duan të gjithë; nuk ka shtypje, frikësim, dhunë, luftë dhe garë armatimi. E gjithë bota do të bëhet e pasur. Imagjinoni se çfarë do të ndodhte nëse fabrikat e armëve do të shndërroheshin në fabrika për prodhimin e mallrave shtëpiake, si frigoriferë dhe lavatriçe. Imagjinoni që ato të prodhojnë shtëpi të parafabrikuara. Bota do të kthehet në parajsë. Çfarë përdorimi ka për armët? Ata po përpiqen të përmirësojnë industrinë e armëve. Por ne dëshirojmë një botë ku nuk nevojitet asnjë mbrojtje, asnjë raketë mbrojtëse, asnjë raketë që mund të rrëzojë raketa vdekjeprurëse në ajër. Ne dëshirojmë që burimet e shpenzuara për këto armë të shpenzohen për shëndet, ushqim, ujë dhe strehim.

(Pjesë nga intervista e z. Adnan Oktar në A9 TV më 29 nëntor të vitit 2012).

Adnan Oktar: Myslimanët gjithmonë kanë një ideal: Bashkimin Islamik. Ideali më i madh është sundimi i vlerave morale islame në botë. Thjeshtë ideali, ëndrra e çdo myslimani është që e gjithë bota të jetë e lirë nga lufta, terrori, anarkia, trazirat, shtypja, armët dhe tmerrri, që të gjithë të jenë vëllezër dhe të jetojnë në paqe dhe bota të jetë si parajsë. Parajsa pra është qëllimi kryesor. Ne do të synojmë parajsën edhe në tokë, dhe do ta synojmë atë edhe në ahiret. Prandaj, ne përqafojmë këdo që është në rrugën e vërtetë me dashuri dhe respekt të thellë.

(Pjesë nga intervista e z. Adnan Oktar në A9 TV më 3 shkurt të vitit 2013).

Populli i devotshëm turk refuzoi hegjemoninë britanike

Udhëheqësit britanikë, të lëkundur nga tronditja e fitores turke në Lozanë, bënë disa komente për t'u ndier më mirë me humbjen e tyre, ndërsa Nëntoka Shtetërore Britanike shfrytëzoi çdo mundësi për të deklaruar ëndrrën e saj që Turqia përfundimisht do të shkatërrohej edhe nëse kjo nuk ndodhi në Lozanë.

Lord Curzon, Sekretari i Jashtëm Britanik që drejtoi bisedimet e Lozanës për një kohë të gjatë, u dërgoi një udhëzim ambasadorëve të Britanisë në Paris dhe Romë, nëntë ditë pas nënshkrimit të Traktatit të Lozanës. Ai deklaroi se Turqia ishte një vend i vogël dhe se Aleatët nuk duhet të dërgonin ambasadorë fuqiptotë në Turqi, një diplomat i nivelit të ulët si një ambasador në detyrë do të ishte i mjaftueshëm.⁴⁴⁰


Vetëm 21 ditë pasi u nënshkrua traktati në Lozanë, Sir Nevile Meyrick Henderson, diplomati britanik në Stamboll, bëri komentin në vijim në letrën e tij dërguar Londrës:

Turqia ka humbur tokë, është varfëruar dhe është shpopulluar. Do të ishte më se e nevojshme të dërgohet një ambasadore në një vend të parëndësishëm si Turqia për sa i përket madhësisë, pasurisë dhe popullsisë së saj ... Nëse qeveria aktuale turke nuk mund të qëndrojë - besoj se nuk do të zgjasë shumë - atëherë Qeveria Turke do të vijë në atë qytet ku ndodhet Ambasada Britanike. Në këtë mjedis të anarkisë, qeveria aktuale do të rrëzohet dhe një qeveri tjetër që do të jetë aleate me ne do të vijë në pushtet.⁴⁴¹

Sigurisht, kishte një arsye pse Henderson dukej kaq i sigurt. Nëntoka Shtetërore Britanike kishte zbatuar me sukses të njëjtën strategji në shumë vende më parë. Dhe siç theksoi Henderson, ato vende përfundimisht filluan të lëvizin në drejtimin e imponuar nga Nëntoka Shtetërore Britanike. Mirëpo, Henderson nuk po merrte parasysh vendosmërinë dhe besimin e patundur të Mustafa Kemal Atatürkut dhe popullit turk. Askush nuk kishte fuqinë për ta vënë shtetin turk në pranga kur ata kishin një udhëheqës kaq patriot dhe një komb kaq të devotshëm. Përfaqësuesit e Nëntokës Shtetërore Britanike, të cilët po bënin këto komente arrogante para dhe pas Lozanës, me kalimin e kohës e kuptuan se ata nuk do të ishin në gjendje ta mposhtnin këtë komb të devotshëm. Në fakt, komenti i Gladstone në vitet 1800 se Kurani duhej të merrej nga turqit nëse ata do të mposhteshin ndonjëherë tregoi se që nga shekulli i 19 -të britanikët e dinin se ky komb besnik nuk mund të mposhtej kurrë.

Turqia është një vend i shenjtë nga ku do të shfaqet *Mehdiu* (p.q.m.t), dhe Stambolli është një qytet i shenjtë që do të shohë këtë pamje të bekuar. Edhe *Mehdiu* (p.q.m.t) edhe ky vend i shenjtë do të jetë gjithmonë nën mbrojtjen e Zotit. Prandaj, nuk është në fatin e Turqisë të bjerë nën komplotet e strukturave nëntokësore, që të ndahet ose të shpërbëhet. Asnjë komplot tinëzar kundër Turqisë nuk pati sukses në të kaluarën dhe asnjë nuk do të ketë në të ardhmen. Anëtarët e Nëntokës Shtetërore Britanike që hartojnë plane kundër Turqisë duhet ta kenë këtë të vërtetë në mendje përgjithmonë.

Zoti do ti mbrojë besimtarët. Allahu nuk i do tradhtarët mosmirënjohës. (Kur'an, 22:38)



Ideatori i vërtetë

Përgjatë historisë, Nëntoka Shtetërore Britanike ka qëndruar nën komandën e sistemit djallëzor si një fuqi mbi qeveritë, ligjet, politikat shtetërore dhe udhëheqësit e zgjedhur. Ndërsa udhëheqësit e vërtetë punuan për paqen, Nëntoka Shtetërore Britanike ndezi luftërat; ndërsa vendet punonin për t'u zhvilluar dhe përparuar në paqe, Nëntoka Shtetërore Britanike pengoi përpjekjet e tyre, i ndau ata dhe shkaktoi paqëndrueshmëri përmes trazirave dhe puqeve ushtarake. Ajo mbolli farë armiqësie midis bashkësive që kishin jetuar me shekuj në paqe. Organizatori që qëndron pas vendimeve të vërteta, luftërave, trazirave dhe shqetësimeve ka qenë gjithmonë kjo strukturë e fshehtë. Asnjëherë asnjë sistem nuk ka qenë në gjendje të sfidojë ose ndalojë Nëntokën Shtetërore Britanike. Deri tani.


Nëntoka Shtetërore Britanike do të ballafaqohet me një të vërtetë të pamohueshme; njëra kundër së cilës është përgatitur për vite me radhë: shfaqja e Mehdiut (p.q.m.t). Për shekuj me radhë, Nëntoka Shtetërore Britanike ka punuar pa pushim për të parandaluar këtë shfaqje; ndryshoi kufijtë, rrëzoi perandoritë dhe vuri vëllezërit kundër vëllezërve. Ajo mendoi gabimisht se përmes kompleteve dinake, mund të pengonte të pashmangshmen. Mirëpo, suksesi i saj sipërfaqësor nuk është i mjaftueshëm për të ndaluar shfaqjen e Mehdiut (p.q.m.t). Tani për tani Mehdiu (p.q.m.t) është i pranishëm në botë dhe shumë shpejt bota do të jetë dëshmitare e paraqitjes së tij.

Ndoshta për herë të parë në historinë e saj, Nëntoka Shtetërore Britanike është mundur. Kjo ndodhi sepse nuk arriti të kuptonte se ekziston një Mendje mbi të gjithë ideatorët. Mendja e vërtetë, Ai që kontrollon të gjitha mendjet e tjera, Ai që planifikon të gjitha planet, pra Zoti ynë i Plotfuqishëm. Asnjë fuqi nuk mund të mbizotërojë mbi planet e Perëndisë. Planet e Zotit shuajnë të gjitha komplotet.

Fitoret sipërfaqësore të Nëntokës Shtetërore Britanike nuk duhet të mashtrojnë askënd. E vërteta është se asnjë plan nuk është i pavarur nga Zoti. Ky burim kërcënimi është vetëm një mjet i përdorur nga Zoti për të zbuluar dëshalin. Tani, pasi për caq shumë kohë besonin gabimisht se kishin fuqi absolute, Nëntoka Shtetërore Britanike do të shohë që Zoti i Plotfuqishëm ka kontrollin dhe fuqinë e vetme. Nuk do të jetë në gjendje të ndalojë rrjedhën e fatit dhe do të kuptojë se nuk do të ketë vend për komplete ose dredhi në një botë ku mbizotëron ndikimi i Mehdiut (p.q.m.t). Erërat paqësore dhe të dashura të rrymës që përfaqëson Mehdiu (p.q.m.t) do të fshijnë urrejtjen e mbjellur nga Nëntoka Shtetërore Britanike, do të përhapin paqen në botë dhe do të korrigjojnë mendjet që më parë ishin dorëzuar nën ndikimin e dëshallit.

Për këtë arsye, zemrat mund të jenë të qeta. Çdo sy i kujdesshëm mund të dallojë se pengesat për në rrugën e paraqitjes së Mehdiut (p.q.m.t) po hiqen një nga një. Kërcënimi i Nëntokës Shtetërore Britanike do të përfundojë së shpejti. Zoti me siguri do t'i bëjë fitimtar besimtarët dhe njerëzit e mirë.

Zoti ka vendosur, "Unë dhe të dërguarit e MI do të triumfojmë."Allahu është më i Fuqishmi, më i Madhërishti. (Kur'an, 58:21)



Mashtrimi i Evolucionit

Darvinizmi, me fjalë të tjera teoria e evolucionit, u parashtrua me qëllim të mohimit të fakteve të Krijimit, por në të vërtetë nuk është gjë tjetër veçse një marrëzi e dështuar, pa bazë shkencore. Teoria e evolucionit e ka origjinën në bestytnitë pagane që datojnë në kohën e Egjiptit të lashtë dhe Sumerisë. Ashtu si këto bestytini, teoria e evolucionit shpjegon origjinën e universit dhe jetës përmes rastësive dhe po përmes shkencës. Kjo teori, e cila pohon se jeta doli rastësisht nga materia e pajetë, u shfuqizua nga provat shkencore që demonstrojnë rendin e mrekullueshëm në univers dhe në gjallesa, si dhe nga zbulimi i rreth 700 milion fosileve që zbulojnë se evolucionit nuk ka ndodhur kurrë. Për më tepër, teoria e evolucionit është e paaftë për të shpjeguar formimin e një proteine të vetme, bllokun kryesor ndërtues të jetës. Shkenca ka vërtetuar se është e pamundur që një proteinë të krijohej përmes rastësive. Në këtë mënyrë, fakti që Zoti krijoi universin dhe gjallesat në të është konfirmuar edhe nga shkenca. Propaganda mbarëbotërore e përhapur sot për të mbajtur gjallë teorinë e evolucionit bazohet vetëm në shtrembërimin e fakteve shkencore, interpretimin e njëanshëm dhe gënjeshttrat e maskuar kinse shkencore.

Megjithatë kjo propagandë nuk mund ta fshehtë të vërtetën. Fakti që teoria e evolucionit është mashtrimi më i madh në historinë e shkencës është shprehur gjithnjë e më shumë në botën shkencore gjatë 20-30 viteve të fundit. Hulumtimet e kryera pas viteve 1980 në veçanti zbulojnë se pretendimet e Darvinizmit janë krejtësisht të pabaza dhe ky fakt është deklaruar nga një numër i madh i shkencëtarëve. Shumë shkencëtarë nga fusha të ndryshme si biologjia, biokimia, paleontologjia, gjenetika, zoologjia dhe arkeologjia njohin pavlefshmërinë e darvinizmit dhe shpjegojnë origjinën e jetës përmes faktit të Krijimit.

Ne kemi ekzaminuar në detaje shembjen e teorisë së evolucionit dhe kemi dëshmuar provat e Krijimit në shumë hulumtime tona shkencore dhe po vazhdojmë ta bëjmë këtë. Duke pasur parasysh rëndësinë e madhe të kësaj lënde, do të jetë me përfitim të madh ta përmbledhim këtu.

Sfidat të cilat e shkatërrojnë Darvinin

Si një doktrinë pagane që shkon deri në Egjiptin dhe Sumerinë e lashtë, teoria e evolucionit doli në pah më gjerësisht edhe një herë në shekullin e nëntëmbëdhjetë. Zhvillimi më i rëndësishëm që e bëri atë temën kryesore të botës shkencore ishte publikimi i Darvinit *Origjina e Specieve* në vitin 1859. Në këtë libër, Darvini në mënyrën e tij kundërshtoi faktin se Zoti krijoi specie të ndryshme të gjalla në Tokë veç e veç, sepse ai gabimisht pohoi se të gjitha qeniet e gjalla kishin një paraardhës të përbashkët imagjinar dhe ishin diversifikuar me kalimin e kohës përmes ndryshimeve të vogla.

Teoria e Darvinit nuk u bazua në ndonjë gjetje konkrete shkencore; siç pranoi edhe ai, ishte thjesht një "supozim". Për më tepër, siç rrëfeu Darvini në kapitullin e gjatë të librit të tij të titulluar, "Vështirësitë në teori", teoria dështoi përballë shumë pyetjeve kritike.

Darvini investoi të gjitha shpresat e tij në zbulimet e reja shkencore, të cilat ai priste që do t'i zgjidhnin këto vështirësi. Ai e tregoi këtë pritje pambarim në librin e tij. Sidoqoftë, në kundërshtim me pritjet e tij, gjetjet shkencore zgjeruan dimensionet e këtyre vështirësive dhe hodhën poshtë supozimet themelore të teorisë një nga një.

Humbja e Darvinizmit përballë shkencës mund të rishikohet nën tre tituj bazë:

1) Teoria nuk mund të shpjegojë se si lindi jeta në Tokë.

2) Nuk ka asnjë zbulim shkencor që tregon se "mekanizmat evolucionarë" të propozuar nga teoria kanë ndonjë fuqi evolucionare.

3) Të dhënat përmes fosileve dëshmojnë të kundërtën e asaj që sugjeron teoria.

Në këtë pjesë, ne do të shqyrtojmë këto tri pika themelore në skica të përgjithshme:

Hapi i parë i pakapërcyeshëm: Origjina e jetës

Teoria e evolucionit supozon se të gjitha speciet e gjalla kanë evoluar nga një qelizë e vetme e gjallë që doli rastësisht në Tokë 3.8 miliardë vite më parë, gjoja se ishte shfaqur si rezultat i rastësive. Si një qelizë që përfshin një gamë të gjerë organelesh si vakuola, mitokondri, lizozome dhe aparate Golgi mund të ekzistojë në një pellg balte, si një qelizë e vetme dhe mund të gjenerojë miliona specie komplekse të gjalla dhe nëse vërtet ka ndodhur një evolucion i tillë, pse gjurmët e tij nuk mund të vërehen në të dhënat e fosileve, këto janë vetëm disa nga pyetjet të cilave teoria e evolucionit nuk mund t'u japë përgjigje. Sidoqoftë, para së gjithash, ne duhet të përqëndrohemi në hapin e parë të procesit të supozuar evolucionar. Si lindi "qeliza e parë" e lartpërmendur?

Meqenëse teoria e evolucionit mohon me injorancë Krijimin, ajo pohon se "qeliza e parë" ka origjinën tek një produkt i cili vie nga rastësia brenda ligjeve të natyrës, pa ndonjë plan apo rregullim. Sipas teorisë, materia e pajetë duhet të ketë prodhuar rastësisht një qelizë të gjallë nga hiçi. Një pretendim i tillë, është në kundërshtim me të gjithë e biologjisë.

"Jeta vie nga e gjalla"

Në librin e tij, Darvini kurrë nuk iu referua origjinës së jetës. Kjo ndodh sepse kuptimi primitiv i shkencës në kohën e tij bazohej në supozimin se qeniet e gjalla kishin një strukturë shumë të thjeshtë. Që nga kohët mesjetare, brezi spontan, i cili pohon se materialet jo të gjalla u bashkuan për të formuar organizma të gjallë, ishte pranuar gjerësisht. Në atë periudhë, zakonisht besohej se insektet u krijuan nga mbetjet e ushqimit, dhe minjtë nga gruri. Janë kryer eksperimente interesante për të vërtetuar këtë teori. Disa grurë u vendosën në një copë pëlhure të ndyrë dhe besohej se minjtë do të buronin prej saj pas një kohe.

Në mënyrë të ngjashme, krimbat që zhvillohen në mishin e kalbur supozoheshin se ishin dëshmi të jetës që buronte nga materia e pajetë. Mirëpo, **më vonë u kuptua se krimbat nuk u shfaqën në mish spontanisht, por u bartën atje nga mizat në formën e larvave, të padukshme për syrin e lirë.** Në kohën kur Darvini shkroi Origjinën e Specieve, besimi se bakteret mund të lindnin nga materia jo e gjallë u pranua gjerësisht në botën e shkencës.

Sidoqoftë, **pesë vite pas botimit të librit të Darvinit, Louis Pasteur shpalli rezultatet e tij, pas studimeve dhe eksperimenteve të gjata, të cilat mohuan gjenerimin spontan, gur themelin e teorisë së Darvinit. Në ligjëratën e tij triumfale në Sorbonne në vitin 1864, Pasteur theksoi: "Kurrë doktrina e brezit spontan nuk do të shërohet nga goditja vdekjeprurëse e këtij eksperimenti të thjeshtë."** (Sidney Fox, Klaus Dose, Molecular Evolution dhe Origjina e Jetës, W. H. Freeman and Company, San Francisco, 1972, fq. 4.)

Për një kohë të gjatë, avokatët e teorisë së evolucionit u rezistuan gjetjeve të Pasteur. Sidoqoftë, ndërsa zhvillimi i shkencës zbuloi strukturën komplekse të qelizës së një qenieje të gjallë, ideja se jeta mund të lindte rastësisht u përball me një ngërç edhe më të madh.

Përpyekjet e kota në Shekullin XX

Evolucionisti i parë që mori për shtjellim temën e origjinës së jetës në shekullin XX ishte biologu i njohur rus Alexander Oparin. Me tezat e ndryshme që ai i parashtrroi në vitet 1930, ai u përpoq të dëshmonte se një qelizë e gjallë mund të fillonte rastësisht. Mirëpo, këto studime ishin të predestinuara për dështim dhe Oparin duhej të bënte rrëfimin në vijim:

Fatkeqësisht, problemi i origjinës së qelizës është ndoshta pika më e errët në të gjithë studimin e evolucionit të organizmave. (Alexander I. Oparin, Origjina e Jetës, Dover Publications, New York, 1936, 1953 dhe 2003 (rieditim), fq. 196)

Pasuesit evolucionistë të Oparinit u përpoqën të kryenin eksperimente për të zgjidhur këtë problem. Eksperimenti më i njohur u krye nga kimisti amerikan Stanley Miller në vitin 1953. Duke kombinuar ato gazra që ai pretendonte se ekzistonin në atmosferën fillestare të Tokës në një përbërje eksperimentale dhe duke shtuar energji në përzierje, Miller sintetizoi disa molekula organike (aminoacide) të pranishme në strukturën e proteinave.

Vetëm pak vite kishin kaluar para se të zbulohet se ky eksperiment, i cili më pas u paraqit si një hap i rëndësishëm në emër të evolucionit, ishte i pavlefshëm, sepse atmosfera e përdorur në eksperiment ishte shumë e ndryshme nga kushtet e vërteta të Tokës. ("Dëshmi të reja mbi evolucionin e atmosferës dhe jetës së hershme", *Buletini i Shoqërisë Meteorologjike Amerikane*, vëll. 63, nëntor 1982, 1328-1330)

Pas një heshtjeje të gjatë, Miller, vetë rrëfeu se mjedisi i atmosferës që ai përdorte ishte joreal. (Stanley Miller, *Evolucioni Molekulare i Jetës: Statusi Aktual i Sintezës Prebiotike të molekulave të vogla*, 1986, fq. 7)

Të gjitha përpjekjet e evolucionistëve gjatë shekullit të njëzetë për të shpjeguar origjinën e jetës përfunduan në dështim. Gjeokimisti Jeffrey Bada, nga Instituti San Diego Scripps, e pranoi këtë fakt në një artikull të botuar në revistën *Earth* në vitin 1998:

Sot kur lëmë pas shekullin XX, ne ende përballemi me problemin më të madh të pazgjidhur që kishim kur hymë në shekullin XX: Si lindi jeta në Tokë? (Jeffrey Bada, Earth, shkurt 1998, fq. 40)

Struktura komplekse e jetës: As edhe një proteinë e vetme nuk mund të hyjë në ekzistencë rastësisht

Arsyeja kryesore pse evolucionistët përfunduan në një ngërç kaq të madh në lidhje me origjinën e jetës ishte se edhe organizmat të e gjallë të cilën konsiderohen nga Darwinistët të thjeshtë kanë veçori jashtëzakonisht komplekse. Qeliza e një qenieje të gjallë është më komplekse se të gjitha produktet tona teknologjike të krijuara nga njeriu. **Sot, edhe në laboratorët më të zhvilluar të botës as edhe një proteinë e vetme e një qelize, e aq më pak një qelizë e gjallë, nuk mund të prodhohet duke sjellë së bashku materie jo të gjalla..**

Kushtet e kërkuara për formimin e një qelize janë shumë më komplekse për tu krijuar thjesht nga rastësia. Andaj, nuk ka nevojë të shpjegohet situata më në detaje. Evolucionistët janë në një rrugë të humbur edhe para se të arrijnë në fazën e qelizës. Kjo ndodh sepse **probabiliteti që vetëm një proteinë e vetme, një bllok ndërtues thelbësor i qelizës, të krijohet rastësisht është matematikisht "0"**.

Arsyeja kryesore për këtë është nevoja që proteinat e tjera të jenë të pranishme nëse do të formohet një proteinë, dhe kjo çrrënjës plotësisht mundësinë e formimit të rastësisë. Ky fakt në vetvete është i mjaftueshëm për të eliminuar pretendimin evolucionist të rastësisë që në fillim. Për të përmbledhur,

1. Proteinat nuk mund të sintetizohen pa enzima, dhe enzimat janë të gjitha proteina.
2. Rreth 60 proteina që marrin detyrën e një enzime duhet të jenë të pranishme që një proteinë e vetme të sintetizohet. Prandaj, proteinat janë thelbësore për ekzistencën e proteinave.
3. ADN-ja prodhon enzimat sintetizuese të proteinave. Proteinat nuk mund të sintetizohen pa ADN. Prandaj ADN-ja është e nevojshme edhe për formimin e proteinave.
4. Të gjitha organelet në qelizë kanë detyra të rëndësishme në sintezën e proteinave. Me fjalë të tjera, që proteinat të formohen, një qelizë e plotë dhe plotësisht funksionale duhet të ekzistojë me të gjitha organelet e saj.

Shkrimtari evolucionist Brian Switek pranoi se origjina e jetës mbetet e pasqaruar nga evolucionistët me fjalët në vijim:

Mënyra se si filloi jeta është një nga misteret e qëndrueshëm të natyrës. (Brian Switek, "Flluska debati mbi origjinën e jetës", Natyrë, 13 shkurt 2012)

Kimisti nga Harvardi George Whitesides bëri rrëfimin e mëposhtëm në fjalimin e tij të pranimit të Medaljes Priestley, çmimi më i lartë i Shoqërisë Kimike Amerikane:

Origjina e Jetës. Ky problem është një nga problemet më të mëdha në shkencë. ... Shumica e kimistëve besojnë, ashtu si edhe unë, se jeta doli spontanisht nga përzierjet e molekulave në Tokën probiotike. Si? Nuk e kam idenë. (George M. Whitesides, "Revolucioni në Kimi: Priestley Medalist George M. Whitesides 'Adresa", Chemical and Engineering News, 85: 12-17, 26 Mars 2007)

Molekula e ADN-së, e vendosur në bërthamën e një qelize dhe e cila ruan informacionin gjenetik, është një bankë e të dhënave madhështore. Nëse informacioni i koduar në ADN do të transkriptohej në letër, do të bënte një bibliotekë gjigante të përbërë nga rreth 900 vëllime me nga 500 faqe secila.

Një pengesë e pakapërcyeshëm shfaqet në këtë pikë për evolucionistët: ADN-ja mund të përsëritet vetëm me ndihmën e disa proteinave (enzimave) të specializuara. Pra, sinteza e këtyre enzimave mund të realizohet vetëm nga informacioni i koduar në ADN. Meqenëse të dy varen nga njëri -tjetri, ato duhet të ekzistojnë në të njëjtën kohë për t'u përsëritur. Kjo rrëzon skenarin ku jeta filloi në vetvete në tokë. Profesor Leslie Orgel, evolucionist me reputacion nga Universiteti i San Diego, Kaliforni, e rrëfen këtë fakt në numrin e shtatorit të vitit 1994 të revistës Scientific American:

Është jashtëzakonisht e pamundur që proteinat dhe acidet nukleike, të dyja strukturore komplekse, të lindin spontanisht në të njëjtin vend në të njëjtën kohë. Megjithatë duket gjithashtu e pamundur të kesh njërin pa tjetrën. Dhe kështu, në shikim të parë, dikush mund të konkludoj se jeta, në fakt, nuk mund të ketë origjinën kurrë me mjete kimike. (Leslie E. Orgel, "Origjina e jetës në tokë", Scientific American, vëll. 271, tetor 1994, f. 78.)

Pa dyshim, nëse është e pamundur që jeta të ketë origjinën spontanisht përmes rastësisë së verbër, atëherë duhet pranuar se jeta është krijuar. Ky fakt zhvlerëson në mënyrë eksplicite teorinë e evolucionit, qëllimi kryesor i së cilës është mohimi i Krijimit.

Mekanizmat Imagjinarë të Evolucionit

Pika e dytë e rëndësishme që mohon teorinë e Darvinit është se të dy konceptet e parashtruara nga teoria si "mekanizma evolucionarë" kuptoheshin se nuk kishin, në të vërtetë, fuqi evolucionare.

Darvini e bazoi pohimin e tij të evolucionit tërësisht në mekanizmin e "seleksionimit natyror". Rëndësia që ai i dha këtij mekanizmi ishte e qartë në emrin e librit të tij: *Origjina e Specieve, Me anë të Përzgjedhjes Natyrore...*

Përzgjedhja natyrore thotë se ato gjallesa që janë më të forta dhe më të përshtatshme për kushtet natyrore të habitateve të tyre do të mbijetojnë në luftën për jetën. Për shembull, një tufë drerash kur sulmohen nga kafshët e egra, ato që mund të vrapojnë më shpejt do të mbijetojnë. Prandaj, tufa e drerave do të përbëhet nga individë më të shpejtë dhe më të fortë. Sidoqoftë, pa dyshim, ky mekanizëm nuk do të bëjë që dreri të evoluojë dhe të shndërrohet në një specie tjetër të gjallë, për shembull, kuaj.

Prandaj, mekanizmi i përzgjedhjes natyrore nuk ka fuqi evolucionare. Darvini ishte gjithashtu i vetëdijshëm për këtë fakt dhe duhej ta deklaronte këtë në librin e tij *Origjina e Specieve*:

Përzgjedhja natyrore nuk mund të bëjë asgjë derisa të ndodhin dallime ose ndryshime të favorshme individuale. (Charles Darwin, Origjina e Specieve me anë të përzgjedhjes natyrore, Biblioteka moderne, Nju Jork, fq. 127)

Gabimi i Lamarkut

Pra, si mund të ndodhin këto "ndryshime të favorshme"? Darvini u përpoq t'i përgjigjej kësaj pyetjeje nga pikëpamja primitive e të kuptuarit të shkencës së asaj kohe. Sipas biologut francez Chevalier de Lamarck (1744-1829), i cili jetoi para Darvinit, krijesat e gjalla i kaluan tiparet që fituan gjatë jetës së tyre në brezin e ardhshëm. Ai pohoi se këto tipare, të grumbulluara nga një brez në tjetrin, shkaktojnë formimin e specieve të reja. Për shembull, ai pohoi se gjirafat evoluon nga antilopat; ndërsa ata përpiqeshin të hanin gjethet e pemëve të larta, qafa e tyre u zgjerua brez pas brezi.

Darvini gjithashtu dha shembuj të ngjashëm. Në librin e tij *Origjina e Specieve*, për shembull, ai tha se disa arinj që shkonin në ujë për të gjetur ushqim u shndërruan në balena me kalimin e kohës. (Charles Darwin, *Origjina e Specieve*: Një Faksimile e Botimit të Parë, Shtypi i Universitetit Harvard, 1964, f. 184.)

Mirëpo, ligjet e trashëgimisë të zbuluara nga Gregor Mendel (1822-84) dhe të verifikuara nga shkenca e gjenetikës, e cila lulëzoi në shekullin XX, shkatërruan plotësisht legjendën se tiparet e fituara u kaluan brezave të mëvonshëm. Kështu, seleksionimi natyror u la 'vetëm' dhe rrjedhimisht u bë plotësisht joefektiv si një mekanizëm evolucionar.

Neo-Darvinizmi dhe Mutacionet

Për të gjetur një zgjidhje, Darwinistët përparuan "Teorinë Sintetike Moderne", ose siç njihet më tepër, Neo-Darvinizmin, në fund të viteve 1930. Neo-Darvinizmi shtoi mutacione, të cilat janë shtrembërime të formuara në gjenet e qenieve të gjalla për shkak të faktorëve të tillë të jashtëm si rrezatimi ose gabimet e replikimit, si "shkak i ndryshimeve të favorshme" përveç seleksionimit natyror.

Sot, modeli që përkrahin darvinistët, pavarësisht se janë të vetëdijshëm për pavlefshmërinë shkencore, është Neo-Darvinizmi. Teoria pohon se miliona specie të gjalla u formuan përmes një procesi ku organe të shumta komplekse të këtyre organizmave (p.sh. veshët, sytë, mushkëritë dhe krahët) iu nënshtruan "mutacioneve", domethënë çrregullimeve gjenetike. Megjithatë, ekziston një fakt i plotë shkencor që minon plotësisht këtë teori: **Mutacionet nuk shkaktojnë zhvillimin e qenieve të gjalla; përkundrazi, ato janë gjithmonë të dëmshme.** Imazhet e tmerrshme që u shfaqën pas shpërthimeve bërthamore në Çernobil, Hiroshima dhe Nagasaki janë rezultatet e sakta të shkaktoara nga mutacionet. Organizmat me strukturat e duhura ose vdiqën ose u dëmtuan rëndë nga mutacionet.

Arsyeja për këtë është shumë e thjeshtë: **ADN-ja ka një strukturë shumë komplekse, dhe efektet e rastësishme mund ta dëmtojnë atë.** Gjenetisti amerikan B. G. Ranganathan e shpjegon këtë në vijim:

*Së pari, mutacionet e vërteta janë shumë të rralla në natyrë. Së dyti, shumica e mutacioneve janë të dëmshme pasi ato janë të rastësishme, në vend të ndryshimeve të rregullta në strukturën e gjeneve; çdo ndryshim i rastësishëm në një sistem shumë të rregulluar do të ndikojë për keq, jo për mirë. Për shembull, nëse një tërmet do të trondiste një strukturë të rregulluar siç është një ndërtesë, do të kishte një ndryshim të rastësishëm në kuadrin e ndërtesës i cili, me shumë mundësi, nuk do të ishte një përmirësim. (B. G. Ranganathan, *Origjina?*, *Pensilvania: Flamuri i Trust Trust*, 1988, f. 7.)*

Sipas pretendimeve të darvinistëve, mutacionet duhet të prodhojnë ndryshime proporcionale dhe koherente në të gjithë trupin. Për shembull, sipas pretendimeve të darvinistëve, nëse një vesh formohet në anën e djathtë si rezultat i mutacioneve të rastësishme ashtu siç pretendojnë ata, mutacionet e rastësishme gjithashtu duhet të formojnë një vesh të dytë në anën e majtë që ndan të njëjtën simetri dhe veti, dhe dëgjon po aq mirë. Çekiçi, kudhura dhe shufra duhet të krijohen secila në të njëjtën gjendje të përsosur dhe të barabartë. Mutacionet e rastësishme duhet të formojnë valvulat e zemrës në të dy anët në të njëjtën mënyrë; valvulat dhe veshët e prodhuar nga mutacione të rastësishme duhet të formohen njëkohësisht dhe në mënyrë të barabartë në përputhje me njëra-tjetrën; ato duhet të jenë të përsosura, në vendet e tyre të duhura. Mospërputhje të mëdha do të shfaqeshin nëse kjo simetri dhe rregull nuk mund të mbahej në çdo organ të trupit. Do të shfaqeshin struktura të çuditshme me njërin vesh përmbys, një dhëmb të pazakontë, një sy në ballë ndërsa tjetri në hundë. Por organizmat e gjallë nuk posedojnë një çekuilibër të tillë. Sipas pretendimeve të darvinistëve, gjithçka që formohet nga mutacionet duhet të jetë simetrike dhe e pajtueshme. Sidoqoftë, të gjitha mutacionet janë të dëmshme. Në të kaluarën, supozohej se 99% e mutacioneve ishin të dëmshme ndërsa 1% e mbetur

ishite neutrale. Megjithatë, hulumtimet e reja zbuluan se ato 1% e mutacioneve që ndodhin në ato rajone të ADN-së që nuk kodojnë proteinat dhe që supozoheshin se ishin të padëmshme, janë në fakt të dëmshme në afat të gjatë. Kjo është arsyeja pse shkencëtarët i quajtën këto mutacione si 'mutacione të heshtura'. Është e pamundur që mutacionet absolutisht të dëmshme të formojnë organe racionale, të pajtueshme, simetrike në të njëjtën kohë.

Mutacionet mund të krahasohen me të shtënat në një strukturë të paprekur me një mitraloz. Të shtënat në një objekt të paprekur do të prishin plotësisht strukturën e tij. Një nga plumbat që rezulton i paefektshëm, ose kurimi i një infeksioni ekzistues në trup nuk e ndryshon rezultatin. Organizmi tashmë do të ishte shkatërruar nga 99 plumbat e mbetur që e goditën.

Lynn Margulis, anëtare e Akademisë së Shkencave të ShBA-ve, ka bërë rrëfimin vijim në lidhje me efektet e dukshme të dëmshme të mutacioneve:

Mutacionet e reja nuk krijojnë specie të reja; ata krijojnë pasardhës që janë të dëmtuar. (Lynn Margulis, e cituar në Darryl Madden, UMass Scientist to Lead Debat on the Evolutionary Theory, Brattleboro (Vt.) Reformer, 3 shkurt 2006)

Gjithashtu në një intervistë në vitin 2011, Margulis theksoi faktin se "nuk ka prova" që tregojnë se mutacionet modifikojnë organizmat dhe kështu krijojnë lloje të reja:

Neo-Darvinistët thonë se specie të reja shfaqen kur ndodhin mutacione dhe modifikojnë një organizëm. Unë u mësova pa pushim se akumulimi i mutacioneve të rastësishme çoi në ndryshime evolucionare të çuara në specie të reja. Unë e besova derisa kërkova prova. (Lynn Margulis cituar në "Lynn Margulis: Q + A", Revista Discover, Prill 2011, f. 68)

Siç tha Margulis, nuk ka asnjë dëshmi të vetme që tregon se mutacionet e rastësishme çojnë në ndryshime evolucionare, të cilat nga ana tjetër çojnë në shfaqjen e specieve të reja.

Në të vërtetë, asnjë mutacion përfitues - ai që do të avanconte kodin gjenetik - nuk është vërejtur ndonjëherë. Të gjitha mutacionet janë provuar të jenë të dëmshme. Tani kuptohet se mutacioni, i cili paraqitet si një "mekanizëm evolucionar", është në të vërtetë një dukuri gjenetike që dëmton gjallesat dhe i lë ata të paaftë. (Efekti më i zakonshëm i mutacionit tek qeniet njerëzore është kanceri.) Sigurisht, një mekanizëm destruktiv nuk mund të jetë një "mekanizëm evolucionar". Përzgjedhja natyrore, nga ana tjetër, "nuk mund të bëjë asgjë në vetvete", siç pranoi edhe Darvini. Ky fakt na tregon se **nuk ka "mekanizëm evolucionar" në natyrë**. Meqenëse nuk ka mekanizëm evolucionar, asnjë proces i tillë imagjinar i quajtur "evolucion" nuk mund të ndodhë.

Të dhënat nga fosilet: Asnjë shenjë nga format e ndërmjetme

Të dhënat nga fosilet përbëjnë dëshminë më të qartë që na tregon se skenari i sygjerruar nga teoria evolucioniste nuk ka ndodhur.

Sipas supozimit joshkencor që qëndron pas kësaj teorie, çdo specie e gjallë ka dalë nga një paraardhës. Një specie e mëparshme (evolucionistët ende nuk kanë ofruar një shpjegim se si ka lindur kjo specie) u shndërrua në diçka tjetër me kalimin e kohës dhe të gjitha speciet kanë lindur në këtë mënyrë. Me fjalë të tjera, ky transformim imagjinar zgjati miliona vjet dhe vazhdoi gradualisht.

Nëse do të ishte kështu, specie të panumërta ndërmjetëse duhet të kishin ekzistuar dhe jetuar brenda kësaj periudhe të gjatë transformimi.

Për shembull, disa gjysmë peshq/gjysmë zvarranikë do të kishin jetuar në të kaluarën, të cilët kishin fituar disa tipare zvarranikësh, përveç tipareve të peshkut që kishin tashmë. Ose duhet të kishte ekzistuar disa zogj zvarranikësh, të cilët fituan disa tipare zogjsh përveç tipareve të zvarranikëve që ata tashmë kishin. Meqenëse këto do të ishin në një fazë

kalimtare, ato duhet të jenë qenie me aftësi të kufizuara, të dëmtuara, të gjymta. Evolucionistët i referohen këtyre krijesave imagjinare, për të cilat ata besojnë se kanë jetuar në të kaluarën, si "forma kalimtare".

Nëse kafshë të tilla do të ekzistonin ndonjëherë, do të kishte miliona dhe madje miliarda prej tyre në numër dhe shumëllojshmëri. Më e rëndësishmja, mbetjet e këtyre krijesave të çuditshme duhet të jenë të pranishme në të dhënat fosile. Në Origjinën e Specieve, shpjegoi Darvini:

Nëse teoria ime është e vërtetë, varietete të ndërmjetme të panumërta, që lidhin më së afërmi të gjitha llojet e të njëjtit grup së bashku duhet të kenë ekzistuar me siguri ... Rrjedhimisht, dëshmitë e ekzistencës së tyre të mëparshme mund të gjenden vetëm midis mbetjeve fosile ... (Charles Darwin, Origjina e Specieve, Nju Jork: D. Appleton and Company. F. 161)

Mirëpo, Darvini, pasi kishte shkruar këto rreshta, ishte gjithashtu i vetëdijshëm për faktin se ende nuk ishin gjetur fosile të këtyre formave të ndërmjetme. Ai e konsideroi këtë si një vështirësi të madhe për teorinë e tij. Kjo është arsyeja se pse, në një kapitull të librit të tij të titulluar "Vështirësitë në teori", ai shkroi:

Së pari, pse, nëse speciet kanë zbritur nga speciet e tjera me gradacione tepër të imëta, a nuk shohim kudo forma kalimtare të panumërta? Pse nuk është konfuzion kjo në natyrë për speciet, siç i shohim, të jenë të përcaktuara mirë? Por, meqë sipas kësaj teorie duhet të kenë ekzistuar forma kalimtare të panumërta, pse nuk i gjejmë të ngulitura në numër të panumërt në koren e tokës? ... (Charles Darwin, Origjina e Specieve, Nju Jork: D. Appleton dhe Company. Fq. .154, 155)

Pse atëherë nuk është çdo formacion gjeologjik dhe çdo shtresë e mbushur me lidhje të tilla të ndërmjetme? (Charles Darwin, Origjina e Specieve, New York: D. Appleton and Company. F. 246)

Shpresat e shkatërruara të Darvinit

Sidoqoftë, megjithëse evolucionistët kanë bërë përpjekje të mëdha për të gjetur fosile që nga mesi i shekullit të nëntëmbëdhjetë në të gjithë botën, **asnjë formë kalimtare ende nuk është zbuluar**. Të gjitha fosilet, në kundërshtim me pritjet e evolucionistëve, **tregojnë se jeta u shfaq në Tokë krejt papritur dhe plotësisht e formuar**.

Paleontologu i njohur britanik, Derek V. Ager, e pranon këtë fakt, edhe pse është evolucionist:

